



This project is funded  
by the European Union



QENDRA E SHËRBIMEVE  
DHE PRAKTIKAVE LIGJORE TË INTEGRUARA  
CENTRE OF INTEGRATED LEGAL SERVICES AND PRACTICES



**Save the Children**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

# **RAPORT**

## **KRIJIMI DHE FUNKSIONIMI I ORGANEVE TË REJA TË QEVERISJES SË DREJTËSISË**

**Referuar gjetjeve të monitorimit  
në periudhën Prill 2018 – Mars 2019**

Ky raport u përgatit nga Komitetit Shqiptar i Helsinkit (KShH) në kuadër të nismës “Për të rritur pavarësinë, llogaridhënien, transparencën dhe efikasitetin e institucioneve të reja të qeverisjes të drejtësisë”, pjesë e skemës së granteve të projektit “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e KShH-së dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Save the Children.

#### **Përgatitën:**

1. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e KShH-së
2. Emidio Tedeschini, Ekspert i jashtëm i KShH-së
3. Fjoralba Caka, Eksperte e jashtme e KShH-së

#### **Kontribuuan në realizimin e raportit:**

4. Dr. Rainer Deville, Ekspert i jashtëm i KShH-së
5. Migena Kondo, Eksperte e jashtme e KShH-së
6. Armand Sokoli, Ekspert i jashtëm i KShH-së
7. Ardita Kolmarku, Juriste/Asistente Projektsh pranë KShH-së
8. Alketa Vushaj, Juriste pranë KShH-së
9. Arisa Shkrepi, Eksperte e jashtme e KShH-së

#### **Rishikoi:**

1. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

**Autor:** ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”  
Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania  
Kutia Postare nr.1752  
Tel: 04 2233671  
Mob: 0694075732  
E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al);  
Web site: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)**

## PËRMBAJTJE E LËNDËS

Listë shkurtimesh .....	4
Hyrje .....	5
FJALA PËRSHËNDETËSE NGA PROKURORI I PËRGJITHSHËM, ZNJ. ARTA MARKU .....	7
FJALA PËRSHËNDETËSE NGA KRYETARJA E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, ZNJ. NAUREDA LLAGAMI .....	9
FJALA PËRSHËNDETËSE NGA KRYETARI I KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI, Z. ARDIAN DVORANI .....	10
FJALA PËRSHËNDETËSE NGA AVOKATI I POPULLIT, ZNJ. ERINDA BALLANCA .....	12
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	14
KAPITULLI I - MONITORIMI I NGRITJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË .....	28
1. PËRZGJEDHJA DHE EMËRIMI I ANËTARËVE JO MAGJISTRATË NË DY KËSHILLAT .....	29
1.1 Anëtarët jo magjistratë nga radhët e avokatisë .....	29
1.2 Anëtarët jo magjistratë nga trupa e fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës .....	38
1.3 Anëtarët jo magjistratë nga radhët e Shoqërisë Civile .....	46
2. PËRZGJEDHJA DHE EMËRIMI I ANËTARËVE MAGJISTRATË NË DY KËSHILLAT .....	58
2.1 Procedurat e ndjekura për anëtarët prokurorë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë .....	58
2.2 Procedurat e ndjekura për anëtarët gjyqtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor .....	65
KAPITULLI II - MONITORIMI I KOMPETENCAVE TRANZITORE TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË .....	74
1. Organizimi dhe funksionimi i KLD-së .....	75
2. Kompetencat tranzitore të KLD sipas legjislacionit të ri të reformës në drejtësi .....	78
3. Analizë e monitorimit të vendimmarrjes tranzitore të KLD .....	80
3.1 Emërimi i magjistratëve sipas nenit 160, pika 1, gërma “a” e ligjit nr.96/2016 .....	81
3.2 Caktimi në pozicion i magjistratëve sipas nenit 160, pika 2, gërma “b” e ligjit nr.96/2016 .....	84
3.3. Vendosja e masave disiplinore sipas nenit 160, pika 1, gërma “c” e ligjit nr.96/2016 .....	87
3.4. Pezullim i gjyqtarëve, sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në nenin 160, pika 1, gërma “ç” e ligjit nr.96/2016 .....	93
3.5. Vlerësimi i punës së gjyqtarëve dhe ofrimi i ndihmës në rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve .....	94
3.6. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve për plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata dhe caktimi i përkohshëm i gjyqtarëve në institucionet e drejtësisë .....	96
KAPITULLI III - MONITORIMI I KOMPETENCAVE TRANZITORE TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME .....	99
1. Prokuroria para Reformës në Drejtësi .....	100
2. Prokuroria pas Reformës në Drejtësi .....	101
3. Vendimet e Prokurorit të Përgjithshëm gjatë periudhës tranzitore .....	102
4. Ankimi i vendimeve të Prokurorit të Përgjithshëm në rrugë gjyqësore .....	105
5. Debati publik dhe mediatik për vendimmarrjen tranzitore të Prokurorit të Përgjithshëm .....	107
KAPITULLI IV - MONITORIMI I MBLEDHJEVE TË KLGJ-SË DHE KLP-SË .....	108
1. Fillimi i funksionimit të dy Këshillave (KLP dhe KLGJ) .....	109
2. Pajisja e Këshillave me infrastrukturë, buxhet dhe personelin e nevojshëm .....	110
3. Objekti i veprimtarisë së deritanishme të Këshillave referuar kompetencave të parashikuara nga ligji nr. 115/2016 .....	112
4. Natyra e diskutimeve të anëtarëve të Këshillave, në optikën e monitorimit të KShH-së .....	117
5. Raportet midis anëtarëve magjistratë dhe atyre jomagjistratë në vendimmarrjet e Këshillave ..	117
6. Çështjet e debatueshme nga Këshillat në drejtim të qartësisë, plotësisë dhe unitetit të formulimit të dispozitave të ligjit nr. 115/2016 .....	118
7. Transparenca e Këshillave kundrejt medias dhe vëzhguesve të autorizuar .....	119
KAPITULLI V - MONITORIMI I NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI (KED) .....	122

1. Listat e përgatitura për shortin e vitit 2019.....	123
2. Shorti i hedhur për anëtarët e KED-së për vitin 2019.....	124
3. Funksionimi i KED-së 2019 .....	127
4. Përbërja e KED 2019 dhe procesi i vettingut për kandidatët e saj.....	129
5. Veprimtaria e deritanishme e KED-së 2019 .....	131
6. Miratimi i Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e KED-së .....	136
7. Veprimtaria e Komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit 115/2016, lidhur me monitorimin e KED-së.....	137
<b>KAPITULLI VI - MONITORIMI I PËRZGJEDHJES SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË (ILD) .....</b>	<b>139</b>
1. Baza ligjore për zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë .....	140
2. Kriteret për përzgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë .....	140
3. Procedurat e kandidimit për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.....	141
4. Rivlerësimi kalimtar dhe vlerësimi i kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë .....	142
<b>KAPITULLI VII - REKOMANDIME.....</b>	<b>148</b>

## Listë shkurtimesh

<b>RSH</b>	<b>REPUBLIKA E SHQIPËRISË</b>
<b>KSHH</b>	<b>KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT</b>
<b>KLD</b>	<b>KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË</b>
<b>KLJG</b>	<b>KËSHILLI I LARTË I GJYQËSOR</b>
<b>KLP</b>	<b>KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË</b>
<b>KED</b>	<b>KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI</b>
<b>KPA</b>	<b>KOMISIONI I POSAÇËM I APELIMIT</b>
<b>KPK</b>	<b>KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT</b>
<b>DHKA</b>	<b>DHOMA KOMBËTARE E AVOKATISË</b>
<b>IAL</b>	<b>INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË</b>
<b>ILD</b>	<b>INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË</b>
<b>ONM</b>	<b>OPERACIONI NDËRKOMBËTAR I MONITORIMIT</b>
<b>OJQ</b>	<b>ORGANIZATA JO QEVERITARE</b>
<b>GJ.K</b>	<b>GJYKATA KUSHTETUESE</b>
<b>PP</b>	<b>PROKURORI I PËRGJITHSHËM</b>
<b>GJL</b>	<b>GJYKATA E LARTË</b>
<b>OPDAT</b>	<b>OVERSEAS PROSECUTORIAL DEVELOPMENT ASSISTANCE AND TRAINING</b>
<b>EURALIUS</b>	<b>EU FUNDED PROJECT</b>
<b>KPKM</b>	<b>KOMISIONI I PAVARUR PËR KOORDINIMIN, MONITORIMIN DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT 115/2016</b>

## Hyrje

Të dashur lexues,

Korniza e re kushtetuese dhe ligjore për reformimin e sistemit të drejtësisë, ndër të tjera parashikon organizimin dhe funksionimin e organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, përkatësisht të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe Shkollës së Magjistraturës.

Aspektet themelore të organizimit dhe funksionimit të organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë janë parashikuar në ndryshimet e fundit Kushtetuese të miratuara me ligjin nr.76/2016 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ndërkohë, ligji organik që rregullon në mënyrë më të detajuar parimet dhe rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre është ligji nr.115/2016.

Në përmbushje të misionit të tij, KShH zbatoi nismën “Për të rritur pavarësinë, llogaridhënie, transparencën dhe efikasitetin e institucioneve të reja të qeverisjes të drejtësisë”, si pjesë e skemës së granteve të projektit “Përfshirja Shoqërisë Civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë në Shqipëri”, financuar nga Bashkimi European dhe zbatuar nga Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara. Projekti është zbatuar gjatë periudhës Prill 2018 – Maj 2019.

Ky botim realizohet si pjesë e nismës së sipërpërmendur, duke evidentuar dhe analizuar aspektet më të rëndësishme të ngritjes dhe funksionimit të organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Raporti është konceptuar dhe projektuar mbi 6 shtylla kryesore, të cilat kanë të bëjnë me ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe atij të Prokurorisë, ushtrimin e kompetencave tranzitore nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm, veprimtarinë e deritanishme e të dy Këshillave, ngritjen dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KShH në sajë të një metodologjie pune të hartuar nga ekspertë të fushës, ka përpunuar dhe analizuar në këtë botim të dhëna cilësore dhe sasore për ngritjen dhe funksionimin e pesë institucioneve të reja të qeverisjes së drejtësisë. Në fokus të analizës janë aspekte të ndryshme të ngritjes së organeve këtyre organeve, si transparenca karshi publikut, meritokracia dhe profili publik i kandidatëve që garuan për këto organe, përgjegjshmëria e institucioneve të angazhuara me procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të tyre, respektimi i procedurave të parashikuara në ligj dhe efikasiteti i tyre, etj. Gjithashtu, në fokus të analizës është funksionimi i këtyre organeve për pajisjen me infrastrukturë, buxhet dhe personel të tyre, përmbushjen e kompetencave ligjore që ju akordon legjislacioni i ri i reformës në drejtësi, konsistencën e praktikës në zbatimin e legjislacionit, qartësia dhe kuptueshmëria e tij, dinamika e veprimtarisë së këtyre institucioneve dhe prioritarizimi i çështjeve sipas natyrës dhe rëndësisë së tyre, etj. Ekspertët monitorues të KShH-së kanë përdorur një sërë burimesh informacioni për pasqyrimin e të dhënave dhe analizën e tyre në këtë botim, të tilla si faqet zyrtare të institucioneve përkatëse, media, korrespondenca e realizuar nga KShH me një sërë institucionesh përgjegjëse për zbatimin e reformës në sistemin e drejtësisë, përfshi këtu edhe organet e reja të qeverisjes së drejtësisë.

Duke qenë se në fokus të nismës tonë ishte monitorimi i institucioneve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ky botim nuk përmban të dhëna mbi funksionimin e Shkollës së Magjistraturës sipas legjislacionit të ri të drejtësisë. Megjithatë, KShH vlerëson funksionet e rëndësishme të Shkollës së Magjistraturës, e cila siguron formimin profesional të magjistratëve. Gjithashtu vlerësojmë peshën që ka mbajtur ky institucion dhe kontributin e dhënë përgjatë rrugëtimit të deritanishëm të reformës në sistemin e drejtësisë.

Para finalizimit të tij, gjetjet dhe konkluzionet kryesore të raportit në variantin draft të tij janë konsultuar në një tryezë diskutimi me një sërë aktorësh, përfaqësues të institucioneve të monitoruara, përfaqësues të shoqërisë civile, juristë të fushës, etj. Gjithashtu, drafti i plotë i raportit i është dërguar

më vonë për konsultim të gjitha institucioneve të monitoruara, si edhe institucioneve të vettingut dhe komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016. Kërkesës me shkrim për konsultimin e raportit i janë përgjigjur disa prej institucioneve, përkatësisht Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe komisioni i pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr.115/2016. Gjatë finalizimit të raportit të monitorimit, KShH ka reflektuar ato vërejtje dhe sugjerime të këtyre institucioneve, të cilat janë vlerësuar të arsyeshme. Por edhe për sugjerimet e tjera të natyrës parimore, KShH, me transparencë i ka reflektuar ato duke paraqitur vlerësimin e tij të kundërt.

Në përfundim dëshirojmë të falënderojmë për kontributin për zbatimin e kësaj nisme, stafin ekzekutiv të KShH-së, këshilltarin ligjor Z. Niazi Jaho, koordinatoren e projektit Valmira Kallushi, ekspertët ndërkombëtarë, Dr. Rainer Deville dhe Irina Kotenko të angazhuar në përgatitjen e metodologjisë, ekspertët vendas të angazhuar në monitorim, Emidio Tedeschini, Fjoralba Caka, Migena Kondo, Armand Sokoli, Ardita Kolmarku dhe Alketa Vushaj. Dëshirojmë të falënderojmë ato institucione të drejtësisë që janë treguar të hapura në shkëmbimin e korrespondencave dhe dhënien e informacionit të kërkuar në kuadër të kësaj nisme.

Një falënderim i veçantë shkon për donatorët që mbështetën financiarisht këtë nismë, Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Duke ju uruar lexim të mbarë të raportit!

**Erida Skëndaj,**

**Drejtoreshë Ekzekutive  
Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

## **FJALA PËRSHËNDETËSE NGA PROKURORI I PËRGJITHSHËM, ZNJ. ARTA MARKU**

Ndihem me të vërtetë e nderuar që jam pjesë e kësaj tryeze dhe që marr pjesë në një diskutim që në fakt na prek të gjithëve. Siç e dini, që nga miratimi dhe hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese fillimisht, dhe më pas miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjeve kryesore pjesë e paketës së reformës në drejtësi e deri në krijimin e institucioneve të reja të drejtësisë, kaloi një kohë relativisht e gjatë, prej rreth 2 vitesh.

1. Gjatë kësaj kohe, u krijuan komisionet që do të bënin rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe, pas disa muajsh filluan funksionimin.
2. Filloi procesi i rivlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët që kishin aplikuar për të qenë pjesë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë e Prokurorisë apo, si rezultat i shortit, ishin bërë pjesë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
3. Sapo ky proces mbaroi dhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit u dërguan listat me prokurorët dhe gjyqtarët që kishin kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, nga Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm, u thirrën Mbledhjet e Përgjithshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të zgjedhur anëtarët gjyqtarë dhe prokurorë të Këshillave. Të dyja mbledhjet u realizuan me sukses dhe nuk pati ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kështu, pak ditë pas mbledhjes, në fund të Dhjetorit 2018, Këshillat u krijuan dhe filluan të funksionojnë, duke shënuar kështu ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të para, të reja të drejtësisë.
5. Që nga 1 Janari i këtij viti, ka filluar funksionimin Këshilli i Përkohshëm i Emërimeve në Drejtësi, dhe kanë filluar procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë e Drejtësisë.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm që çdo reformë merr kohën e saj për t'u implementuar, aq më tepër kur është rrënjësore, siç është në fakt reforma në drejtësi.

Të gjitha institucionet e reja që janë ngritur kanë marrë kohën e tyre deri në fillimin e funksionimit, por kjo fazë tashmë është kapërcyer dhe Këshillat janë në fazën e përzgjedhjes së kandidatëve për SPAK dhe për Gjykatën kundër Korrupsionit.

Së shpejti do të kemi edhe Gjykatën Kushtetuese funksionale, pa të cilën nuk mund të kuptohet ekzistenca e një shteti ligjor.

Rëndësi shumë të madhe paraqet edhe përzgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pa të cilin nuk mund të kuptohet funksionimi i sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë. Mekanizmat e kontrollit disiplinor janë një garanci në funksion të një veprimtarie të përgjegjshme të funksioneve të sistemit të drejtësisë.

Mungesa e ILD dhe boshllëku ligjor i krijuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar të gjitha dispozitat që përcaktonin se cilat sjellje të magistratëve përbënin shkelje disiplinore, kanë qenë një handicap gjatë gjithë kësaj periudhe të implementimit të reformës në drejtësi.

Të gjitha këto janë konstatime të bëra jo nga dikush që në distancë vëzhgon mënyrën se si po funksionojnë institucionet e reja të drejtësisë dhe i gjithë sistemi i drejtësisë, janë konstatime të bëra duke qenë pjesë e sistemit, duke prekur përditë problematikat e krijuara.

Gjatë gjithë kësaj periudhe, një rol të veçantë në funksionimin e sistemit të prokurorisë ka pasur Prokurori i Përgjithshëm, që përveç kompetencave të zakonshme, ka pasur edhe disa kompetenca të



përcaktuara me një dispozitë tranzitore deri në krijimin e KLP-së dhe vazhdon të ketë kompetenca për të kryer hetim disiplinor deri në krijimin e ILD-së.

Pra, pavarësisht se KLP-ja ende nuk ishte krijuar, vlerësimi i prokurorëve në funksion të Organeve të Vettingut, është bërë nga Prokurori i Përgjithshëm dhe stafi i tij. Po kështu, prej Prokurorit të Përgjithshëm janë kryer caktime të përkohshme të prokurorëve dhe të drejtuesve të prokurorive sipas nevojave. Me krijimin e KLP-së, këto kompetenca janë ekskluzive të këtij Këshilli.

Për ta mbyllur, mendoj se si institucionet ekzistuese, si ato të reja, kanë rolin e tyre thelbësor në funksionimin e mekanizmit të reformës në drejtësi, dhe nuk mund të funksionojnë të shkëputura nëse synojnë të kenë një veprimtari të suksesshme.

Ju falënderoj për vëmendjen.

## **FJALA PËRSHËNDETËSE NGA KRYETARJA E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, ZNJ. NAUREDA LLAGAMI**

Në radhë të parë faleminderit organizatorëve për ftesën. Të them të drejtën unë e kam lexuar me shumë kujdes draft-raportin dhe pa diskutim dua t'ju përgëzoj për punën e kryer në një kohë kaq të shkurtër dhe kaq të ngjeshur me aktivitete si nga ana institucioneve të reja dhe aktiviteteve që lidhen me reformën në drejtësi. Mendoj se ky raport është një fillim i mirë dhe shpresoj se dokumentimi i disa nga proceseve, diskutimeve, vendimmarrjeve dhe risive do t'i shërbejnë një analize më të thelluar drejt nxjerrjes së mësimëve të dobishme për të ardhmen.

Duke qenë se unë vet jam kontributi i shoqërisë civile në këto institucione të drejtësisë, unë jam shumë e ndërgjegjshme që transparenca është më e lehtë për t'u thënë sesa për tu bërë. Gjithashtu transparenca nuk është vetëm e mjaftueshme, ajo duhet shoqëruar me përgjegjshmëri, llogaridhënie në lidhje me vendimmarrjet tona, respektimi i kornizave ligjore pra frymës së ligjit, kushteve dhe mundësive reale në të cilat ne ndodhemi. Pra e thënë ndryshe transparenca duhet të jetë reale dhe jo thjesht formale. Ne jemi munduar që transparencën ta kemi në cilësi dhe jo vetëm në sasi.

Ne kemi ndjekur (kur flas ne, flas në emër të Këshillit të Lartë Gjyqësor) një logjikë në bërjen e transparencës duke balancuar interesin publik për informacionin në lidhje me veprimtarinë e Këshillit me kushtet tona fizike, kapacitetet infrastrukturore dhe burimet njerëzore, për të balancuar nevojën për transparencë me nevojën për të krijuar besim tek publiku, nevojën për të vepruar më shpejt me atë për të vepruar drejt. Krahas çështjeve urgjente që lidhen me funksionimin e gjykatave, shkollës së magistraturës, fillimit të punës për ngritjen e gjykatave të posaçme antikorrupsion dhe kundër krimit të organizuar, këshilli ka punuar fort për ngritjen e një baze të shëndoshë vendimmarrje mbi bazën e rregullave dhe kritereve të cilat sigurojnë paanshmëri dhe transparencë, siç është edhe rasti i skemës së delegimeve dhe caktimit të gjyqtarëve nëpër çështje të veçanta.

Meqenëse e keni ngritur edhe ju si shqetësim dhe unë e vlerësoj shumë, listën e prioriteteve, hartimit nga ana e Këshillit të listës së prioriteteve, unë dua t'ju informoj se aktualisht Këshilli është duke punuar me këtë listë të prioriteteve, duke menduar strategjikisht se kush do të jetë kjo listë e prioriteteve. Në këtë proces të hartimit të planit strategjik të Këshillit janë hartuar lista e prioriteteve në qasje dhe me strategjinë ndër sektoriale të drejtësisë dhe shumë shpejt ky lloj plani strategjik do të dalë me të gjithë aktorët kontribuues në reformën në drejtësi.

Së fundmi do doja në fakt të jepja disa sugjerime të paktën për draft-raportin që është ndarë me mua.

Së pari do të dëshiroja që të kemi një reflektim më të thellë për sa i përket konstatimit dhe dokumentimit. Unë shoh në këtë raport si një hap të parë i cili duhet të ndiqet me një analizë më cilësore përveç diskutimeve me aktorët institucional, ekspertët vendor dhe institucional.

Së dyti, ndoshta dhe për hir të qartësisë së lexuesve do të sugjeroja që vendimmarrjet e këshillave të trajtoheshin ndryshe, kur flasim për Këshillin e Prokurorisë dhe Këshillin e Gjyqësorit.

Së treti në fakt, do të ishte shumë e nevojshme që raporte të tilla të kishin pak edhe një qasje të këndvështrimit gjinor. Pra për herë të parë ne duhet ta pranojmë që në institucionet e drejtësisë shqiptare kemi një pjesëmarrje të konsiderueshme të grave në nivelet më të larta të sistemit të drejtësisë. Mendoj që ky ka qenë një nga kontributet, le të themi një punë shumë e madhe dhe disavjeçare nga ana e shoqërisë civile.

Me këtë fjalë, unë dua ta mbyll duke ju falënderuar shumë për mbështetjen dhe për këtë bashkëpunim të frytshëm.

## **FJALA PËRSHËNDETËSE NGA KRYETARI I KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI, Z. ARDIAN DVORANI**

Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni të falënderoj organizatorët dhe zbatuesit e projektit për pjesëmarrjen në këtë veprimtari, të cilin e vlerësoj me shumë interesa jo vetëm nisur nga tematikat por edhe për çështje që kanë të bëjnë me krijimin dhe funksionimin e organeve të reja të qeverisjes së drejtësisë. Vërej se janë ftuar dhe marrin pjesë përfaqësues të organeve të reja të qeverisjes së drejtësisë të cilët kanë përgjegjësinë të jetësojnë parashikimet e reja kushtetuese ligjore dhe pritshmërinë e të gjithëve për rezultatet e reformës në drejtësi. Ndërkohë që për shkak jo të pak faktorëve por edhe të zhvillimeve dhe që pak kanë të bëjnë me përmbajtjen, cilësinë dhe plotësinë e paketës legjislative. Këto organe janë përballur dhe po përballen me jo pak sfida dhe problematika kompleksë në drejtim të krijimit, mirëfunksionimit, efektivitetit në veprimtarinë dhe ushtrimin e kompetencave të tyre. Po kështu vërej se janë pjesëmarrës një pjesë e ekspertëve të njohur të sistemit të drejtësisë dhe të së drejtës në përgjithësi dhe ndër kontribuuesit më të rëndësishëm në përgatitjen e analizës mbi gjetjet dëshpëruese mbi sistemin tonë të drejtësisë, të masave që duhet të merreshin dhe që kanë përgatitur paketën legjislative të reformës në drejtësi. Gjithsesi kontributi i tyre sipas mendimit tonë vijon të jetë i domosdoshëm drejt zhvillimeve dhe të fazës aktuale drejt zbatimit të reformës në drejtësi. Po kështu pjesëmarrës janë ekspertë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile veçanërisht të atyre që janë të angazhuar posaçërisht në çështje e reformës në drejtësi dhe monitorimin e natyrës së saj, përfshirë pra edhe çështjet e krijimit dhe mirëfunksionimit të ligjshmërisë, të transparencës dhe llogaridhënies së organeve të reja të drejtësisë. Nuk i shoh pjesëmarrjes por doja t'i evidentoja për rolin e rëndësishëm organizmat ndërkombëtarë ndaj reformave dhe tashmë në procesin e zbatimit të saj. Të nderuar pjesëmarrës natyrisht që unë jam këtu për të dëgjuar dhe për të mbajtur shënim, me interes, gjetjet dhe përfundimet e projekt-raportit të monitorimit mbi krijimin dhe funksionim e organeve të qeverisjes së drejtësisë sikurse dhe diskutimet dhe shkëmbimin e mendimeve që sipas programit parashikohet në projekt-raport. Gjithsesi në mënyrë shumë të përmbledhur do të vlerësoja dhe të ndaja me ju disa momente që lidhen me krijim dhe funksionim e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Është tashmë fakt i njohur se KED nuk ka mundur të mblidhet dhe të funksionojë asnjëherë pas miratimit të reformës në drejtësi pra as këshilli i zgjedhur në vitin 2017 dhe as ai për vitin 2018. Në fakt në vitin 2018 është zhvilluar vetëm një mbledhje dhe trashëgimia e vetme ishte një skicë-projekt me disa rregulla paraprake të brendshme. Ndërsa këshilli i emërimeve aktual ka filluar menjëherë veprimtarinë e tij për të zbatuar kushtetutën dhe ligjin, duke punuar intensivisht për të riparuar sa më parë situatën krejtësisht të pazakontë të krijuar në kushtet kur KED nuk kishte të miratuar as akte ligjore normative që janë të domosdoshme për organizimin e brendshëm si dhe për procedurat e verifikimit të kandidatëve dhe në kushte të llahtarshme ishin krijuar dhe janë prezente vendet vakante në të gjithë përbërjen e gjykatës kushtetuese e cila nuk është funksionale, krahas vakancës së pozicionit kushtetues së inspektorit të lartë të drejtësisë. pas një ndarje intensive përgatitore në grupe punë dhe rreth 16 mbledhjesh plenare të gjata dhe me diskutime të thella në përmbajtje edhe me mbështetjen e pazëvendësueshme të Euralius, në datën 2 prill 2019, KED ka përfunduar ngarkesën nga aktet nënligjore normative pa të cilat nuk mund të kalojë në procesin e shqyrtimit, verifikimit dhe përzgjedhjes së kandidaturave. Kjo është një paketë prej qindra dispozitash që përmbajnë rregulla materiale procedurale të cilat synojnë kryerjen e një procesi shume të kujdesshëm, të detajuar dhe të thelluar verifikimi të kandidatëve, që do të finalizohet me lejimin ose ndalimin e kandidimeve si dhe me një procedurë dhe sistem kriteresh, burimesh shumë të hollësishëm mbi bazën e të cilave këshilli i emërimeve do të evidentojë dhe do të vendosë për renditjen e kandidaturave ekskluzivisht bazuar në meritat profesionale dhe morale. Tashmë mund t'ju informoj, në fakt ne kemi bërë publike nëpërmjet një komunikate për media, që në datën 5 prill 2019, këshilli ka filluar zyrtarisht procesin e verifikimit dhe kontrollit të kandidaturave. Kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese dhe për inspektorë të lartë të drejtësisë janë paraqitur për të kryer procedurat përkatëse dhe këshilli ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer verifikimin e pasurisë, figurës, dinjitetit si dhe të kushteve të tjera ligjore. Vlen të ritheksojmë edhe një herë në

tryezë se ndryshe nga sa artikullohet në ndonjë rast kohët e fundit, procedura e verifikim të kandidatëve nga KED nuk është formale. Krahas studimit të mëtejshëm dhe rigoroz që po bëhet, dokumentacionet që kanë paraqitur vetë kandidatët, këshilli ka filluar dhe tashmë janë në proces ndjekje mbi 2000 veprime kontrolli dhe verifikimesh për kandidatët. Duke ju drejtuar me kërkesa për informacion deri më tani, më shume se 60 institucioneve publike dhe subjekteve private lidhur me të dhëna mbi integritetin pasuror, etik dhe moral të kandidatëve. E gjithë kjo veprimtari e Këshillit të Lartë të Drejtësisë po zhvillohet pavarësisht nga kontrollet që do të kryhen dhe janë duke kryer institucionet e tjera ligj zbatuese si Inspektoriat i Lartë për Deklarimin e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, prokuroria e përgjithshme dhe organet e tjera ligj zbatuese. Po kështu gjejmë vend të theksojmë në këtë tryezë se veprimtaria aktuale e KED është krejtësisht e pazakontë madje e jashtëzakonshme. Vetë Kushtetuta dhe ligji e përcaktojnë si një organ kolegial që nuk ka organik, struktura organizative sepse parashikohet që për këto aspekte do të mbështetet në burimet njerëzore dhe financiare të Gjykatës së Lartë. Këto përcaktime kushtetuese mbajnë parasysh situata ku rast pas rasti do të lindte nevoja që Këshilli të mblidhej e të kryejë procedurat për ndonjë vend vakant të krijuar dhe për një numër të kufizuar kandidatësh. Ndërkohë Këshilli për vitin 2019 përballet me sfida që janë tej këtyre parashikimeve ligjore dhe njëkohësisht janë krijuar dhe këshilli duhet të procedojë dhe po procedon për të gjitha vendet vakante në gjykatën kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për të cilin kanë paraqitur interesin për të kandiduar me dhjetëra kandidatë. Nga ana tjetër edhe Gjykata e Lartë ku KED duhet të gjejë mbështetjen administrative, po kalon një situatë tejet të pazakontë, ku janë në detyrë 3 nga 19 gjyqtarë dhe ka vetëm 8 nga 30 këshilltarë. Me këtë përbërje edhe gjykata e lartë duhet të përballojë jo vetëm problematikat e saj të panumërta por edhe njëkohësisht duhet të mbështesë veprimtarinë e KED. Kjo gjendje e ka detyruar pashmangshmërisht KED që të përdorë burimet njerëzore dhe mjetet e mundshme dhe të kufizuara në dispozicion, për të realizuar detyrimet e tij njëra pas tjetrës. Natyrisht që kjo gjendje ka ndikuar dhe në pamundësinë objektive që këshilli të përmbushë ,të mos përmbushë disa prej detyrimeve të tij përfshirë për shembull përgatitjen e publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit gjë për të cilën po punohet për ta riparuar gjatë kohës në të ardhmen. Gjithsesi duke njohur situatën e pazakontë të gjendjes së sistemit të drejtësisë, këshilli është tërësisht i angazhuar për të kryer jo vetëm verifikim të thelluar, vlerësim dhe renditje sipas meritave të kandidatëve por edhe kryerjen e këtij procesin për një kohë sa më të shpejt. Kjo shpejtësi do të varet në mënyre vendimtare nga angazhimi, përgjegjshmëria dhe shpejtësia e ngarkimit të institucioneve publike të ngarkuara me detyra kontrolli si dhe nga subjektet private veçanërisht ato të sistemit bankar. Një pjesë e këtyre institucioneve publike dhe subjekteve private tashmë kanë kthyer përgjigje duke dërguar informacionet përkatëse. Nëse ato do t'i përgjigjen kërkesave të këshillit, për të dhënat dhe informacionet e kandidatëve jo vetëm me saktësinë dhe cilësinë që kërkon ligji por edhe me formën më të shpejtë të mundshme edhe këshilli do të ketë mundësinë që javët e ardhshme pse jo edhe brenda muajit Maj të dërgojë para Kuvendit dhe Presidentit listën e kandidatëve mes të cilëve këto institucione janë të detyruara të zgjedhin gjyqtarë të rinj të gjykatës kushtetuese dhe inspektori i lartë i drejtësisë. Së fundmi, në komunikatën e fundit për media që ka bërë këshilli i emërimeve në drejtësi, jo vetëm si detyrim formal ligjor por i kemi bërë thirrje edhe shoqërisë civile, mediave, të gjithë faktorëve të interesuara që t'i përcjellin këshillit të emërimeve në drejtësi informacione që janë të rëndësishme dhe që kanë vlerë për vlerësimin dhe verifikimin e figurës së kandidatëve.

## **FJALA PËRSHËNDETËSE NGA AVOKATI I POPULLIT, ZNJ. ERINDA BALLANCA**

Te nderuar pjesëmarrës!

Në radhë të parë dua të përgëzoj Komitetin Shqiptar të Helsinkit për këtë punë të lavdërueshme që na prezantoi sot.

Besoj nuk ka nevojë të përsëris edhe unë rëndësinë e madhe që reforma në drejtësi ka për vendin tonë dhe për qytetarët. I dëgjova me vëmendje të madhe të gjitha lëvdatat e shkëlqyera që u bënë këtu rreth kësaj iniciative e cila mund të them me bindje ishte jo thjesht e nevojshme, por edhe absolutisht jetike. Bashkohem pa as më të voglin ngurrim me secilin prej atyre që shprehin besimin se rezultatet e saj do të nisin të duken herët a vonë. Gjithsesi jam tek ata që duan t'i shohin këto rezultate më mirë herët, sesa kur të jetë tashmë tepër vonë.

Reforma në Drejtësi do të jetë për shumë kohë mbase ndërhyrja më domethënëse që ne si shqiptarë kemi kryer në sistemin e shtet ndërtimit tonë në demokraci. Si e tillë, ajo do duhej trajtuar mendoj unë me seriozitetin që i takon, jo vetëm gjatë implementimit, por qysh në zanafillë prej konceptimit të saj.

Ndërsa të gjithë jemi dëshmitarë tashmë të procesit të zbatimit të saj, besoj se nuk do të kundërshtohem po të them se pikërisht ky proces, ai i zbatimit të reformës po dëshmohet me shumë më tepër ndërlikime nga sa jo thjesht ishte imagjinuar, por edhe nga sa ishte garantuar në fazën e artikullimit të nevojës për këtë reformë.

Nëse ka një element që besoj mund të biem dakord këtu, ai është fakti se sa më shumë po zgjat procesi i zbatimit të kësaj reforme, aq më i largët duket fundi i saj. Ecja drejt destinacionit ku ishte menduar se do të mbërrishej me implementimin e kësaj reforme, po duket përherë e më e pafundme dhe e mundimshme.

Mirëpo, kam përshtypjen, në një opinion publik të ngopur me retorikën e reformës që do të bëjë mrekullira dhe do të ndryshojë brenda ditës një realitet i cili vërtet kishte nevojë për ndryshim rrënjësor, kjo tej zgjatje pa rezultate konkrete mund të sjellë një efekt krejt të kundërt nga ai që ishte objektivi.

Dhe që të mos e harrojmë, le ta përsërisim: cili ishte rezultati që donim të arrinim me reformën në drejtësi? Të kthenim besimin e humbur te drejtësia apo jo?

Nëse vazhdojnë ndërlikimet e njëpasnjëshme që po lindin gjatë procesit, tej zgjatja, vonesat, mungesa e rezultateve konkrete apo edhe incidente të papëlqyeshme që dëshmojnë për mungesë efikasiteti në zbatimin e saj, atëherë nuk do të mund as të flasim po as të shpresojmë për besueshmëri në sytë e publikut.

Reforma në drejtësi nuk mund të funksionojë si një vijë horizonti e cila është gjithsesi imagjinare dhe nuk mund të arrihet dot sado të rendësh e të lodhesh drejt saj. Ajo gjithashtu nuk duhet të trajtohet sikur të kishim të bënë me një utopi politike e cila ka vlerë vetëm kur konceptohet si një faktor nxitës për të ecur në një drejtim të caktuar por jo si caku vetë.

Unë e përgëzoj Komitetin Shqiptar të Helsinkit për punën e dobishme që na paraqiti këtu me gjetjet e studimit të tyre.

Megjithatë, siç e dini institucioni i Avokatit të Popullit është i kyçur përgjatë gjithë reformës në drejtësi, fillimisht në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve të shoqërisë civile, e mandej edhe si monitorues i zbatimit të reformës.

Unë dua t'ju vë në dijeni të konstatimeve të ekspertëve tanë gjatë procesit të monitorimit të procesit, të cilat do t'i vendosen në dispozicion edhe Kuvendit dhe opinionit publik përmes raportit tonë vjetor.

Nisur nga ndjekja e ritmit të deritanishëm të procesit, vërehet se ritmet me të cilat po zhvillohen seancat dëgjimore (KPK) dhe seancat publike (KPA) janë të ngadalta në raport me numrin total të subjekteve që janë shortuar deri më tani dhe atyre që janë në pritje për t'u shortuar dhe njëkohësisht do t'i nënshtrohen vlerësimit kalimtar nga KPK dhe KPA (nëse ankimohen).

Përkatësisht, deri në Dhjetor 2018, i janë nënshtuar procesit të vlerësimit kalimtar 77 subjekte nga të cilët 42 subjekte janë konfirmuar në detyrë dhe 35 subjekte janë shkarkuar nga detyra. Ndërkohë, 7 subjekteve u është ndërprerë procesi i rivlerësimit, në referim të shkronjës G të Aneksit të Kushtetutës dhe për 8 subjekte është vendosur pushimi i procedimit administrativ. Në rrethin e subjekteve të proceduar rezulton të jenë gjyqtarë, prokurorë, ndihmës ligjore, magjistratë (ish prokuror i përgjithshëm).

Zhvillimi me ritme më të shpejta i këtij procesi, por sigurisht pa cënuar cilësinë e vendimmarrjes së institucioneve të rivlerësimit do të ndihmojë në plotësimin e vendeve vakante në institucionet më të rëndësishme të drejtësisë si dhe zhblokimin e ngërçeve të krijuara.

Në këto kushte, edhe pse efektet e reformës po ndihen, sistemi i drejtësisë po punon në mënyrë të sforcuar deri në rikthimin e tij në identitetin që kjo reformë synon.

Megjithatë, duke qenë një optimiste e pashërueshme, unë besoj se ne gjithsesi kemi mundësi ta shpëtojmë reformën. Për mendimin tim, mënyra e vetme për ta shpëtuar atë është një detoks i detyrueshëm nga gjuha që mbjell pritshmëri jo-realiste.

Ilaçi i vetëm për ta bërë këtë është sinqeriteti. Thamë që rezultati kryesor që synon kjo reformë është besueshmëria. Besueshmëri që themelohet mbi përrallat nuk ka. Me njerëzit duhet folur hapur. Reforma në drejtësi ka nevojë për një narrativë të re të sinqertë e realiste me anë të së cilës të tregohen mundësitë e vërteta të saj si dhe të ri dimensionohen pritshmëritë prej saj.

Unë besoj se kjo është e mundur!

Faleminderit!"

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vendi ynë po kalon një proces të rëndësishëm, sa i takon reformimit të thellë dhe të gjithanshëm të sistemit të drejtësisë. Legjislacioni bazë, amendamentet e kushtetutës dhe ligjet organike të cilat rregullojnë organizimin e gjyqësorit si dhe luftën kundër korrupsionit, u miratuan dhe hynë në fuqi në vitin 2016. Përgatitjet për reformën në drejtësi filluan më herët, në vitin 2014 kur u krijua komisioni parlamentar *ad hoc* për reformën në drejtësi. Dokumenti i parë i Komisionit *ad hoc* ishte analiza e sistemit të drejtësisë, e cila identifikoi problemet më të rëndësishme sa i takon organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë. Bazuar në këto problematika, një grup ekspertësh të nivelit të lartë u angazhuan për të hartuar drejtimet strategjike ku do fokusohet reforma në drejtësi dhe më pas paketën e amendamenteve kushtetuese dhe 7 ligjeve të para bazë organike. Prosesi i hartimit të reformës në drejtësi vlerësohet se është realizuar me përfshirjen e të gjitha forcave politike, ekspertëve juristë të fushës, shoqërisë civile, jetës akademike dhe grupeve të tjera të interesit.

Sot, vëzhguesit pyesin veten a do të kërkonte reforma më tepër kohë dhe një proces konsultimi më afatgjatë? Megjithatë, një farë tendence e përshpejtimit të reformës u kushtëzua nga një sërë problematikash shqetësuese, me të cilat po përballëshin çdo ditë qytetarët e vendit tonë, duke përfshirë perceptimet shqetësuese për nivelin e korrupsionit në vend, zvarritjet dhe padrejtësitë në proceset gjyqësore.

Një sërë rrethanash dhe faktorësh sollën vonesën e zbatimit të reformës në drejtësi, për të paktën 3 vjet. Deri më tani, pavarësisht nga të gjitha vonesat, pengesat dhe sfidat, reforma gjyqësore si e tillë, nuk është ndalur. Reforma në drejtësi vijon të sjellë rezultate sa i takon krijimit dhe funksionimit të organeve të reja të drejtësisë, përfshi këtu edhe organet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë që janë analizuar në këtë botim.

Legjislacioni i ri i drejtësisë parashikoi afate të ngurta, me qëllim që periudha tranzitore e funksionimit të institucioneve ekzistuese deri në ngritjen e institucioneve të reja, të ishte sa më e shkurtër. Këto afate nuk u respektuan. Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, rezultoi që partia që fitoi shumicën e votave në parlament, nuk kishte ndërkohë shumicën e cilësuar prej 3/5-ve të anëtarëve të Kuvendit, për të miratuar apo ndryshuar për shkak të rrethanave të paparashikuara që u diktuan më vonë, ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara në Kushtetutë (Neni 81, pika 2, gërma “a” e kushtetutës). Pas këtyre zgjedhjeve, në vend pati polarizim politik, i cili në momente të caktuara krijoi ngërçe, duke bllokuar përkohësisht hallka të rëndësishme të lidhura me zbatimin e reformës në drejtësi. Mungesa e shumicës së cilësuar për të adresuar vakumin ligjor të krijuar nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese të cilat shfuqizuan disa dispozita të dy ligjeve organike të reformës në drejtësi, ndikoi gjithashtu negativisht në ecurinë e reformës.

Problematika pati gjithashtu në drejtim të garantimit në kohë të burimeve të identifikuar, të përlogaritura dhe të premtuara, të nevojshme për infrastrukturën e domosdoshme të institucioneve të reja të drejtësisë. Faktikisht, pjesa më e madhe e institucioneve të reja, duke përfshirë këtu edhe organet e vettingut u përballën me vështirësi dhe mangësi në këtë drejtim që në muajt e parë të punës së tyre, sa i takon infrastrukturës, buxhetit dhe punonjësve të nevojshëm. E njëjta situatë vlen të përshkruhet për KLGJ-në dhe KLP-në.

Një faktor tjetër ndikues në zbatimin e ngadaltë të të gjithë reformës kanë qenë ritmet jo dinamike të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, disa prej të cilëve ishin njëkohësisht kandidatë për institucionet e reja të qeverisjes së drejtësisë. Megjithatë, numri i katër trupave gjyqësore të shkallës së parë të vettingut (Komisionit të Pavarur të Kualifikimit) vlerësohet nga ekspertët se është i mjaftueshëm. Në periudhën që ky raport studimor mbulon, këto trupa kanë funksionuar me ritme kryesisht të ngadalta, me ndonjë përjashtim në javë apo muaj të caktuar. Shkaku i ritmeve të ngadalta mund të jetë edhe mënyra se si institucionet e tjera që ofrojnë informacion gjatë hetimit administrativ bashkëveprojnë me organet e vettingut, cilësia e informacionit të vendosur në

dispozicion, fakti që këto trupa janë përgjegjëse për një proces të ku parimet kushtetuese dhe të drejtat e çdo prokurori dhe gjyqtari (subjekti) duhet të respektohen. Gjithashtu, shkak ndikues mund të jetë edhe mungesa e përvojës gjyqësore të anëtarëve apo personelit mbështetës të organeve të vettingut.

Sistemi gjyqësor i paplotësuar është një problem i rëndë për Shqipërinë. Duke qenë se një gjyqësor i përbërë nga gjyqtarë dhe prokurorë me probleme me pasuritë, figurën dhe aftësitë profesionale nuk mund të konsiderohet gjyqësor, në legjislacion është parashikuar se gjyqësori duhet të pastrohet së pari dhe pastaj parashikohet ri-ngritja e tij. Pastrimi i sistemit filloi nga gjykatat më të larta, nga ku rezultoi se gati të gjithë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë u shkarkuan dhe një minorancë e tyre u dorëhoqën, ndërkohë që edhe Prokurori i Përgjithshëm dha dorëheqjen gjithashtu. Ky proces kemi mendimin se evidentoi se sa urgjente ishte reforma në drejtësi. Megjithatë, emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj u pengua për shkaqet e analizuar më sipër, duke krijuar një pengesë tjetër të aksesit në drejtësi të qytetarëve në një periudhë të konsiderueshme.

Tashmë ky proces është në fazën ku tre prej institucioneve të rëndësishme të qeverisjes së drejtësisë janë krijuar dhe po ushtrojnë kompetencat e tyre. Përkatësisht këto institucione janë Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2019. Ndërkohë rezultoi që nuk është emëruar ende, organi i katërt i qeverisjes së drejtësisë, i monitoruar nga KShH dhe më konkretisht Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Pa këtë organ, procedimi disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk mund të fillojë dhe rrjedhimisht as të kurorëzohet me një vendim të Këshillave.

Do të jetë puna me ritme dinamike dhe cilësore e këtyre tri organeve të ngritura të qeverisjes së drejtësisë që mund të ndikojë në zhbllokimin e ngërceve të krijuara për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm me mandat të plotë, emërimet në Prokurorinë dhe në Gjykatën e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe të plotësimin të të gjitha vakancave që janë krijuar në nivele të ndryshme të gjyqësorit. Megjithatë, ajo çka është më e rëndësishme në fazën aktuale, në një vend të vogël si Shqipëria ku lidhjet familjare, shoqërore dhe ndikimet politike janë tepër të forta është krijimi i një trupe gjyqtarësh dhe prokurorësh me integritet të lartë moral dhe profesional dhe të paanshëm nga çdo ndërhyrje.

Në vijim, po përcjellim në mënyrë të përmbledhur disa prej gjetjeve më të rëndësishme të këtij raporti, të cilat janë analizuar me në detaje edhe në kapitujt përkatës.

## **1. PËR NGRITJEN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE ATIJ TË PROKURORISË**

Ngërçi i krijuar për ngritjen e dy Këshillave, Këshillit të Lartë Prokurorisë (KLP) dhe atij Gjyqësor (KLGJ) u zhbllokua pas dy viteve e gjysmë nga miratimi i amendamenteve kushtetuese të reformës në drejtësi, konkretisht me realizimin e mbledhjes së prokurorëve dhe gjyqtarëve, përkatësisht në datat 11 dhe 12 Dhjetor 2018.

**a)** Vonesat në fillimin e zbatimit të ligjit të vettingut, ritmet jo dinamike në drejtim të rivlerësimit kalimtar të kandidatëve magistratë (prokurorë dhe gjyqtarë në dy Këshillat), mos kalimi me sukses i vettingut nga disa prej këtyre kandidatëve si dhe vështirësitë e paraqitura në drejtim të gjetjes së kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj, vlerësohen se janë disa nga arsyet që kanë penguar krijimin në kohë të të dy Këshillave.

**b)** Konstatohet se KPK nuk ka arritur të përfundojë rivlerësimin e subjekteve kandidatë për KLP brenda afatit ligjor prej 3 muajsh të parashikuar në ligjin nr.115/2016. Vendimi i KPK-së mbi kandidatin e fundit magistrat që garonte në një prej Këshillave, rezultoi jetë shpallur një vit e gjysmë pas ngritjes së organeve të vettingut, përkatësisht me datë 27 nëntor 2018.



c) Procesi i krijimit dhe funksionimit të strukturave të posaçme të ngarkuara me kompetenca në drejtim të përzgjedhjes dhe emërimit të **anëtarëve jo magjistrat** të KLGJ-së dhe KLP-së (Komisionet Ad Hoc, Nënkomisione parlamentare, Mbledhje, etj.) si dhe përzgjedhja e kandidatëve në radhët e këtyre anëtarëve, u shtri në një kohë që i kapërceu afatet ligjore tranzitore. Ky proces u karakterizua nga vonesa, dhe në disa raste nga mungesa në transparencë dhe zvarritje të mbledhjeve dhe procedurave të ndjekura nga këto struktura.

d) *Ngritja e dy Këshillave të Lartë Gjyqësor dhe atij të Prokurorisë është vonuar edhe për arsye të vështirësive të gjetjes së kandidatit jomagjistrat nga radhët e shoqërisë civile. Komisioni ad hoc i shoqërisë civile, në një periudhë 9 mujore kërkoi 6 herë rihapjen e thirrjes për kandidimin e të interesuarve në KLP, pasi 5 thirrjet e para dështuan për shkak se kandidaturat e paraqitura nuk përmbushnin kriteret ligjore. KShH vëren se pjesa më e madhe e kandidaturave të kualifikuara nga Sekretari i Përgjithshëm nuk kishin përvojë të gjatë dhe të konsiderueshme në organizatat e shoqërisë civile, për fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut. Nga verifikimet e kryera nga ONM për katër kandidatët e KLP-së, vetëm një prej tyre plotëson kushtet ligjore, ndërkohë që kandidatët e tjerë nuk i plotësojnë kushtet.*

e) Transparenca e realizuar nga organet e ngarkuara me përgjegjësi për përzgjedhjen e anëtarëve jomagjistratë është respektuar më së shumti nga Avokati i Popullit. KShH vëren se ka pasur momente të rëndësishme të procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të kandidatëve jo magjistrat të cilat nuk janë bërë publike, si p.sh. mos publikimi i përgjigjeve të Autoritetit të Hapjes së Dosjeve të Ish-Sigurimit të shtetit, mospublikimi i relacioneve të plota të ONM-së për kandidatët, mospublikimi i platformave të tyre, etj. Gjithashtu, nuk vlerësohet e mirë transparenca e organeve propozuese të anëtarëve jomagjistratë si Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Akademia e Shkencave, Fakultetet e Drejtësisë, etj.

f) Të dhënat e publikuara nga institucionet përgjegjëse për profilin dhe përvojat e kandidatëve jomagjistratë kanë qenë të pakta, ndërkohë që platformat e tyre nuk janë publikuar nga institucionet e ngarkuara me përzgjedhjen dhe emërimin e tyre dhe nuk kanë pasur vëmendje nga media. Nga informacioni i publikuar në raportet dhe materialet e strukturave apo institucioneve të përfshira për përzgjedhjen e kandidatëve jomagjistratë, evidentohet në pjesën më të madhe se platformat e tyre në përgjithësi nuk reflektonin objektiva të mirë përcaktuara dhe vizionare.

g) Kemi mendimin që vetë ligji nr.115/2016 parashikon mekanizma jo të domosdoshëm kontrolli dhe vlerësimi të përsëritur të kriterëve profesionale dhe morale të kandidatëve jomagjistratë për anëtarë në dy Këshilla, sikurse është ai që bëhet në faza të ndryshme të procesit, por pak a shumë në të njëjtën mënyrë, nga Komisionet përkatëse Ad-Hoc dhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Dispozitat e ligjit nr.115/2016 të do të sugjeronim të rishikoheshin në të ardhmen, duke parashikuar ngritjen nga Sekretari i Përgjithshëm i mekanizmave ad-hoc të pavarur me natyrë konsultative, për realizimin e këtij procesi. Kjo siguron një përgjegjësi të zgjeruar ndaj institucioneve të cilat kanë rol në emërimin e anëtarëve.

h) Kandidatët jomagjistratë për anëtar në dy Këshilla janë s'kualifikuar kryesisht për mungesën e kriterit të përvojës. Megjithatë i diskutueshëm është edhe fakti i përmbushjes së kriterëve të tjera ligjore, p.sh. për kandidatët nga avokatia të cilët janë emëruar më vonë në Këshilla. Pavarësisht parashikimeve të neneve 19/3/ç dhe 117/3/ç të ligjit nr. 115/2016, mos përmbushja e detyrimeve tatimore ndaj Dhomës së Avokatisë prej tyre nuk është konsideruar si kusht s'kualifikues, por si një mangësi në kriteret.

**i) Mendimi i ONM-së për kandidatët jomagjistratë në dy Këshilla është publikuar pjesërisht në raportin e vlerësimit të kandidatëve, të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.** Sipas informacionit të publikuar në këtë raport, rezulton se për disa kandidatë, ONM ka pasur vërejtje për mos përmbushje kriteresh dhe për platformat e tyre. Këtu bëjnë pjesë edhe disa nga kandidatët që

kanë rezultuar fitues dhe janë emëruar më vonë nga Kuvendi në Këshilla. Relacionet ku janë shfaqur opinionet e ONM-së nuk janë bërë publike.

**j)** Procedura parlamentare për përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve jo magjistratë në të dy Këshillat u shoqërua me debate dhe kundërshti të natyrës politike si dhe shkelje të etikës për sa i takon interpretimit të përvojës profesionale dhe integritetit moral të kandidatëve. Për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm për vendimmarrje në nënkomisionin parlamentar, përzgjedhja ishte rastësore, bazuar në rezultatet e shortit me gogla, duke anashkaluar dialogun konstruktiv për të zgjedhur kandidatët për shkak të meritës së tyre. Kjo praktikë, edhe pse ligjore dhe me natyrë zhblllokuese, e cenon meritokracinë e kandidatëve në këtë proces garues.

**k) Procesi i verifikimit të kandidaturave në radhët e prokurorisë që garonin në KLP dhe të kandidaturave në radhët e gjyqësorit që garonin në KLGJ nuk ishte transparent** për shkak të faktit se Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykata e Lartë nuk publikuan në faqen zyrtare urdhrin për ngritjen e Komisioneve, nuk publikuan raportin mbi verifikimin e përmbushjes së kriterëve nga secili kandidat. Publikimi u realizua vetëm pas mbarimit të verifikimit, duke i mos dhënë mundësi institucioneve të tjera ose OJQ-ve që të marrin pjesë si monitorues në këtë proces.

**l)** Për disa javë, KLP u përball me një vakancë pasi Kolegji i Posaçëm i Apelit shkarkoi nga detyra një prej anëtarëve magjistrat në këtë Këshill, të konfirmuar më herët në detyrë nga KPK. Ky Këshill mund të përballlet me vakanca të tjera pasi për gjysmën e anëtarëve të konfirmuar në detyrë nga KPK, Komisioneri Publik ka ushtruar të drejtën e ankimit në KPA. **Në 9 rastet e shkarkimit të prokurorëve kandidatë në KLP rezulton se shumica dërrmuese e tyre janë penalizuar për shkak të kriterit të pasurisë.**

**m)** Në ndryshim nga KLP, për KLGJ-në, evidentohet se të gjithë anëtarët e zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve janë konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, çka i jep një qëndrueshmëri më të lartë këtij organi. Gjatë garimit të anëtarëve magjistratë në KLGJ, pesë anëtarë janë shkarkuar nga KPK, pasi janë gjetur me probleme sa i takon kriterit të pasurisë. Megjithatë, këta kandidatë janë përjashtuar nga gara edhe pse kanë ushtruar të drejtën e ankimit në KPA, për shkak se ligji nr.115/2016 parashikon një klauzolë të tillë.

**n)** Në ndryshim nga procesi i përzgjedhjes së anëtarëve jomagjistratë për dy Këshillat, i cili parashikon numër minimal kandidatësh për vendet vakante, për kandidatët që vijnë nga gjyqësori dhe prokuroria, ligji nr.115/2016 nuk parashikon kuota minimale, çka e ul parimisht konkurrueshmërinë midis kandidatëve për këto vende. Praktikisht, dy kandidatët nga prokurorët pranë gjykatave të apelit kandidonin për 2 vende vakante në KLP dhe një kandidat nga Gjykata e Lartë garonte për një vend vakant në KLGJ. Përputhja e numrit të kandidatëve me numrin e vendeve vakante nuk mundësoi një garim konkurrues midis këtyre kandidatëve. Megjithatë, është pozitiv fakti që legjislacioni i ri parashikon që anëtarët magjistratë duhet të vijnë nga nivele të ndryshme, çka ul riskun e mbipërfaqësimit të gjyqësorit.

**o)** Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve dhe ajo e Prokurorëve u zhvilluan në klimën e një transparence të lartë për median dhe rrjedhimisht edhe publikun. Platformat e kandidatëve për në këto dy Këshilla u prezantuan përkatësisht në mbledhjet respektive. Në pjesën më të madhe të këtyre platformave u vërejt mungesë e elementëve dhe objektivave vizionarë si dhe përdorimi i një strategjie për të marrë votat e anëtarëve të mbledhjes duke u ndalur më shumë tek problematikat e reformës në sistemin e drejtësisë. Të paktë ishin anëtarët që vendosën një balancë të drejtë midis karrierës meritokratike brenda sistemit gjyqësor si dhe nevojës për rritjen e llogaridhënies dhe të përgjegjësisë të sistemit me anë të dy Këshillave. Kjo mangësi mund të adresohet në të ardhmen.

**p)** Pavarësisht udhëzimeve të dhëna për anëtarët me të drejtë vote, sërish vërehet që 12.7% e votave të anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve kanë qenë të pavlefshme. Ndërkohë,

përqindja e votave të pavlefshme e anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve paraqitet në nivele më të larta, përkatësisht 16.7%. Ky numër është relativisht i lartë, nëse krahasohet me totalin e votave të vlefshme, çka mund të kishte ndikuar në përmbysjen e rezultatit për kandidatë e përzgjedhur për të dy Këshillat, nëse gjyqtarët dhe prokurorët do të kishin respektuar procedurën e votimit.

q) Pesë nga 11 anëtarët e KLGJ-së janë të gjinisë femër, çka krijon një pjesëmarrje të konsiderueshme të gjinisë femër në këtë institucion të rëndësishëm të qeverisjes së gjyqësorit. Përkundrejt këtij konstatimi, gjinia femër është e nënperfaqësuar në KLP, ku vetëm 1 prej 11 anëtarëve është femër.

## 2. MONITORIMI I KOMPETENCAVE TRANZITORE TË KLD-SË

a. Ngritja me vonesë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, passolli funksionimin në mënyrë të sforcuar të KLD-së për gati dy vite e gjysmë pas miratimit të amendamenteve kushtetuese. E diskutueshme është edhe çështja e legjitimitetit të funksionimit të KLD-së, pasi neni 277, pika 1 e Ligjit 115/2016 parashikon se anëtarët e KLD – së qëndrojnë në detyrë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe se mandati i anëtarëve përfundon në ditën kur zgjidhet anëtari i fundit i KLGJ-së, **por në çdo rast jo më vonë se 8 muaj pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese.**

b. KLD ushtroi kompetenca të cilat legjislacioni i ri i kishte reduktuar në periudhën tranzitore të funksionimit të saj ndikuan. Kjo passolli problematika të mirëqeverisjes së pushtetit gjyqësor, i cili u përball me vakancat e krijuara në Gjykatën e Lartë dhe në gjykatat e tjera si pasojë e shkarkimeve apo dorëheqjeve të disa gjyqtarëve për shkak të vettingut.

c. KLD gjatë kësaj periudhe të tej zgjatur tranzitore e ushtroi veprimtarinë e tij në mënyrë të të sforcuar edhe për shkak të përplasjeve, paqartësisë për zbatimin e legjislacionit të ri të drejtësisë dhe vendimmarrjeve të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e disa dispozitave të këtij legjislacioni. Këto kanë krijuar tensione për çështje të rëndësishme të veçantë, midis anëtarëve të këtij Këshilli. Në disa prej mbledhjeve janë vërejtur mendime të ndryshme të anëtarëve të KLD-së, qëndrimet e të cilëve janë ndarë mes anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi dhe/ose Ministri i Drejtësisë të cilët kanë qenë në pakicë dhe anëtarëve që përfaqësonin gjyqësorin, të cilët kanë qenë në shumicë.

d. Në mbledhjen e datës 20 Janar 2017, KLD mori 8 vendime për emërimin Magjistrat të kandidatëve të Shkollës së Magjistraturës (SHM) të diplomuar në 2016. Për të gjithë kandidatët e diplomuar, KLD realizoi emërimin mbështetur në vlerësimin përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës “shumë mirë”, por pa përcaktuar nëse të diplomuarit kanë plotësuar ose jo kriterin ligjor për të pasur nivelin minimal të pikëve (të paktën 70%). Gjithashtu, KLD nuk referon nëse këta kandidatë kanë kaluar testin e kontrollit të pasurisë dhe figurës, kriter tjetër i parashikuar nga ligji nr.96/2016. Shumica e anëtarëve të KLD-së ka vendosur të mos presë raportet e ILDKPKI-së dhe SHISH për këta kandidatë, me arsyetimin se ata do ti nënshtrohen filtrave të vettingut kur të emërohen në detyrë. Gjithashtu, shmangia nga këto filtra sipas tyre është bërë edhe për të respektuar afatin ligjor dy mujor nga hyrja në fuqi e ligjit nr.96/2016.

e. Për shkak të kompetencave të kufizuara tranzitore dhe vonesave në ngritjen e KLGJ-së, u krijuar një ngërç për emërimin e kandidatëve magjistratë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2017 dhe 2018. Nisma ligjore e propozuar nga deputetët e mazhorancës qeverisëse nuk gjeti mbështetjen e shumicës së cilësuar në Kuvend, për më tepër çështja u shoqërua me debate politike. Ky ngërç gjeti zgjidhje me krijimin e KLGJ-së, e cila e adresoi këtë çështje në vendimmarrjet e para të saj.

f. Votimi i anëtarëve të KLD-së për caktimin në pozicion të secilit kandidat për magjistrat të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016, u shoqërua me debate dhe kundërshti në drejtim të leximit dhe interpretimit të legjislacionit të ri të reformës në drejtësi. Për tre kandidatët e diplomuar

në vitin 2016, të cilët kishin shfaqur si preferencë të parë caktimin në pozicion pranë Gjykatave Administrative, shumica e anëtarëve të KLD-së vendosi pro kësaj preference. Anëtarët e KLD-së nuk ju referuan plotësimin ose jo të kriterëve ligjore nga secili kandidat, përkatësisht përvoja e punës të paktën një vit e gjysmë në administratën publike ose të pasurit e rezultateve shumë të mira në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës.

**g.** KLD ka marrë në shqyrtim disa raste të procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve të nisura para se ligji i ri nr.96/2016 të hynte në fuqi, por të cilat nuk kishin përfunduar ende pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në disa raste, pyetjet që anëtarët i drejtuan gjyqtarëve ndaj të cilëve kishte filluar procedimi kishin natyrë ndihmëse dhe nuk reflektuan pozita objektiviteti dhe paanshmërie nga këta anëtarë, çka e paracaktoi qartazi pozitën e tyre para se të votonin.

**h.** Për tre raste ndaj të cilave Ministri i Drejtësisë kishte kërkuar procedim disiplinor ndaj gjyqtarëve, KLD vendosi në Mars të vitit 2017 kundër masave të propozuara, në dy prej të cilave votimi “kundër” ishte unanim. Në një rast, anëtarët e KLD-së referuan se shkeljet e pretenduara ishin të natyrës procedurale për një proces ndaj të cilit gjykata kishte dhënë vendim që kishte marrë formë të prerë, i cili nuk mund të diskutohet. Në fakt, sipas legjislacionit të ri, parashikohet si shkak për procedimin disiplinor edhe shkelje të natyrës procedurale<sup>1</sup>.

**i.** Për një pjesë të procedimeve disiplinore të nisura para hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr.96/2016 dhe të cilat KLD i mori në shqyrtim pas hyrjes në fuqi të tij, nuk rezultoi të jetë respektuar afati 6 mujor për përfundimin e këtyre procedimeve, i parashikuar në nenin 172, pika 2 të ligjit nr.96/2016. Kjo çështje është evidentuar edhe nga Ministrja e Drejtësisë në disa prej mbledhjeve të KLD-së.

**j.** Në diskutimet e mbledhjes së dt.24 Janar 2018, mes anëtarëve të KLD-së pati momente paqartësie, akuza reciproke dhe tensioni sa i takon legjislacionit të aplikueshëm për masat disiplinore, lidhur me arsyet që e kishin çuar KLD-në në bllokimin e vendimmarrjes përtej afateve ligjore si dhe pati interpretime të ndryshme për mënyrën se si do të zbatohet ky legjislacion në dritën e vendimit nr.34/2017 të Gjykatës Kushtetuese. Pavarësisht debatit juridik, në këtë mbledhje, KLD vendosi kundër masave disiplinore të propozuara nga Ministri i Drejtësisë për 10 gjyqtarë. Në vendimmarrje mbizotëroi dukshëm ndarja midis anëtarëve nga radhët e gjyqësorit nga njëra anë dhe Ministres së Drejtësisë dhe Presidentit, nga ana tjetër.

**k.** Për sa i takon vlerësimin nga pikëpamja faktike të shkeljeve për të cilat kishte filluar procedimi disiplinor ndaj gjyqtarëve, sërish anëtarët e KLD-së patën ndasi. **Së pari**, pikëpamjet e ndryshme u shfaqën në rastet kur ndaj gjyqtarëve për të cilët ishte kërkuar procedimi disiplinor, për të njëjtin fakt prokuroria kishte vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të tyre. **Së dyti**, anëtarët gjyqtarë referuan në përgjithësi që shkeljet e pretenduara i përkisnin çështjeve për të cilat janë dhënë vendime të formës së prerë<sup>2</sup>. Gjatë debateve të zbardhura në procesverbalin e mbledhjes, vërehet dukshëm që në disa raste pyetjet e anëtarëve kanë mbështetur pozitën e mbrojtjes së kolegëve të proceduar disiplinorisht si dhe ka pasur edhe qëndrime apo pyetje sugjestionuese<sup>3</sup>.

**l.** *Në mbledhjet e KLD-së është përcjellë shqetësimi për zbatimin e detyrimeve ligjore tranzitore që ka Inspektorati i KLD-së për të ndihmuar në procesin e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarëve, në kuadër të vettingut. Sipas Inspektoratit, legjislacioni në këtë drejtim nuk është i plotë dhe ka nevojë për udhëzime të detajuara nga organet e vettingut. Në ofrimin e kësaj ndihme,*

<sup>1</sup> Në nenin 140 të Kushtetutës së ndryshuar në kuadër të reformës në drejtësi, gjyqtari mund të shkarkohet kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

<sup>2</sup> Ministrja e Drejtësisë ka argumentuar në një rast se, në vendimin nr.11 të vitit 2004 të Gjykatës Kushtetuese thuhet se KLD-ja mund të marrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve pa e kushtëzuar atë me faktin nëse ky vendim ka marrë formë të prerë, vetëm për rastet kur vendimi shoqërohet me akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe cenon në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor

<sup>3</sup> Citim i deklaratave të bërë nga një prej anëtarëve në mbledhje “I bëj këto pyetje se unë e njoh mirë ligjin “Për konfliktin...”, se e kam vuajtur vetë në kurriz këtë pikën e konfliktit të interesit.

*Inspektorati u përball me problematika për shkak numrit të ulët të inspektorëve të cilët duhet ti përgjigjeshin një numri të konsiderueshëm subjektësh që do të kalonin në këtë proces, përkatësisht 466 subjekte. Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë ka ngritur shqetësimin se vlerësimi i zakonshëm etik dhe profesional i gjyqtarëve është i vonuar, sidomos referuar faktit që ka ende gjyqtarë të cilët nuk kanë asnjë vlerësim nga Inspektorati (62 prej tyre)<sup>4</sup>.*

**m.** Transferimet e përkohshme për plotësim të trupave gjyqësore në çështje gjyqësore të caktuara janë referuar nga KLD me termin delegime, sipas aktit nënligjor të tij të vitit 2013. Pothuajse në shumicën e mbledhjeve të realizuara nga KLD ka pasur një numër të konsiderueshëm delegimesh të gjyqtarëve nga një gjykatë në gjykatën tjetër, për një numër relativisht të lartë çështjesh gjyqësore shkon në disa raste edhe mbi 100, çka evidenton një ngarkesë çështjesh gjyqësore që nuk i përgjigjet numrit të tyre.

**n.** Transferimet e përkohshme për gjykatat me ngarkesë tepër të lartë si rezultat i rënies së numrit të gjyqtarëve nën organikën e parashikuar, sërish janë shoqëruar me debate dhe kundërshti reciproke, qartazi të ndara midis anëtarëve gjyqtarë dhe Ministres së Drejtësisë. M.gj.th, ka pasur raste kur këto argumente janë mbështetur nga vetë anëtarët gjyqtarë në KLD. Një prej anëtarëve të KLD-së kërkon zbatimin e procedurës së parashikuar në nenin 46 të ligjit nr.96/2016 dhe se kriteri i afërsisë gjeografike nuk është një kriter ligjor<sup>5</sup>. Pas ngritjes së këtij shqetësimi, KLD ndryshon qëndrimin dhe konkludon për të ndjekur rregullat e parashikuara në ligjin e ri nr.96/2016, për të njoftuar me shpallje shprehjen e interesit nga gjyqtarët që duan të transferohen përkohësisht për jo më shumë se një vit në gjykatat ku ka mungesa në organikë. Ky është një zhvillim shumë pozitiv.

### **3. MONITORIMI I KOMPETENCAVE TRANZITORE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

**a.** Në ndryshim nga monitorimi i kompetencave tranzitore të KLD-së, ku vëzhguesit kanë pasur akses në procesverbalet e çdo mbledhje që ka qenë objekt i monitorimit, në rastin e kompetencave tranzitore të PP, vëzhguesit e KShH-së kanë pasur akses vetëm në vendimet/urdrat e këtij institucioni. Këto vendime nuk mundësojnë një analizë të plotë, pasi në tekstin e tyre referohet baza ligjore dhe pjesa e dispozitivit të vendimit që konkretizon vendimmarrjen përkatëse.

**b.** Disa prej vendimeve, relacionet shpjeguese të vendimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të Prokurorisë nuk rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, ndaj transparenca për këto dokumente ka qenë në nivele të ulëta.

**c.** KShH ju drejtua Prokurorisë së Përgjithshme në dt.11 Mars 2019 me kërkesë për informacion, për vënien në dispozicion të disa urdhrave dhe vendimeve që i përkasin vitit 2018 për transferimin e prokurorëve dhe caktimin përkohësisht të tyre si drejtues prokurorie si dhe për masat e marra ndaj prokurorëve që refuzuan të bëhen pjesë e shortit të dosjes “Shullazi”. Në kthimin e përgjigjes, Prokuroria na ka vendosur në dispozicion urdhrat dhe vendimet e kërkuara.

**d.** M.gj.th, pavarësisht nga kërkesa e KShH-së, ky institucion nuk vendosi në dispozicionin tonë procesverbalet dhe opinionet këshillimore të dhëna nga Këshilli i Prokurorisë (organi konsultativ me legjislacionin e vjetër), nuk përcaktoi nëse përveç urdhrave/vendimeve të kërkuara në mënyrë specifike ishin marrë ose jo vendime/urdhra të tjera në ushtrim të kompetencave tranzitore si dhe nuk vendosi në dispozicion, informacionin e kërkuar për ankimet në rrugë gjyqësore nga ana e prokurorëve, të urdhrave që lidhen me transferimin dhe procedimin disiplinor gjatë fazës tranzitore.

<sup>4</sup> Ndërkohë që Kryeinspektorja referon se një pjesë e këtyre gjyqtarëve janë emëruar pas vitit 2012 dhe do të mbeten pa vlerësim nga kjo KLD pasi ajo ka kompetencë të vlerësojë punën e tyre deri në vitin 2012

<sup>5</sup> *Në këtë mënyrë se si është menduar realizimi i transferimeve nga grupi i punës, në vlerësimin e këtij anëtari lë vend për “qoka”.*

e. Në mungesë të informacionit dhe dokumentacionit të plotë, gjetjet dhe konkluzionet tona për monitorimin e kompetencave tranzitore të Prokurorit të Përgjithshëm janë të pjesshme.

f. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion në rrugë zyrtare, rezulton se për vitin 2018, Prokurori i Përgjithshëm ka marrë 17 vendime/urdhra, përkatësisht për pezullimin nga detyra të dy prokurorëve, ndërprerjen e komandimit për tre prokurorë, caktimin e përkohshëm të 8 prokurorëve si Drejtues të Prokurorive të Rretheve Gjyqësore (në disa rrethe) duke përfshirë këtu edhe Prokurorinë e Krimeve të Rënda, caktimin e përkohshëm të tre prokurorëve nga Prokuroria e Krimeve të Rënda në prokuroritë e rretheve gjyqësore, largimi nga funksioni i drejtuesit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

g. Me përjashtim të dy vendimeve të pezullimit, vendimet e tjera që janë dhënë në ushtrim të kompetencave tranzitore gjatë vitit 2018 (kampioni i studimit tonë) nuk janë të motivuara ose janë motivuar vetëm pjesërisht, se në cilat kushte apo rrethana janë marrë. Kështu, p.sh. në rastin e caktimit të përkohshëm të prokurorëve si drejtues të prokurorive, duke përfshirë këtu edhe ndryshimet e drejtimit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, në vendimmarrjet mungon informacioni nëse është bërë një vlerësim paraprak i performancës së drejtuesve pararendës dhe drejtuesve që caktohen përkohësisht në këto pozicione. I njëjti konstatim vlen edhe për kalimin përkohësisht të tre prokurorëve nga Prokuroria e Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore jashtë Tiranës.

h. Urdhri nr.136, dt.09.05.2018 “Për largimin nga Funksioni” si drejtues i Prokurorisë së Krimeve të Rënda i prokurorit Z. Hajdarmataj është i diskutueshëm sa i takon ligjshmërisë, pasi në këtë urdher është referuar si bazë ligjore neni 160/4 e ligjit nr. 96/2016, i cili nuk parashikon si kompetencë tranzitore, largimin nga funksioni të drejtuesit të prokurorisë së krimeve të rënda por parashikon vetëm caktimin në pozicione të përkohshme të magjistratëve.

i. Nga informacioni që kemi mundur të marrim, rezulton se katër prokurorë i janë drejtuar Gjykatës Administrative (në shkallë të parë dhe/ose të dytë) për të kundërshtuar vendimmarrjen e Prokurorit të Përgjithshëm.

j. Ndaj dy prokurorëve të pezulluar, Gjykata e Apelit Administrativ shfuqizoi urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm me arsyetimin se shkak i pezullimit që ka të bëjë me akuzën që rëndon ndaj prokurorëve për kryerjen e një krimi të parashikuar në nenin në nenin 257/a-2 të Kodit Penal, nuk përbën krim të rëndë.

k. Ndaj dy prokurorëve të Prokurorisë së Krimeve të Rënda të transferuar në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Berat dhe Pogradec, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka shfuqizuar urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm, me arsyetimin se Prokuroria e Përgjithshme dështoi të provonte qëllimin për të cilin janë nxjerrë këto urdhra, duke mos qenë në përputhje me nenin 59 të Ligjit Nr. 96/2016. Mbi bazën e këtij vendimi gjyqësor, KLP ka vendosur të rikthejë prokurorët në detyrën e tyre të mëparshme pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

l. Në media janë pasqyruar gjerësisht mendime dhe opinione përsa i përket transferimeve dhe emërimeve të realizuara në mënyrë tranzitore nga PP. Në disa raste vlen të evidentohet se media nuk ka pasur informacionin e duhur lidhur me parashikimet ligjore të kësaj vendimmarrje dhe rrjedhimisht këto vendime emërtohen në mënyrë të gabuar.

#### **4. MBLEDHJET E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE ATIJ TË PROKURORISË**

a. Me përzgjedhjen e anëtarëve nga radhët e magjistratëve për KLGJ-në dhe KLP-në, të dy këto Këshilla filluan nga veprimtaria brenda një afati shumë të shpejtë vetëm disa ditë më vonë, përkatësisht në dt.19 dhe 20 Dhjetor 2018.

**b.** Që në ditët e para të krijimit, Këshillat u përballën me një ngarkesë dhe volum të lartë pune, sa i takon çështjeve të rëndësishme të qeverisjes së sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë. Pavarësisht nga fakti që legjislacioni nuk parashikon detyrime për vendosjen e prioriteteve në vendimmarrjen e Këshillave, kemi mendimin se të dy Këshillat duhet të hartonin një plan masash të shoqëruar me një kalendar që të detajonte përmbushjen e tyre në terma afatshkurtër (çështjet emergjente) dhe afatmesëm. Nga komunikimi me KLGJ-në, informohemi se ky këshill që nga momenti i krijimit, ka punuar për hartimin e planit strategjik 2 vjeçar dhe planin përkatës të veprimit, të cilat pas konsultimit do të miratohen brenda muajve qershor – korrik 2019. Këto plane do të shërbejnë për orientimin strategjik të KLGJ-së.

**c.** Të dy Këshillat kanë pasur bashkëpunim me misionet e asistencës ndërkombëtare. Mbledhjet janë shoqëruar nga diskutime pro aktive dhe pjesëmarrja e anëtarëve në mbledhjet plenare ka qenë në respektim të Ligjit nr. 115/2016.

**d.** Të dy Këshillat që nga momenti i krijimit janë përballur me vështirësi dhe mungesa përsa i përket infrastrukturës, buxhetit dhe pajisjes me personelin e nevojshëm. Anëtarët e KLGJ-së ushtrojnë funksionin e tyre pranë godinës së ish KLD-së, ndërkohë që anëtarët e KLP-së, në mungesë të një infrastrukture të përshtatshme janë të akomoduar në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme. Ndërkohë që për KLGJ shfaqet si problematikë mungesa e hapësirës së nevojshme për anëtarët dhe realizimin e mbledhjeve të komisioneve, për KLP-në përbën problem krijimi i perceptimit tek publiku mbi mungesën e objektivitetit dhe paanshmërisë së anëtarëve për vendimmarrje që lidhen me Prokurorinë e Përgjithshme.

**e.** Me anë të vendimeve të Kuvendit, numri i punonjësve të miratuar për KLGJ-në është 125 veta ose 30 persona më pak se propozimi i KLGJ-së, ndërkohë që numri i punonjësve për KLP-në është 65 veta ose 10 persona më pak se propozimi i KLP-së. Buxheti i të dy Këshillave nuk rezulton të jetë miratuar ende nga Këshilli i Ministrave dhe rrjedhimisht nuk është alokuar.

**f.** Mangësitë dhe vështirësitë e përmendura më sipër mund të kenë ndikuar në krijimin e pengesave objektive për përmbushjen e përgjegjësisë të Këshillave. Kjo gjendje mund të ndikojë në ngadalësimin e efikasitetit të të dy Këshillave, në këtë fazë shumë të rëndësishme të punës së tyre, teksa po përballen me nevojën për të pasur vendimmarrje të rëndësishme për një sërë çështjesh, përfshi këtu edhe ato emergjente.

**g.** Transparenca e të dy Këshillave në raport me mediat nuk është në nivele të kënaqshme. Media është lejuar të filmojë vetëm në mbledhjet e konstituimit të dy Këshillave dhe nuk është lejuar për filmimin e mbledhjeve vijuese. Kjo qasje është e diskutueshme sa i takon pajtueshmërisë me nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës. Kjo vendimmarrje e KLP-së, e bërë publike në Mbledhjen e datës 22 Shkurt 2019 bazohej në prevalencën që i jepet parimit të mbrojtjes së të dhënave personale të personave ndaj të cilëve zhvillohet diskutimi. Ndërkohë që KLGJ, edhe përse nuk i është përgjigjur specifikisht kërkesës për informacion të KShH-së lidhur me këtë çështje, referon se me gjithë mungesës së ambienteve të përshtatshme për të akomoduar një grup të madh pjesëmarrësish, institucioni ka mirëpritur të gjithë pjesëmarrësit që kanë shfaqur interes për të ndjekur punimet e tij

**h.** Praktika të ndryshme vërehen edhe për mënyrën e dokumentimit të mbledhjeve nga të dy Këshillat. Në faqen zyrtare të KLP-së<sup>6</sup> rezultojnë të publikuara regjistrimet audio të mbledhjeve plenare dhe vetëm 1 procesverbal i transkriptuar i mbledhjes së parë të tij. Nga ana tjetër, KLGJ nuk ka publikuar asnjë regjistrim audio të mbledhjeve plenare, ndërsa procesverbalet me përmbledhjet e diskutimeve janë publikuar. KLGJ referon ka ndeshur problematika me përdorimin e faqes zyrtare

<sup>6</sup> <http://klp.al/>



aktuale të trashëguar nga KLD-ja e mëparshme<sup>7</sup> dhe se është në proces të krijimit të një portali online të përkohshëm.

**i.** Pranë të dy Këshillave janë ngritur katër Komisionet e përhershme si dhe janë caktuar anëtarët dhe zëvendësuesit e tyre. Relacionet shpjeguese të përpiluara nga Komisionet e përhershme nuk gjenden të publikuara në faqen zyrtare të institucioneve dhe as nuk ju vihen në dispozicion vëzhguesve gjatë procesit të monitorimit. Gjithashtu, ato relatohen gjatë mbledhjeve plenare shumë shpejt dhe në mënyrë të përmbledhur nga anëtarët. Kjo ka bërë që shumë prej gjetjeve cilësore të monitorimit të kryer nga vëzhguesit të KShH-së, të pasqyrohen pjesërisht në këtë raport.

**j.** Standardi që kanë ndjekur dy Këshillat sa i takon vendimmarrjeve të tyre të diktuar nga vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin e disa drejtuesve të Gjykatave dhe Prokurorive nuk ka qenë i njëjtë. KLGJ nuk ka vijuar me shpalljen e vakancave dhe ja ka deleguar zëvendëskryetarit ushtrimin e kompetencave të kryetarit, duke qenë se vendimet e KPK-së nuk kanë marrë ende formë të prerë, ndërkohë që KLP ka vijuar me shpalljen e vakancave.

**k.** KShH vlerëson se ngritja e SPAK dhe Gjykatës së Posaçme duhet të jetë një proces i mirë koordinuar midis dy Këshillave dhe procedurat e ndjekura, pavarësisht veçorive që kanë në secilin Këshill duhet të ecin me të njëjtin ritëm. Në këtë drejtim, nuk duhet të mungojë bashkëpunimi me organet e vettingut për të pasur një ritëm më dinamik të kandidatëve që kanë shprehur interesin e tyre për të qenë pjesë e këtyre strukturave.

**l.** KShH ka vërejtur se klima e diskutimeve në të dy Këshillat ka reflektuar një rol pro aktiv dhe përfshirje vazhdimisht në debate të të gjithë anëtarëve, si në radhët e magistratëve dhe në radhët e anëtarëve jo magistratë.

**m.** Vlen të nënvizohet si fakt pozitiv që debatet e anëtarëve gjatë mbledhjeve plenare të Këshillave janë realizuar në mënyrë të moderuar dhe në respektim të rregullave të etikës. Kritikant e shfaqura në drejtim të mangësive apo interpretimeve të ndryshme të legjislacionit të ri të drejtësisë kanë pasur frymën e konstruktivitetit. Ky është një zhvillim shumë pozitiv.

**n.** Në përgjithësi vendimmarrja e të dy Këshillave ka pasur mbështetjen e shumicës dërrmuese të të gjithë anëtarëve. Në disa raste tepër sporadike, për çështje të caktuara ka pasur edhe qëndrime të ndara mes anëtarëve magistratë dhe atyre jomagjistratë. Rast i ndarjes së pastër të qëndrimeve midis anëtarëve magistratë dhe atyre jomagjistratë në KLP është vendimi për rikthimin në Prokurorinë e Krimeve të Rënda të prokurorëve O. Çela dhe B. Hajdarmata.

**o.** Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të cilat kanë shfuqizuar disa nga dispozitat e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe disa dispozita të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë krijuar vështirësi në interpretimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni në vendimmarrjet e të dy Këshillave.

**p.** Në disa raste, Këshillat kanë gjetur zgjidhjen më të favorshme dhe legjitime duke ju referuar dispozitave të tjera në fuqi të ligjit përkatës, Kushtetutës apo ligjeve të tjera të reformës në sistemin e drejtësisë, të aplikueshme në rastin konkret.

**q.** Pranë KLGJ-së rezulton se janë depozituar rreth 179 kërkesa nga kryetarët respektivë të gjykatave për delegime të 259 gjyqtarëve për shkak të mos formimit të trupave gjyqësore. Për shkak të fluksit të kërkesave dhe situatës aktuale emergjente të krijuar në sistemin gjyqësor, nga anëtarët u vlerësua se skema e delegimit dhe e transferimit të përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale.

<sup>7</sup> Mgjth, në këtë faqe KLGJ referon se po hidhen dhe mund të aksesohen disa materiale kryesore të KLGJ-së si vendime, procesverbale, legjislacioni dhe aktivitetet (informacione të cilat janë hedhur me shumë pak ose me aspak mungesa).



r. Në disa raste, Këshillat nuk i janë përgjigjur kërkesave për informacion të KShH-së, për aspektet të lidhura me objektin tonë të monitorimit. Kështu, në dt. 12.03.2019, KShH kërkoi të informohet nëse bazuar në nenin 149/b pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, KLP ka marrë ose jo vendim lidhur me pretendimin për ekzistencën ose jo të shkakut të pazgjedhshmërisë për një prej anëtarëve prokurorë të këtij Këshilli. **Për këtë informacion, KShH nuk mori një përgjigje zyrtare nga ana e KLP-së.**

s. Është pozitiv fakti që në disa nga vendimmarrjet e Këshillave është pasur në konsideratë shmangia e procedurave dhe praktikave që kanë rezultuar “problematike” nga veprimtaria e KLD-së.

## 5. NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI (KED)

a. **KED**, për arsye të kompetencave të rëndësishme ishte institucioni i parë i cili duhet të krijohej menjëherë pas miratimit nga Kuvendi të paketës së amendamenteve kushtetuese dhe të ligjeve organike të reformës në sistemin e drejtësisë.

b. Problematikat e shfaqura në drejtim të vonesave për ngritjen dhe funksionimin e plotë të KED-së kanë reflektuar ndër të tjerash në bllokimin e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, e cila po përballlet me një numër tepër të lartë vakancash.

c. **Shorti për KED është hedhur 3 herë**, duke zgjedhur KED 2017, KED 2018 dhe së fundmi KED 2019. Në të gjitha rastet Presidenti i Republikës, edhe pse Kushtetuta i ka caktuar këtë kompetencë, ka refuzuar të hedhë shortin dhe ky i fundit është hedhur nga Kryetari i Kuvendit. Në bazë të arsyetimit të Presidentit për KED-në 2019, arsyeja e refuzimit ka të bëjë me listat për KED-në, të cilat duhet të përgatiten nga KLP e KLGJ<sup>8</sup>.

d. Për sa i përket listave me emrat e kandidatëve për anëtar në KED 2019, vërehet se disa nga institucionet, përkatësisht Gjykata Kushtetuese dhe Prokuroria e Përgjithshme, kanë publikuar listat me kandidatët që plotësonin kriteret si dhe listat me kandidatët të cilët nuk i plotësonin ato. Ndërsa Gjykata e Lartë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka kanë qenë transparente, duke mos dhënë asnjë detaj mbi listat e propozuara prej tyre. Gjithashtu në shumicën e rasteve nuk janë publikuar detaje mbi procedurat e verifikimit të këtyre kriteve.

e. Institucionet propozuese të kandidatëve për në KED kanë interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të ndryshme kriteret ligjore që duhet të plotësonin kandidatët, aspekt i cili ka ndikuar në mungesën e konsistencës dhe njëtrajtshmërisë për zbatimin e legjislacionit për krijimin e KED 2019. Ky aspekt është nënvizuar në mënyrë të gjerë nga Avokati i Popullit, me fokus të veçantë në lidhje me kriterin e përfundimit të Shkollës së Magjistraturës.

f. KShH vëren se Kushtetuta dhe Ligji nr. 115/2016 kanë hapësira vakumi lidhur me mbarimin e mandatit të anëtarit të KED-së para kohe, p.sh. nëse vërtetohen kushtet e pa zgjedhshmërisë në ushtrimin e funksionit (si p.sh. mosplotësimi i kriteve) apo për rrethana të tjera sikurse parashikohet për KLGJ-në dhe KLP-në.

g. Shorti për KED 2019 është hedhur në datë 7 Dhjetor 2018 pranë ambienteve të Kuvendit. Ky proces ka qenë transparent dhe është mundur monitorimi në mënyrë të plotë edhe nga vëzhgues të organizatave jofitimprurëse (OJF-ve).

h. **Rezultatet e shortit** sollën zgjedhjen e 8 anëtarëve dhe 3 zëvendës anëtarëve në KED 2019. Për arsye të mungesës së kandidatëve mbetën pa u plotësuar vakancat përkatësisht të një anëtari dhe

<sup>8</sup> Duke qenë se këto institucione nuk rezultojn të ishin krijuar ende në periudhën që përkon me hedhjen e shtetit, ka një vakum ligjor pasi dispozitat ligjore kalimtare duhet të aplikoheshin vetëm për shortin e parë të KED-së, në vitin 2017.

tre zëvendës anëtarëve. Si rrjedhojë, interpretimi i legjislacionit përkatës çoi në përfundimin se KED mund të krijohet e të funksionojë edhe me një numër më të ulët anëtarësh, nëse ata plotësojnë kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje. Mbas krijimit të KED 2019, njëri prej anëtarëve të zgjedhur nga Gjykata Kushtetuese u shkarkua nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) dhe, si pasojë, KED 2019 tashmë ka vetëm 7 anëtarë. Ndërkohë, anëtari zëvendësues **Z. Medi Bici** është zgjedhur edhe anëtar i KLGJ dhe mandati i tij si anëtar i Gjykatës së Lartë është i pezulluar. Në vlerësimin e KShH-së, kjo rrethanë edhe përse nuk është parashikuar shprehimisht në kuadrin e ri ligjor, përbën rrethanë papajtueshmërie me funksionin e anëtarit të KED-së.

**i.** Në lidhje me **krijimin e KED**, evidentohet se ka pasur një debat të gjerë për interpretimin e dispozitave kalimtare të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 115/2016 ku, nga një anë, disa nga institucionet arritën në përfundimin se dispozitat kalimtare kishin përfunduar efektet e shtrirjes së tyre kohore të zbatimit dhe, nga ana tjetër, disa institucione konkluduan se deri në ngritjen e KLP e KLGJ do të zbatoheshin këto dispozita kalimtare. Si rrjedhojë KED 2019 është krijuar në formë të përkohshme, sipas parashikimit të dispozitave kalimtare.

**j.** Për sa i përket KED 2017 dhe KED 2018, u vlerësua se funksionimi i KED me disa anëtarë, të cilët nuk ishin konfirmuar nga organet e rivlerësimit, do konsiderohej në kundërshtim me parashikimet e Kushtetutës dhe të ligjit nr.115/2016. Si rrjedhojë KED 2017 nuk u mbledh kurrë, ndërsa KED 2018 mbajti vetëm një mbledhje në muajin mars të 2018-ës. Përkundrazi, me krijimin e KED 2019 ndodhemi përballë një vlerësimi të kundërt të dispozitave ligjore, pasi, edhe pse një pjesë e anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve nuk kishin një vendim përfundimtar për kalimin me sukses të vettingut, KED 2019 ka filluar punën me legjitimitet të plotë, duke marrë edhe vendimet e para.

**k.** Vërehet gjithashtu se, në qoftë se KED 2017 do të kishte funksionuar mbi bazën e të njëjtit interpretim sikurse u ndoq për KED-në 2019, kjo do të kishte bërë të mundur plotësimin e disa prej vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**l.** Ndërkohë që ligji i vettingut parashikon rivlerësimin e anëtarëve të KED-së me përparësi, në fakt, procedura e deritanishme e ndjekur nga organet e vettingut nuk i ka prioritarizuar këto subjekte. Ndërkohë KED 2019 referon se në dispozitat kushtetuese dhe ligjore për kushtet që duhet të përmbushen për të qenë anëtarë të KED-së, natyrshëm që nuk bëhet fjalë për kushtin e kalimit me sukses të procesit të vettingut. Pavarësisht nga kjo, KShH vëren se kjo çështje ndikon potencialisht në besueshmërinë e vendimmarrjes së këtij organi (KED-së)

**m.** KED 2019 u mbledh për herë të parë në datë 15 janar 2019. Vetëm gjatë mbledhjes së parë u lejua aksesimi dhe monitorimi i mbledhjes nga ana e institucioneve dhe vëzhguesve të ndryshëm. Të gjitha mbledhjet tjera janë mbajtur me dyer të mbyllura, aspekt që parashikohet shprehimisht nga ligji. Rregullorja nuk parashikon aksesin e vëzhguesve në radhët e shoqërisë civile apo të medias për të monitoruar mbledhjet e KED-së, por favorizon vetëm pjesëmarrjen e ekspertëve që mund të japin kontribut në këto mbledhje për shkak të ekspertizës së tyre. *KED 2019 referon nga ana tjetër se nuk ka asnjë diskrecion të vendosë lejimin e të tretëve për të marrë pjesë në mbledhjet e tij pasi duhet të zbatohet rregullin imperativ të parashikuar në nenin 233 dhe 242 të ligjit nr.115/2016*

**n.** Nga përfaqësuesi i ftuar nga radhët e opozitës në mbledhjen e parë konstituuese të KED-së 2019, u përdorën në mënyrë të përsëritur deklarata me ngjyrimë “politike”. Kjo solli tej zgjatjen e mbledhjes, duke mos arritur në rezultate konkrete.

**o.** Përmbledhjet e publikuara të mbledhjeve të deritanishme KED-së 2019 janë shumë të përgjithshme ndërkohë që vetëm një procesverbal rezulton i publikuar në faqen e KED-së për mbledhjen e parë të tij, ndërkohë që në periudhën që ky raport mbulon (deri në fund të muajit mars) janë zhvilluar 14 mbledhje. KED 2019 evidenton se është gjendur përpara vështirësive të shumta objektive dhe pengesave teknike për realizimin e këtyre detyrimeve (për publikimin e

procesverbaleve), si p.sh. personeli mbështetës i pamjaftueshëm, teknologjia me mangësi në realizimin e detyrës si edhe shtimi progresiv i ngarkesës së punës së KED-së dhe personelit mbështetës nga numri i pazakontë i vendeve vakante në proces, etj.

**p.** KShH tërheq vëmendjen për më shumë transparencë në faqen e Kuvendit për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr.115/2016 (KPMK), organ ky i krijuar në Kuvendin e RSH. Përkatësisht në faqen e tij zyrtare, KShH vëren se nuk janë të publikuar në mënyrë të plotë apo edhe të pjesshme aspekte të rëndësishme të punës së tij të lidhura me raportet e monitorimit që ky Komision harton, korrespondencën e realizuar me institucionet shtetërore, etj.

**q.** Konkluzionet e KPMK-së në raportin e monitorimit të ngritjes së KED-së 2019 kanë natyrë të përgjithshme, mungon arsyetimi i tyre ligjor dhe në disa raste, mungon qartësia apo konkretizimi i tyre. KShH vlerëson se, në përfundimet dhe rekomandimet e KPMK-së drejtuar institucioneve të qeverisjes së drejtësisë (përfshi këtu KED) nuk duhet të mungojë qasja e pavarur e kritikës konstruktive dhe profesionale, e udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe paanshmërisë.

## **6. PËRZGJEDHJA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË (ILD)**

**a)** Kuadri ligjor për reformën në drejtësi ka parashikuar se një organ i rëndësishëm si Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) që duhet të ngrihej për herë të parë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ndryshimeve Kushtetuese (neni 179 pika 9 i Kushtetutës), por ky afat nuk u respektua, duke konsideruar faktin se kanë kaluar mbi 2 vite nga miratimi i reformës në drejtësi.

**b)** Legjislacioni i ri kishte vendosur një afat prekluziv për KED-në, i cili është institucioni që realizon procedurën e vlerësimit të përmbushjes së kriterëve dhe renditjen e kandidatëve për ILD që ishte data 1 Shkurt 2017. Ky afat nuk rezulton të jetë respektuar, edhe për faktin se KED 2017 nuk u mblodh asnjëherë ndërkohë që KED 2018 u mblodh vetëm një herë dhe pezulloi veprimtarinë e mëtejshme të saj.

**c)** Vonesat në ngritjen e ILD-së kanë krijuar ngërçe problematike për ushtrimin e kompetencave ligjore që ky institucion ka në drejtim të verifikimit të shkeljeve me natyrë disiplinore të kryera nga gjyqtarë dhe prokurorë si dhe për fillimin e procedimit disiplinor pranë dy KLGJ-së dhe KLP-së. Ndaj KShH vlerëson se, ngritja e ILD-së duhej ti kishte paraprirë ngritjes së dy Këshillave.

**d)** Gjatë vitit 2017 kanë shprehur interesin për të kandiduar për ILD, 4 kandidatë, dy prej të cilëve magjistratë, por ndërkohë njëri prej tyre ka tërhequr kandidaturën. Kandidatët magjistratë për ILD të vitit 2017 nuk janë trajtuar me përparësi nga organet e vettingut për shkak të faktit se procesi i rivlerësimit në shkallë të parë për dy kandidatët e vetëm filloi në muajin nëntor 2017 dhe përfundoi në muajin mars 2019, pra 15 muaj më vonë. Ndërkohë KPK rezulton se filluar dhe përfunduar vettingun e qindra subjekteve të tjerë deri në fillim të vitit 2019.

**e)** Institucionet përgjegjëse nuk kanë pasur transparencë në faqet e tyre zyrtare, veçanërisht në lidhje me shprehjen e interesit nga kandidatët që kanë aplikuar në vitin 2017 (konkretisht Sekretari i Përgjithshëm dhe Gjykata e Lartë në faqen e të cilës publikohet informacion për KED-në).

**f)** KSHH vlerëson se nga pikëpamja formale, KED 2019 duhet të merrte një vendim për statusin ligjor të kandidaturave për ILD të paraqitura në vitin 2017. Edhe pse e ndodhur përballë një situatë ekstra-ligjore e lidhur me mosfunksionimin e dy KED-ve të vitit 2017 dhe 2018, në vlerësimin tonë, statusi i kandidatëve për ILD në vitin 2017 nuk mund të barazohej me kandidatët që do të shprehnin interesin e tyre për të kandiduar për këtë vend vakant, pas thirrjes së publikuar nga KED 2019. KED 2019 mund t'ju ishte drejtuar kandidatëve për ILD të paraqitur në vitin 2017, me një komunikim zyrtar për paraqitjen e dokumentacionit shtesë nëse ishte nevoja. KShH vlerëson se kjo listë e tre kandidatëve

të vitit 2017 duhej ti shtohet listës me kandidatët e paraqitur rishtazi pas publikimit të thirrjes në muajin Mars 2019.

**g)** Në fillim të muajit Mars 2019, KED 2019 ka hapur një shpallje të re për kandidatura për ILD. Në vlerësimin e KShH-së, KED 2019 duhet të kishte qenë më transparentë në këtë thirrje, për të informuar publikun për motivin dhe arsyet ligjore të saj. Ndërkohë me shkresë zyrtare, KShH është informuar nga KED 2019 se arsyeja e publikimit të thirrjes kishte të bënte me mos arritjen e kuorumit të nevojshëm kushtetues për të pasur të paktën 5 persona si kandidatë për vendin vakant të ILD-së.

**h)** Lista me 13 kandidatët që kanë shprehur interesin për kandidaturën e ILD-së është publikuar në datë 21 mars 2019, nga ku rezulton se një prej kandidatëve kanë dhënë dorëheqjen dhe 3 prej kandidatëve janë të vitit 2017 të cilët kanë shprehur sërish interesin për të aplikuar.

**i)** Në datën 5 prill 2019, KED ka hedhur shortin për caktimin e relatorit në radhët e anëtarëve të saj, për kandidaturat që kanë aplikuar për ILD<sup>9</sup>, duke mos respektuar afatin 5 ditor të caktuara vetë nga KED për hedhjen e këtij shorti nga momenti i përfundimit të afatit të thirrjes për paraqitjen e kandidaturave. Lidhur me këtë, KED 2019 parashton se procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave nuk mund të fillonin dhe të zhvilloheshin pa miratuar paketën e akteve nënligjore normative përkatëse sepse kjo urdhërohet nga neni 229 i ligjit nr.115/2016. Pavarësisht nga ngarkesa që impononte ky proces, duke marrë parasysh që KED filloi veprimtarinë e saj në dt.15 Janar 2019 si dhe duke ditur urgjencën që paraqet plotësimi i vakancave për ILD dhe anëtar të Gjykatës Kushtetuese, KShH ndan mendimin se kjo periudhë ka qenë e arsyeshme për të përfunduar këtë paketë.

**j)** Lidhur me verifikimin që KED duhet të kryente për 13 kandidatët për ILD, KShH nuk mund të ndajë gjetje dhe të dhëna për këtë fazë, pasi periudha që ky raport mbulon shtrihet deri në fund të muajit Mars 2019, që korrespondon vetëm me 10 ditë nga afati 1 mujor sipas të cilit, KED 2019 kishte në dispozicion për të kryer këtë verifikim.

---

<sup>9</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja\\_e\\_K\\_E\\_D\\_e\\_dates\\_02\\_04\\_2019\\_5743\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_K_E_D_e_dates_02_04_2019_5743_1.php)

**KAPITULLI I**

**MONITORIMI I NGRITJES SË  
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE  
KËSHILLIT TË LARTË TË  
PROKURORISË**

# 1. PËRZGJEDHJA DHE EMËRIMI I ANËTARËVE JO MAGJISTRATË NË DY KËSHILLAT

## 1.1 Anëtarët jo magjistratë nga radhët e avokatisë

### 1.1.1 Ligjshmëria e procedurave për përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve në radhët e avokatëve

#### a) *Faza përgatitore për përzgjedhjen e anëtarëve nga radhët e avokatisë*

Faza e parë në drejtim të përzgjedhjes së këtyre anëtarëve është publikimi i thirrjes ku vihen në dijeni personat e interesuar, të cilët plotësojnë kriteret lidhur me dokumentet e kërkuara dhe afatet për të shprehur interesin për të kandiduar. Konkretisht në nenet 20 dhe 276, pika 8 të ligjit nr.115/2016 parashikohet detyrimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit për të shpallur vendet vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. **Kjo dispozitë ligjore është respektuar pasi ligji ka hyrë në fuqi me datë 16.12.2016 ndërsa publikimi i shpalljes për vendet vakante është realizuar me datë 13.01.2017 (brenda 30 ditësh).**

Në pikën 1, të nenit 20 dhe në nenin 119 të ligjit 115/2016, parashikohet se shpallja për vendet vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga avokatët që plotësojnë kriteret e parashikuara bëhet në faqen zyrtare të Kuvendit, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të Avokatit të Popullit dhe në të paktën një gazetë me tirazhin më të lartë. **Kjo procedurë nuk është respektuar plotësisht pasi shpallja është publikuar vetëm në faqen zyrtare të Kuvendit<sup>10</sup> dhe në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit, ndërsa në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Avokatisë<sup>11</sup> nuk rezulton e publikuar.** Lidhur me detyrimin për publikim në gazetën e tirazhit më të lartë, shpallja në fjalë është publikuar në gazetën “Koha Jonë”<sup>12</sup>.

**Në përfundim të afatit 15 ditor të parashikuar në pikën 1 të nenit 21 të ligjit nr.115/2016, Avokati i Popullit ka respektuar ligjin duke publikuar listën me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet formale për anëtarë në KLGJ dhe KLP nga radhët e avokatisë.**

#### b) *Krijimi dhe funksionimi i Komisionit Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve*

Dhoma Kombëtare e Avokatisë sipas parashikimeve në nenet 25 dhe 125 të ligjit 115/2016, i ka përcjellë <sup>13</sup> Avokatit të Popullit listën me kandidatët që plotësojnë kriteret për anëtarë të komisionit Ad Hoc. Avokati i Popullit, mes kandidaturave të sugjeruara nga DHKA, ka zgjedhur si anëtar të komisionit Ad Hoc avokatin Maksim Haxhia dhe avokaten Eris Hysi si dhe anëtar zëvendësues Av. Arjan Salati. **Në shkresën që ka publikuar Avokati i Popullit me emrat për anëtar të komisionit Ad Hoc nga DHKA, rezultojnë të pasqyruar vetëm emrat e anëtarëve të zgjedhur nga kjo strukturë, duke mos dhënë informacion nëse është respektuar pika 2 e nenit 123 të ligjit 115/2016, për përzgjedhjen e anëtarit më të ri në moshë dhe më të vjetrin në moshë ndër**

<sup>10</sup><http://www.parlament.al/News/Index/5704>

<sup>11</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/content/13012017-njoftim-p%C3%ABr-shpalljen-e-vendeve-vakante-p%C3%ABr-an%C3%ABtar%C3%AB-t%C3%AB-klgj-s%C3%AB-dhe-klp-s%C3%AB>

<sup>12</sup><http://www.kohajone.com/2017/01/13/kuvendi-shpall-vakancen-per-10-anetare-te-klgj-dhe-klp/>

<sup>13</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/20.02.2017%20PROCESVERBAL%20n%C3%AB%20mbledhjen%20e%20paraprak%20nga%20rradh%C3%ABt%20e%20Avokatis%C3%AB%20p%C3%ABr%20an%C3%ABtar%C3%AB%20KLGJ%20dhe%20KLP.pdf>

**kandidatë që të shërbejnë si anëtarë të Komisionit të Pavarur Ad Hoc.** Po në këtë nen përcaktohet se Avokati i Popullit duhet të caktojë dy anëtar zëvendësues, **ndërkohë që është caktuar vetëm një, përkatësisht Av. Arjan Salati.**<sup>14</sup>

Në faqen e Avokatit të Popullit<sup>15</sup> është publikuar shkresa e Akademisë së Shkencave drejtuar Avokatit të Popullit, me anë të cilës i komunikohen anëtarët e zgjedhur nga Asambleja e Akademisë së Shkencave për anëtarë të Komisionit Ad Hoc. Si përfaqësues të Akademisë së Shkencave, u zgjodhën konkretisht Muzafër Korkuti si anëtar i rregullt dhe Vasil Tole si anëtar zëvendësues, **në respektim të neneve 23 dhe 121 të Ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”.**<sup>16</sup>

Avokati i Popullit me shkresën me nr. Prot 31, datë 07.02.2017, me lëndë “Mbi përbërjen e Komisionit Ad Hoc që do verifikojë dhe vlerësojë paraprakisht kandidatët nga radhët e avokatëve për KLGJ dhe KLP”, i drejtohet Kryetarit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë lidhur me mungesën e zëvendës-kryetarit të këtij Komisioni Ad Hoc. Kjo për arsye se, në bazë të neneve 23 dhe 121 të ligjit 115/2016, thuhet shprehimisht se Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi duhet të jetë anëtar dhe njëkohësisht zëvendës-kryetar i Komisionit Ad Hoc për verifikimin paraprak të kandidatëve avokatë. **Në kushtet kur kryetari i zgjedhuri Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ka dhënë dorëheqjen nga detyra e tij, Komisioni Ad Hoc është gjendur përballë mungesës në anëtarësi, të kërkuar shprehimisht në ligjin nr. 115/2016 duke kushtëzuar kështu rrjedhën normale të mbledhjeve të Komisionit të Pavarur Ad Hoc.** Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit me anë të kësaj shkresë ka kërkuar nga Kuvendi hedhjen e shortit për zgjedhjen e Kryetarit të ri të KED-së, me qëllim që edhe Komisioni i pavarur Ad Hoc të vijojë më tej nga puna.<sup>17</sup> Me shkresën nr. Prot. 29, datë 16.02.2017, me lëndë “Mbi përbërjen e Komisionit Ad Hoc që do verifikojë dhe vlerësojë paraprakisht kandidatët nga radhët e avokatëve për KLGJ dhe KLP”, është vënë në dijeni të kësaj vakance edhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, të cilit i është kërkuar orientim lidhur me zgjidhjen e kësaj situatë në mënyrë që të mos pengohet ecuria e punës së komisionit të pavarur Ad Hoc.

Me anë të shkresës me nr. Prot 634/1, datë 17.02.2018, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, i bashkëngjiti përgjigjes zyrtare një opinion nga EURALIUS, ku shprehet se në bazë të pikës 7 të nenit 221 të ligjit 115/2016, **kryetarja e dorëhequr e KED mund të zëvendësohet nga zëvendës-kryetari i KED-së, i zgjedhur me short nga i njëjti institucion, duke bërë kështu që Komisioni Ad Hoc të plotësojë anëtarësinë e saj.**<sup>18</sup> Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kryetari i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të përcjellë me anë të shkresës nr. Prot 662/1, datë 24.02.2018.

### **c) Ligjshmëria e mbledhjeve të Komisionit të pavarur Ad Hoc**

**Me datë 20.02.2017, në përpunje me afatet e caktuara në nenet 26 dhe 124 të ligjit 115/2016, Komisionin i Pavarur Ad Hoc realizoi mbledhjen e parë<sup>19</sup>, në të cilën morën pjesë përkatësisht,**

<sup>14</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/20.02.2017%20PROCESVERBAL%20n%20C3%AB%20mbledhjen%20e%20par%20C3%AB%20t%20C3%AB%20Komisionit%20t%20C3%AB%20pavarur%20Ad%20Hoc%20p%20C3%ABr%20vler%20C3%ABsimin%20paraprak%20nga%20radh%20C3%ABt%20e%20Avokatis%20C3%AB%20p%20C3%ABr%20an%20C3%ABtar%20C3%AB%20t%20C3%AB%20KLGJ%20dhe%20KLP.pdf>

<sup>15</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KomInstitucioneTjera/20.02.2017%20Mbi%20trajtimin%20financiar%20t%20C3%AB%20an%20C3%ABtar%20C3%ABve%20t%20C3%AB%20komisionit%20Ad%20Hoc%20q%20C3%AB%20do%20t%20C3%AB%20verifikoj%20C3%AB%20dhe%20vler%20C3%ABsoji%20paraprakisht%20kandidat%20C3%ABt%20nga%20radh%20C3%ABt%20e%20avokat%20C3%A%20Bve%20C3%ABr%20an%20C3%ABtar%20C3%AB%20t%20C3%AB%20KLGJ%20dhe%20KLP.pdf>

<sup>16</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/20.02.2017%20Caktohet%20an%20C3%ABtari%20dhe%20an%20C3%ABtari%20z%20C3%ABvend%20i%20Akademis%20C3%AB%20s%20C3%AB%20Shkencave%20n%20C3%AB%20Komisionin%20A%20d%20Hoc%20p%20C3%ABr%20vler%20C3%ABsimin%20paraprak%20kandidat%20C3%AB%20t%20C3%AB%20an%20C3%ABtar%20C3%ABt%20t%20C3%AB%20KLGJ%20dhe%20KLP.pdf>

<sup>17</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/16.02.2017%20Mbi%20P%20C3%ABr%20C3%ABrjen%20e%20komisionit%200%20Ad%20Hoc%20nga%20radh%20C3%ABt%20e%20avokat%20C3%ABve%20p%20C3%ABr%20KLGJ%20dhe%20KLP.pdf>

<sup>18</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KomInstitucioneTjera/Kthim%20p%20C3%ABrgjigje%20p%20C3%ABr%20shkresat%20nr.Prot.2031%20dat%20C3%AB%2017.02.2017%20dhe%20nr.Prot.36%20dat%20C3%AB%2020.02.2017.pdf>

<sup>19</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/20.02.2017%20PROCESVERBAL%20n%20C3%AB%20mbledhjen%20e%20par%20C3%AB%20t%20C3%AB%20Komisionit%20t%20C3%AB%20pavarur%20Ad%20Hoc%20p%20C3%ABr%20vler%20C3%ABsimin%20>



avokati i popullit, kryetari i Akademisë së Shkencave, Avokati zëvendësues i anëtarit nga radhët e avokatisë në këtë Komision dhe anëtarja tjetër sërish nga radhët e avokatisë. Në mbledhje nuk ishte përfaqësuesi i KED-së, njëkohësisht edhe Zv. Kryetar i Komisionit Ad Hoc, mungesa e të cilit u evidentua nga kryetari dhe anëtarët e tjerë. Avokati i Popullit gjatë kësaj mbledhje sqaroi se prezenca e Kryetarit të KED është e detyrueshme në bazë të ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund të fillohet nga puna në kushtet kur kryetarja në fuqi, Znj. Mirela Fana ka dhënë dorëheqjen. Pavarësisht kësaj, Avokati i Popullit zgjodhi që për anëtarët e pranishëm të bëhej një prezantim në vija të përgjithshme i punës së komisionit, procedurave dhe afateve. Mbledhja u ndërpre nga anëtarët për të vijuar nga puna me plotësimin e komisionit sipas përbërjes të përcaktuar në nenin 23 dhe 121 të ligjit 115/2016.

Duke pasur parasysh opinionin e Euralius si dhe përgjigjet e dhëna nga Sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit dhe Komisioni parlamentar i Ligjeve, Avokati i Popullit me shkresën nr. Prot 44, datë 27.02.2017<sup>20</sup>, fton Z. Artan Zeneli, (anëtar zëvendësues i KED nga Gjykata e Lartë) të marrë pozicionin e zëvendës kryetarit të Komisionit të pavarur Ad Hoc, për të marrë kështu pjesë në mbledhjen e radhës të caktuar për tu zhvilluar më datë 02 Mars 2017.

**Në përputhje me nenet 27 dhe 125 të ligjit 115/2016, Avokati i Popullit shpall në faqen zyrtare thirrjen për pjesëmarrje në mbledhjen e komisionit me datën 02 Mars 2017.** Gjithashtu, rezultoi se janë lajmëruar me anë të shkresave zyrtare, anëtarët e Komisionit.

Me shkresën nr. Prot 814/1, datë 28.02.2017<sup>21</sup>, Z. Artan Zeneli është përgjigjur se ka pengesa ligjore, për shkak edhe të konfliktit të interesit dhe pamundësisë fizike për të qenë pjesëmarrës në mbledhjen e datës 02 Mars 2017 si dhe për të qenë anëtar i Komisionit të pavarur Ad Hoc.

1. Pengesa ligjore e cituar nga Z. Artan Zeneli lidhet me faktin se mungesa apo dhënia e dorëheqjes nga ana e Kryetares së KED nuk legjitimon anëtarin zëvendësues të marrë menjëherë atributet e kryetarit të KED. Sipas tij është pikërisht zëvendës kryetari i KED-së që zë vendin e kryetarit të KED, dhe jo anëtarin zëvendësues. Në bazë të neneve 226-242 të ligjit "Për organet e qeverisjes në drejtësi", anëtarin zëvendësues zëvendëson kryetarin kur në mënyrë të përkohshme ai nuk mund të ushtrojë funksionet e tij, por pa përfshirë zëvendësimin në ushtrimin e funksioneve drejtuese. Sa i përket nenit 30 të ligjit 115/2016, Zeneli shprehet se ligji e thotë shprehimisht se kryetari i KED zëvendësohet nga zëvendës-kryetari i KED.
2. Lidhur me shkakun e konfliktit të interesit, Z. Zeneli me anë të shkresës informon se ka shprehur interesin për kandidat në KLGJ dhe në këto kushte në bazë të nenit 222 të ligjit 115/2016 nuk mund të jetë pjesë e Komisionit të pavarur Ad Hoc, **pasi do binte ndesh me nenet 27 dhe 126 të ligjit 115/2016.**
3. Sa i përket pamundësisë fizike, Zeneli argumentoi se ndodhet jashtë Shqipërie për arsye shëndetësore.

Me datë 01.03.2018, Avokati i Popullit<sup>22</sup> i është drejtuar sërish Kryetarit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, këtë herë edhe Kryetarit të Kuvendit, me anë të shkresës me nr. Prot 53, në të cilën është kërkuar të caktohej përfundimisht emri i anëtarit të KED-së, i cili do mbajë detyrën e zëvendës-kryetarit të komisionit Ad Hoc. Nëpërmjet shkresës nr. Prot

[paraprak%20nga%20rradh%C3%ABt%20e%20Avokatis%C3%AB%20p%C3%ABr%20an%C3%ABtar%C3%AB%20t%C3%AB%20KLGJ%20dhe%20KLP.pdf](http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/27.02.2017%20Njoftim%20p%C3%ABr%20mbledhjen%20e%20Komisionit%20t%C3%AB%20Pavarur%20Ad%20Hoc%20p%C3%ABr%20KLGJ%20dhe%20KLP%20drejtuar%20Gjykat%C3%ABs%20s%C3%AB%20Lart%C3%AB.pdf)

<sup>20</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/27.02.2017%20Njoftim%20p%C3%ABr%20mbledhjen%20e%20Komisionit%20t%C3%AB%20Pavarur%20Ad%20Hoc%20p%C3%ABr%20KLGJ%20dhe%20KLP%20drejtuar%20Gjykat%C3%ABs%20s%C3%AB%20Lart%C3%AB.pdf>

<sup>21</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/28.02.2017%20Kthim%20p%C3%ABrgjigje%20nr%20C44%20prot%20dat%2027.02.2017%20me%20l%C3%ABnd%C3%AB%20Njoftim%20p%C3%ABr%20mbledhjen%20e%20Komisionit%20t%C3%AB%20Pavarur%20Ad%20Hoc%20p%C3%ABr%20KLGJ%20dhe%20KLP%20drejtuar%20Gjykat%C3%ABs%20s%C3%AB%20Lart%C3%AB.pdf>

<sup>22</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/01.03.2017%20Mbi%20p%C3%ABrb%C3%ABrjen%20e%20komisionit%20t%C3%AB%20Pavarur%20Ad%20Hoc%20q%C3%AB%20do%20t%C3%AB%20verifikoj%C3%AB%20dhe%20vler%C3%ABsoj%C3%AB%20paraprakisht%20kandidat%C3%ABt%20nga%20radh%C3%ABt%20e%20avokat%C3%ABve%20p%C3%ABr%20an%C3%ABtar%C3%AB%20t%C3%AB%20KLGJ-s%C3%AB%20dhe%20KLP-s%C3%AB.pdf>



662/3 datë 09.03.2017, Kryetari i Kuvendit i përgjigjet shkresës së Avokatit të Popullit se është Komisioni Ad Hoc, si një strukturë vendimmarrëse kolegjiale e cila vendos për interpretimin dhe zbatimin e ligjit në lidhje me përcaktimin e emrit të zëvendëskryetarit të Komisionit të Pavarur Ad-Hoc.

**Po në zbatim të neneve 27 dhe 125 të ligjit 115/2016, me datë 09.03.2017, Avokati i Popullit i drejtohet me shkresë zyrtare sërish përfaqësuesve të Dhomës Kombëtare të Avokatisë<sup>23,24</sup>, përfaqësuesit të Akademisë së Shkencave<sup>25</sup> si dhe anëtarit zëvendësues të kryetarit të KED-së<sup>26</sup>, duke i informuar për mbledhjen e radhës që do mbahet me datë 13 Mars 2017.**

Në mbledhjen e datës 13 Mars 2017 të pranishëm ishin vetëm 2 anëtarë, nga 5 të tillë, përkatësisht Avokati i Popullit dhe kryetari i Akademisë së Shkencave. Pavarësisht njoftimeve zyrtare të cilat ju ishin dërguar anëtarëve të tjerë të Komisionit të Pavarur Ad-Hoc, ata nuk janë paraqitur në mbledhjeje. Në këto kushte, mbledhja u shty për tu zhvilluar në datën 24.03.2017. Me datë 21.03.2017 përsëritet thirrja për pjesëmarrjen e anëtarëve në mbledhjen e komisionit Ad Hoc<sup>27, 28, 29, 30</sup>. Në mbledhjen e Komisionit të Pavarur “Ad-Hoc”, të datës 24.03.2017 është konstatuar se pavarësisht nga njoftimi, Z. Artan Zeneli nuk ka njoftuar pjesëmarrjen dhe nuk ka qenë prezent. Anëtarët prezent, pasi kanë konstatuar prezencën e më shumë se gjysmës së anëtarësisë së këtij komisioni dhe duke vlerësuar bazën ligjore në fuqi, për vlefshmërinë e punës së këtij organi kolegjial (nenet 23 dhe 121 të ligjit 115/2016), kanë vendosur në prezencën e katër nga 5 anëtarëve që parashikon ligji se, Komisioni “Ad Hoc” konstituohet për të vazhduar punën e tij.

Me datë 28 mars 2017, sërish Avokati i Populli njofton anëtarët e komisionit Ad Hoc për mbledhjen e radhës, atë të datë 31.03.2018, duke i njoftuar zyrtarisht me anë të shkresave përkatëse anëtarët e tij<sup>31, 32, 33, 34, 35</sup>. Në ndryshim nga njoftimet e kaluara, këtë herë njoftohet edhe Z. Vladimir Kristo, në cilësinë e zëvendës kryetarit të KED-së.

Në vijim të punës së tij, Komisioni Ad Hoc në vazhdimësi ka njoftuar dhe thirrur anëtarët për pjesëmarrje. Shpesh herë këto mbledhje, në përputhje me nenet 23 dhe 121 të Ligjit 115/2016 janë shtyrë si pasojë e mungesës së prezencës së anëtarëve dhe mos-plotësimit të kuorumit të nevojshëm. **Shkak i vazhdueshëm i shtyrjes ka qenë mungesa e përfaqësuesit të KED, për shkak të ngërçit ligjor që u krijua si pasojë e interpretimit ligjor të ndryshëm se kush do të zëvendësojë kryetarin e dorëhequr të KED-së.** Në mungesë të Avokatit të Popullit, në përputhje me ligjin (nenet 30 dhe 128 i ligjit 115/2016) është bërë zëvendësimi i tij me Z. Arben Shkëmbi, Komisioner pranë Avokatit të Popullit, duke mos penguar kështu ecurinë e punës. E njëjta praktikë është ndjekur edhe me zëvendësimin e anëtarëve të tjerë të komisionit, si p.sh. në rastin e përfaqësuesit të Shkollës Kombëtare të Avokatisë, i cili në mungesë të tij zëvendësohej nga anëtari zëvendësues, përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Z. Arjan Salati.

<sup>23</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/09.03.2017%20Njoftim%20Dhom%C3%ABs%20Komb%C3%ABtare%20%C3%AB%20Avokatis%C3%AB%20Eris%20Hysi.pdf>

<sup>24</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/09.03.2017%20Njoftim%20Dhom%C3%ABs%20Komb%C3%ABtare%20%C3%AB%20Avokatis%C3%AB%20Maksim%20Haxhia.pdf>

<sup>25</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/09.03.2017%20Njoftim%20Akademis%C3%AB%20s%C3%AB%20Shkencave.pdf>

<sup>26</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/09.03.2017%20Njoftim%20Gjykat%C3%ABs%20s%C3%AB%20Lart%C3%AB.pdf>

<sup>27</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/21.03.2017%20Dhom%C3%ABs%20Komb%C3%ABtare%20%C3%AB%20Avokatis.pdf>

<sup>28</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/21.03.2017%20Dhom%C3%ABs%20Komb%C3%ABtare%20%C3%AB%20Avokatis%C3%AB.pdf>

<sup>29</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/21.03.2017%20Akademis%C3%AB%20s%C3%AB%20Shkencave.pdf>

<sup>30</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/21.03.2017%20Gjykat%C3%ABs%20s%C3%AB%20Lart%C3%AB.pdf>

<sup>31</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/28.03.2017%20Dhom%C3%ABs%20Komb%C3%ABtare%20%C3%AB%20Avokatis.pdf>

<sup>32</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/27.03.2017%20Dhom%C3%ABs%20Komb%C3%ABtare%20%C3%AB%20Avokatis%C3%AB.pdf>

<sup>33</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/28.03.2017%20Akademis%C3%AB%20s%C3%AB%20Shkencave.pdf>

<sup>34</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/28.03.2017%20Gjykat%C3%ABs%20s%C3%AB%20Lart%C3%AB.pdf>

<sup>35</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/28.03.2017%20Gjykat%C3%ABs%20Kushtetuese.pdf>

Pavarësisht ngërçit të sipërpërmendur, Komisioni Ad Hoc vijoi punën dhe u konstituua në mungesë të këtij anëtar, në ato raste kur numri i anëtarëve prezent ishte i mjaftueshëm dhe përbënin shumicën e kërkuar me ligj për të vijuar nga puna (nenet 23 dhe 121 të ligjit 115/2016).

Komisioni i pavarur Ad Hoc u angazhua me shqyrtimin e dosjeve dhe verifikimin e kushteve ligjore të kandidatëve nga radhët e avokatisë që shprehën interes për të qenë anëtarë jomagjistratë në dy Këshillat. Verifikimi u krye bazuar në nenin 3 të ligjit nr.115/2016, duke u mbështetur në vlerësimin e kriterëve ligjore, profesionale dhe morale të tyre, sipas një formulari të pikëzuar<sup>36</sup>.

Në bazë të nenit 31 dhe 129 të ligjit nr. 115/2016, Komisioni Ad Hoc i përcolli Prokurorisë së Përgjithshme për verifikimin e kontrollit të integritetit, formularët e tyre të vetë deklarimit. Komisioni është informuar nga Prokuroria e Përgjithshme se kandidatët aplikues nuk prekeshin nga dispozitat e ligjit për dekriminalizimin (referuar nenit 2 të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”). Gjithashtu, Komisioni ka shkëmbyer korrespondencë me Autoritetin e Hapjes së Dosjeve të Ish Sigurimit të Shtetit, lidhur me kandidatët Znj. Fatmira Luli dhe Znj. Nurihan Seiti nëse kanë qenë anëtare, bashkëpunëtore ose të favorizuara nga ish sigurimi i shtetit. Ky institucion ka kthyer përgjigje me disa gjetje të konstatuara për këto subjekte, **por ky informacion nuk është publikuar në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit**. Nisur nga konstatimet e këtij institucioni, Avokati i Popullit hap diskutimin dhe më pas votimin për të vendosur nëse këta kandidatë do konsiderohen se i plotësojnë kushtet ligjore apo jo. Por edhe gjatë diskutimeve, referuar procesverbaleve të publikuara nuk del e qartë përmbajtja e shkresës së Autoritetit të Dosjeve. Në përfundim të votimit u vendos me 3 vota pro dhe një kundër që dy kandidatet plotësojnë kushtet ligjore. Për këto kandidate, anëtarët ranë dakord që të ketë një sistem pikëzimi të diferencuar në momentin e vlerësimit të kriterëve ligjore etike-profesionale, sa i takon kriterit që ka të bëjë me cilësitë morale dhe integritetin.

**Anëtarët e komisionit pasi janë njohur me dosjet e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet ligjore, sipas verifikimit paraprak të kryer nga ana e administratës së institucionit të Avokatit të Popullit në përputhje me nenet 19, 24, 35, 133 kanë vendosur se:**

**Plotësojnë kushtet ligjore për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor<sup>37</sup>:** Alban Toro, Arben Prifti, Arben Vani, Fatos Lazimi, Genti Sinani, Gëzim Allaraj, Saimir Vishaj, Sinan Tafaj, Sokol Lamaj dhe Fatmira Luli.

**Plotësojnë kushtet ligjore për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë<sup>38</sup>:** Floreta Gjini, Gëzim Allaraj, Kozma Jano, Nurihan Seiti dhe Veronika Vangjeli.

**Pas shqyrtimit të dosjeve nga ana e anëtarëve të Komisionit “Ad Hoc” është konstatuar se numri i kandidatëve nga radhët e avokatisë për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilët plotësojnë kriteret formale ligjore është më i ulët, sesa minimumi i mundshëm i parashikuar në nenin 133, pika 1, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”.** Në këto kushte është vendosur që ti drejtohet një shkresë zyrtare Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, për të rishpallur thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit për avokatët që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 117 të ligjit nr.115/2016. Komisioni i Pavarur Ad Hoc ka vlerësuar se kandidaturat që plotësojnë kriteret ligjore në këtë fazë për anëtarë të KLP-së, do të konsiderohen të vlefshme, duke iu shtuar kandidaturave të reja që do të përzgjidhen pas ri shpalljes për shprehje interesi nga Kuvendi. Komisioni vendosi që, në përputhje me nenin 31 dhe 129, të ligjit nr.115/2016 të

<sup>36</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/MIRATIMI%20I%20RREGULLAVE%20DHE%20PROCEDURAVE%20-KLGJ-KLP.pdf>

<sup>37</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/10.04.2017%20Kandidat%C3%ABt%20nga%20Avokatia%20p%C3%ABr%20KLGJ.pdf>

<sup>38</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/10.04.2017%20Kandidat%C3%ABt%20nga%20Avokatia%20p%C3%ABr%20KLP.pdf>

bëjë shpalljen e emrave të kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të KLGJ-së dhe KLP-së, sipas parashikimeve ligjore, si dhe t'ua komunikojë individualisht kandidatëve rezultatin e verifikimit të të dhënave të deklaruara. Pas kësaj faze, puna e komisionit në zbatim të neneve 34 dhe 132 të ligjit 115/2016, u pasua nga vlerësimi i kandidatëve sipas kritereve profesionale dhe morale në bazë të një formulari të pikëzuar.

**d) Ankimet kundër vendimeve të përjashtimit të kandidatëve**

Në mes të kandidatëve të cilët kanë shprehur interesin për KLGJ dhe KLP, ka pasur edhe nga ata të cilët kanë kundërshtuar vendimin e Komisionit Ad Hoc, për përfshirjen e tyre në listën e kandidatëve të cilët nuk përmbushin kriteret ligjore për kandidatë për në dy Këshillat. Kështu, Znj. Betula Toto, e cila ka shprehur interesin për kandidate në KLGJ **ka paraqitur kërkesë-padi në Gjykatën Administrative të Apelit në përputhje me nenet 32 dhe 130 të ligjit 115/2016, me objekt “Shfuqizimin e vendimit të përjashtimit nga lista për KLGJ dhe KLP”**. Lidhur me këtë Komisioni Ad Hoc ka vendosur për përcaktimin e dy prej ndihmës-komisionerëve në institucionin e Avokatit të Popullit, si përfaqësues të autorizuar në procesin gjyqësor të hapur nga ana e Znj. Toto.

Sipas nenit 32, pika 2 të ligjit nr.115/2016, Gjykata Administrative e Apelit duhet të vendosë brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i kësaj Gjykate është përfundimtar dhe i formës së prerë. Nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të Gjykatës së Administrative të Apelit nuk rezultoi të jetë dhënë ende një vendim për ankimin e kandidates së refuzuar. Nëse është kështu, atëherë ky mjet juridik ankimi nuk është efektiv për kandidaten e s'kualifikuar nga lista<sup>39</sup>. Një ankesë tjetër e paraqitur pranë Komisionit të Pavarur Ad Hoc është ajo e Znj. Valentina Teodoresku, ku shprehet kërkesa e saj për t'iu bërë me dije arsyet e renditjes së saj në listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret formale.

**e) Përcjellja tek Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit e listës së kandidatëve që plotësojnë kriteret**

**Në zbatim të nenit 35 dhe 133 të ligjit nr. 115/2016, Komisioni Ad Hoc i ka përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit listën me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta.** Bashkëlidhur është dërguar edhe raporti i vlerësimit si edhe dokumentacioni për çdo kandidat. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në përputhje me nenet 147 dhe 149 të Kushtetutës ka verifikuar dosjen e çdo kandidati dhe në rastin kur janë konstatuar mangësi në dokumentacion ia ka komunikuar këtë kandidatit që të bëjë plotësimet përkatëse brenda afatit të parashikuar nga neni 35 pika 3 e ligjit nr.115/2016. Gjithashtu, Sekretari i Përgjithshëm ka kryer verifikimet përkatëse të fakteve të vetë deklaruara pranë institucioneve ligj zbatuese, të cilat mbledhin, administrojnë dhe përpunojnë këto të dhëna si dhe ka vijuar më pas me përfundimin e vlerësimit të plotësimit të kushteve kushtetuese dhe ligjore, si edhe me tej, me vlerësimin profesional dhe moral të atyre kandidateve që kanë plotësuar kushtet ligjore.

**Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në paraqitjen e raportit përfundimtar ka pasqyruar edhe vlerësimin e dhënë nga ONM lidhur me listat e kandidatëve të hartuar nga ana e tij, për kandidatët e kualifikuar dhe s'kualifikuar në përputhje me nenet 286 dhe 287 të ligjit.** Kushtetuta në nenet 147 dhe 149 dhe ligji 115/2016, neni 35, i kanë njohur Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, si një organ kushtetues, diskrecionin e kryerjes së një vlerësimi të pavarur dhe të pakushtëzuar nga vlerësimet e ONM-së dhe komisioneve Ad Hoc. Në përputhje me neni 35, pika 7 të ligjit nr.115/2016, Sekretari i Përgjithshëm në vlerësimin e tij është mbështetur edhe në procesin e zhvilluar dhe në raportin e miratuar nga Komisioni Ad Hoc.

Në vijim në bazë të pikës 9 të nenit 35, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i dërgon Komisionit të Përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend listat së bashku me raportin vlerësues.

<sup>39</sup>[http://www.gjykataadministrativeapelit.al/?dtregjnga=&dtregjideri=&page\\_id=396&nrakti=&padites=Betula+Toto&ipaditur=&paletet\\_reta=&objekti=&submit=K%C3%ABrko](http://www.gjykataadministrativeapelit.al/?dtregjnga=&dtregjideri=&page_id=396&nrakti=&padites=Betula+Toto&ipaditur=&paletet_reta=&objekti=&submit=K%C3%ABrko)

*f) Procedurat parlamentare për përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve nga radhët e avokatisë*

Lista e kandidatëve të kualifikuar nga avokatia në të dy Këshillat i është paraqitur komisionit përgjegjës për çështjet ligjore nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Kjo listë përbëhej nga 10 kandidatë që garonin për anëtarë në KLGJ dhe nga 7 kandidatë që garonin për anëtarë në KLP<sup>40</sup>. Ky numër korrespondon me numrin minimal dhe maksimal që parashikohet në nenin 35, pika 1 të ligjit nr.115/2016, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante (pra 6 kandidatë nëse i referohemi trefishit të dy vendeve vakante nga radhët e avokatëve).

Në zbatim të pikës 11 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, Komisioni parlamentar i ligjeve krijon një nënkomision me 5 deputetë, prej të cilëve, 3 caktohen nga mazhoranca dhe 2 nga radhët e pakicës parlamentare.

Mbledhja e Komisionit të Ligjeve u realizua në dt.17 Janar 2018 dhe ishte me dyer te hapura. Vëzhguesit e KShH-së monitoruan këtë mbledhje<sup>41</sup>. Rendi i ditës ishte shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për krijimin e nënkomisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. Diskutimet në mbledhjen e këtij Komisioni u shoqëruan me një sërë debatesh lidhur me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të forcave opozitare, duke argumentuar se të gjitha pengesat e krijuara kanë pasur si qëllim kontrollin e vazhdueshëm të KLGJ dhe KLP nga mazhoranca parlamentare. **Gjithashtu, në këtë mbledhje kishte debate dhe mungesë konsensusi lidhur me numrin e kandidatëve, i cili sipas forcës opozitare nuk plotëson kuorumin e kërkuar nga ana e Kushtetutës. Ndërsa sipas përfaqësuesve të mazhorancës parlamentare në këtë komision, dispozitat kushtetuese parashikojnë se numri i kandidatëve jo magjistratë në KLGJ dhe KLP nuk mund të jetë më pak se 6 anëtarë, kur në fakt janë paraqitur 10 kandidatura.** Pas përfundimit të këtij diskutimi u hap votimi për krijimin e Nën Komisionit *ad hoc*. Nga monitorimi i kësaj procedure rezulton se të gjithë anëtarët votuan unanimitisht PRO.

Me 22 janar 2018, nënkomisioni parlamentar për përzgjedhjen e anëtarëve jomagjistratë në dy Këshilla, vijoi sipas rendit të ditës me shqyrtimin e listës së kandidatëve jo magjistratë të ardhur nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Nënkomisioni shqyrtoi nominalisht listën e kandidatëve të kualifikuar. Pas shqyrtimit dhe hedhjes në votim nga nënkomisioni për secilin prej kandidatët, asnjë prej kandidaturave nuk mundi të sigurojë katër votat e nevojshme nga anëtarët e nënkomisionit. Referuar nenit 35, pika 14 e ligjit 115/2016, përzgjedhja e kandidatëve u bë përmes procedurës së hedhjes së shortit manual. Kandidaturat e përzgjedhura me short manual për KLGJ, nga avokatia rezultuan, Z. Arben Vani dhe Z. Sokol Lamaj. Kandidaturat e përzgjedhura me short manual për KLP, nga avokatia rezultuan Z. Kozma Jano dhe Znj. Floreta Gjini.

Në seancën plenare të datës 26.01.2017, Kuvendi nuk mundi të miratojë me shumicë të cilësuar prej 2/3-ve, përkatësisht listën në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për KLGJ-në dhe KLP-në.

**Në bazë të nenit 35, pika 16 të ligjit nr.115/2016**, nëse nuk arrihet shumica e kërkuar në seancë plenare, nënkomisioni miraton një listë të re, brenda 2 ditëve nga votimi në seancë plenare. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej dy të tretave edhe në votimin e dytë, nënkomisioni miraton një listë të re, brenda 2 ditëve nga votimi i fundit në seancë plenare. Lista e re i paraqitet Kryetarit të Kuvendit dhe hidhet në votim në seancën më të afërt të Kuvendit por jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e listës. Kuvendi miraton listën e kandidatëve me dy të tretat e të gjithë anëtarëve. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej dy të tretave edhe në votimin e tretë, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur.

<sup>40</sup> <https://www.parlament.al/News/Index/5255>

<sup>41</sup>Raport i monitorimit i KShH-së për ngritjen e nën komisionit Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për KLP dhe KLGJ.



Pas dështimit të seancës së parë plenare për të miratuar në bllok listën e paraqitur nga nënkomisioni parlamentar, ky i fundit u mblodh sërish konform dispozitave të ligjit nr.115/2016. Pas shqyrtimit dhe hedhjes në votim nga nënkomisioni për secilin prej kandidatët nga radhët e avokatisë (duke mos përjashtuar edhe ata të përzgjedhur në fazën e parë), asnjë prej kandidaturave nuk mundi të sigurojë katër votat e nevojshme nga anëtarët e nënkomisionit. Me dorëheqjen e një kandidati për anëtar nga radhët e avokatëve në KLGJ, lista e kandidatëve të kualifikuar zbriti nga 10 në 9 kandidatë<sup>42</sup>, ndërkohë që për KLP ishte e njëjta listë pa ndryshime, përkatësisht me 7 anëtarë. Sërish, edhe në mbledhjen e dytë të nënkomisionit parlamentar, në mungesë të dialogut të nevojshëm për të arritur shumicën e kërkuar, përzgjedhja e kandidatëve u bë përmes procedurës së hedhjes së shortit manual. Pas shortit manual, emrat e përzgjedhur janë Z. Fatos Lazimi dhe Znj. Fatmira Luli për KLGJ si dhe Z. Gëzim Allaraj dhe Znj. Floreta Gjini për KLP. Kjo listë rrëzohet sërish në bllok për herë të dytë për shkak të mosarritjes së kuorumit të kërkuar në seancën plenare të Kuvendit (vendimet nr. 11/2018 dhe 12/2018, datë 01.02.2018).

Në fazën e tretë të procedurave parlamentare, mblidhet sërish nënkomisioni parlamentar në datën 05.02.2018, ku në mungesë të shumicës së kërkuar për votimin e kandidatëve nga të dy listat realizohet sërish shorti manual. Emrat e zgjedhur pas shortit manual janë Znj. Fatmira Luli dhe Z. Alban Toro për KLGJ-në si dhe Znj. Nurihan Seiti Meta dhe Z. Tartar Bazaj për KLP-në. Kuvendi i Shqipërisë me vendimin 18/2018 dhe 19/2018, të datës 08.02.2018 vendosi të konsiderojë të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të mosarritjes së kuorumit të kërkuar prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në zbatim të pikës 17 të nenit 35 të ligjit 115/2016 vendimi 18/2018<sup>43</sup> dhe vendimi 19/2018<sup>44</sup> i Kuvendit për miratimin e listës së kandidatëve për KLGJ dhe KLP janë botuar në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

### **1.1.2 Kriteret dhe profili i kandidatëve nga radhët e avokatisë që kandidojnë për dy Këshillat**

Në nenet 19, 34 dhe 132 të ligjit 115/2016 përcaktohen kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët nga radhët e avokatisë për të qenë pjesë e dy Këshillave<sup>45</sup>. Lidhur me përmbushjen ose jo të këtyre kriterëve, në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit apo në faqe të tjera zyrtare të lidhura ka shumë pak informacion për përvojën dhe platformat e këtyre kandidatëve, duke prekur transparencën karshi publikut. Gjithashtu, nuk është bërë publik vlerësimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit për këta kandidatë.

Sa i takon kandidatëve të cilët nuk janë kualifikuar, pasi nuk kanë plotësuar kushtet ligjore të parashikuara në nenet 19 dhe 117 të ligjit nr.116/2016, rezulton se shumica dërmuese e tyre nuk plotësonin kriterin e vjetërsisë në punë. Një minorancë e kandidatëve jo të kualifikuar ndërkohë rezulton se kanë dhënë dorëheqjen, kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit, apo kanë pasur mungesa në dokumentacionin e nevojshëm që vërteton plotësimin kriterëve ligjore përkatëse.

**Gjatë diskutimeve në nënkomisionin parlamentar për kandidaturat, përfaqësues të opozitës kanë deklaruar se nuk është marrë në konsideratë vlerësimi i ONM-së mbi nivelin profesional të kandidatëve.**

Gjithashtu, rezulton se pakica parlamentare në nënkomisionin Ad Hoc për vlerësimin dhe zgjedhjen e kandidatëve ka publikuar një raport alternativ, në dt. 18.01.2018 mbi shkeljet e konstatuara në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve jomagjistratë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë

<sup>42</sup> <http://www.javanews.al/doreheqja-nga-kandidimi-zbardhet-letra-e-vishajt-sdoja-te-zgjidhesha-gogla/>

<sup>43</sup> <http://qzb.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2019/VENDIM%20KUVENDI%20nr.%2018-2018.%20date%208.2.2018.pdf> (Vendimi 18/2018 i Kuvendit për miratimin e listës së kandidatëve për KLGJ)

<sup>44</sup> <http://qzb.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2019/VENDIM%20KUVENDI%20nr.%2019-2018.%20date%208.2.2018.pdf> (vendimi 19/2018 i Kuvendit për miratimin e listës së kandidatëve për KLP)

<sup>45</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ligj\\_nr\\_115\\_2016\\_per\\_organet\\_e\\_qeverisjes\\_se\\_sistemit\\_te\\_drejtjesise\\_1726.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ligj_nr_115_2016_per_organet_e_qeverisjes_se_sistemit_te_drejtjesise_1726.pdf)

të Prokurorisë. Ndër shkeljet e raportuara nga pakica parlamentare për disa nga kandidatët që konkurrojnë nga avokatia dhe të cilët nuk përmbushin një ose më shumë se disa prej kriterëve ligjore dhe rrjedhimisht duhet të ishin s'kualifikuar nga gara për të dy Këshillat, janë si vijon:

- a) Mos shlyerja rregullisht e detyrimeve tatimore nga disa prej kandidatëve, sipas ligjit përbën shkak për s'kualifikim, por në fakt, një mos përmbushje e tillë, nuk është konsideruar si kusht s'kualifikues, por si një mangësi në kritere (pra, si një kriter vlerësues). Kandidatët janë kualifikuar, dhe për këtë mangësi, thjesht iu janë ulur pikët në vlerësim!
- b) Kandidati, Z. Kozma Jano nuk përmbush kushtin e parashikuar në nenet 19/3/f dhe 117/3/f të ligjit nr. 115/2016, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, në zgjedhjet vendore 2011 ka qenë kryesues i listës së këshilltarëve bashkiak të subjektit politik Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH). Gjithashtu, ky kandidat rezulton se ka qenë i kallëzuar penalisht.
- c) Kandidati, Z. Petrit Gaci ka qenë hetues në periudhën 1988-1991 si dhe është larguar me masë disiplinore “shkarkim nga detyra e hetuesit” (1991), dhe interpretimi se “ligji parashikon si kusht s'kualifikues largimin me masë disiplinore vetëm për gjyqtar, prokuror dhe OPGJ” dhe jo për hetuesit e dikurshëm, është krejtësisht i gabuar! Hetuesi i dikurshëm sipas legjislacionit procedural ka rol dhe përgjegjësi të njëjtë apo të ngjashme me OPGJ sot.
- d) Kandidatët Znj. Nurihan Meta Seiti dhe Znj. Fatmira Luli, kanë qenë pjesëmarrëse, para vitit '90, në gjyqe politike, respektivisht në cilësinë e prokurores dhe gjyqtares. Ligji kërkon që të favorizuarit e sigurimit të shtetit para vitit 1990 duhet të s'kualifikohen.
- e) Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Z. Alban Toro i mungon Libreza e Punës, për të provuar se ka ushtruar gjatë 10 viteve të fundit, pa ndërprerje, profesionin e avokatit. Ndërkohë Z. Genti Sinani nuk ka dokumentacion që të provojë kohën kur është licensuar si avokat. Gjithashtu, Z. Arben Prifti nuk figuron se ka ushtruar avokatinë për së paku 10 vjetët e fundit pa ndërprerje.

Gjithashtu, referuar të dhënave të publikuara si dhe, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka vlerësuar kriteret profesionale e morale vetëm për kandidatët të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë. Referuar nenit 35, pika 6 të ligjit nr.115/2016, vlerësimi i kriterëve morale dhe profesionale të kandidatëve nga S. Përgjithshëm i Kuvendit bëhet sipas të njëjtave rregulla dhe specifikave të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji (pra njësoj si vlerësimi që kryen Komisioni i pavarur Ad-Hoc. Vlerësimi i Sekretarit të Përgjithshëm ka ndjekur të njëjtën linjë kryesisht me atë të Komisionit të pavarur Ad-Hoc. Vetëm në rastet kur kandidatët nuk kanë shlyer detyrimet tatimore për ushtrimin e profesionit të avokatit, atyre ju është zbritur 3 pikë nga pikëzimi total i dhënë nga Komisioni i pavarur Ad-Hoc. Shumica dërmuese e kandidatëve të s'kualifikuar janë penalizuar për shkak se nuk plotësonin kriterin e vjetërsisë ose nuk provonin me dokumentacion plotësimin e këtij kriteri.

KShH vlerëson se ligji nr.115/2016 parashikon mekanizma jo të domosdoshëm kontrolli dhe vlerësimi të përsëritur, sikurse është ai që bëhet në faza të ndryshme të procesit, por pak a shumë në të njëjtën mënyrë, nga Komisioni i Pavarur Ad-Hoc dhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

### **1.1.3 Transparenca dhe vizibiliteti i procesit të përzgjedhjes dhe zgjedhjes së anëtarëve të Këshillave nga radhët e avokatisë**

Përgjithësisht procesi i krijimit dhe konstituimit të Komisionit të Pavarur Ad Hoc dhe përzgjedhjes së kandidatëve avokatë për KLGJ dhe KLP është karakterizuar nga transparenca.

Kryesisht institucioni i Avokatit të Popullit ndërmjet përditësimit të faqes së tij zyrtare ka informuar vazhdimisht publikun lidhur me ecurinë e këtij procesi. Megjithatë, ka pasur edhe raste kur në faqen

zyrtare të këtij institucioni nuk janë gjendur të publikuara procesverbalet e mbledhjeve,<sup>46</sup>. Sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të Komisionit Ad Hoc nuk është lejuar prezenca e publikut në mbledhje. Neni 27, pika 2 e ligjit nr. 115/2016, parashikon se mbledhjet e këtij Komisioni janë të mbyllura. Megjithatë, kemi mendimin se në funksion të garantimit të transparencës së procesit, do vlerësohej pozitivisht nëse në faqen e Avokatit të Popullit do ishin publikuar procesverbalet e mbledhjeve të këtij komisioni.

Ndërkohë sa i takon transparencës në faqen zyrtare të Kuvendit lidhur me këtë proces, KShH nuk ndan të njëjtin vlerësim pozitiv. I njëjti konstatim vlen edhe për mungesën e transparencës në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Akademisë së Shkencave, të cilat në faqet e tyre zyrtare kanë përcjellë vetëm listën e anëtarëve të Komisionit Ad Hoc që përfaqëson institucionin e tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit të publikuar, kemi shfaqur pengesa në drejtim të mungesës së transparencës për publikimin e këtyre dokumenteve:

- a) Përgjigja zyrtare e dërguar nga Autoriteti për Informimin e Dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit (shkresa nr.153 datë 24.03.2017).
- b) Shkresë zyrtare drejtuar Autoritetit për Informimin e Dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, në lidhje me sqarimin e pjesëmarrësve të kandidatëve në gjyqe politike, dhe përkufizimin e togfjalëshit “fond i sigurimit të shtetit”, nëse do të përbëjë shkak ligjor për listimin e tyre, në listën e kandidatëve nga radhët e avokatisë, të cilët nuk plotësojnë kriteret ligjore (shkresa nr.63/2 datë 4.04.2017)
- c) Dy shkresa të Prokurorisë së Përgjithshme, më konkretisht shkresa me nr.786/20 datë 04.04.2017, si dhe shkresa me nr.786/22 datë 07.04.2017.

Sikurse është evidentuar më herët, mangësi në funksion të garantimit të transparencës konsiderohet edhe informacionin i vakët lidhur me profilin e kandidatëve për KLGJ dhe KLP nga radhët e avokatëve, mospublikimi i opinioneve të ONM-së lidhur me këta kandidatë, mos publikimi i platformave të kandidatëve, çka nuk ka bërë të mundur që publiku të njihet dhe të informohet objektivisht me këto informacione zyrtare.

## **1.2 Anëtarët jo magjistratë nga trupa e fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës**

### **1.2.1 Ligjshmëria e procedurave për përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës**

Në përputhje me Ligjin nr. 115/2016, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka shpallur vendet vakante për 2 anëtarë të KLGJ-së dhe 2 anëtarë të KLP-së nga trupa e pedagogëve. Thirrja publike ka respektuar kërkesat e ligjit nr. 115/2016, duke u publikuar në faqen zyrtare të fakulteteve të drejtësisë, Shkollës së Magjistraturës dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL).<sup>47</sup> Duke qenë se thirrja është shpallur në përputhje me nenin 37 dhe 135 të këtij ligj, nuk ka qenë i nevojshëm zbatimi i nenit 38 dhe 136 të këtij ligji, i cili njuh detyrimin ligjor për shpalljen e thirrjes nga ana e Ministrit të Drejtësisë.

#### **a) Procedura e ndjekur nga Shkolla e Magjistraturës dhe fakultetet e drejtësisë**

<sup>46</sup> Konkretisht, proces - verbali nr.64 datë 13.03.2017, proces-verbali nr.78 datë 24.03.2017, proces-verbali nr.78/1 datë 31.03.2017, proces-verbal nr.109/13 datë 18.04.2017, proces-verbal nr.109/14 datë 18.04.2017, proces-verbali nr.114/17 datë 27.04.2017

<sup>47</sup>Lista e IAL-ve publike, jopublike dhe publike të pavarura gjendet në link: [https://www.asc.al/sq/?option=com\\_k2&view=item&layout=item&id=6&Itemid=677](https://www.asc.al/sq/?option=com_k2&view=item&layout=item&id=6&Itemid=677)

Në përputhje me nenet 36, pika 3 dhe 4, si dhe 134, pikat 3 e 4 të ligjit nr. 115/2016, secili prej IAL-ve që ka në përbërje si njësi kryesore, fakultete të drejtësisë të akredituar, përzgjedh jo më shumë se 3 kandidatë nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë. Ndërkohë që Shkolla e Magjistraturës përzgjedh jo më shumë se një kandidat nga radhët e pedagogëve me kohë të plotë dhe pedagogëve me kohë të pjesshme me kushtin që të mos jenë magjistratë në detyrë, avokatë ose të punësuar me kohë të plotë në OJF.

### ➤ Procedura e ndjekur nga Shkolla e Magjistraturës

Më datë 16.01.2017, në përputhje me nenet 37 dhe 135 të ligjit nr. 115/2016, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës ka shpallur thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit nga pedagogët e kësaj shkolle për anëtarë në KLGJ<sup>48</sup> dhe KLP<sup>49</sup>. Për shkak të mungesës së numrit minimal të kandidatëve, përkatësisht 6 kandidatura për pedagogët, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka rishpallur thirrjen tre herë, respektivisht për të dy këshillat. Në përputhje me nenin 40 të Ligjit, në respektim të afatit 7 ditor nga dita kur mbyllet afati për dorëzimin e shprehjeve të interesit<sup>50</sup>, Këshilli Pedagogjik pranë Shkollës së Magjistraturës ka zhvilluar mbledhjen për verifikimin e dokumentacionit të depozituar nga ana e pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë shprehur interesin për të kandiduar.<sup>51</sup> Nga pasqyrimi në media i këtij procesi nuk rezultojnë që të ketë pasur ankime kundër vendimeve për përjashtim, si rrjedhojë e shkeljeve të rënda procedurale.

Në zbatim të neneve 42 dhe 140 të ligjit nr.115/2016, më datë 20.02.2017 është mbledhur Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës për të realizuar procesin e votimit të kandidatëve anëtarë për KLGJ dhe KLP, në të cilin kanë marrë pjesë 14 anëtarë të Këshillit me të drejtë vote.<sup>52</sup> Nga njoftimi i publikuar në faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës, rezultojnë se procedurat e votimit janë realizuar bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 115/2016. Teksa rezultojnë i pasqyruar krijimi i komisionit të votimit të zgjedhur me short nga radhët e anëtarëve të Këshillit Pedagogjik,<sup>53</sup> nuk është pasqyruar ndërkohë në këtë njoftim, përbërja e këtij komisioni. **Nga rezultati i votimit të shpallur nga ana e komisionit të votimit kanë rezultuar fitues:**<sup>54</sup>

- Ilir Panda për Këshillin e Lartë Gjyqësor
- Alma Faskaj (Vokopola) për Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Kandidatja për në KLP, Znj. Alma Faskaj (Vokopola) u zgjodh pjesë e organeve të vettingut, në cilësinë e komisioneres në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Për këtë arsye është rishpallur thirrja për herë të tretë nga Shkolla e Magjistraturës.<sup>55</sup> Më datë 27.07.2017, rezultojnë se është mbledhur Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës, për të votuar për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të KLP-së, Z. Gent Ibrahimimi. Në faqen zyrtare të shkollës së Magjistraturës është publikuar vendimmarrja e Komisionit të Votimit “Për përzgjedhjen e Z. Gent Ibrahimimi si kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.<sup>56</sup>

**Në nenin 45, pika 7 të ligjit nr. 115/2016 është parashikuar vetëm njoftimi publik i vendimeve në përfundim të Mbledhjes së Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, ndërkohë që nga leximi literal i kësaj dispozite nuk parashikohet detyrimi për publikimin e procesverbalit. Megjithatë, kemi mendimin se procesverbali i hartuar nga anëtarët e komisionit të votimit është një akt tepër i rëndësishëm i cili i shërben transparencës së kësaj procedure, pasi vetëm**

<sup>48</sup><http://www.magjistratura.edu.al/976-thirrje-per-paraqitjen-e-interesit-per-anetare-te-klgj-16-janar-2017.html>

<sup>49</sup><http://www.magjistratura.edu.al/975-thirrje-per-paraqitjen-e-interesit-per-anetare-te-klp-16-janar-2017.html>

<sup>50</sup>Afati për shprehjen e interesit është përmbyllur më datë 31.01.2017.

<sup>51</sup><http://www.magjistratura.edu.al/1011-thirrje-per-mbledhjen-e-keshillit-pedagogjik-ne-date-20-shkurt-2017-16-shkurt-2017.html>

<sup>52</sup><http://www.magjistratura.edu.al/index.php?id=1014>

<sup>53</sup><http://www.magjistratura.edu.al/1011-thirrje-per-mbledhjen-e-keshillit-pedagogjik-ne-date-20-shkurt-2017-16-shkurt-2017.html>

<sup>54</sup><http://www.magjistratura.edu.al/index.php?id=1015>

<sup>55</sup>Njoftim për ri shpalljen e thirrjes për herë të tretë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit:

<https://www.parlament.al/News/Index/5532>

<sup>56</sup><http://www.magjistratura.edu.al/index.php?id=1103>



**nëpërmjet këtij akti konstatohet numri i pjesëmarrësve, diskutimet parimore dhe procedurale, numri i votave të hedhura dhe votave të pavlefshme, si dhe numri i votave për çdo kandidat.**

Gjithashtu, nuk mund të konstatohet nëse në përputhje me nenin 46 të Ligjit nr. 115/2016 ka pasur ankime kundër vendimeve të Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik. Edhe në media nuk rezulton që të jetë pasqyruar një fakt i tillë.

➤ **Procedura e ndjekur nga institucionet e arsimit të lartë (fakultetet e drejtësisë)**

Duke iu referuar të dhënave nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në vendin tonë rezultojnë 37 institucione të arsimit të lartë të akredituara.

Mungesa e kandidaturave ose numri i pamjaftueshëm i tyre për anëtar në KLGJ dhe KLP nga institucionet e arsimit të lartë ka sjellë gjithashtu vonesa në procesin e plotësimit të vakancave përkatëse në të dyja Këshillat. Konkretisht, në datën 13.03.2017, është vendosur pezullimi i procedurave të thirrjes së Mbledhjes së Posaçme të drejtuesve të institucioneve të arsimit të lartë për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve<sup>57</sup>. Si rrjedhojë është përcjellë kërkesa për ri-shpalljen për herë të tretë të thirrjeve për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga anëtarët e personelit akademik.<sup>58</sup> Lista e kandidaturave të përzgjedhura nga IAL-të ose nuk mund të aksesohet në rubrikat përkatëse të faqeve të tyre zyrtare. Kështu, kandidaturat për në KLGJ në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës nuk mund të aksesohet në versionin online.<sup>59</sup> Gjithashtu, në seksionin e eventeve dhe njoftimeve në faqen zyrtare të këtij Universiteti është e pamundur që të aksesohen të dhëna për vitin 2017. E njëjta problematikë vërehet edhe në aksesimin e të dhënave nga universitetet e tjera, duke përfshirë dhe ato publike siç është Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër.<sup>60</sup>

Mungesa e interesit nga universitetet publike është pasqyruar dhe në media. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka kërkuar kontribute nga 5 universitetet private.<sup>61</sup> Nga universitetet vërehet një mungesë e transparencës për të pasqyruar procesin e votimit, procesverbalet përkatëse, ndërkohë që kandidatët e zgjedhur rezultojnë vetëm në raportin e publikuar nga ana e Kuvendit RSH. **Bazuar në këto të dhëna, publiku e ka të pamundur që të konkludojë nëse procesi i realizuar nga IAL-të është zhvilluar mbi baza meritokracie, në respektim të parimeve të një konkurrimi të ndershëm.** Ky proces është kontestuar nga opozita parlamentare. Sipas një raporti paralel të opozitës parlamentare të publikuar në media, pasqyrohet se procedura e votimit e realizuar nga organet e arsimit të lartë ka eliminuar në mënyrë përfundimtare konkurrimin, duke çuar në paracaktimin e anëtarëve të KLGJ dhe KLP.<sup>62</sup> Është paraqitur e kontestueshme procedura e kualifikimit e realizuar nga Rektori dhe Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë pranë Universitetit New York Tiranë dhe pranë Universitetit European të Tiranës.<sup>63</sup>

Hezitimi për të kandiduar në radhët e pedagogëve në institucionet e arsimit të lartë është vënë në dukje edhe nga dekani i Fakultetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër. Sipas tij, kriteri ligjor për të pasur minimalisht 15 vite përvojë ka krijuar tepër problematika, duke qenë se fakultetet e drejtësisë në vendin tonë janë fakultete të reja.<sup>64</sup>

Mbledhja e posaçme e realizuar nga Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, më datë 9 Shkurt 2017, është pasqyruar gjerësisht në media. Rezulton se 64 pedagogët e Asamblesë së Personelit Akademik të Fakultetit të Drejtësisë kanë votuar kolegët e tyre, me qëllim mbështetjen e

<sup>57</sup> Bazuar në Shkresën nr. 1760 Prot., datë 27.06.2017 të adresuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit drejt 7 (shtatë) Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL-ve).

<sup>58</sup> <http://www.droni.al/wp-content/uploads/2017/07/Rishpallje-per-here-te-trete.pdf>

<sup>59</sup> <https://www.uamd.edu.al/new/?p=8018>

<sup>60</sup> <http://www.unishk.edu.al/multimedia/fotogaleri/>

<sup>61</sup> <https://sot.com.al/politike/bojkoti-i-klgj-dhe-klp-nga-akademik%C3%ABt-kuvendi-k%C3%ABrkon-p%C3%ABrfaq%C3%ABSues-nga-universitetet-private>

<sup>62</sup> <http://www.rd.al/2018/01/baterdia-e-rames-per-kapjen-e-drejtises/>

<sup>63</sup> Po aty.

<sup>64</sup> <http://tv1-channel.tv/2017/07/04/hezitimi-per-aplikimet-ne-klgj-dhe-klp/>

tyre.<sup>65</sup> Tre kandidaturat e zyrtarizuara për pozicionet e anëtarit të KLGJ-së janë: Z. Erjon Muharremaj (me 17 vota), Znj. Mirela Bogdani (e renditur në vend të parë me 28 vota) dhe Z. Maksim Qoku (me 13 vota).<sup>66</sup> Tre kandidaturat e zyrtarizuara për pozicionet e anëtarit të KLP-së janë: Znj. Mirela Bogdani (23 vota – e renditur në vend të parë), Znj. Oriona Muçollari (22 vota – e renditur në vend të dytë) dhe Znj. Eneida Sema (16 vota – e renditur në vend të tretë). *Në faqen zyrtare të Fakultetit të Drejtësisë nuk rezulton i publikuar procesi i votimit, numri i votave të pavlefshme apo procesverbalet përkatëse. Nga media rezulton se kandidatët kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga ligji, si: më shumë se 5 vite eksperiencë në profesion sipas ligjit; nuk kanë marrë masa disiplinore; kanë bërë vetë-deklarim dhe është plotësuar një raport për secilin për plotësimin ose mosplotësimin e kriterëve ligjore.*<sup>67</sup> **Raporti i vlerësimit, detyrim i parashikuar në pikën 6, neni 40 të Ligjit nr. 115/2016 nuk është i aksesueshëm në formë elektronike, prandaj rezulton e pamundur që të konkludohet nëse kushtet e parashikuara për secilin kandidat janë plotësuar apo jo.**

➤ **Procedura e zhvilluar nga Mbledhja e Posaçme e institucioneve të arsimit të lartë dhe Shkollës së Magjistraturës**

Më datë 20.09.2017 rezulton që në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të jetë zhvilluar Mbledhja e Posaçme e institucioneve të arsimit të lartë dhe Shkollës së Magjistraturës, referuar nenit 48 të ligjit nr. 115/2016.<sup>68</sup> Kjo mbledhje u realizua pas publikimit të thirrjes që mban datën 05.09.2017.<sup>69</sup> Në vendimin nr. 9 të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, zgjedhja e kandidatëve për anëtarë të KLGJ dhe KLP është pika e vetme e rendit të ditës.<sup>70</sup> Nga media rezulton se lista e plotë e kandidatëve pedagogë për KLGJ dhe KLP është:<sup>71</sup>

1. Z. Sandër Beci (Universiteti Luigj Gurakuqi, kandidat për në KLP)
2. Znj. Oriona Mucollari (Universiteti i Tiranës, Kandidat për në KLP)
3. Z. Ilir Panda (Shkolla e Magjistraturës, Kandidat për në KLGJ)
4. Z. Maks Qoku (Universiteti i Tiranës, Kandidat për në KLGJ)
5. Znj. Mirela Bogdani (Universiteti i Tiranës, Kandidate për në KLGJ dhe KLP)
6. Znj. Eneida Sema (Universiteti i Tiranës, Kandidat për në KLP)
7. Znj. Eriona Canaj (Universiteti Europian i Tiranës, Kandidat për në KLP dhe KLGJ)
8. Z. Dariel Sina (Universiteti New York-Tiranë, Kandidat për në KLP dhe KLGJ)
9. Z. Gent Ibrahimimi (Shkolla e Magjistraturës, Kandidat për në KLP)
10. Z. Erion Muharremaj (Universiteti i Tiranës, Kandidat për në KLGJ)
11. Znj. Brunela Kullolli (Universiteti Aleksandër Moisiu, kandidate për në KLGJ )

Në këtë mbledhje kanë marrë pjesë drejtuesit e institucioneve të arsimit të lartë publik e jopublik dhe të Shkollës së Magjistraturës, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, deputetë të Komisionit Parlamentar të Ligjeve dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtarë, në cilësinë e vëzhguesve. Kjo mbledhje është drejtuar nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës dhe është monitoruar nga përfaqësues të KSHH-së. **Nga ky monitorim është konstatuar se numri i kandidatëve të propozuar nga IAL-të që paraqitën platformat e tyre përpara Mbledhjes së Posaçme, ishte shumë më i ulët në raport me numrin që parashikojnë nenet 36 dhe 134, të këtij ligji.**<sup>72</sup> Vlen të përmendet se platformat e kandidatëve nuk janë pasqyruar në media, çka nuk i mundësoi kandidatëve ti nënshtroheshin një vlerësimi nga publiku. Saktësia dhe ligjshmëria e procesverbalit, i cili është përpiluar nga ana e komisionit të votimit, në përputhje me nenin 51, pika 4 të ligjit nr.115/2016, nuk mund të konstatohet përsa kohë që ky procesverbal nuk gjendet i publikuar në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse.

<sup>65</sup><https://www.youtube.com/watch?v=VXhYBb3PGgk>

<sup>66</sup><http://www.oranews.tv/article/fakulteti-i-drejtisesise-zyrtarizon-kandidaturat-per-klgj-e-klp>

<sup>67</sup><https://www.youtube.com/watch?v=VXhYBb3PGgk>

<sup>68</sup><https://www.parlament.al/News/Index/5490>

<sup>69</sup><https://www.parlament.al/News/Index/5514>

<sup>70</sup><https://www.parlament.al/News/Index/5514>

<sup>71</sup><http://www.scan-tv.com/zgjidhen-sot-anearet-e-klgj-dhe-klp-lista-e-plote-e-kandidateve/>

<sup>72</sup><http://www.ahc.org.al/pjesemarrje-e-ulet-ne-garen-per-organet-e-qeverisjes-se-sistemit-te-drejtisesive/>

Mbledhja e Posaçme ka realizuar procedurë të përbashkët për të dy kategoritë e kandidatëve për anëtar të KLGJ dhe KLP, në përputhje me nenin 48, pika 6 të ligjit nr. 115/2016. Mendojmë se realizimi i një procedure të tillë është i ligjshëm, për sa kohë që vakancat në dy Këshillat përkatës janë krijuar në të njëjtën kohë. Në aspektin metodologjik, kjo mbledhje është karakterizuar nga adresimi i pyetjeve ndaj kandidatëve në mënyrë pro aktive nga anëtarët e këtij Komisioni. Natyra e këtyre pyetjeve u bazua kryesisht në vlerësimin e integritetit moral të kandidatëve. Pyetjet e adresuara bazoheshin kryesisht në kujtesën dhe logjikën e kandidatëve dhe në disa raste anashkaluan kulturën juridike të tyre. Pyetjet e adresuara në formatin anglosakson nëpërmjet versionit të kujtesës me anë të emrave të personave, mendojmë se nuk ishte versioni i duhur për vënien në dukje të integritetit moral dhe profesional. Gjatë kësaj faze kishte dhe pyetje specifike të cilat ishin tepër logjike, që vunë në dukje mungesën e njohurive të legjislacionit të brendshëm procedural nga kandidatët.<sup>73</sup> Gjithashtu, pyetjet nuk ishin të diferencuara sipas fushës dhe natyrës së kompetencave të Këshillave, ku aplikonin kandidatët.

Me vendimin nr. 1, dt. 20.09.2017, Mbledhja e Posaçme miratoi rregullat për vlerësimin e kriterëve profesionale dhe etike. Formulari tip i miratuar gjithashtu si një mjet metodologjik i vlerësimit objektiv kategorizohet në 4 kriterë bazë si: *kriteri i meritave profesionale (30 pikë); kriteri i meritave morale (20 pikë); kriteri i meritave organizative, drejtuese, menaxheriale (30 pikë) dhe kriteri i meritave të tjera (20 pikë).*

Në përfundim të procesit të votimit, 24 anëtarët e mbledhjes së posaçme, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr.115/2016, vlerësuan, votuan dhe më pas publikuan:

a) **listën e kandidatëve të përzgjedhur për KLGJ**, si vijon:<sup>74</sup>

1. <b>Illir Panda</b> (Shkolla e Magjistraturës)	<b>84.95 pikë</b>
2. <b>Mirela Bogdani</b> (Universiteti i Tiranës)	<b>82.7 pikë</b>
3. <b>Erjon Muharremaj</b> (Universiteti i Tiranës)	<b>79 pikë</b>
4. <b>Erjona Canaj</b> (Universiteti European i Tiranës)	<b>75.3 pikë</b>
5. <b>Maksim Qoku</b> (Universiteti i Tiranës)	<b>73.34 pikë</b>
6. <b>Brunela Kullolli</b> (Universiteti “Aleksandër Moisiu”)	<b>66.87 pikë</b>
7. <b>Dariel Sina</b> (Universiteti i New York, Tiranë)	<b>65 pikë</b>

b) **listën e kandidatëve të përzgjedhur për KLP**, si vijon:<sup>75</sup>

1. <b>Gent Ibrahim</b> (Shkolla e Magjistraturës)	<b>90.47 pikë</b>
2. <b>Mirela Bogdani</b> (Universiteti i Tiranës)	<b>86.95 pikë</b>
3. <b>Sandër Beci</b> (Universiteti “Luigj Gurakuqi”)	<b>82 pikë</b>
4. <b>Dariel Sina</b> (Universiteti i New York, Tiranë)	<b>71.7 pikë</b>
5. <b>Erjona Canaj</b> (Universiteti European i Tiranës)	<b>68.2 pikë</b>
6. <b>Eneida Sema</b> (Universiteti i Tiranës)	<b>66.95 pikë</b>
7. <b>Oriona Mucollari</b> (Universiteti i Tiranës)	<b>56.2 pikë</b>

Raporti i vlerësimit të Mbledhjes së Posaçme, lidhur me shkallën e përmbushjes së kriterëve etike e profesionale të kandidatëve të mësipërm nuk rezulton i aksesueshëm në asnjë faqe zyrtare. Të dhëna shumë të përmbledhura të këtij raporti janë pasqyruar në raportin e vlerësimit që ka përpiluar Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

<sup>73</sup><https://www.youtube.com/watch?v=HxS21-msPaE>

<sup>74</sup><https://www.parlament.al/News/Index/5490>

<sup>75</sup><https://www.parlament.al/News/Index/5490>

Me qëllim përfshirjen e kandidatëve nga IAL-të publike dhe ato jopublike, ligjvënësi në nenin 51, pika 5 të Ligjit nr. 115/2016 parashikon procedurën e përzgjedhjes ku ndër të tjerash thuhet se “*Quhen të përzgjedhur 7 kandidatët nga IAL-et publike ose Shkolla e Magjistraturës dhe 3 kandidatët nga IAL-et jopublike që kanë marrë numrin më të madh të votave. ... Në qoftë se nuk ka kandidatë të mjaftueshëm nga IAL-et jopublike për të plotësuar kuotat e parashikuara në këtë pikë, vendet e mbetura bosh plotësohen nga kandidatët e IAL-ve publike*”. Sipas kësaj dispozite, për një vend vakant nga IAL-të dhe Shkolla e Magjistraturës kërkohen 10 kandidatë. Si në rastin e kandidatëve të përzgjedhur si anëtar të KLGJ-së dhe të KLP-së, rezulton se në përputhje dhe me nenin 36, pika 3 të Ligjit nr. 115/2016, secili prej institucioneve të arsimit të lartë përzgjedh jo më shumë se 3 kandidatë nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë. **Nga përzgjedhja e realizuar, KShH vëren se kandidatët nga IAL jopublike nuk kanë qenë 3, dhe plotësimi i kuotave është realizuar me kandidatët e IAL-ve publike.**

Numri minimal i kandidatëve parashikuar në nenin 51, pika 5 nuk përputhet me atë të parashikuar në nenin 53, pika 1 të ligjit nr.115/2016, i cili parashikon se “... i përcillen Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit në një listë me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta, por jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante...”. Sipas kësaj dispozite, për dy vende vakante në secilin prej Këshillave kërkohen të paktën 6 kandidatë (pra 3 për një vend vakant). Rrjedhimisht kemi mendimin se neni 51, pika 5 dhe neni 53, pika 1 e ligjit nr.115/2016 kanë nevojë të harmonizohen për të shmangur paqartësitë, subjektivizmin dhe zbatimin jo të njëtrajtshëm të ligjit.

Një nga të drejtat që ligjvënësi i ka njohur kandidatëve nga bota akademike për t’u bërë pjesë e Këshillave është e drejta e ankimit ndaj vendimmarrjeve të mbledhjes së posaçme. Në media apo në faqet zyrtare të institucioneve nuk është pasqyruar asnjë ankim i depozituar nga ana e kandidatëve për shkelje të procedurës, referuar nenit 52 të Ligjit nr. 115/2016.

## **b) Procedura e ndjekur në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë**

Nga dy raportet e publikuara nga Sekretari i Përgjithshëm, përkatësisht për vendet vakante në secilin Këshill, rezulton se është kryer procesi i verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave për vendet vakante në secilin Këshill nga trupa e pedagogëve<sup>76</sup>. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, pas depozitimit të listës së kandidatëve, në respektim të nenit 53, pika 2 dhe nenit 35 të ligjit nr.115/2016 ka filluar menjëherë punën për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët. Më datë 03.10.2017, nëpërmjet shkresës nr. 2014/24, datë 03.10.2017, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i ka përcjellë ONM-së kopje të dokumentacionit të administruar për çdo kandidat.

Gjatë verifikimit të plotësimit të kushteve nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm është konkluduar se disa kandidatë kanë pasur mangësi në plotësimin e dokumentacionit provues të përmbushjes së kriterëve të parashikuara në nenin 36 të ligjit. Rezulton se Sekretari i Përgjithshëm ka kërkuar verifikimin e kandidaturave për të dy Këshillat, nga ana e organeve si Prokuroria e Përgjithshme, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve etj.

Nga procedura e verifikimit e realizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nga 7 kandidatët që garojnë për 2 vendet në KLGJ, ka rezultuar se vetëm 4 prej tyre plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara në nenin 36, pika 2 të Ligjit nr. 115/2016.<sup>77</sup> Ndërkohë tre kandidatët e tjerë që nuk kanë plotësuar kushtet ligjore, janë si vijon:

<sup>76</sup> <http://www.droni.al/wp-content/uploads/2017/11/Raport-kandidatet-pedagoge-KLP.pdf>  
<http://www.droni.al/wp-content/uploads/2017/11/Raport-kandidatet-pedagoge-KLGJ.pdf>

<sup>77</sup>Këto kandidatë janë: Mirela Bogdani, Maksim Qoku, Erjon Muharremaj dhe Ilir Panda.

- Kandidatja Znj. **Brunela Kullolli**, rezulton se nuk plotëson kriterin ligjor të parashikuar në nenin 36, pika 2, gërma ç) të ligjit të sipërcituar, pasi nuk është personel akademik i kategorisë “lektor”. Kjo kandidatë e cila është përfshirë në garë vetëm si personel i IAL-ve, në momentin e vlerësimit ka qenë në fazën e marrjes së gradës shkencore “Doktor”, një gradë e cila është e lidhur detyrimisht me kategorinë “Lektor”.
- Kandidati Znj. **Darjel Sila**, është konstatuar se nuk plotëson kriterin ligjor të parashikuar në pikën b) të dispozitës së sipërcituar, pasi nuk ka arritur të provojë përvojën e punës 15 vjeçare në profesionin e juristit, duke qenë se është diplomuar më 03.02.2004 pranë Universitetit të Athinës.
- Kandidatja Znj. **Erjona Canaj**, është diplomuar në vitin 2005 në Universitetin “La Sapienza” Romë, e si rrjedhojë nuk përmbush kriterin ligjor të minimumit të përvojës si juriste prej 15 vitesh parashikuar në pikën b) të dispozitës së sipërcituar.

Pas verifikimit të kandidaturave që garojnë në KLP, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka përpiluar listën me 5 kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore, përkatësisht: Znj. **Mirela Bogdani**, Znj. **Oriona Muçollari**, Znj. **Eneida Sema**, Z. **Sandër Beci** dhe Z. **Gent Ibrahimi**. Siç është përmendur më herët, kandidatët Z. **Darjel Sina** dhe Znj. **Erjona Canaj**, të cilët rezultojnë të kenë kandiduar për të dy Këshillat nuk plotësojnë kushtet ligjore ndaj, edhe për KLP-në janë s’kualifikuar nga gara.

Për realizimin e pikëzimit për kandidatët për KLP dhe KLGJ, në respektim të nenit 35, pika 7, gërma “c: të ligjit nr.115/2016, Sekretari i Përgjithshëm është bazuar në procesin dhe praktikën e Mbledhjes së Posaçme. Pikëzimi për dy nën komponentë si: **cilësia e platformës dhe vizioni që paraqet kandidati dhe aftësitë e përfaqësimit në publik**, është i ndryshëm nga pikëzimi i realizuar nga Mbledhja e Posaçme. Në raportin e përpiluar nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm është referuar si problematikë **mungesa e informacionit nga mbledhja e posaçme për mënyrën e dhënies së pikëve për çdo nën komponent të meritave profesionale, meritave morale, meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale si dhe meritave të tjera**. Mbledhja e Posaçme rezulton të ketë vënë në dispozicion vetëm procesverbalin e mbledhjes së saj, ndërkohë që ky dokument dhe vendimmarrja e kësaj mbledhje nuk gjendet i publikuar në asnjë faqe zyrtare.

Në përfundim të vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm, rezulton se pikëzimi i kandidatëve ka qenë i ndryshëm nga pikëzimi vlerësues i realizuar nga Mbledhja e Posaçme. Arsyet e ndryshimeve ndërmjet pikëzimeve kanë prekur kryesisht të tre kategoritë, me përjashtim të meritave morale, pasi kjo e fundit është një kategori e vlerësuar vetëm për kandidatin Gent Ibrahimi për shkak të ofrimit të kontributit të tij në reformën në drejtësi. Gjithashtu, cilësia e platformës, aftësitë e përfaqësimit në publik, mos prezenca gjatë seancës dëgjimore etj., kanë qenë disa nga arsyet përse kandidatët janë vlerësuar më me pak pikë në aspektin e meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale. Ndërkohë, përsa i përket meritave profesionale, një element ndikues në uljen e pikëve ka qenë moskryerja e veprimtarive dhe përvojave profesionale të lidhura me fushën e Këshillave.

Nr.	Kandidatët për Këshillin e Lartë të Prokurorisë	Pikët totale sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm	Pikët totale sipas vlerësimit të Mbledhjes së Posaçme
1	Gent Ibrahimi	94.17 pikë	90.47 pikë
2	Mirela Bogdani	85.95 pikë	86.95 pikë
3	Sandër Beci	77 pikë	82 pikë
4	Eneida Sema	65.95 pikë	66.95 pikë
5	Oriona Muçollari	57.2 pikë	56.2 pikë
6	Erjona Canaj	Nuk kualifikohet	68.2 pikë
7	Dariel Sina	Nuk kualifikohet	71.7 pikë

Nr.	Kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor	Pikët totale sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm	Pikët totale sipas vlerësimit të Mbledhjes së Posaçme
1	Ilir Panda	88.27 pikë	84.95 pikë



2	Mirela Bogdani	80.7 pikë	82.7 pikë
3	Erjon Muharremaj	79 pikë	79 pikë
4	Erjona Canaj	Nuk kualifikohet	75.3 pikë
5	Maksim Qoku	74.34 pikë	73.34 pikë
6	Brunela Kullolli	Nuk kualifikohet	66.87 pikë
7	Dariel Sina	Nuk kualifikohet	65 pikë

Në përputhje me nenin 35, pika 7 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm ka hartuar listën me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji për të qenë anëtarë të KLGJ-së dhe KLP-së; listën me emrat e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet si dhe raportin ku vlerësohet shkalla e përmbushjes së kriterëve profesionale e morale nga secili kandidat i kualifikuar.

ONM ka realizuar verifikimet për kandidatët, bazuar në nenin 286 të ligjit nr. 115/2016. Raportet e verifikimit të kandidatëve nga ONM nuk janë bërë publike. Megjithatë, një informacion i pjesshëm për vlerësimet e ONM-së është pasqyruar në raportin e vlerësimit të përpiluar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

**Sipas vlerësimit të ONM-së platformat e pjesës më të madhe të kandidatëve në KLGJ reflektojnë parime të përgjithshme, pa ndonjë vizion specifik.** Përsa i përket vlerësimit të kriterit profesional për pjesën më të madhe të kandidatëve në KLGJ, ONM është shprehur se kontributi akademik/shkencor ose ka qenë mesatar ose nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk është dhënë ndonjë informacion i vlefshëm. Referuar vlerësimit të kriterit moral (integritetit) të kandidatëve në KLGJ, rezultojnë të jetë pasqyruar në raportin e vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm, vlerësimi i ONM-së për kandidatin, Z. Ilir Panda, për të cilin vërehet se *“Ka qenë i angazhuar politikisht në nivel shumë të lartë në të kaluarën”*.

Përsa i përket vlerësimit të kriterit profesional për kandidatët në KLP, vërehet se, **ONM ka evidentuar se platformat e paraqitura nga shumica e kandidatëve konsistojnë më shumë në një letër motivuese, duke mos paraqitur ndonjë vizion specifik me objektiva që duhen përmbushur.** Ndërkohë përsa i përket elementit të jetëshkrimit, vetëm për 2 nga kandidatët ONM është shprehur se profili i tyre akademik duket të jetë mbi mesataren. Nga vlerësimi i realizuar nga ONM, rezultojnë se kandidati Gent Ibrahim i nuk duket se plotëson kriterin e parashikuar në nenin 36, paragrafi 2, shkronja c) të ligjit nr. 115/2016, sipas të cilit veprimtaria pedagogjike me kohë të pjesshme duhet të ketë ndodhur secilin vit në 5 vite përpara kandidimit. Nga jetëshkrimi i paraqitur rezultojnë se nuk shihet veprimtaria e tillë në periudhën kohore ndërmjet viteve 1998 dhe 2016. Për mos përmbushjen e këtij kriteri rezultojnë se kandidatja për në KLGJ, Znj. Kullolli është përjashtuar nga gara, situatë e cila sipas këtij Raporti ka gjeneruar në një procedurë diskriminimi. Por këtij pretendimi i është dhënë përgjigje nga ana e Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës dhe verifikimit të dosjes së realizuar nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm. Sipas argumenteve të këtyre institucioneve, ligji nr. 115/2016 ka bërë një dallim të qartë ndërmjet ‘anëtarëve të personelit akademik’ të IAL-ve, të cilët sipas ligjit “Për arsimin e lartë” duhet të gëzojnë statusin e lektorit ose të profesorit, si dhe ‘pedagogëve jo magjistratë të Shkollës së Magjistraturës’.<sup>78</sup> **Përsa i përket kriterit moral (integritetit) të kandidatëve në KLP, në Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm nuk evidentohet asnjë vlerësim i ONM-së.**

### **Procedura e ndjekur nga nënkomisioni i posaçëm parlamentar**

Më datë 17.01.2018, dy raportet e Vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm përkatësisht për kandidatët që garojnë në KLP dhe kandidatët që garojnë në KLGJ i është përcjellë Komisionit të Ligjeve në Kuvend, i cili brenda afatit 3 ditor nga paraqitja e listës ka krijuar Nënkomisionin *Ad Hoc* për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve.

<sup>78</sup>Faqe 12 e Raportit: <http://www.droni.al/wp-content/uploads/2017/11/Raport-kandidatet-pedagoge-KLP.pdf>

Duke qenë se Nënkomisioni *Ad Hoc* i krijuar ka vlerësuar dhe ka përzgjedhur në të njëjtat mbledhje të gjithë kandidatët jo magjistratë për të qenë anëtarë të KLGJ-së dhe KLP-së (nga avokatia, trupa e pedagogëve dhe shoqëria civile), monitorimi i këtij procesi në mënyrë të detajuar është pasqyruar në seksionin e “**kandidatëve nga shoqëria Civile**” në këtë raport (shih pikën 1.3 të këtij raporti në vijim të tij). Veprimtaria e këtij nënkomisioni u realizua në përputhje me parashikimet ligjore, por u vërejt një mungesë e theksuar e bashkëpunimit mes përfaqësuesve të mazhorancës dhe opozitës në këtë komision. Mbetet shqetësuese mënyra e përdorimit të të dhënave personale të kandidatëve, ku ngjyrimet politike të pasqyruara në debatet mes anëtarëve të komisionit në mënyrë të përsëritur kanë krijuar premisa për cënimin e integritetit profesional të kandidatëve. **Mungesa e kuorunit të nevojshëm midis anëtarëve të këtij nënkomisioni, shmangu dhe dëmtoi meritokracinë e këtij procesi, i cili përfundoi me përzgjedhjen me short manual.**

Në seancë plenare, për shkak të mungesës së kuorunit prej 2/3 të anëtarëve të Kuvendit, është vendosur rrëzimi në bllok 2 herë i listës së paraqitur nga nënkomisioni parlamentar ad hoc. Në përputhje me nenin 35, pika 16 e Ligjit nr. 115/2016 kandidatët e listës së tretë, e cila nuk është votuar me kuorumin e nevojshëm në Kuvend, u konsideruan të zgjedhur në mënyrë automatike.<sup>79</sup>

### 1.3 Anëtarët jo magjistratë nga radhët e Shoqërisë Civile

#### 1.3.1 Ligjshmëria e procedurave për përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve nga shoqëria civile

##### a) *Shpallja e vendeve vakante në të dy Këshillat nga radhët e shoqërisë civile*

Ligji nr. 115/2016 ka hyrë në fuqi më datë 16.12.2016.<sup>80</sup> Më datë 14 Janar 2017, rezulton të jetë afati i fundit brenda të cilit Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shpall vendet vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga përfaqësuesit e shoqërisë civile që plotësojnë kriteret ligjore. Në respektim të nenit 276, pika 8 të ligjit, është respektuar nga ky institucion afati ligjor 30 ditor nga hyrja në fuqi e ligjit.<sup>81</sup> Në shpalljen e Sekretarit të Përgjithshëm parashikohet data 28 Janar 2017, afati në të cilin anëtarët e organizatave të shoqërisë civile mund të shprehin interesin me shkrim pranë Avokatit të Popullit, për të garuar për vendet vakante në të dy Këshillat.<sup>82</sup>

##### b) *Procedurat paraprake për konstituimin e Komisionit Ad Hoc të shoqërisë civile*

Në respektim të afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 56, pika 10 të ligjit nr. 115/2016, Avokati i Popullit ka publikuar thirrjen për shprehje interesi për anëtar të komisionit të shoqërisë civile,<sup>83</sup> që do të kryejë verifikimin paraprak të kandidaturave nga shoqëria civile në të dy Këshillat.<sup>84</sup> Në këtë thirrje është parashikuar detyrimi ligjor për të shprehur interesin së bashku me dokumentacionin nga organizatat e shoqërisë civile, brenda afatit 7 ditor nga dita e publikimit të thirrjes. **Megjithatë, Avokati i Popullit nuk ka respektuar afatin ligjor 10 ditor për verifikimin e plotësimin të**

<sup>79</sup>Kandidatët e listës së tretë për KLGJ janë: 1. Fatmira Luli (nga avokatia) 2. Alban Toro (nga avokatia) 3. **Erjon Muharremaj (nga trupa e pedagogëve)** 4. **Maksim Qoku (nga trupa e pedagogëve)** 5. Naureda Llagami (nga shoqëria civile).  
<http://www.parlament.al/Files/Akte/vendim-nr.-18-dt.-8.2.2018.pdf>

Kandidatët e listës së tretë për KLP janë: 1. Nurihan Meta (Seiti) (nga avokatia) 2. Tartar Bazaj (nga avokatia) 3. **Gent Ibrahim** (nga trupa e pedagogëve) 4. **Sandër Beci (nga trupa e pedagogëve)** 5. Alfred Balla (nga shoqëria civile).  
<http://www.parlament.al/Files/Akte/vendim-nr.-19-dt.-8.2.2018.pdf>

<sup>80</sup>Është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 231, datë 01.12.2016.

<sup>81</sup>Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka shpallur vendet vakante dhe ka publikuar thirrjen më datë 13.01.2017.

<sup>82</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/2..SHPALLJE%20E%20VENDIT%20VAKANT%20DHE%20THIRRI%20P%20C3%8BR%20PARAQITJEN%20E%20SHPREHJES%20S%20C3%8B%20INTERESIT%20P%20C3%8BR%20AN%20C3%8BTAR%20T%20C3%8B%20K%20C3%8B%20SHILLIT%20T%20C3%8B%20LART%20C3%8B%20GJYQ%20C3%8BSOR.pdf>

<sup>83</sup>Thirrja është publikuar më dt. 16.01.2017.

Online:<http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/Thirrje%20p%20C3%ABr%20shprehje%20interesi%20p%20C3%ABr%20an%20C3%ABtar%20komisioni%20t%20C3%AB%20shoq%20C3%ABris%20C3%AB%20civile%20n%20C3%AB%20KLGJ.pdf>

<sup>84</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/Thirrje%20p%20C3%ABr%20shprehje%20interesi%20p%20C3%ABr%20an%20C3%ABtar%20komisioni%20t%20C3%AB%20shoq%20C3%ABris%20C3%AB%20civile%20n%20C3%AB%20KLGJ.pdf>

kritereve nga organizatat që kanë shprehur interesin për të qenë pjesë e Komisionit. Verifikimi ka përfunduar 10 ditë me vonesë. Shqetësimi i kalimit të këtij afati ligjor është pasqyruar nga ana e Avokatit të Popullit në një shkresë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, më datë 31.01.2017, nëpërmjet së cilës evidentohet domosdoshmëria e përsëritjes së procedurës së shprehjes së interesit duke qenë se procedura fillestare për krijimin e Komisionit të Shoqërisë Civile ka përfunduar pa asnjë rezultat për shkak të numrit të ulët të aplikimeve që nuk plotësojnë numrin minimal prej 5 organizatash.

Më datë 17.02.2017, Avokati i Popullit në përputhje me nenet 56, pika 11 dhe 154, pika 11 të ligjit nr. 115/2016 ka përfunduar verifikimin për plotësimin dhe përmbushjen e kritereve nga organizatat që shprehën interesin për tu përfaqësuar në Komision ad hoc dhe publikoi emrat e 5 organizatave të cilat përmbushin kriteret dhe 2 organizatave të cilat nuk përmbushin kriteret.<sup>85</sup> Përfaqësuesit e këtyre 5 organizatave fituese, nën statusin e anëtarit të Komisionit *ad hoc*, janë: Z. Andi Dobrushit (Kryetar i Komisionit), Znj. Rajmonda Bozo, Znj. Ina Xhepa, Znj. Elsa Ballauri dhe Z. Atmir Mani. Në datën 27.02.2017 është mbajtur Mbledhja e parë e Komisionit të Shoqërisë Civile për verifikimin paraprak të kandidaturave për përfaqësuesin e shoqërisë civile në dy Këshillat.

**c) Procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore nga Komisioni i Shoqërisë Civile pranë Avokatit të Popullit**

**c.1) Për kandidatët nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë**

Duke iu referuar të dhënave të reflektuara në raportin e vlerësimit të përpiluar nga Komisioni *ad hoc* i Shoqërisë Civile, aplikantët të cilët kanë shprehur interesin për pozicionin e anëtarit përfaqësues për KLP janë: Z. Bledar Ilia (ka shprehur interes edhe për KLGJ), Z. Mevlut Derti, Znj. Drita Avdyli, Z. Alban Tutuani dhe Z. Palarën Ndreca. Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit nga ana e Komisionit në përputhje me nenet 152 e vijues të Ligjit nr. 115/2016, u konkludua se:

- **Z. Bledar Ilia**, u s'kualifikua pasi nga dokumentacioni vërtetues nuk plotësonte kriterin ligjor të **15 viteve përvojë profesionale si jurist**. Gjithashtu **nuk është përmbushur nga ana e aplikantit detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 152, pika 4** të ligjit nr.115/2016 për paraqitjen e mbështetjes së shprehur nga 3 organizata të shoqërisë civile që punojnë në fushat e sistemit të drejtësisë ose të drejtat e njeriut.

- **Mungesa e përmbushjes së kriterit të 15 vite përvojë profesionale si jurist**, është kriteri i cili solli s'kualifikimin e kandidatit **Z. Mevlut Derti**.

- Përsa i përket kandidatës **Znj. Drita Avdyli**, Komisioni vendosi s'kualifikimin e saj për shkak të mosplotësimin të kriterit ligjor që parashikon **përfundimin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi, ose diplomë të njehsuar me të**. Gjithashtu, në kundërshtim me nenin 152, pika 4, të ligjit nr.115/2016 aplikantja ka paraqitur **vetëm një letër referencë nga organizatat e shoqërisë civile**.

- Kandidatit **Z. Plarent Ndreca** iu kërkuan sqarime shtesë lidhur me projektet dhe veprimtarinë në organizatën ku kandidati angazhohej në 5 vitet e fundit, si dhe përshkrim i rolit të tij në secilin projekt/veprimtari ku është angazhuar. Pas vënies në dispozicion të këtyre sqarimeve, **Komisioni vendosi të mos e thërrasë aplikantin në seancë dëgjimore, pasi kontratat e paraqitura prej tij konsistojnë në konsulencë permanente, të përgjithshme dhe të njëjta me njëra-tjetrën; ndërkohë kërkesa e dytë e Komisionit nuk është shpjeguar prej aplikantit**.

- Aplikantit **Z. Arban Tutulani**, iu kërkua informacion sqarues për të njëjtat arsye si për kandidatit Z. Ndreca. **Pas dhënies së këtij informacioni, Komisioni kërkoi nga ana e Presidencës dhe Prokurorisë së Përgjithshme motivacionin shkarkimit të tij nga detyra**. Komisioni vendosi përjashtimin e këtij kandidati, pasi nuk plotëson kriterin ligjor për një profil të spikatur shoqëror,

<sup>85</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/17.02.2017Lista%20me%20emrat%20e%20organizatave%20q%C3%AB%20p%C3%ABrmbushin%20kriteret%20e%20Komisionit%20t%C3%AB%20Shoq%C3%ABris%C3%AB%20Civile%20q%C3%AB%20do%20t%C3%AB%20krvej%C3%AB%20verifikimin%20paraprak%20t%C3%AB%20kandidatur%C3%ABs%20p%C3%ABr%20an%C3%ABtarin%20q%C3%AB%20p%C3%ABrfaq%C3%ABson%20shoq%C3%ABrin%C3%AB%20civile%20n%C3%AB%20KLGJ%20dhe%20n%C3%AB%20KLP.pdf>



integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut.

Ankesa e aplikantit Z. Arban Tutulani për rishikimin e vendimmarrjes së Komisionit,<sup>86</sup> passolli zhvillimin e mbledhjes së jashtëzakonshme të Komisionit Ad Hoc, i cili vendosi të mos rishikojë vendimin e dhënë nga ana e tij.<sup>87</sup> Kjo vendimmarrje u ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, por kjo e fundit vendosi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit *ad hoc*, duke argumentuar se barra e provës për të paraqitur provat e nevojshme për sa i përket figurës, i takon kandidatit.<sup>88</sup>

Për shkak të s'kualifikimit të pesë kandidatëve të mësipërme, Komisioni i Shoqërisë Civile vendosi unanimisht ti drejtohej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për **rihapjen e thirrjes për të kandiduar nga përfaqësues të shoqërisë civile për dy Këshillat** (mbledhja e dt. 10.03.2017). Në mbledhjen e dt. 4 Prill 2017, Komisioni vendosi në mënyrë unanime që të mos shqyrtoheshin në rast ri - kandidimi, dosjet e kandidatëve të s'kualifikuar në fazën e parë.

Bazuar në thirrjen e dytë për të kandiduar si anëtarë të KLP-së nga shoqëria civile, rezultoi se kanë shprehur interes 2 kandidatë, përkatësisht **Znj. Mimoza Qinami dhe Z. Tartar Bazaj (të dy kandidojnë njëkohësisht dhe për KLGJ)**. Ky i fundit u s'kualifikua nga ana e Komisionit, bazuar në shkresën e dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, me anë të së cilës evidentohet masa disiplinore shkarkim nga detyra. Ndërkohë që për kandidaten **Znj. Mimoza Qinami**, Komisioni nuk vendosi s'kualifikimin e saj të menjëhershëm, pavarësisht faktit se kandidatja nuk kishte depozituar shkresë provuese mbi plotësimin e kriterit të parashikuar në nenin 152, pika 2, gërma dh) të Ligjit.

Duke qenë se nuk arrihej numri minimal i kandidatëve për KLP-në, më datë 29.05.2017 kërkoi nga Kuvendi rihapjen e Thirrjes së Tretë. Në kuadër të kësaj thirrje shprehën interesin 3 kandidatura, por nga verifikimi paraprak i tyre u kualifikuan vetëm dy prej tyre si vijon:

- Fillimisht u vlerësua se kandidati **Z. Kostandin Kazanxhi** nuk plotëson kriterin ligjor të mos mbajtjes së funksioneve politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Por pas shqyrtimit të dosjes u konstatua depozitimi i dokumentacionit prej tij, si dhe u kërkua informacion mbi angazhimin e tij në shoqërinë civile përgjatë 5 viteve të fundit. ***Pas depozitimit të provave shkresore, Komisioni vendosi se kandidati plotëson kriteret ligjore e si rrjedhojë duhet të kalojë në seancë dëgjimore.***

- Kandidatja **Znj. Lindita Xhillari** u vlerësua se i plotëson kriteret e parashikuara në nenin 152 të ligjit nr. 115/2016, por ju kërkua informacion sqarues mbi angazhimin e saj në shoqërinë civile përgjatë 5 viteve të fundit. ***Pas depozitimit të provave shkresore, Komisioni vendosi se kandidatja plotëson kriteret ligjore e si rrjedhojë duhet të kalojë në seancë dëgjimore.***

- Edhe për kandidatin e tretë **Z. Vasil Shandro**, u kërkua informacion sqarues mbi angazhimin e tij në shoqërinë civile përgjatë 5 viteve të fundit. Në mbledhjen e datës 02.08.2017, ***Komisioni vendosi s'kualifikimin e tij pasi ai nuk kishte depozituar asnjë kontribut konkret për angazhimin e tij në shoqërinë civile.***

Në mbledhjen e jashtëzakonshme të realizuar më datë 07.09.2017, Komisioni *ad hoc*, pas vlerësimit të opinionit negativ të dhënë nga ONM mbi kandidatët Lindita Xhillari dhe Kostandin Kazanxhi vendosi s'kualifikimin e tyre për shkak të mos përmbushjes së kriterit **ligjor për të pasur një profil të spikatur shoqëror, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut**. Të dy këto kandidatë iu drejtuan Gjykatës Administrative të

<sup>86</sup>Kandidati ankues argumentonte se masa disiplinore për shkarkimin e tij nga detyra ishte bërë objekt gjykimi edhe pranë Gjykatës së Apelit, e cila kishte pranuar pjesërisht padinë e tij përsa i përket dëmshpërblimit por kishte rrëzuar kërkesën e tij për shfuqizim të Dekretit të Presidentit dhe kthimin në punë.

<sup>87</sup>Kjo Mbledhje u zhvillua më datë 29.05.2017.

<sup>88</sup>Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 56, datë 24.07.2017.

Apelit Tiranë, e cila la në fuqi vendimet e dhëna nga Komisioni, mbi argumentin se procedura e verifikimit paraprak shtrihet edhe në drejtim të kriterëve morale. Kandidati Z. Kostandin Kazanxhi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se mosparashikimi në ligjin nr.115/2016 i së drejtës për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i ka cenuar të drejtën e ankimit. Ky pretendim është deklaruar haptazi i pabazuar nga Gjykata Kushtetuese e si rrjedhojë është vendosur mos kalimi i çështjes për shqyrtim në seance plenare. GJK (Kolegji) ka argumentuar se parashikimi ligjor është i mjaftueshëm për të realizuar të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj akteve administrative dhe shteti nuk ka detyrim të parashikojë më shumë se një shkallë ankimi.

Nëpërmjet shkresës së datës 27 tetor 2017, Komisioni i Shoqërisë Civile i ngritur pranë Avokatit të Popullit ju drejtua Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.<sup>89</sup> Në këtë shkresë argumentohet pamundësia e Komisionit për të përmbushur detyrimin e tij ligjor dhe për t'i përcjellë Kuvendit sipas nenit 156, pika 1 të Ligjit nr. 115/2016, listën me emrat e kandidatëve “*në çdo rast jo më pak se trefishi i vendeve vakante*”. Në përfundim të thirrjes së pestë, rezultoi të jetë paraqitur vetëm 1 kandidaturë për KLP-në, Z. **Vladimir Vladaj**. Ky aplikant u s'kualifikua nga ana e Komisionit për shkak të mosplotësimit të kriterit për të pasur minimalisht 15 vite përvojë pune në profesion si jurist dhe mos ushtrimi aktiv i profesionit të avokatit për të paktën 2 vite.

Komisioni *ad hoc* i ngritur pranë Avokatit të Popullit ka reaguar mbi pamundësinë e përcjelljes së 3 kandidaturave për KLP-në, duke deklaruar se: “*Nga muaji shkurt, kur Komisioni i Shoqërisë Civile u krijua e deri në muajin tetor, me propozim të këtij komisioni nga Kuvendi i Shqipërisë janë hapur dhe njoftuar 5 thirrje publike për kandidatët që shprehin interesin për të qenë anëtarë të “KLP” si përfaqësues të shoqërisë civile. Bazuar në këto thirrje, 10 nga 11 kandidaturat e mbërritura janë s'kualifikuar për shkak se nuk përmbushin kriteret formale ligjore*”<sup>90</sup>.

Pas rihapjes për herë të gjashtë të thirrjes për kandidatët nga shoqëria civile që dëshirojnë të aplikojnë për vendin vakant në KLP, rezultoi se kanë shprehur interesin 5 kandidatë, tre prej të cilëve rezultuan se plotësonin të gjitha kriteret, përkatësisht Z. **Alfred Balla**, Z. **Andi Muratej dhe Znj. Entela Baci (Hoxhaj)**. Ndërkohë, kandidatët Z. **Bledar Bejri**<sup>91</sup> dhe Z. **Vladimir Vladaj**<sup>92</sup>, u s'kualifikuan për mos plotësim të kriterëve ligjorë të parashikuara respektivisht në nenin 152, pika 2, gërma c), ç), d), dh), e) dhe f) të ligjit nr.115/2016.

## c.2) Për kandidatët për në Këshillin e Lartë Gjyqësor

Në përputhje me nenin 56 të ligjit nr. 115/2016, më datë 31.01.2017 janë publikuar emrat e kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar nga shoqëria civile për në KLGJ, të cilët rezultoi të jenë: Z. Bledar Ilia, Znj. Naureda Llagami dhe Znj. Ermira Deçka.<sup>93</sup> **Në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit nuk janë publikuar Procesverbalet e mbledhjeve të realizuara nga ana e Komisionit *ad hoc*, në ndryshim nga praktika që ky komision ka ndjekur me kandidatët për KLP. Në kontekstin e transparencës karshi publikut dhe vëzhgimit që KSHH i ka bërë këtij procesi, nuk mund të shfaqim konstatime lidhur me fazën e vlerësimit paraprak, kriteret e përmbushura apo arsyet përjashtuese të këtyre kandidatëve.**

<sup>89</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/30.10.2017%20Komisioni%20i%20Shoq%C3%ABris%C3%AB%20Civile%20pran%C3%AB%20Avokatit%20t%C3%AB%20Popullit%20p%C3%ABrcjellje%20shkres%C3%ABs%20Sekretarit%20t%C3%AB%20P%C3%ABrgjithsh%C3%ABm%20t%C3%AB%20Kuvendit.pdf>

<sup>90</sup><http://www.osfa.al/njoftime/reagim-i-komisionit-ad-hoc-te-shoqerise-civile>

<sup>91</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/18.12.2017%20Z.Bledar%20Bejri%20CP%C3%ABrcjellje%20Vendimi%20i%20Komisionit%20t%C3%AB%20Shoq%C3%ABris%C3%AB%20Civile.pdf>

<sup>92</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/18.12.2017%20Kthim%20p%C3%ABrgjigje%20Z.Vladimir%20Vladaj%20C%20p%C3%ABrcjellja%20e%20vendimit%20dhe%20pro%20p%C3%A7esverbalit.pdf>

<sup>93</sup>[http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/31.01.2017%20Njoftim%20p%C3%ABr%20emrat%20kandidat%C3%AB%20%20aplikant%C3%AB%20p%C3%ABr%20KLGJ%20dhe%20KLP%20nga%20Avokatia%20dhe%20SH.Civile\\_0.pdf](http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/31.01.2017%20Njoftim%20p%C3%ABr%20emrat%20kandidat%C3%AB%20%20aplikant%C3%AB%20p%C3%ABr%20KLGJ%20dhe%20KLP%20nga%20Avokatia%20dhe%20SH.Civile_0.pdf)

Më datë 17.03.2017, me vendimin nr. 3, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka rishpallur thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit nga kandidatët e shoqërisë civile për KLGJ-në.<sup>94</sup> Në përmbushje të nenit 57, pika 2 të ligjit nr. 115/2016, Komisioni i Shoqërisë Civile me përfundimin e procedurës së verifikimit paraprak ka shpallur listën me kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore formale për të qenë anëtarë të KLGJ-së. Kandidatët janë: Znj. Naureda Llagami, Z. Altin Hazizaj dhe Znj. Mimoza Qinami.<sup>95</sup> Më datë 22.06.2017, këto kandidatë iu nënshtruan seancës dëgjimore publike. **Procesverbali i kësaj seance dëgjimore është i aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit, por Raporti i Vlerësimit i cili përpilohet nga ana e Komisionit Ad Hoc pranë Avokatit të Popullit nuk rezultoi i publikuar.**

*d) Ushtrimi i së drejtës së ankimit nga kandidatët e s’kualifikuar*

Në harkun kohor tetë mujor, përkatësisht në periudhën shkurt – tetor 2017, katër kandidatë të s’kualifikuar ju drejtuan gjykatës e cila ka lënë në fuqi vendimet e Komisionit të Shoqërisë Civile.

*e) Vlerësimi i kriterëve dhe kushteve ligjore si dhe profili i kandidatëve të kualifikuar*

Katër janë kriteret mbi bazën e të cilave Komisioni Ad Hoc i Shoqërisë Civile realizoi vlerësimin e kandidatëve të mbështetura në tre shtylla kryesore, vlerësimi i meritave profesionale, vlerësimi i meritave morale dhe vlerësimi i meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale. Këto kriterë dhe marzhet e vlerësimit të tyre janë verifikuar në përputhje me nenin 34 dhe 155 të ligjit nr. 115/2016.

**e.1) Për kandidatët në Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Më datë 22.06.2017, Komisioni i Shoqërisë Civile zhvilloi seancën dëgjimore të kandidatëve që plotësojnë kriteret formale për të qenë anëtarë të KLGJ-së. Pas përfundimit të procedurës së verifikimit paraprak, ky Komision ka shpallur emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të KLGJ-së: Znj. Naureda Llagami, Z. Altin Hazizaj dhe Znj. Mimoza Qinami.<sup>96</sup>

Në nenin 152, pika 2 të ligjit nr.115/2016 është parashikuar vetëm publikimi i menjëhershëm i emrave të kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore, ndërkohë rezultati i mos plotësimit të kushteve ligjore si dhe shkaqet e përjashtimit i komunikohen në mënyrë individuale kandidatëve. Nga raporti i vlerësimit i publikuar nga Komisioni janë evidentuar edhe emrat e 6 kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore. **Kemi mendimin se kjo dispozitë duhet të reflektonte qartazi detyrimin e publikimit të listës së kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillave. Transparenca e fazës së verifikimit paraprak të plotësimit të kushteve ligjore është një element i domosdoshëm i cili duhet të shoqërojë këtë proces.**

Platformat e pasqyruara në procesverbalin e mbledhjes së datës 22.06.2017, për kandidatët e kualifikuar në KLGJ nga Komisioni i Shoqërisë Civile, reflektojnë objektiva të qartë të disa prej kandidatëve. Megjithatë, në këto platforma i kushtohet një vëmendje e shtuar “korrupsionit”, ndikuar nga situata aktuale në sistemin e drejtësisë. **Platformat e kandidatëve nuk janë dokumente të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit. Pavarësisht se ky nuk është një detyrim ligjor, e parë në këndvështrimin e transparencës ndaj publikut mund të cenohet edhe gjykimi i publikut mbi meritokracinë në vetvete të procesit të vlerësimit të këtyre platformave nga Komisioni.**

<sup>94</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/17.03.2017%20Rishpallje%20e%20Thirrjes%20p%20C3%ABr%20paraqitjen%20e%20shprehjes%20s%C3%AB%20Interesit%20p%20C3%ABr%20KLGJ..pdf>

<sup>95</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/19.06.2017%20Mbi%20p%20C3%ABrcjelljen%20e%20list%C3%ABs%20me%20kandidat%C3%ABt%20q%C3%AB%20p%C3%ABrmbushin%20kriteret%20ligjore%20formale%20p%C3%ABr%20KLGJ%20nga%20rradh%C3%ABt%20e%20Shoq%C3%ABris%C3%AB%20Civile.pdf>

<sup>96</sup>Kjo listë është përcjellë më datë 19.06.2017.

Shih:<http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLGJ/19.06.2017%20Mbi%20p%20C3%ABrcjelljen%20e%20list%C3%ABs%20me%20kandidat%C3%ABt%20q%C3%AB%20p%C3%ABrmbushin%20kriteret%20ligjore%20formale%20p%C3%ABr%20KLGJ%20nga%20rradh%C3%ABt%20e%20Shoq%C3%ABris%C3%AB%20Civile.pdf>

Në formularin tip të krijuar u realizua votimi bazuar në kritere vlerësimi morale dhe profesionale. Renditja e kandidatëve sipas këtij vlerësimi është si vijon:

- Znj. Naureda Llagami (e renditur e para me 83 pikë);
- Znj. Mimoza Qinami (e renditur e dyta me 79 pikë) dhe,
- Z. Altin Hazizaj (i renditur i treti me 74.2 pikë).<sup>97</sup>

## e.2) Për kandidatët në Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Për shkak se 2 prej kandidatëve në KLP u s'kualifikuan në mbledhjen e jashtëzakonshme të Komisionit Ad Hoc të Shoqërisë Civile, pas ri përsëritjes disa herë të shpalljes për paraqitjen e shprehjes së interesit, më datë 19.12.2017, ky Komision i përcolli Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, emrat e tre kandidatëve të cilët kanë kaluar fazën e parë të verifikimit paraprak, përkatësisht për kandidatët Z. Alfred Balla, Z. Andi Muratej dhe Znj. Entela Hoxha.

Kandidatët ju nënshtruan seancës dëgjimore publike më datë 20.12.2017 na ambientet e Avokatit të Popullit. Në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit<sup>98</sup>, rezulton se platformat e paraqitura nga 3 kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore, reflektojnë një cilësi mesatare, ndërkohë që pyetjeve të adresuara nga ana e anëtarëve të Komisionit nuk i jepet përgjigje konkrete dhe sqaruese nga të gjithë kandidatët. Gjithashtu, platformat në pjesën më të madhe të tyre bazohen në parime të përgjithshme si një formë e shmangies dhe reagimit të kandidatëve në momentin e përballjes me raste korruptive, ndërkohë që vërehet mungesa e një logjike objektive.

Vëzhguesit e ONM-së kanë shfaqur kontestime lidhur me platformën e kandidatit Z. Alfred Balla, e cila sipas tyre rezulton identike me atë të kandidatit të s'kualifikuar Z. Plarent Ndreca. **Nga Procesverbalet e seancës publike të realizuar nuk rezultojnë të publikuara platformat e kandidatëve, por në mënyrë të përmbledhur janë evidentuar elementë të këtyre platformave, kur kandidatët i përgjigjen pyetjeve të adresuara nga anëtarët e Komisionit të Shoqërisë Civile.**

Nga raporti i vlerësimit të Komisionit rezulton se në përfundim të procesit, vlerësimi për 4 kandidatët, duke përfshirë dhe kandidaten Mimoza Qinami, e cila ka rezultuar e përzgjedhur nga thirrjet e mëparshme, është si vijon:

- Znj. Entela Baci (e renditur në vendin e parë me 81 pikë),
- Z. Andi Muratej (i renditur në vendin e dytë me 79.5 pikë),
- Znj. Mimoza Qinami (e renditur në vendin e tretë me 79 pikë) dhe
- Z. Alfred Balla (i renditur në vendin e katërt me 63 pikë).

Vetëm pas thirrjes së gjashtë, Kryetari i Komisionit të Shoqërisë Civile i ka përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit listën me emrat e 4 kandidatëve, duke respektuar standardin minimal ligjor "jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se 3-fishi i vendeve vakante".

### f) Procesi i verifikimit i realizuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe nga ONM

Një tjetër fazë e rëndësishme e verifikimit të kandidatëve për anëtarë jomagjistratë nga radhët e shoqërisë civile që kandidojnë për të dy Këshillat është verifikimi që realizohet nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit dhe nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, në përputhje me ligjin nr. 115/2016.

<sup>97</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/22.06.2017%20Pro%20C3%A7es-Verbal%20i%20mbledhjes%20s%C3%AB%20Komisionit%20t%C3%AB%20Shoq%C3%ABris%C3%AB%20Civile%20p%C3%ABr%20Verifikimin%20Paraprak%20t%C3%AB%20Kandidat%C3%ABve%20p%C3%ABr%20KLGJ%20dhe%20KLP.pdf>

<sup>98</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/KLP/31.08.2017%20Pro%20C3%A7es-Verbal%20Komisionit%20t%C3%AB%20Shoq%C3%ABris%C3%AB%20Civile%20p%C3%ABr%20Verifikimin%20Paraprak%20t%C3%AB%20Kandidat%C3%ABve%20p%C3%ABr%20KLP.pdf>

### **f.1) Për kandidatët në Këshillin e Lartë të Prokurorisë**

Kuvendi ka përpiluar raportin për procesin e verifikimit nga Sekretari i Përgjithshëm të plotësimit të kushteve ligjore dhe kritereve profesionale e morale për kandidatët për anëtarë në KLP që përfaqëson shoqërinë civile. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në datë 03.01.2018, i ka përcjellë ONM-së kopje të dokumentacionit të depozituar nga Komisioni i Shoqërisë Civile. Më datë 12.01.2018, rezulton që ONM ka dorëzuar raportin e tij të vlerësimit.

Në raportin e vlerësimit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka konstatuar disa paqartësi në dokumentacionin ligjor provues të depozituar nga kandidatët, duke vlerësuar se *“Komisioni i Shoqërisë Civile nuk ka ndërmarrë të gjitha hapat për të kryer korrespondenca me institucionet e ndryshme publike për kontrollin e kushteve ligjore”*.

Nga analiza e vlerësimeve të Sekretarit të Përgjithshëm dhe ONM-së, pavarësisht se këto vlerësime janë të pavarura nga njëra tjetra, rezulton se për 2 nga kandidatët, respektivisht për Z. Andi Muratej dhe Z. Alfred Balla, vlerësimi nga ana e Sekretarit është i ndryshëm nga ai i dhënë nga ONM. **Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në përfundim të vlerësimit të tij ka konkluduar se vetëm 3 kandidatë nga 4 që kishte vlerësuar Komisioni i Shoqërisë Civile plotësojnë kushtet, ndërkohë që numri i kandidatëve të s’kualifikuar shkon në 12.**

Bazuar në nenin 287 të ligjit nr.115/2016, ONM ka realizuar procesin e verifikimit dhe ka konstatuar se vetëm 1 nga kandidatët, përkatësisht Znj. Mimoza Qinami duhet kualifikuar pasi plotëson kushtet ligjore, ndërkohë që 11 kandidatët e tjerë nuk i plotësojnë kushtet. Në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, nuk rezulton të jetë publikuar vlerësimi i ONM-së për të gjithë kandidatët.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka hartuar dokumentet e parashikuara që konsistojnë në listën me emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret dhe të kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret, si dhe arsyet e përjashtimit të secilit prej tyre. Si më poshtë paraqitet një rezymë për përvojën profesionale të kandidatëve të kualifikuar nga Sekretari i Përgjithshëm:

**Kandidati Alfred Balla**, është angazhuar në Shoqatën e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë. Gjithashtu, ky kandidat ka 26 vite përvojë si prokuror, avokat dhe këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë.<sup>99</sup> Por vlerësimi i ONM-së për këtë kandidat paraqitet shqetësues, pasi siç është argumentuar *“Përveç faktit që ky kandidat nuk i plotëson kriteret ligjore të përmendura në nenin 152/2, shkronja d) të ligjit, vëzhguesit ndërkombëtarë kanë konstatuar se platforma e paraqitur është pothuajse plotësisht një plagjiaturë e një platforme të paraqitur nga një kandidat tjetër (Plarent Ndreca)...ky kandidat nuk ka integritet të lartë moral që shpresohet nga një anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë”*<sup>100</sup>.

**Kandidati Andi Muratej**, në vlerësim të argumentimit të referuar nga Sekretari i Përgjithshëm ka 3 vite që është aktivizuar në shoqërinë civile, përkatësisht në Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KShH), por gjithashtu llogaritet në kriterin e parashikuar në nenet 151/1 dhe 152/2 shkronja “d” të Ligjit nr. 115/2016, dhe angazhimi i tij si aktivist nga viti 2006 i Qendrës Europiane të Avancuar për Sigurinë “George C. Marshall” dhe si anëtar i bordit drejtues të kësaj degës së kësaj shoqate në Shqipëri nga viti 2015.

**Kandidatja Mimoza Qinami**, është angazhuar si eksperte pranë disa organizatave të shoqërisë civile, në fushën e veprimtarisë së të cilave është mbrojtja e të drejtave të grave.

Nr.	Kandidati i kualifikuar	Pikët totale sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm	Pikët totale sipas vlerësimit të Mbledhjes së Posaçme
1.	Andi Muratej	79 pikë	79.5 pikë
2.	Alfred Balla	80 pikë	63 pikë
3.	Mimoza Qinami	78 pikë	79 pikë

<sup>99</sup> <https://www.faxweb.al/kush-eshte-kandidati-i-shoqerise-civile-per-klp-ne-qe-perplas-onm-me-kuvendin/>

<sup>100</sup> Faqe 14 e Raportit: <http://www.droni.al/wp-content/uploads/2018/01/Raporti-SP-per-KLP.pdf>



## **f.2) Për kandidatët në Këshillin e Lartë Gjyqësor**

**Në faqet zyrtare të Avokatit të Popullit dhe Kuvendit nuk mund të aksesohet raporti i përpiluar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, pas realizimit të procedurës së verifikimit paraprak të kandidatëve jogjyqtarë dhe joprokurorë për KLGJ.<sup>101</sup>**

Sekretari i Përgjithshëm ka vlerësuar pozitivisht kandidatin Z. **Altin Hazizaj**, për nivelin e studimeve akademike me rezultate të larta, pjesëmarrjen në trajnime dhe platformën e mirë strukturuar dhe të kompletuar.<sup>102</sup> **Por kandidati është kontestuar nga ana e përfaqësuesit të opozitës në Nënkomisionin Parlamentar Ad Hoc.** Sipas Raportit paralel të publikuar në media nga opozita, i cili mban datën 18.01.2018, reflektohet se dokumentet provuese të depozituara nga ky kandidat paraqesin një element të rëndësishëm, i cili vë në dyshim përbushjen e kushtit të ushtrimit të profesionit të juristit, së paku 5 vitet e fundit dhe në total të 15 vjet eksperiencë.<sup>103</sup> **Sipas përfaqësuesve të opozitës rezultojnë përdorimi i dy standardeve nga ana e Komisionit të Shoqërisë Civile, për verifikimin dhe vlerësimin e disa prej kandidatëve.** Referuar kandidatëve të s'kualifikuar në fazën e thirrjes së parë raporti paralel referon se kandidatët Z. Bledar Ilia dhe Znj. Ermira Deçka s'kualifikohen sepse nuk kanë 15 vite përvojë si jurist, kurse kandidatja Znj. Naureda Llagami kualifikohet edhe pse konstatohet se as ajo nuk i plotëson 15 vite përvojë efektive (i mungojnë 2 muaj) si dhe vihet në pikëpyetje angazhimi 5 vjeçar i saj në shoqërinë civile.

Përsa i përket kandidatës **Znj. Mimoza Qinami**, nga media rezultojnë se kjo është e vetmja kandidatë e cila është kualifikuar sipas vlerësimit të ONM-së, ndërkohë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit është klasifikuar si e fundit në grupin e kandidatëve kalues.<sup>104</sup> Si më poshtë paraqitet një rezymë për përvojën profesionale të kandidatëve të kualifikuar nga Sekretari i Përgjithshëm:

**Kandidatja Naureda Llagami**, e ka nisur karrierën si avokate në një shoqatë që ofronte shërbime ligjore falas, ku ka punuar për rreth 10 vjetësh deri në vitin 2010. Në vitin 2012, ajo merr një tjetër detyrë si eksperte ligjore në një shoqatë joqeveritare. Në vitin 2012 rikthehet në Ministrinë e Drejtësisë ku punon një vit si eksperte ligjore për çështjet e dhunës ndaj grave dhe përmirësimin e legjislacionit në këtë drejtim. Në periudhën 2012-2016, Llagami punon si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë.<sup>105</sup>

**Kandidati Altin Hazizaj**, rezultojnë se është pjesë aktive e shoqërisë civile që në moshën 18 vjeçare. Ai ka nxitur krijimin e organizatës së parë studentore në historinë e Shqipërisë të studentëve të juridikut (Liga e Studentëve të Drejtësisë), për të vazhduar më pas në krijimin e organizatës së parë të drejtave të fëmijëve, CRCA Shqipëri. Po ashtu ai është bashkë-themelues i disa prej rrjeteve më të rëndësishme në Shqipëri dhe në rajon për të drejtat e fëmijëve, të njeriut, të të rinjve etj.<sup>106</sup>

**Kandidatja Mimoza Qinami**, është angazhuar si eksperte pranë disa organizatave të shoqërisë civile, në fushën e veprimtarisë së të cilave është mbrojtja e të drejtave të grave.

Nr.	Kandidati i kualifikuar	Pikët totale sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm	Pikët totale sipas vlerësimit të Mbledhjes së Posaçme
1	Naureda Llagami	Mungon Info në faqen zyrtare	83 pikë
2	Altin Hazizaj	Mungon Info në faqen zyrtare	74.2 pikë
3	Mimoza Qinami	Mungon Info në faqen zyrtare	79 pikë

<sup>101</sup><https://www.parlament.al/News/Index/5525>

<sup>102</sup><https://www.gazetaexpress.com/lajme-nga-shqiperia/del-dokumenti-si-i-refuzuan-nderkombetaret-emrat-e-zgjedhur-ne-klgj-e-klp-491413/?archive=1>

<sup>103</sup><http://www.balkanweb.com/site/wp-content/uploads/2018/01/RAPORTI-KLGJ-KLP.docx>

<sup>104</sup><http://shqiptarja.com/lajm/klp-gjoncaj-rifut-ne-gare-dy-br-emra-nga-lista-e-zeze-e-onm-se-br-br>

<sup>105</sup><http://www.panorama.com.al/ngrihet-klgj-kush-eshte-kryetarja-e-zgjedhur-numerimi-mbrapsht-per-ringritjen-e-gjykates-se-larte/>

<sup>106</sup><http://www.amshc.gov.al/web/KKSHC/C/ALTIN%20HAZIZAJ.pdf>

**d) Procedurat parlamentare të ndjekura në Komisioni i Ligjeve / Nënkomisionet përgjegjëse si dhe në seancë plenare**

Duke u bazuar në kalendarin 3 javor të punimeve të Komisionit parlamentar të Ligjeve, më datë 17.01.2018 është realizuar njoftimi mbi përfundimin në tërësi të procesit të vlerësimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe ONM, të kandidatëve jo magjistratë në të dy Këshillat. Ndërkohë raporti i vlerësimit, lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore dhe atyre të përjashtuar, si dhe raporti i vlerësimit i përpiluar nga ONM, i është depozituar këtij Komisioni më datë 15.01.2018.

Komisioni i Ligjeve, në zbatim të pikës 19 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 shqyrtoi projekt-rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e nënkomisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, dhe vendosi miratimin e kësaj projekt rregulloreje me vendimin nr. 1 datë 17.01.2018. Në zbatim të ligjit, kryetari i Komisionit informoi të gjithë anëtarët e komisionit lidhur me kërkesën drejtuar grupeve parlamentare për caktimin e përfaqësuesve të tyre në nënkomisionin e përzgjedhjes së kandidatëve. Me unanimitet, nëpërmjet Vendimit nr.2, datë 18.01.2018 u krijua nënkomisioni i përzgjedhjes së kandidatëve, i cili përbëhej nga: Z. Ulsi Manja, Kryetar (përfaqësues i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste); Z. Oerd Bylykbashi, Nënkryetar (përfaqësues i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike); Znj. Vasilika Hysi, anëtare (përfaqësuese e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste); Znj. Klotilda Bushka, anëtare (përfaqësuese e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste); Z. Nasip Naço, anëtar (përfaqësues i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim).

**Nën/komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të KLGJ-së dhe KLP-së është konstituuar më datë 18.01.2018. Bazuar në nenin 35, pika 15 të ligjit nr. 115/2016, kryetari i nënkomisionit *ad hoc* jo më vonë se 3 ditë nga krijimi i përcjell kryetarit të Kuvendit listën e kandidatëve me raportin e vlerësimit. Ndërkohë që raporti “Mbi përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e jo gjyqtarëve dhe jo prokurorëve”, mban datën 22 Janar 2018 e si rrjedhojë është përpiluar jashtë këtij afati ligjor.<sup>107</sup>**

Nga monitorimi i mbledhjeve të nënkomisionit *Ad hoc*, vëzhguesit e KShH-së vërejtën mungesën e një dialogu konstruktiv midis anëtarëve si dhe përdorimin e tonaliteteve të larta apo mosrespektimin e rregullave të etikës. Të dhënat personale të kandidatëve u keqpërdorën gjatë këtyre diskutimeve, ndërkohë që përfaqësuesit e opozitës ngritën shqetësimin e mungesës së numrit minimal të kandidatëve të kërkuar nga Kushtetuta. Sipas përfaqësuesve të mazhorancës në këtë nënkomision, kuadri ligjor parashikon se numri i kandidatëve jo magjistratë për KLGJ-në dhe KLP-në nuk mund të jetë më pak se trefishi i vendeve vakante dhe ndaj kufiri minimal i parashikuar në ligj është respektuar.

Gjithashtu, gjatë mbledhjeve të nënkomisionit, u vërejtën një sërë debatesh lidhur me pretendimet e përfaqësuesve të forcave opozitare, të cilët deklaruan se lista e përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm është haptazi e paligjshme, pasi nga ONM-së për një numër të konsiderueshëm kandidatësh ka pasqyruar një sërë arsyesh për s’kualifikimin e tyre. Gjithashtu, ata ngritën akuza për një procedurë jo konsistente dhe me standarde të ndryshme në përzgjedhjen e këtyre kandidatëve, pasi përdorimi i një kriteri për njërin kandidat është i papërfillshëm për kandidatin tjetër. Për zgjedhjet e realizuara për 2 kandidatët nga bota akademike u referua se nuk ka pasur një procedurë të mirëfilltë konkurruese, por vetëm 1 listë të përpiluar. Këto pretendime u hodhën poshtë nga përfaqësuesit e mazhorancës në këtë Nënkomision, duke referuar nenin 149 të Kushtetutës.

Në mbledhjen e Nënkomisionit të datës 22.01.2018, referuar nenit 35, pika 7 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm ka paraqitur 2 lista. Gjithashtu, bazuar në nenin 35, pika 13 të këtij ligji, lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale dhe lista e kandidatëve të përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm, unifikohet në një listë të vetme. Në këtë mbledhje pati një sërë diskutimesh lidhur me kompetencën e nënkomisionit që të mund të përjashtojë me votat e katër anëtarëve ndonjë kandidat

<sup>107</sup><http://www.parlament.al/Files/Projekte/Raporti-i-Nenkomisionit-per-perzgjedhjen-e-kandidateve-per-anetare-te-KLGJ-dhe-KLP.pdf>

nga listat, ndërkohë që pika 13 e dispozitës së sipërcituar ka parashikuar vetëm të drejtën ligjore për të përfshirë në listë kandidatët e përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Megjithatë, ka rezultuar e kundërta kur lista e kandidatëve për anëtarë të KLGJ është rrëzuar në bllok nga Kuvendi dhe procedura parlamentare ka rinisur sërish në nënkomisionin “Ad Hoc”. Sipas njoftimeve të medias, nënkomisioni “Ad Hoc” ka përjashtuar nga gara kandidatin për anëtar të KLGJ-së, A.H, me tre vota nga anëtarët e mazhorancës. Përjashtimi i kandidatit të shoqërisë civile nga shorti është bërë pas akuzave të opozitës se ai prekej nga ligji i dekriminalizimit.<sup>108</sup> Në faqen zyrtare të institucionit të Kuvendit nuk rezultoi i publikuar vendimi dhe procesverbali i mbledhjes së këtij Nënkomisioni. KShH vlerëson se neni 35, pika 13 i ligjit nr.115/2016 duhet rishikuar nga Kuvendi në kuadër të kësaj situatë që është krijuar, pasi nënkomisioni ka vepruar në kushtet e një vakumi ligjor, duke mos pasur atribut të shprehur në ligj për të përjashtuar nga gara, kandidatët e kualifikuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

Gjatë kësaj mbledhjes së nënkomisionit parlamentar, objekt diskutimi u bë dhe përfshirja e një kandidati njëkohësisht në listën e KLGJ-së dhe KLP-së. Por në mënyrë unanime, u vendos që fillimisht do të bëhet vlerësimi i listës së kandidatëve për KLGJ. Nëse ky kandidat zgjidhet në këtë listë, në mënyrë automatike s’kualifikohet nga kandidimi për në KLP.<sup>109</sup> Në votim u hodhën fillimisht kandidatët për anëtar jomagjistratë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, përkatësisht 2 kandidatët nga avokatia, 2 kandidatët nga pedagogët dhe 1 kandidat nga shoqëria civile, respektivisht për të dyja këshillat. Më pas u hodhën për votim kandidatët për anëtar jomagjistratë në KLP.

#### **Kandidatët nga Shoqëria Civile për KLGJ:**

Emër, Mbiemër	PRO	KUNDËR	ABSTENIM	JO PJESË
Altin Hazizaj	1	-	-	4
Mimoza Qinami	1	-	-	4
Naureda Llagami	2	-	-	3

#### **Kandidatët nga trupa e pedagogëve për KLGJ:**

Emër, Mbiemër	PRO	KUNDËR	ABSTENIM	JO PJESË
Erjon Muharremaj	1	-	1	3
Ilir Panda	3	-	-	2
Maksim Qoku	3	-	-	2
Mirela Bogdani	1	-	-	4

#### **Kandidatët nga Shoqëria Civile për KLP:**

Emër, Mbiemër	PRO	KUNDËR	ABSTENIM	JO PJESË
Alfred Balla	2	-	-	3
Andi Muratej	1	-	-	4
Mimoza Qinami	1	-	-	4

#### **Kandidatët nga trupa e pedagogëve për KLP:**

Emër, Mbiemër	PRO	KUNDËR	ABSTENIM	JO PJESË
Eneida Sema	2	-	-	3
Gent Ibrahimimi	3	-	-	2
Mirela Bogdani	1	-	-	4
Oriona Mucollari	2	-	-	3
Sandër Beci	1	-	-	4

<sup>108</sup> <https://balkanweb.com/eshte-denuar-dy-here-perjashtohet-nga-gara-per-klgj-altin-hazizaj/>

<sup>109</sup> Ky është një vendim i ndërmjetëm i mbledhjes, i cili u miratua me shumicën e votave të anëtarëve.



Nga radhët e pedagogëve, lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret është 5, ndërkohë që nga ana e anëtarëve të forcave opozitare prezentë në këtë nënkomision rezulton se duhet të ishin 6 kandidatë, ndërkohë që kandidatja Znj. Mirela Bogdani ka qenë pjesë e të dy listave. Duke qenë se asnjë nga kandidatët për KLGJ dhe KLP nuk u miratuan me të paktën 4 vota të anëtarëve të nënkomisionit, kuorum ky i parashikuar në nenin 35, pika 14 të ligjit nr. 115/2016, u vendos që anëtarët të përzgjidhen me short manual nga lista e Sekretarit të Përgjithshëm. Referuar monitorimit të procesit të votimit të këtyre kandidatëve me anë të shortit manual të hedhur, bazuar në nenin 147, paragrafët 3 dhe 4, si dhe neni 149, paragrafët 3 dhe 4 të Kushtetutës u përzgjedhën kandidatët respektivë për KLGJ dhe KLP. Lista e kandidatëve pjesë e shortit është lista e hartuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Me shortin manual u përzgjedhën këta kandidatë:

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR		
AVOKATIA	Arben Vani	Sokol Lamaj
PEDAGOGJIA	Erion Muharremaj	Illir Panda
SHOQËRIA CIVILE	Altin Hazizaj	

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË		
AVOKATIA	Kozma Jano	Floreta Gjini
PEDAGOGJIA	Eneida Sema	Mirela Bogdani
SHOQËRIA CIVILE	Alfred Balla	

Bazuar në listën e kandidatëve që kanë rezultuar fitues nga hedhja e shortit në nënkomisionin parlamentar ad hoc për të dy Këshillat, në mbështetje të pikës 8 të nenit 147 të Kushtetutës, të pikës 16 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, Kuvendi ka rrëzuar në bllok 2 herë kandidatët e përzgjedhur për anëtarë të KLGJ-së<sup>110111</sup> dhe anëtarë të KLP-së.<sup>112</sup> **Në raundin e tretë të votimit në seancë plenare, nëpërmjet vendimeve nr. 18/2018<sup>113</sup> dhe 19/2018<sup>114</sup>, për shkak të mosarritjes së shumicës prej 2/3 të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, u vendos të konsiderohen të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të KLGJ dhe KLP, në përputhje me pikën 16 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016.**

<sup>110</sup><http://www.parlament.al/Files/Projekte/Projektvendim-KLGJ-1.pdf> (Datë depozitimi: 30.01.2018).

Kandidatët janë: **1. Fatos Lazimi (nga avokatia) 2. Fatmira Luli (nga avokatia) 3. Maksim Qoku (nga trupa e pedagogëve) 4. Mirela Bogdani (nga trupa e pedagogëve) 5. Naureda Llagami (nga shoqëria civile)** Kjo listë e dytë është rrëzuar në bllok nëpërmjet Vendimit nr. 11/2018, datë 01.02.2018.

<http://www.parlament.al/Files/Akte/vendim-nr.-11-dt.-1.2.2018.pdf>

<sup>111</sup>Kandidatët janë: **1. Arben Vani (nga avokatia) 2. Sokol Lamaj (nga avokatia) 3. Erjon Muharremaj (nga trupa e pedagogëve) 4. Illir Panda (nga trupa e pedagogëve) 5. Altin Hazizaj (nga shoqëria civile).**

<http://www.parlament.al/Files/Akte/vendim-nr.-3-dt.-25.1.2018-1.pdf>

<sup>112</sup>Lista e parë është rrëzuar në bllok nëpërmjet Vendimit nr. 4/2018, datë 25.01.2018.

<http://www.parlament.al/Files/Akte/vendim-nr.-4-dt.-25.1.2018.pdf>

Kandidatët sipas kësaj liste janë: **1. Floreta Gjini (nga avokatia) 2. Kozma Jano (nga avokatia) 3. Eneida Sema (nga trupa e pedagogëve) 4. Mirela Bogdani (nga trupa e pedagogëve) 5. Alfred Balla (nga shoqëria civile).**

Lista e dytë në bllok e kandidatëve për KLP-në është rrëzuar nëpërmjet Vendimit nr. 12/2018.

<http://www.parlament.al/Files/Projekte/vendim-nr.-12-dt.-1.2.2018-1.pdf>

Kandidatët janë: **1. Gëzim Allaraj (nga avokatia) 2. Floreta Gjini (nga avokatia) 3. Eneida Sema (nga trupa e pedagogëve) 4. Gent Ibrahimimi (nga trupa e pedagogëve) 5. Andi Muratej (nga shoqëria civile).**

Lista e dytë në bllok e kandidatëve për KLP-në është rrëzuar nëpërmjet Vendimit nr. 12/2018.

<http://www.parlament.al/Files/Projekte/vendim-nr.-12-dt.-1.2.2018-1.pdf>

<sup>113</sup>Kandidatët e listës së tretë për KLGJ janë: **1. Fatmira Luli (nga avokatia) 2. Alban Toro (nga avokatia) 3. Erjon Muharremaj (nga trupa e pedagogëve) 4. Maksim Qoku (nga trupa e pedagogëve) 5. Naureda Llagami (nga shoqëria civile).**

<http://www.parlament.al/Files/Akte/vendim-nr.-18-dt.-8.2.2018.pdf>

<sup>114</sup>Kandidatët e listës së tretë për KLP janë: **1. Nurihan Meta (Seiti) (nga avokatia) 2. Tartar Bazaj (nga avokatia) 3. Gent Ibrahimimi (nga trupa e pedagogëve) 4. Sandër Beci (nga trupa e pedagogëve) 5. Alfred Balla (nga shoqëria civile).**

<http://www.parlament.al/Files/Akte/vendim-nr.-19-dt.-8.2.2018.pdf>

Kandidatët fitues në Këshillin e Lartë Gjyqësor		
AVOKATIA	Fatmira Luli	Alban Toro
PEDAGOGJIA	Erion Muharremaj	Maksim Qoku
SHOQËRIA CIVILE	Naureda Llagami	
Kandidatët fitues në Këshillin e Lartë të Prokurorisë		
AVOKATIA	Nurihan Meta (Seiti)	Tartar Bazaj
PEDAGOGJIA	Gent Ibrahimimi	Sandër Beci
SHOQËRIA CIVILE	Alfred Balla	

## 2. PËRZGJEDHJA DHE EMËRIMI I ANËTARËVE MAGJISTRATË NË DY KËSHILLAT

### 2.1 Procedurat e ndjekura për anëtarët prokurorë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë

#### 2.1.1 Baza ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e prokurorëve

Baza ligjore e zgjedhjes së anëtarëve prokurorë në KLP është e përmblodhur në seksionin 2 (Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë), nënseksioni I (Procedura e zgjedhjes së anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë) i ligjit nr.115/2016, ku përfshihen nenet 105 - 116 si dhe në nenin 279 të këtij ligji.

Në veçanti, sipas nenit 105/1 të ligjit nr. 115/2016, mbledhja e përgjithshme e prokurorëve të të gjitha niveleve zgjedh 6 anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga të cilët:

- a) tre prej të zgjedhurve janë prokurorë të shkallës së parë. Së paku 1 prej tyre është prokuror në një prokurori pranë gjykatës të shkallës së parë jashtë Tiranës;
- b) dy prej të zgjedhurve janë prokurorë të prokurorisë pranë gjykatave të apelit, duke përfshirë edhe prokurorinë e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Së paku 1 prej tyre është prokuror në një prokurori pranë një gjykate apeli jashtë Tiranës;
- c) një prej të zgjedhurve është prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

#### 2.1.2 Shprehja e interesit për pozicionin e anëtarit prokuror në Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Në bazë të nenit 279 /1 të ligjit nr. 115/2016, jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, prokurorët e interesuar për pozicionin e anëtarit të KLP-së duhet të paraqesin pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) një kërkesë me shprehjen e interesit për të kandiduar si dhe dokumentacionin që kërkohet për rivlerësimin sipas ligjit përkatës. Në rast se KPK nuk do të ishte krijuar ende, ligji parashikonte se kërkesa duhet të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Për shkak të vonesës në ngritjen e KPK-së, me **njoftimin e datës 9 janar 2017**<sup>115</sup>, Kuvendi publikoi thirrjen me anë të së cilës prokurorëve të interesuar ju komunikua që, brenda datës **16 janar 2017**, të depozitonin edhe pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit një **kërkesë ku të shprehin interesin për të kandiduar në KLP**, si dhe një kopje të dokumentacionit përkatës për rivlerësimin.

Ndërkohë që, sipas nenit 108 dhe 279/2 të ligjit nr.115/2016, **brenda të njëjtit afat**, prokurorët e interesuar për pozicionin e anëtarit të KLP-së duhet t'i paraqisnin **Prokurorit të Përgjithshëm** dokumentacionin përkatës, në bazë të formularëve të vënë në dispozicion nga ky institucion.

Sipas raportimit të mediave, brenda afatit të sipërpërmendur, 19 prokurorë shprehën interesin për të kandiduar, ndërkohë që nuk pati njoftim në faqen zyrtare të Kuvendit apo të Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me këta kandidatë.

Më tej, sipas neneve 109 dhe 279/3 të ligjit nr. 115/2016, brenda 7 ditëve nga paraqitja e dokumentacionit, Prokurori i Përgjithshëm duhet të verifikonte përmbushjen e kriterëve ligjore dhe të njoftonte KPK-në dhe kandidatin, në rast nuk do të plotësonte kriteret. Në datë **24.01.2017**, në faqen

<sup>115</sup> <https://www.parlament.al/News/Index/5706>

zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme është publikuar lista me kandidatët zyrtarë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë<sup>116</sup>, e cila përmbante këto emra:

- **Nga Prokuroria e Përgjithshme, rezultojnë 3 kandidatë**, përkatësisht prokurorët e kësaj prokurorie, Znj. Anila Leka, Z. Kostaq Beluri dhe Z. Ramadan Troci.
- **Nga Prokuroritë e Apelit, rezultojnë 4 kandidatë**, përkatësisht Z. Luan Kaloci, Z. Bujar Hoti, Z. Arben Dollapaj dhe Znj. Besa Nikëhasani.
- **Nga Prokuroritë e Shkallës së Parë, rezultojnë 12 kandidatë zyrtarë**, përkatësisht 5 prokurorë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (z. Adriatik Cama, Znj. Antoneta Sevdari, Z. Arben Nela, Z. Dritan Rreshka, Z. Shpëtim Kurti) 2 prokurorë të Prokurorisë për Krimet e Rënda (z. Besnik Muçi dhe Z. Gentian Osmani), 2 prokurorë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (z. Arta Marku dhe Z. Vatë Staka), 1 prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (z. Besnik Cani), 1 prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë (z. Elsion Sadiku) dhe 1 prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës (z. Dritan Prençi).

I njëjti njoftim i Prokurorisë së Përgjithshme raporton se, në mbështetje të nenit 109/1, të ligjit nr. 115/2016, Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr.18 datë 17.01.2017, ka ngritur komisionin administrativ për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve prokurorë për KLP. Ky komision, i përbërë nga pesë anëtarë, në përfundim të kryerjes së verifikimeve të nevojshme dhe shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve, konstatoi se plotësonin kushtet ligjore për t'u zgjedhur anëtar i KLP-së, prokurorët e renditur më sipër. KShH vëren se, **procesi i verifikimit të kandidaturave nuk ishte transparent** për shkak të faktit se Prokuroria e Përgjithshme nuk publikoi të dhëna mbi dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, nuk publikoi në faqen zyrtare urdhrin për ngritjen e Komisionit, nuk publikoi informacione mbi përbërjen e tij, nuk publikoi raportin mbi verifikimin e përmbushjes së kriterëve nga secili kandidat.

Duke qenë se nga lista e datës 24.01.2017, disa nga kandidatët nga prokuroritë e apelit (siç do të analizohet në vijim), nuk arritën të konfirmohen në detyrë gjatë vettingut, Prokurori i Përgjithshëm, në datë **25 Shtator 2018** publikoi sërish shpalljen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga prokurorët e Prokurorisë të Apelit për pozicionin e anëtarit të KLP-së<sup>117118</sup>, duke caktuar si afat 15 ditë kohë nga data e shpalljes së njoftimit. Në të njëjtën shpallje, Prokuroria e Përgjithshme raportonte se me informacion të ardhur nga KPK, me nr. Prot 6250, datë 20 shtator 2018, mbi ecurinë e procesit të vettingut për prokurorët e listës prioritare, kandidatë për KLP, rezultonte se vetëm një prokuror nga Prokuroritë e Apelit ishte konfirmuar në detyrë.

Pas përfundimit të afatit ligjor të shpalljes së dytë asnjë kandidat nuk paraqiti shprehjen e interesit. Ndaj, në dt. 12 tetor 2018, Prokuroria e Përgjithshme publikoi ri shpalljen e *“Thirrje[s] për paraqitjen e shprehjes së interesit për kandidatë në KLP”*<sup>119</sup>. Në vijim, Prokuroria e Përgjithshme, në datë **1 nëntor 2018**, publikoi relacionin mbi verifikimin e plotësimit të kushteve për kandidatë në KLP<sup>120</sup>, i cili përmban të dhënat kryesore mbi verifikimet e kryera nga Komisioni i Prokurorisë së Përgjithshme, sipas të cilave kandidati i vetëm prokurori Bujar Sheshi plotëson kushtet ligjore. Në këtë rast, procesi i verifikimit të kandidaturave ishte transparent për shkak të faktit se Prokuroria e Përgjithshme publikoi në njoftimin saj emrat e kandidatëve që kishin shprehur interesin në sajë të ri shpalljes së dytë, pasqyroj një përshkrim të shkurtër të profilit të kandidatit, publikoi relacionin e komisionit të verifikimit. Megjithatë, puna e Komisionit u publikua vetëm pas mbarimit të verifikimit duke i mos dhënë mundësi institucioneve ose OJQ-ve që të vëzhgojnë procesin.

<sup>116</sup>[http://www.pp.gov.al/web/Shpallen\\_kandidatet\\_zyrtare\\_per\\_Keshillin\\_e\\_Larte\\_te\\_Prokurorise\\_1040\\_1.php#.XCCi9y2h1QI](http://www.pp.gov.al/web/Shpallen_kandidatet_zyrtare_per_Keshillin_e_Larte_te_Prokurorise_1040_1.php#.XCCi9y2h1QI)

<sup>117</sup>[http://www.pp.gov.al/web/thirrja\\_per\\_paraqitjen\\_e\\_shprehjes\\_se\\_interesit\\_per\\_kandidate\\_ne\\_keshillin\\_e\\_larte\\_te\\_prokurorise\\_1397.pdf](http://www.pp.gov.al/web/thirrja_per_paraqitjen_e_shprehjes_se_interesit_per_kandidate_ne_keshillin_e_larte_te_prokurorise_1397.pdf)

<sup>118</sup> Shkresa dt. 24.09.2018, nr. Prot 2542

<sup>119</sup> [http://www.pp.gov.al/web/thirrje\\_kandidatet\\_e\\_klp\\_12\\_10\\_2018\\_1411.pdf](http://www.pp.gov.al/web/thirrje_kandidatet_e_klp_12_10_2018_1411.pdf)

<sup>120</sup> [http://www.pp.gov.al/web/relacioni\\_per\\_kandidatin\\_e\\_keshillit\\_e\\_larte\\_te\\_prokurorise\\_1412.pdf](http://www.pp.gov.al/web/relacioni_per_kandidatin_e_keshillit_e_larte_te_prokurorise_1412.pdf)

KShH vëren se neni 279 i ligjit nr. 115/2016, i cili përmban dispozitat kalimtare mbi zgjedhjen e anëtarëve të KLP-së parë, nuk ka shprehur se çfarë ndodh në rast se nuk ka më kandidatë nga njëri prej niveleve të prokurorisë të parashikuan nga ligji. Megjithatë, kjo parashikohet në dispozitat e pjesës së tretë që rregullojnë procedurën e plotë të përzgjedhjes së këtyre kandidatëve, kreu I të ligjit dhe konkretisht në nenin 109, pika 5 të tij, ku parashikohet se “*Në qoftë se edhe pas thirrjes së dytë nuk paraqiten kandidatë nga shkallët e pa përfaqësuar të prokurorisë, zgjedhja e tyre bëhet me short nga radhët e prokurorëve që kanë kandiduar për vendin vakant. Çdo kandidat që përmbush kriteret për t’u zgjedhur anëtar i Këshillit dhe kriteret për t’u ngritur në detyrë ose për t’u transferuar në shkallët e pa përfaqësuar të prokurorisë, ka të drejtë të kandidojë për vendin vakant përkatës*”.

### **2.1.3 Procesi i rivlerësimit kalimtar (vettingu) të kandidatëve zyrtar për anëtar të KLP-së**

Në bazë të nenit 279/4 të ligjit nr. 115/2016, brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit, KPK duhet të bënte rivlerësimin e prokurorëve që kandidojnë për anëtar në KLP. Ky afat nuk është respektuar, për shkak se KPK u konstituua me vonesë të konsiderueshme. Më tej, po i njëjti nen parashikon se prokurori, i cili, me vendim të KPK, nuk e kalon procedurën e rivlerësimit përjashtohet nga procesi i kandidimit, edhe kur ndaj vendimit të KPK-së është ushtruar ankim. Si rrjedhojë zgjedhja e kandidatëve vazhdon pa pjesëmarrjen e këtij kandidati.

Në vijim do analizohen rezultatet e procesit të vettingut mbi secilin nga kandidatët e komunikuar në listat e shpallura nga Prokuroria e Përgjithshme.

#### **A) Rivlerësimi kalimtar (vettingu) i kandidatëve të listës së datës 24 janar 2017**

Të gjithë kandidatët e kësaj liste ju nënshtruan procesit të rivlerësimit me përparësi dhe emri i secilit prej tyre u përfshi në shortin e parë që u hodh nga KPK, në datë 30 nëntor 2017<sup>121</sup>. Procedurat e rivlerësimit kalimtar për kandidatët e komunikuar në këtë listë sollën konfirmimin në detyrë të pothuajse më shumë se gjysmës së tyre, përkatësisht 10 prej kandidatëve dhe shkarkimin nga detyra të 9 prej prokurorëve. Nga 10 prokurorë të konfirmuar në detyrë nga KPK, rezultojnë se 3 prej tyre janë prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, 2 në Prokurorinë e Apelit (një prej të cilëve në Prokurorinë e Apelit për Krimet e Rënda), 3 në Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe 3 prokurorë në Prokuroritë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda.

Për gjysmën e anëtarëve të konfirmuar në detyrë nga KPK, Komisioneri Publik ka ushtruar të drejtën e ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, dhe rrjedhimisht vendimi i konfirmimit në detyrë nuk ka qenë i formës së prerë pas kalimit të afatit të ankimit. Deri në periudhën që ky raport mbulon, për një nga subjektet ndaj të cilit është ushtruar ankim është vendosur shkarkim nga detyra, çka ka bërë që në KLP të krijohet një vakancë në radhët e anëtarëve prokurorë.

Ndërkohë që për 7 nga 9 vendimet e shkarkimit rezultojnë të jenë ankimuar në KPA, ku deri në periudhën që raporti mbulon, në tre raste ky organ ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KPK-së. Në asnjë rast nga çështjet e ankimuar nuk është vendosur nga KPA ndryshimi i vendimit. Në 9 rastet e shkarkimit të prokurorëve kandidatë në KLP rezultojnë se shumica dërmuese e tyre janë penalizuar për shkak të kriterit të pasurisë dhe vetëm në raste sporadike ky kriter është lidhur edhe me kritere të tjera si p.sh. figura apo aftësitë profesionale.

Për vendimet e KPK-së për kandidatët anëtarë në KLP rezultojnë se mesatarja e gjyqimit të çështjeve të ankuara në KPA varion 5-6 muaj. Konkretisht, vettingu i kandidatëve për anëtar nga radhët e prokurorëve në KLP të përfshirë në listën e dt.24 Janar 2017 solli këto rezultate:

**Kandidatët e konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit janë si vijon:**

<sup>121</sup> <http://kpk.al/2017/12/12/njoftim/>

(i). **Znj. Anila Leka (Prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme)**, konfirmohet në detyrë me vendimin e datës 06/06/2018 të KPK-së. Komisioneri Publik, me datë 20/07/2018 ka vendosur mos-ankimin e vendimit të KPK dhe me kalimin e afatit të ankimit, vendimi i KPK-së është i formës së prerë.

(ii). **Z. Kostaq Beluri (Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme)**, konfirmohet në detyrë me vendimin e datës 12/07/2018 të KPK-së. Me datë 29/08/2018, Komisioneri Publik vendosi mos-ankimin e vendimit dhe me kalimin e afatit të ankimit, vendimi i KPK-së është i formës së prerë.

(iii). **Z. Arben Dollapaj (Prokuror në Prokurorinë e Apelit Shkodër)** konfirmohet në detyrë me vendimin e datës 06/08/2018, të KPK-së. Me datë 20/08/2018, Komisioneri Publik ka vendosur të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi. Rezulton se në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, është hedhur shorti për caktimin e trupit gjykues, kryesuesin e këtij trupi dhe relatorin e çështjes.

(iv). **Znj. Antoneta Sevdari (Prokurore në Prokurorinë e Rrethit Tiranë)** konfirmohet në detyrë me vendimin e datës 18/07/2018 të KPK-së. Me datë 29/08/2018 Komisioneri Publik ka vendosur të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi. Në dt.28 Shkurt 2019, KPA ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.42, datë 18.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

(v). **Z. Besnik Muçi (Prokuror pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Tiranë)** është konfirmuar në detyrë me vendimin e datës 01/08/2018 të KPK-së. Me datë 31/10/2018, Komisioneri Publik vendos ankimin e vendimit të KPK. Me datë 15/11/2018 është hedhur shorti në KPA, për përcaktimin e trupit gjykues, kryesuesit të këtij trupi dhe relatorit të çështjes.

(vi). **Z. Gentian Osmani (Prokuror në Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë)** është konfirmuar në detyrë me vendimin e datës 02/08/2018 të KPK-së. Me datë 15/11/2018 Komisioneri Publik ka vendosur ankimin e vendimit të KPK. Deri tani KPA nuk është shprehur për këtë subjekt.

(vii). **Z. Besnik Cani (Prokuror në Prokurorinë e Rrethit të Elbasanit)** është konfirmuar në detyrë me vendimin e KPK-së të datës 27/11/2018. Në dt.8 Shkurt 2018, Komisioneri Publik ka vendosur të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj vendimit të KPK-së. Ndërkohë që referuar të dhënave të publikuara në faqen e KPA-së, nuk rezulton të jetë publikuar ende trupi gjykues që do të shqyrtojë këtë çështje.

(viii). **Z. Dritan Prenci (prokuror i përkohshëm në Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë)** është konfirmuar në detyrë me vendimin e KPK-së të datës 07/06/2018. Me datë 10/07/2018, Komisioneri Publik ka vendosur mos ankimin e vendimit të KPK. Ky vendim ka marrë formë të prerë me datë 17/07/2018.

(ix). **Znj. Arta Marku (Prokurore e Përgjithshme në Prokurorinë e Përgjithshme)** është konfirmuar në detyrë me vendimin e datës 04/07/2018 të KPK-së. Komisioneri Publik me datë 15/08/2018 ka bërë publik vendimin e saj për mos ankimin e këtij vendimi. Vendimi i KPK-së ka marrë formë të prerë.

(x). **Z. Vatë Staka (Prokuror pranë prokurorisë së Rrethit, Shkodër)**, është konfirmuar në detyrë me vendimin e datës 03/07/2018 të KPK-së. Me datë 03/09/2018 Komisioneri Publik ka vendosur mos ankimin e vendimit të KPK. Vendimi i konfirmimit në detyrë nga KPK ka marrë formë të prerë me datë 05/09/2018.

#### **Kandidatët e shkarkuar nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit janë si vijon:**

(i). **Z. Ramadan Troci (prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme)** është shkarkuar nga detyra me vendimin e KPK-së të datës 15/11/2018. Subjekti e ka ushtuar të drejtën e ankimit dhe KPA nuk ka dhënë ende vendim, deri në periudhën që mbulon ky raport.

(ii). **Z. Luan Kaloçi (prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë)** është shkarkuar nga detyra me vendimin e KPK-së të datës 05/07/2018, pasi u konstatua se subjekti nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë. Me datë 03/09/2018 subjekti i rivlerësimit ka ankimuar vendimin e KPK. KPA me datë 23/10/2018 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KPK dhe shkarkimin nga detyra të prokurorit.



(iii). **Z. Bujar Hoti (prokuror në Prokurorinë e Apelit Durrës)** është shkarkuar me vendimin e KPK-së të datës 10/09/2018, me arsyetimin se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Me datë 06/11/2018 është bërë ankimi i vendimit nga vetë subjekti i rivlerësimit. Me datë 09/11/2018 është bërë hedhja e shortit për përcaktimin e trupit gjykues .

(iv). **Znj. Besa Nikëhasani (prokurore në Prokurorinë e Apelit Shkodër)** është shkarkuar nga detyra me vendim të KPK-së të datës 20/04/2018, për shkak se rezultoi se ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë. Me datë 21/12/2018, subjekti i rivlerësimit ka ankimuar vendimin e KPK-së. Me datë 12/09/2018, KPA ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KPK për shkarkimin nga detyra të prokurores.

(v). **Z. Adriatik Cama (prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjiqësor Tiranë)** është shkarkuar nga detyra me vendimin e KPK-së të datës 12/07/2018, në të cilin konstatohet se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të pasurisë. Me datë 01/10/2018, subjekti i rivlerësimit ka ankimuar vendimin e KPK, për shkarkimin e tij nga detyra. Në dt.18 Shkurt 2019, KPA ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 35, datë 12.07.2018 të KPK-së.

(vi). **Z. Arben Nela (prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjiqësor Tiranë)** është shkarkuar nga detyra me vendimin e KPK-së të datës 23/07/2018, me arsyetimin se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë. Subjekti ka ushtruar të drejtën e ankimit në KPA, e cila me datë 09/11/2018 ka hedhur shortin për përcaktimin e trupit gjykues.

(vii). **Z. Dritan Rreshka (prokuror në Gjykatën e Rrethit Gjiqësor Tiranë)** është shkarkuar me vendimin e datës 31/07/2018, pasi nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave, duke bërë kështu deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Me 14/11/2018, Komisioneri Publik ka vendosur mos ankimin e vendimit të KPK. Subjekti ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe në datën 07.12.2018, në KPA është hedhur shorti për caktimin e trupit gjykues, kryesuesin e këtij trupi dhe relatorin e çështjes.

(viii). **Z. Shpëtim Kurti (prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjiqësor Tiranë)** është shkarkuar nga detyra me vendimin e KPK të datës 23/11/2018. Ky vendim është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit dhe në datën 30.01.2019, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, është shorti për caktimin e trupit gjykues, kryesuesin e këtij trupi dhe relatorin e çështjes.

(ix). **Z. Elision Sadiku (prokuror në Prokurorinë e Rrethit të Korçës)** është shkarkuar me vendimin e KPK-së të datës 27/07/2018. Me datë 25/10/2018, subjekti ka ankimuar vendimin e KPK. Në datën 19.03.2019, do të gjykohet pranë KPA-së në dhomë këshillimi ankimi i tij.

## **B. Rivlerësimi i kandidatëve që kandiduan pas ri shpalljes së thirrjeve për shprehje interesit nga ana e Prokurorisë**

Prokuroria e Përgjithshme, në datë 1.11.2018 njoftoi se pas shpalljes së thirrjeve të reja, vetëm kandidati Bujar Sheshi kishte shprehur interesin për kandidaturën si anëtar i KLP. Me vendimin nr.71, dt. 24.10.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur konfirmimin në detyrë të këtij subjekti. Ndërkohë, Komisioneri Publik ka njoftuar në faqen zyrtare mos ankimimin e këtij vendimi.<sup>122</sup>

### **2.1.4 Mbledhja e përgjithshme e prokurorëve**

Një numër i mjaftueshëm kandidatësh rezultuan se e kishin kaluar procedurën rivlerësimit kalimtar ndaj u vijua më tej me procedurat e parashikuara në ligjin nr.115/2016, për përzgjedhjen e anëtarëve të KLP-së.

#### **A. Thirrja e mbledhjes dhe procedurat paraprake**

Pas përfundimit të procedurës së rivlerësimit për të gjithë kandidatët e listës së Prokurorit të Përgjithshëm, KPK, në respektim të nenit 279/5 të Ligjit nr. 115/2016, në datë 27.11.2018 me shkresën nr. 7995/1 Prot., i përcolli Prokurorisë së Përgjithshme listën me emrat e kandidatëve

<sup>122</sup> <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/12/Njoftim-për-mosankimin-e-vendimit-nr.-71-datë-24.10.2018-të-KPK-së-për-subjektin-e-rivlerësimit-z.-Bujar-Sheshi.pdf>

prokurorë që e kaluan me sukses vettingun. Lista zyrtare me emrat e kandidatëve prokurorë që e kaluan me sukses procesin e vettingut nuk është e publikuar në faqen zyrtare të KPK dhe as në faqen e Prokurorisë së Përgjithshme, por u bë publike vetëm nga media.

Kandidatët prokurorë të përfshirë në këtë listë, siç do të rezultonte nga informacioni i marrë gjatë realizimit të mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve, janë 2 prokurorë nga Prokuroria e Përgjithshme, 2 prokurorë nga Prokuroritë e Apelit dhe 6 prokurorë nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë (3 prej të cilëve nga Gjykata e Krimeve të Rënda)<sup>123</sup>.

Referuar nenit 279/6 të ligjit nr.115/2016, brenda afatit 3 ditore të parashikuar nga ligji, pas marrjes së listës nga KPK, Prokurori i Përgjithshëm nëpërmjet njoftimit të datës 27.11.2018 thërriti mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve<sup>124</sup> në datën 11.12.2018, ora 09.00. Disa ditë para mbajtjes së mbledhjes, në datë 8 dhjetor 2018, në faqen zyrtare të prokurorisë së përgjithshme u publikua draft rregullorja e mbledhjes për zgjedhjen e anëtarëve të KLP-së<sup>125</sup>.

Më datë 10.11.2018, në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme, vëzhguesit e KShH-së monitoruan procesin e shortit për zgjedhjen e 3 anëtarëve të komisionit të votimit. Sipas këtij shorti, anëtarët e komisionit rezultuan Z. Arqilea Koça (kryetar), Z. Alfred Progonati (anëtar) dhe Z. Adnand Kosova (anëtar). Ky komision u krijua sipas nenit 114/4 të ligjit nr. 115/2016 dhe nenit 7 të draft rregullores “Për procesin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të KLP-së dhe zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit”. Në mënyrë unanime, nga ana e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme u miratua dhe kërkesa e paraqitur nga ana e prokurorit Z. Sokol Stojani, i cili për arsye shëndetësore nuk mund të ishte pjesë si kandidat që të shortohej për të krijuar këtë komision.

## **B. Zhvillimi i mbledhjes dhe shpallja e rezultateve**

Mbledhja e përgjithshme e prokurorëve u mbajt në datë 11.12.2018. Thirrja dhe realizimi i kësaj mbledhje është karakterizuar nga një transparencë e lartë karshi organizatave vendase dhe ndërkombëtare që e monitoruan procesin si dhe medias së pranishme në sallën e mbledhjes.

Prokurori i Përgjithshëm, në cilësinë e drejtuesit të mbledhjes verifikoi ekzistencën e kuorumit të parashikuar në nenin 112/2 të ligjit nr. 115/2016. Nga ky verifikim rezultoi se numri i përgjithshëm i prokurorëve ishte 305, ndërkohë që pjesëmarrja e të pranishmëve ishte e lartë, përkatësisht 295 prokurorë që përbënin 96.7% të numrit total të tyre.<sup>126</sup>

Pas verifikimit të kuorumit, u prezantua draft rregullorja, e cila u hodh për votim me anë të një flete të bardhë ku prokurorët u shprehën me alternativat PO/JO, nëse ishin ose jo dakord për miratimin e saj, ose në të kundërt mund të referonin ndryshime. Rregullorja u miratua nga shumica dërrmuese e prokurorëve,<sup>127</sup> përkatësisht 262 prokurorë votuan PRO dhe 2 prokurorë votuan KUNDËR.<sup>128</sup>

Prokurori i Përgjithshëm prezantoi listën e kandidatëve për anëtarë të KLP-së, sipas shkallëve të prokurorisë si dhe numrin e vendeve vakante për çdo shkallë. Në përputhje me nenin 149/3 të Kushtetutës u relatua se nga Prokuroria e Përgjithshme kishte 2 kandidatë, përkatësisht Znj. Anila Leka dhe Z. Kostaq Beluri, të cilët garonin për 1 vend vakant. Përsa i përket prokurorëve pranë Prokurorive të Apelit kishte 2 kandidatura për 2 vende vakante, përkatësisht Z. Arben Dollapaj dhe Z. Bujar Sheshi. Ndërkohë për 3 pozicionet vakante në KLP për anëtarët e Prokurorive të Shkallës së

<sup>123</sup> Kandidate për në KLP nga Prokuroria e Përgjithshme ka qenë dhe Znj. Arta Marku, por tashmë ajo rezultoi anëtare automatikisht e zgjedhur (pa iu nënshtruar procedurës shortuese) e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të Përkohshëm, më dt. 7 Dhjetor 2018.

<sup>124</sup> [http://www.pp.gov.al/web/Njoftim\\_per\\_thirrjen\\_e\\_mbledhjes\\_se\\_pergjithshme\\_te\\_prokuroreve\\_per\\_zgjedhjen\\_e\\_anetareve\\_prokuror\\_e\\_te\\_Keshillit\\_te\\_Larte\\_te\\_Prokuroris\\_1248\\_1.php](http://www.pp.gov.al/web/Njoftim_per_thirrjen_e_mbledhjes_se_pergjithshme_te_prokuroreve_per_zgjedhjen_e_anetareve_prokuror_e_te_Keshillit_te_Larte_te_Prokuroris_1248_1.php)

<sup>125</sup> [http://www.pp.gov.al/web/draft\\_rregullore\\_mbledhja\\_e\\_pergjithshme\\_e\\_prokuroreve\\_1423\\_1424.pdf](http://www.pp.gov.al/web/draft_rregullore_mbledhja_e_pergjithshme_e_prokuroreve_1423_1424.pdf)

<sup>126</sup> Kemi plotësim të kuorumit, pasi janë të pranishëm më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të prokurorëve.

<sup>127</sup> [http://www.pp.gov.al/web/rregullorja\\_e\\_miratuar nga\\_mbledhja\\_e\\_pergjithshme\\_e\\_prokuroreve\\_1431.pdf](http://www.pp.gov.al/web/rregullorja_e_miratuar nga_mbledhja_e_pergjithshme_e_prokuroreve_1431.pdf)

<sup>128</sup> Ky numër nuk përkon me numrin e prokurorëve që kanë votuar në fund për kandidatët, por në momentin e diskutimit të Draft Rregullores ky ishte numri i kandidatëve prokurorë të cilët ishin të pranishëm në Mbledhje.



Parë kandidonin 6 prokurorë, përkatësisht: Znj. Antoneta Sevdari, Z. Besnik Cani, Z. Besnik Muçi, Z. Gentian Osmani, Z. Dritan Prençi dhe Z. Vatë Staka. Në ndryshim nga procesi i përzgjedhjes së anëtarëve jomagjistratë për dy Këshillat, i cili parashikon numër minimal kandidatësh për vendet vakante, për kandidatët që vijnë nga gjyqësori dhe prokuroria, ligji nr.115/2016 nuk parashikon kuota minimale, çka e ul konkurrueshmërinë midis kandidatëve për këto vende. Në mënyrë të veçantë kjo vlen në rastet kur numri i vendeve vakante përkon me numrin e kandidatëve që përfaqësojnë të njëjtin nivel prokurorie.

Përpara nisjes së procedurës së votimit, kandidatët paraqitën platformat e tyre. Pjesa më e madhe e platformave nuk ishin vizionare dhe u ndalën më së shumti në analizën e reformës në sistemin e drejtësisë. Ndërkohë që ishin të paktë kandidatët të cilët kishin parashikuar platforma objektive dhe të mirë strukturuara, duke shpalosur në mënyrë koncize, objektivat dhe këndvështrimin e tyre si anëtarë potencialë të KLP. Të pakët ishin anëtarët që në prezantimin e platformave ruajtjen një balancë të drejtë midis nevojës për të pasur një promovim dhe vlerësim meritokratik të prokurorëve si dhe nevojës për të rritur përgjegjshmërinë e prokurorëve me anë të një procesi disiplinor sa më objektiv, profesional dhe të paanshëm. Prosesi i votimit u realizua në përputhje me urdhrin nr. 277, datë 07.12.2018 “Për miratimin e fletës tip të votimit për anëtarët prokurorë të KLP-së” lëshuar nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm.<sup>129</sup> Procedura e votimit u realizua sipas niveleve të prokurorive dhe largësisë së tyre, ndërkohë që rastet përjashtimore u morën në konsideratë kërkesat për lëvizjet emergjente. Ky proces u mbyll në orën 15:05<sup>130</sup>, ndërkohë që numërimi i votave u realizua në përputhje me nenin 13 të Rregullores nga ana e Komisionit të Votimit.

Nga procesverbali i procesit të votimit të mbledhjes së përgjithshme, datë 11.12.2018, rezulton se numri total i votave të hedhura është 1770 (kjo për arsye se një prokuror me të drejtë vote ka votuar disa herë për kandidatët që garonin për pozicionet vakante). Nga numri total i votave, 1544 vota janë deklaruar të vlefshme dhe 226 janë deklaruar të pavlefshme. Pavarësisht udhëzimeve të dhëna për anëtarët me të drejtë vote, sërish vërehet që 12.7% e votave të anëtarëve të mbledhjes kanë qenë të pavlefshme, numër ky relativisht i lartë po të krahasohet me totalin. Numri i votave të hedhura është: 885 vota për kandidatët nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, nga të cilat 778 janë vota të vlefshme dhe 107 janë vota të pavlefshme; 590 vota për kandidatët nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit, nga të cilat 478 janë vota të vlefshme dhe 112 janë vota të pavlefshme; 295 vota për kandidatët nga Prokuroria e Përgjithshme, nga të cilat 288 janë vota të vlefshme dhe 7 janë vota të pavlefshme.

Nga numërimi i votave, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton të jetë votuar për kandidatët sipas çdo shkalle, si vijon:<sup>131</sup>

**a.** Kandidatët nga prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë kandidonin për tre vende vakante dhe janë votuar sipas kësaj renditje (duke filluar nga kandidati që ka marrë numrin më të lartë të votave):

1. Z. Gentian Osmani 181 vota;
2. Znj. Antoneta Sevdari 161 vota;
3. Z. Besnik Cani 148 vota;
4. Z. Dritan Prençi 127 vota;
5. Z. Vatë Staka 86 vota;
6. Z. Besnik Muçi 75 vota;

**b.** Dy kandidatët nga prokurorët pranë gjykatave të apelit kandidonin për 2 vende vakante, çka nuk mundësonte një garim konkurrues midis tyre. Këta kandidatë janë votuar sipas kësaj renditje (duke filluar nga kandidati që ka marrë numrin më të lartë të votave):

<sup>129</sup> [http://www.pp.gov.al/web/urdheri\\_per\\_miratimin\\_e\\_fleteve\\_te\\_votimit\\_1426.pdf](http://www.pp.gov.al/web/urdheri_per_miratimin_e_fleteve_te_votimit_1426.pdf)

<sup>130</sup> Votimi nisi në orën 13:03.

<sup>131</sup> [http://www.pp.gov.al/web/vendim\\_1429.pdf](http://www.pp.gov.al/web/vendim_1429.pdf)

1. Z. Bujar Sheshi 246 vota;
2. Z. Arben Dollapaj 232 vota;

**c.** Kandidatët nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kandidonin për një vend vakant dhe janë votuar sipas kësaj renditje (duke filluar nga kandidati që ka marrë numrin më të lartë të votave):

1. Z. Kostaq Beluri 202 vota;
2. Znj. Anila Leka 86 vota;

Në përputhje me nenin 115, pika 5 të ligjit nr. 115/2016, kandidatët me numrin më të madh të votave që janë zgjedhur në KLP, sipas shkallëve të prokurorive janë:

**Nga prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë:**

1. Z. Gentian Osmani;
2. Znj. Antoneta Sevdari, e cila më vonë u shkarkua nga organi i instancës së dytë të vettingut, Kolegji i Posaçëm i Apelit;
3. Z. Besnik Cani.

**Nga prokurorët pranë gjykatave të apelit:**

1. Z. Bujar Sheshi;
2. Z. Arben Dollapaj.

**Nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme:**

1. Z. Kostaq Beluri.

**C. Ankimet e mundshme**

Në bazë të nenit 116 të ligjit nr. 115/2016, jo më vonë se 5 ditë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme mund të bëhen ankime në Gjykatën Administrative të Apelit për shkelje të procedurës që lidhet me thirrjen e mbledhjes së përgjithshme, në verifikimin e pjesëmarrjes, të votimit dhe numërimit të votave, të konstatimit dhe shpalljes së votave të pavlefshme dhe të shpalljes së rezultatit gjatë mbledhjes së përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve të KLP-së.

Në rastin konkret, shpallja e rezultateve të mbledhjes së përgjithshme në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme u krye në datë 11 dhjetor 2018<sup>132</sup> dhe nuk pati ndonjë informacion as në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit dhe as në media për ndonjë ankim të mundshëm.

**2.2 Procedurat e ndjekura për anëtarët gjyqtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor**

**2.2.1 Baza ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor**

Baza ligjore për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë në KLGJ është e përmbledhur në seksionin nr.2 (zgjedhja e anëtarëve të KLGJ), nënseksioni I (procedura e zgjedhjes së anëtarëve gjyqtarë të KLGJ) e ligjit nr. 115/2016, ku përfshihen nenet 7-18 si dhe në nenin 276. Në veçanti, referuar nenit 7/1 të ligjit nr. 115/2016, mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të të gjitha niveleve zgjedh 6 anëtarë të KLGJ-së, nga të cilët:

<sup>132</sup> [http://www.pp.gov.al/web/vendim\\_1429.pdf](http://www.pp.gov.al/web/vendim_1429.pdf)

- d) tre prej të zgjedhurve janë gjyqtarë të shkallës së parë. Së paku 1 prej tyre është gjyqtar në një gjykatë të shkallës së parë jashtë Tiranës.
- e) dy prej të zgjedhurve janë gjyqtarë të apelit. Së paku 1 prej tyre është gjyqtar në një gjykatë të apelit jashtë Tiranës.
- f) një prej të zgjedhurve është gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

### 2.2.2 Shprehja e interesit për pozicionin e anëtarit në Këshillin e Lartë Gjyqësor

Në bazë të nenit 276 /1 të ligjit nr. 115/2016, jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, gjyqtarët e interesuar për pozicionin e anëtarit të KLGJ-së duhet të paraqesin pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), një kërkesë me shprehjen e interesit për t'u kandiduar si dhe dokumentacionin që kërkohej për rivlerësimin kalimtar sipas ligjit të vettingut. Në rast se KPK nuk do të ishte krijuar ende, ligji parashikonte se kërkesa duhet të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

Për shkak të vonësës në ngritjen e KPK-së, me njoftimin e datës 9 janar 2017<sup>133</sup>, Kuvendi publikoi thirrjen me anë të së cilës gjyqtarëve të interesuar për pozicionin e anëtarit të KLGJ-së ju kërkua që, brenda datës 16 janar 2017, të depozitonin edhe pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit një kërkesë ku të shprehin interesin për të kandiduar, si dhe një kopje të dokumentacionit që kërkohet për rivlerësimin. Ndërkohë që, sipas nenit 276/2 të ligjit nr. 115/2016, brenda të njëjtit afat, gjyqtarët e interesuar për këtë pozicion duhet t'i paraqisnin kryetarit të Gjykatës së Lartë, dokumentacionin përkatës, në bazë të formularëve të vënë në dispozicion nga Gjykata e Lartë.

Sipas raportimit të mediave, brenda afatit të sipërpërmendur, 14 gjyqtarë paraqitën shprehjen e interesit. Ndërkohë që në faqet zyrtare të internetit të institucioneve të sipërpërmendura nuk pati asnjë njoftim mbi detajet e shprehjeve të interesit.

Referuar nenit 276/3 të ligjit nr. 115/2016, brenda 7 ditëve nga paraqitja e dokumentacionit, kryetari i Gjykatës së Lartë duhet të verifikonte përmbushjen e kriterëve ligjore, sipas procedurave të parashikuara në nenin 11 të ligjit si dhe të njoftonte KPK dhe kandidatin, në rast se ndonjë prej tyre nuk plotësonte kriteret. Në datë 25.01.2017, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është publikuar lista për ‘‘Shpalljen e kandidatëve zyrtarë për Këshillin e Lartë Gjyqësor’’<sup>134</sup>, e cila përmbante këto emra:

- Nga Gjykata e Lartë rezultojnë 2 kandidatë zyrtarë, përkatësisht, Z. Artan Zeneli dhe Z. Medi Bici.
- Nga Gjykatat e Apeleve rezultojnë 3 kandidatë zyrtarë, përkatësisht Z. Ilir Toska nga Gjykata e Apelit Tiranë, Znj. Nertina Kosova nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe Z. Besim Trezhnjeva nga Gjykata e Apelit Durrës.
- Nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore rezultojnë 9 kandidatë, përkatësisht, 7 kandidatë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (znj. Alma Brati, Z. Artan Lazaj, Z. Astrit Faqolli, Z. Bledar Abdullahi, Znj. Brunilda Kadi, Znj. Brunilda Kasmi, Znj. Manjola Xhaxho), 1 kandidat nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (z. Dritan Hallunaj) dhe 1 kandidate nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin (znj. Marçela Shehu)

Procesi i verifikimit të kandidaturave nuk ishte transparent për shkak të faktit se Gjykata e Lartë nuk publikoi të dhëna mbi dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, mbi komisionin i cili verifikoi përmbushjen e kriterëve si dhe mbi rezultatet e plota të verifikimit, ndërkohë që u publikuan vetëm emrat e gjyqtarëve që plotësonin këto kriterë.

<sup>133</sup> <https://www.parlament.al/News/Index/5706>

<sup>134</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Shpallen\\_kandidatet\\_zyrtare\\_per\\_Keshillin\\_e\\_Larte\\_Gjyqesor\\_4137\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Shpallen_kandidatet_zyrtare_per_Keshillin_e_Larte_Gjyqesor_4137_1.php)

Duke qenë se nga lista e parë, disa nga kandidatët e përzgjedhur nga Gjykatat e Apelit jashtë Tiranës (siç do të analizohet në vijim), nuk arritën të kualifikohen gjatë procedurës së rivlerësimit, pas një viti e gjysmë nga shpallja e listës së parë, kryetari i Gjykatës së Lartë në datë 1 gusht 2018 publikoi ri shpalljen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga gjyqtarët e Gjykatave të Apelit jashtë Tiranës për pozicionin e anëtarit të KLGJ, duke caktuar si afat datën 15 shtator 2018. Kjo shpallje, edhe pse fillimisht u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, tashmë gjendet e publikuar vetëm nga mediat<sup>135</sup>. Gjatë javëve të para të rihapjes së thirrjes, asnjë kandidat nuk paraqiti shprehjen e interesit. Ndaj, në dt. 22 gusht 2018 Gjykata e Lartë publikoi ri shpalljen e thirrjes drejtuar gjyqtarëve të gjykatave të apelit jashtë Tiranës<sup>136</sup>, me afat deri në dt. 6 shtator 2018. Po në këtë datë, Gjykata e Lartë publikoi njoftimin<sup>137</sup> me emrat e kandidatëve që paraqitën interesin për në KLGJ nga këto gjykata, përkatësisht Znj. Brikena Ukperaj dhe Z. Luan Dervishi. Në të njëjtin njoftim referohej se Gjykata e Lartë do të vijonte menjëherë me procedurën për verifikimin e plotësimit të kushteve nga kandidatët, sipas përcaktimeve të nenit 7, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr.115/2016 dhe më pas kjo gjykatë do të shpallte zyrtarisht kandidaturat në faqen zyrtare të saj.

Në dt. 13 shtator 2018, Gjykata e Lartë publikoi nëpërmjet faqes zyrtare, njoftimin për “Shpalljen e listës përfundimtare të kandidatëve gjyqtarë për KLGJ”<sup>138</sup>, e cila përmbante këto emra:

- Nga Gjykata e Lartë rezultojnë një kandidat zyrtar, përkatësisht Z. Medi Bici.
- Nga Gjykatat e Apeleve rezultojnë katër kandidatë zyrtarë, dy prej të cilëve në Gjykatat e Apelit jashtë Tiranës, përkatësisht, Z. Ilir Toska, Znj. Nertina Kosova, Z. Luan Dervishi dhe Znj. Brikena Ukperaj.
- Nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore rezultojnë gjashtë kandidatë zyrtarë, një prej të cilëve nga një gjykatë rrethi jashtë Tiranës, përkatësisht Znj. Alma Brati, Z. Astrit Faqolli, Znj. Brunilda Kadi, Znj. Manjola Xhaxho, Znj. Marçela Shehu, Z. Dritan Hallunaj.

Ligjit nr. 115/2016 në nenin 11, pika 5 të tij parashikon se “Në qoftë se edhe pas thirrjes së dytë nuk paraqiten kandidatë nga shkallët e pa përfaqësuara të gjyqësorit, zgjedhja e tyre bëhet me short nga radhët e gjyqtarëve që kanë kandiduar për vendin vakant. Çdo kandidat që përmbush kriteret për t’u zgjedhur anëtar i Këshillit dhe kriteret për t’u ngritur në detyrë ose për t’u transferuar në shkallët e pa përfaqësuara të gjyqësorit, ka të drejtë të kandidojë për vendin vakant përkatës”.

### 2.2.3 Procesi i rivlerësimit kalimtar (vettingu) të kandidatëve gjyqtar në KLGJ

Në bazë të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016, brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit, KPK duhet të bënte rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve që kandidojnë. Ky afat nuk është respektuar për shkak se KPK u krijua me vonesë të konsiderueshme. Më tej, po i njëjti nen parashikon se gjyqtari, i cili, me vendim të KPK, nuk e kalon procedurën e rivlerësimit përjashtohet nga procesi i kandidimit, edhe kur ndaj vendimit të komisionit është ushtruar ankim. Si rrjedhojë zgjedhja e kandidatëve vazhdon pa pjesëmarrjen e këtij kandidati. Në vijim do analizohen rezultatet e procesit të vettingut mbi secilën nga listat e shpallura nga Gjykata e Lartë.

#### **A. Rivlerësimi i kandidatëve gjyqtar për në KLGJ, referuar listës së datës 25 janar 2017**

<sup>135</sup> <http://www.panorama.com.al/gjykata-e-larte-ne-kolaps-pas-shkarkimit-te-brocit-mbetet-me-kater-anetare-del-njoftimi-per-aplikimet-ne-klgj/>

<https://www.reporter.al/rihapet-thirrja-per-gjyqtar-apeli-kandidat-per-klgj/>

<http://shqiptarja.com/lajm/gjykata-e-larte-jep-njoftimin-rihapet-gara-per-klgj-tw-aplikojnw-gjyqtarwt-jashtw-tiranws>

<sup>136</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Rishpallje\\_e\\_thirrjes\\_per\\_paraqitjen\\_e\\_shprehjes\\_se\\_interesit\\_nga\\_gjyqtaret\\_e\\_gjykatave\\_te\\_apelit\\_jashte\\_Tiranes\\_per\\_pozicionin\\_e\\_anetarit\\_te\\_5317\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Rishpallje_e_thirrjes_per_paraqitjen_e_shprehjes_se_interesit_nga_gjyqtaret_e_gjykatave_te_apelit_jashte_Tiranes_per_pozicionin_e_anetarit_te_5317_1.php)

<sup>137</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Kandidatet\\_qe\\_kane\\_paraqitur\\_interesin\\_per\\_ne\\_KLGJ\\_nga\\_gjykatat\\_e\\_apeleve\\_jashte\\_Tiranes\\_5333\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Kandidatet_qe_kane_paraqitur_interesin_per_ne_KLGJ_nga_gjykatat_e_apeleve_jashte_Tiranes_5333_1.php)

<sup>138</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/njoftim\\_shpallja\\_lista\\_perfundimtare\\_kandidate\\_klgj\\_1841.doc](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/njoftim_shpallja_lista_perfundimtare_kandidate_klgj_1841.doc)

Të gjithë kandidatët e kësaj liste ju nënshtruan procesit të rivlerësimit me përparësi dhe emri i secilit prej tyre u përfshi në shortin e parë që u hodh nga KPK në datë 30 nëntor 2017<sup>139</sup>. Konkretisht, vettingu i kandidatëve për anëtar nga radhët e gjyqtarëve në KLGJ të përfshirë në listën e dt.25 Janar 2017 solli këto rezultate:

**Kandidatët gjyqtar që garonin për anëtar të KLGJ të konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit janë si vijon:**

(i) **Z. Medi Bici, gjyqtar në Gjykatën e Lartë** është konfirmuar në detyrë me vendimin e KPK-së datë 31.07.2018. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim dhe rrjedhimisht ka marrë formë të prerë.

(ii) **Z. Ilir Toska, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë** është konfirmuar në detyrë me vendimin e KPK-së të datës 21/06/2018. Ky vendim nuk është ankimuar e për rrjedhojë ka marrë formë të prerë.

(iii) **Znj. Nertina Kosova, gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda** është konfirmuar në detyrë me vendimin e KPK-së të datës 18/07/2018. Ky vendim është ankimuar nga Komisioneri Publik dhe në datën 09.11.2018, në KPA, është hedhur shorti për caktimin e trupit gjykues.

(iv) **Znj. Alma Brati, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë** është konfirmuar në detyrë me vendimin e KPK-së të datës 05/07/2018. Ky vendim është ankimuar nga Komisioneri Publik. Nga data e hedhjes së shortit për caktimin e trupit gjykues dhe deri më sot janë zhvilluar disa seanca publike, por edhe pse kanë kaluar 6 muaj nga caktimi i trupës gjyqësore, çështja nuk ka përfunduar ende me një vendimmarrje përfundimtare nga KPA gjatë periudhës që mbulon ky raport.

(v) **Z. Astrit Faqolli, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë** është konfirmuar nga KPK me vendimin e datës 27/05/2018. Ky vendim është ankimuar nga Komisioneri Publik. Kolegji i Posaçëm i Apelit zhvilloi në datën 7 mars 2019, seancën e parë gjyqësore publike për këtë çështje. Kjo seancë u zhvillua përkatësisht 6 muaj pas hedhjes së shortit për caktimin e trupit gjykues. Çështja vijon të jetë ende në proces gjatë periudhës që mbulon ky raport.

(vi) **Znj. Brunilda Kadi, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë** është konfirmuar në detyrë me vendimin e KPK-së nr. 57 të datës 01/08/2018. Në faqen zyrtare të Komisionerëve Publik është komunikuar për publikun njoftimi për mos ushtrimin e të drejtës së ankimit lidhur me këtë vendim<sup>140</sup>. Për rrjedhojë vendimi i KPK-së ka marrë formë të prerë.

(vii) **Znj. Manjola Xhaxho, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë** është konfirmuar nga KPK me vendimin nr.19 të datës 14/05/2018. Në faqen zyrtare të Komisionerëve Publik është komunikuar për publikun njoftimi për mos ushtrimin e të drejtës së ankimit lidhur me këtë vendim<sup>141</sup>. Për rrjedhojë, vendimi i KPK-së ka marrë formë të prerë.

(viii) **Z. Dritan Hallunaj, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda** është konfirmuar në detyrë me vendimin e KPK-së nr.56, të datës 01/08/2018. Në faqen zyrtare të Komisionerëve Publik është komunikuar për publikun njoftimi për mos ushtrimin e të drejtës së ankimit lidhur me këtë vendim<sup>142</sup>. Për rrjedhojë, vendimi i KPK-së ka marrë formë të prerë.

(ix) **Znj. Marçela Shehu, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin** është konfirmuar në detyrë me vendimin e KPK-së, nr.20, të datës 04/06/2018. Në faqen zyrtare të Komisionerëve Publik është komunikuar për publikun njoftimi për mos ushtrimin e të drejtës së ankimit lidhur me këtë vendim<sup>143</sup>. Për rrjedhojë, vendimi i KPK-së ka marrë formë të prerë.

**Kandidatët gjyqtar që garonin për anëtar të KLGJ të shkarkuar nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit janë si vijon:**

<sup>139</sup> <http://kpk.al/2017/12/12/njoftim/>

<sup>140</sup> <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/11/47.Njoftim-për-mosankimin-e-vendimit-nr.-57-datë-1.8.2018-znj.-Brunilda-Kadi.pdf>

<sup>141</sup> <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/07/Njoftim-për-mosankimin-e-vendimit-nr.-19-datë-14.5.2018-të-KPK-së-për-subjektin-e-rivlerësimit-znj.-Manjola-Xhaxho.pdf>

<sup>142</sup> <http://ikp.al/2018/09/17/njoftim-per-mosankimin-e-vendimit-nr-56-date-1-8-2018-te-kpk-se-per-subjektin-e-rivleresimit-z-dritan-hallunaj/>

<sup>143</sup> <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/07/Njoftim-për-mosankimin-e-vendimit-nr.-202c-datë-4.6.20182c-të-KPK-së2c-për-subjektin-e-rivlerësimit-znj.-Marçela-Shehu-1.pdf>



(i) **Z. Artan Zeneli, gjyqtar në Gjykatën e Lartë** është shkarkuar nga detyra me vendimin e KPK-së të datës 14.09.2018. Shkaqet e shkarkimit sipas vendimmarrjes së KPK-së lidhen me kriterin e pasurisë, pasi sipas KPK-së subjekti ka ndërmarrë hapa për të fshehur pasurinë e tij, ka bërë deklaram të pasaktë si dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi dhe në dt.4 Shkurt 2019, rezulton që KPA ka shqyrtuar në dhomë këshillimi këtë çështje dhe në përfundim të gjykimit, trupi gjykues ka vendosur unanimitisht lënien në fuqi të vendimit të KPK-së<sup>144</sup>.

(ii) **Z. Besim Trezhnjeva, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës** është shkarkuar nga detyra nga KPK me vendimin e datës 13/04/2018. Shkaqet e shkarkimit sipas vendimmarrjes së KPK-së lidhen me kriterin e pasurisë pasi rezulton se subjekti ka deklarime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Ky vendim është ankimuar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në datën 26.07.2018, KPA ka shqyrtuar në dhomë këshillimi këtë çështje dhe në përfundim të gjykimit ka vendosur unanimitisht lënien në fuqi të vendimit të KPK-së<sup>145</sup>.

(iii) **Z. Artan Lazaj, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë** është shkarkuar nga detyra me vendimin e KPK-së të datës 11.07.2018. Shkaqet e shkarkimit sipas vendimmarrjes së KPK-së lidhen me kriterin e pasurisë, pasi rezulton se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse për këtë kriter, duke mos arritur kështu një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Vendimi është ankimuar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në dt.31 Janar 2019, trupi gjykues i KPA-së ka shpallur vendimin duke vlerësuar se “mos shqyrtimi i kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin nga gjykimi i mëtejshëm i komisioneres së KPK-së nga një trup tjetër gjykues, përbën shkelje të rëndë procedurale. Për këto arsye, trupi gjykues vendos prishjen e vendimit nr. 34, datë 11.07.2018 të KPK-sa. Bazuar në nenin F, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, KPA nuk mund të kthejë për rishqyrtim në KPK çështjen e rivlerësimit të subjektit, por ka kryer vetë rivlerësimin e tij që nga momenti i konstatimit të shkeljes së rëndë procedurale gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore në KPK. Në përfundim, KPA vendos shkarkimin e subjektit, vendim i cili është i formës së prerë.

(iv) **Z. Bledar Abdullahi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë** është shkarkuar nga detyra me vendimin e KPK-së të datës 30/07/2018, pasi është vlerësuar se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë. Vendimi i KPK është ankimuar nga vetë subjekti. Në datën 30.10.2018, në KPA, është hedhur shorti për caktimin e trupit gjykues, kryesuesin e këtij trupi dhe relatorin e çështjes. Deri në periudhën që mbulon ky raport, KPA nuk ka zhvilluar seancë apo të ketë shqyrtuar në dhomë këshillimi ankimin e subjektit.

**Nga lista e kandidatëve për KLGJ rezulton vetëm një kandidate për të cilën është ndërprerë procesi i vettingut për shkak të dorëheqjes.** Konkretisht, Znj. Brunilda Kasmi, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur dorëheqjen nga detyra e saj si gjyqtare. Me vendimin e datës 25/06/2018 KPK ka vendosur ndërprerjen e procesit të vettingut dhe ka deklaruar humbjen e së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar ndër të tjera, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **B. Rivlerësimi i kandidatëve të listës së datës 13 shtator 2018**

Lista e dytë e shpallur nga Gjykata e Lartë në datë 13.09.2018 përmbante emrat e shumë kandidatëve gjyqtar që garonin për anëtar të KLGJ-së, të cilët ishin përfshirë edhe në listën e parë të publikuar në datë 25 janar 2017. Procedurat e rivlerësimit për dy kandidatët e rinj të përfshirë në këtë listë sollën konfirmim në detyrë të një prej kandidatëve dhe shkarkimin në detyrë të kandidatit tjetër.

(i) Kandidatja gjyqtare që garonte për anëtarë të KLGJ-së, e cila u konfirmua në detyrë është Znj. Brikena Ukperaj Lubonja, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Subjekti u konfirmua në detyrë me vendimin e datës 25.06.2018 të KPK-së. Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Komisionerit Publik rezulton se ky vendim nuk është ankimuar nga Komisioneri Publik. Për rrjedhojë vendimi ka marrë formë të prerë.

<sup>144</sup> <http://www.kpa.al/njoftim-92/>

<sup>145</sup> <http://www.kpa.al/njoftim-17/>

(ii) Kandidati gjyqtar që garonte për anëtar të KLGJ-së, i cili u shkarkua nga detyra është Z. Luan Dervishi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër. Subjekti rezulton se është shkarkuar nga detyra me vendimin e KPK të datës 26/11/2018, pasi është vlerësuar se ka pasur probleme me kriterin e pasurisë, konkretisht ka pasur deklarime të pasakta të pasurisë, nuk ka pasur burim të ligjshëm për justifikimin e tyre, ka kryer fshehje të pasurisë, ka pasur deklaram të rremë dhe ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe në datën 01.03.2019, në KPA, është hedhur shorti për caktimin e trupit gjykues.

### **C. Të dhëna të përpunuara për ecurinë e vettingut të kandidatëve për anëtar nga radhët e Gjyqësorit në KLGJ**

Procedurat e rivlerësimit kalimtar për kandidatët e komunikuar në të dyja listat sollën konfirmimin në detyrë të pothuajse 2/3 së tyre, përkatësisht 10 prej kandidatëve dhe shkarkimin nga detyra të 5 gjyqtarëve si dhe ndërprerjen e procesit për një kandidate si rezultat i dorëheqjes.

Për tre prej anëtarëve të konfirmuar në detyrë nga KPK, Komisioneri Publik ka ushtruar të drejtën e ankimit në KPA, dhe rrjedhimisht vendimi i konfirmimit në detyrë nuk ka qenë i formës së prerë. Ndërkohë që të pesta vendimet e shkarkimit rezulton të jenë ankimuar nga vetë subjektet në KPA. Për dy nga subjektet, KPA është shprehur me vendim, ku në një rast vendimi i KPK-së është lënë në fuqi dhe në rastin tjetër vendimi i KPK-së është prishur për shkak të shkeljeve procedurale por në përfundim sërish subjekti është shkarkuar. Tre ankimet e tjera vijojnë të jenë në proces pranë KPA-së gjatë periudhës që mbulon ky raport, ndaj dhe vendimi nuk është i formës së prerë. Për pesë vendimet e shkarkimit të KPK-së, rezulton se kandidatët për në KLGJ janë penalizuar për shkak të kriterit të pasurisë, me argumentin se ka pasur fshehje ose deklaram të pasaktë apo të pamjaftueshëm.

Në total, 6 vendimet KPK-së për konfirmimin në detyrë ose shkarkimin e subjekteve gjyqtar që garonin në KLGJ, për të cilat është ushtruar e drejta e ankimit (nga Komisioneri Publik ose vetë subjekti) rezultojnë gjatë periudhës që mbulon ky raport të jenë ende në proces shqyrtimi nga KPA, ndaj nuk kanë marrë formë të prerë. Për pjesën tjetër të subjekteve të konfirmuara ose të shkarkuara nga KPK, përkatësisht për 10 kandidatë, rezulton se vendimet janë të formës së prerë.

Mesatarja e gjykimit të çështjes në KPA, varion mesatarisht 7-9 muaj nga data e dhënies së vendimit nga KPK. Ritmet e gjykimit të këtyre çështjeve kemi mendimin se mund të ishin më dinamike.

### **2.2.4 Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve**

Një numër i mjaftueshëm kandidatësh, përkatësisht 10 gjyqtarë që përfaqësonin nivele të ndryshme të gjyqësorit rezultuan se kaluan vettingun, ndaj u vijua më tej me procedurat e parashikuara në ligjin nr.115/2016, për njoftimin dhe zhvillimin e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, të cilës i është dhënë atributi për të bërë zgjedhjen e anëtarëve të KLGJ-së.

#### **a. Thirrja e mbledhjes dhe procedurat paraprake**

Pas përfundimit të vettingut për të gjithë kandidatët e listës së publikuar nga Gjykata e Lartë, KPK në respektim të nenit 276/5 të ligjit nr. 115/2016, në datë 27.11.2018 i përcolli kryetarit të Gjykatës së Lartë listën me emrat e kandidatëve gjyqtarë që e kaluan me sukses vettingun. Kjo listë me emrat zyrtarë të kandidatëve nuk u publikua në faqen zyrtare të KPK-së apo në faqen e Gjykatës së Lartë.

Siç do të rezultonte edhe nga monitorimi i mbledhjes së përgjithshme, nga 10 gjyqtarë të konfirmuar në detyrë nga KPK, rezulton se 1 prej tyre është gjyqtar në Gjykatën e Lartë, 3 në Gjykatat e Apelit (një prej të cilëve në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda), 3 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, 1 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe 1 në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Bazuar në nenin 13 të ligjit nr. 115/2018, brenda afatit 3 ditor të parashikuar nga ligji, pas marrjes së listës nga KPK, Kryetari i Gjykatës së Lartë nëpërmjet njoftimit nr. 4132 Prot., datë 30.11.2018 thërriti



mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve<sup>146</sup> për datën 12.12.2018. Disa ditë para, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë u publikua draft rregullorja e mbledhjes për zgjedhjen e anëtarëve të KLGJ-së<sup>147</sup>.

Ndërkohë, më datë 10.12.2018 u zhvillua procesi i shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Votimit, të cilët në bazë të Draft Rregullores kanë për detyrë administrimin e procesit të votimit për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të KLGJ-së. Në respektim të nenit 16/4 të ligjit nr. 115/2016, ishin 4 kandidatë të cilët ishin njëkohësisht ndihmës-magjistratë të Gjykatës së Lartë. Nga shorti manual i hedhur për caktimin e anëtarëve të komisionit u zgjodhën: Z. Durim Kadiu (kryetar), Z. Engert Pëllumbi (anëtar) dhe Z. Florian Kalaja (anëtar).<sup>148</sup>

Në lidhje me mbledhjen e thirrur, më datë 11.12.2018 në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë u publikua njoftimi mbi depozitimin e kërkesës për heqje dorë nga kandidimi i gjyqtarës Znj. Alma Brati për anëtare të KLGJ-së.<sup>149</sup>

## **b. Zhvillimi i mbledhjes dhe shpallja e rezultateve**

Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve u mbajt në datë 12.12.2018. Njoftimi i thirrjes së kësaj mbledhje nuk përmbante një rend dite me çështjet që do të ishin objekt shqyrtimi.

Në fillim të mbledhjes u prezantua draft rregullorja e mbledhjes, e cila u miratua në mënyrë unanime me votim me anë të ngritjes së dorës. Gjatë realizimit të punimeve të kësaj mbledhjeje nuk u realizua e njëjta procedurë si në mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve, për votimin me PO/JO lidhur me miratimin ose ndryshimin e Draft-Rregullores. Versioni përfundimtar i kësaj rregulloreje nuk është publikuar ende në faqen e Gjykatës së Lartë (ndryshe nga mbledhja e përgjithshme e prokurorëve, ku rregullorja përfundimtare u publikua në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme).

Më tej mbledhja e përgjithshme vazhdoi me paraqitjen e **platformave nga ana e kandidatëve**, të cilat në përgjithësi nuk reflektonin objektiva të mirë përcaktuara, por konsistonin kryesisht në vënien në dukje të problematikave aktuale të sistemit të drejtësisë, mungesën e bashkëpunimit me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, mungesën e mbështetjes motivuese për gjyqtarët në sistem etj. Të paktë ishin kandidatët që shfaqën platforma vizionare që synonin objektiva të qartë, si dhe ruajtën një balancë midis nevojës për promovimin e një karriere meritokratike brenda sistemit gjyqësor si dhe nevojës për rritjen e llogaridhënies dhe të përgjegjësisë disiplinore të sistemit me anë të KLGJ-së.

Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në listat votuese rezultoi të jetë 354, ndërkohë që numri i gjyqtarëve pjesëmarrës të cilët votuan për zgjedhjen e 6 anëtarëve gjyqtarë në KLGJ ishte 339. Gjatë zhvillimit të mbledhjes, një nga personat e pranishëm adresoi verbalisht problematikën për shkeljen e dispozitave ligjore nga ana e kryetarit të Gjykatës së Lartë, për mos përfshirjen në listën e votuesve të disa prej Inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, në përgjigje sqaroi se gjatë mbledhjes së përgjithshme mund të votonin vetëm personat të cilët kanë statusin e gjyqtarit sipas parashikimeve të ligjit nr.96/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve e të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe si rrjedhojë mund të votonin vetëm Inspektorët e KLD-së me statusin gjyqtar<sup>150</sup>.

Sipas procesverbalit të publikuar në faqen e Gjykatës së Lartë “Mbi rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarit (ëve) të Këshillit të Lartë Gjyqësor” rezulton se numri total i votave të hedhura është 2035, nga të cilat 1694 fletë votimi të vlefshme dhe 341 fletë votimi të pavlefshme. Pavarësisht udhëzimeve të dhëna në këtë mbledhje për mënyrën e votimit për anëtarët me të drejtë vote, sërish vërehet që 16.7% e fletëve të votimit kanë rezultuar të pavlefshme. Ky numër është relativisht i lartë nëse

<sup>146</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/publikim\\_copy\\_1\\_1873.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/publikim_copy_1_1873.pdf)

<sup>147</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/draft\\_rregullore\\_finale\\_1878.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/draft_rregullore_finale_1878.pdf)

<sup>148</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/njoftimi\\_i\\_shortit\\_1877.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/njoftimi_i_shortit_1877.pdf)

<sup>149</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/document\\_1879.rtf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/document_1879.rtf). Arsyeja e referuar është personale dhe gjatë Mbledhjes në fletët e votimit ishin marrë të gjitha masat për pasqyrimin e këtij ndryshimi.

<sup>150</sup> <https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/kom/Raport%20monitorimi%20per%20zgjedhjen%20e%20anetareve%20te%20KLGJKLP.pdf>

krahasohet me totalin, çka mund të kishte ndikuar në përmbysjen e rezultatit për kandidatët e përzgjedhur nëse gjyqtarët do të kishin respektuar procedurën e votimit. Për shkak të dëmtimit numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar është 26.<sup>151</sup>

Pesë kandidatët pranë gjykatave të shkallës së parë që garonin për tre vende vakante në KLGJ, janë votuar sipas kësaj renditje (duke filluar nga kandidati që ka marrë numrin më të lartë të votave):

- (i) Znj. Marçela Shehu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin u votua me 289 vota<sup>152</sup>.
- (ii) Z. Dritan Hallunaj, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda u votua me 215 vota.
- (iii) Znj. Brunilda Kadi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë u votua me 135 vota.
- (iv) Z. Astrit Faqolli, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë u votua me 129 vota.
- (v) Znj. Manjola Xhaxho, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë u votua me 42 vota.

Tre kandidatët pranë Gjykatave të Apelit që garonin për 2 vende vakante në KLGJ, janë votuar sipas kësaj renditje (duke filluar nga kandidati që ka marrë numrin më të lartë të votave):

- (i) Znj. Brikena Ukperaj, Gjykata e Apelit Vlorë u votua me 287 vota<sup>153</sup>.
- (ii) Z. Ilir Toska, Gjykata e Apelit Tiranë u votua me 200 vota.
- (iii) Znj. Nertina Kosova, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda (Tiranë) u votua me 111 vota.

Pjesëmarrja e një kandidati nga Gjykata e Lartë, i cili garonte për një vend vakant në KLGJ, nuk mundësoi një garim konkurrues për këtë vend vakant. Konkretisht:

- (i) Z. Medi Bici, Anëtar i Gjykatës së Lartë u votua me 290 vota.

Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është publikuar vendimi nr. 242, datë 12.12.2018 “Për shpalljen e anëtarëve fitues për anëtarë gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor”<sup>154</sup>. Në përputhje me nenin 115/5 të ligjit nr. 115/2016, kandidatët në KLGJ me numrin më të madh të votave që janë fitues për 6 vendet vakante në këtë Këshill, sipas shkallëve të Gjyqësorit janë:

**Anëtarët e zgjedhur në KLGJ nga gjyqtarët pranë gjykatave të shkallës së parë janë:**

- (i) Znj. Marçela Shehu
- (ii) Z. Dritan Hallunaj
- (iii) Znj. Brunilda Kadi

**Anëtarët e zgjedhur në KLGJ nga gjyqtarët pranë gjykatave të apelit janë:**

- (i) Znj. Brikena Ukperaj
- (ii) Z. Ilir Toska

**Anëtari i zgjedhur në KLGJ nga Gjykata e Lartë është:**

- (i) Z. Medi Bici.

### **c. Ankimet e mundshme**

Shpallja e rezultateve pas mbarimit të mbledhjes së përgjithshme nuk ka karakter përfundimtar. Sipas nenit 18 të ligjit nr. 115/2016, jo më vonë se 5 ditë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë mund të bëhen ankime në Gjykatën Administrative të Apelit, për shkelje të procedurës që lidhen me thirrjen e mbledhjes, verifikimin e pjesëmarrjes, votimit dhe numërimit të votave, konstatimit dhe shpalljes së votave të pavlefshme dhe të shpalljes së rezultatit gjatë mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve të KLGJ-së.

<sup>151</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/untitled\\_copy\\_1\\_1886.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/untitled_copy_1_1886.pdf)

<sup>152</sup> Vota të pavlefshme: 50.

<sup>153</sup> Vota të pavlefshme: 52.

<sup>154</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/untitled\\_1885.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/untitled_1885.pdf)

Në rastin konkret, shpallja e rezultateve të mbledhjes së përgjithshme në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë ndodhi në datë 13 dhjetor 2018<sup>155</sup> dhe nuk pati ndonjë informacion as në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit dhe as në media për ndonjë ankim të mundshëm. Si rrjedhojë, pas kalimit të afatit 5 ditor dhe mbas konstatimit të karakterit përfundimtar të rezultateve të Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve, në datë 20 dhjetor 2018, siç raporton media, u mbajt mbledhja e parë e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

---

<sup>155</sup>[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja\\_e\\_Pergjithshme\\_e\\_Gjyqtareve\\_date\\_12\\_12\\_2018\\_5450\\_1-9.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_Pergjithshme_e_Gjyqtareve_date_12_12_2018_5450_1-9.php)

**KAPITULLI II****MONITORIMI I KOMPETENCAVE  
TRANZITORE TË KËSHILLIT TË  
LARTË TË DREJTËSISË**

# 1. Organizimi dhe funksionimi i KLD-së

Krijimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është parashikuar për herë të parë në Ligjin “Për dispozitat kryesore Kushtetuese”.<sup>156</sup> Në këtë ligj, KLD ishte autoriteti përgjegjës për sistemin e drejtësisë me kompetenca lidhur me emërimin, transferimin dhe procedimet disiplinore të gjyqtarëve.<sup>157</sup> Nga viti 1992 deri në vitin 1998, KLD funksionoi vetëm në bazë të dispozitave kushtetuese dhe rregullores së brendshme. Në dispozitat kushtetuese të Kushtetutës të vitit 1998, përbërja dhe funksionimi i KLD parashikohej në nenin 147. KLD ishte organ kolegjal, që mblidhej jo më rrallë se një herë në 2 muaj<sup>158</sup> për të ushtruar kompetencat që i jepte ligji.<sup>159</sup> Ky institucion kishte në përbërje të tij Presidentin e Republikës, Kryetarin e Gjykatës së Lartë, ministrin e Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, si dhe 9 gjyqtarë të të gjitha niveleve, të cilët zgjidheshin nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.<sup>160</sup> Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës dhe Ministri i Drejtësisë ishin anëtarë *ex officio*. Presidenti i Republikës konsiderohej se kishte një status *primus inter pares*<sup>161</sup> dhe vota e tij kishte të njëjtën peshë me anëtarët e tjerë të KLD-së.

Ligji organik për KLD-në nr. 8811, datë 17.5.2001 (i ndryshuar) parashikonte që funksioni i anëtarit të këtij institucioni “është i papajtueshëm me funksionin e prokurorit, të anëtarit të organeve drejtuese dhe ekzekutive, të partive politike ose me veprimtarinë e avokatisë në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit.” Lidhur me funksionet dhe fushën e veprimtarisë, KLD ishte autoriteti përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën, dhe për kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.<sup>162</sup> KLD, me propozim të Ministrisë të Drejtësisë shpallte publikisht vendet vakante për gjyqtarë<sup>163</sup>, merrte në shqyrtim dhe vendoste mbi kandidaturat e paraqitura në bazë të shpalljes publike<sup>164</sup>, i propozonte Presidentit të Republikës emërimin e një gjyqtari,<sup>165</sup> si dhe kryente procedimin disiplinor të gjyqtarëve në përputhje me nenet 31-34 të ligjit organik të KLD-së.

KLD, në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tij asistohet nga Inspektorati pranë KLD. Inspektorati përbëhet nga Kryeinspektori dhe inspektorët, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga KLD.<sup>166</sup> Inspektorati grumbullonte dhe përpunonte të dhënat e nevojshme dhe përgatiste vlerësimin

<sup>156</sup> Ligji Nr. 7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 Për dispozitat kryesore Kushtetuese”.

<sup>157</sup> Neni 15 i Ligjit “Për dispozitat kryesore Kushtetuese” parashikonte “Këshilli i Lartë i Drejtësisë kryesohet nga Presidenti i Republikës dhe përbëhet nga Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe nga 9 juristë të njohur për aftësitë e tyre, që zgjidhen një herë në pesë vjet në mbledhjen e përbashkët të Gjykatës së Kasacionit dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme. Këshilli i Lartë i Drejtësisë është i vetmi autoritet që vendos për emërimin, lëvizjen dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të shkallës së parë, të apelit si edhe të prokurorëve. Mënyra e funksionimit dhe e ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë përcaktohet me rregulloren e miratuar prej tij.”

<sup>158</sup> Neni 18 dhe Neni 19(1) Ligji KLD

<sup>159</sup> Sipas nenit 2 të ligjit organik nr. 8811, datë 17.5.2001 (i ndryshuar), KLD ushtron këto detyra: “a) I propozon Presidentit të Republikës emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit; b) Vendos për shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit; c) Vendos për transferimin e gjyqtarëve; ç) Vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve; d) Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve; dh) Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve, kontrollon dhe garanton procesin e vlerësimit dhe shqyrton ankimet e gjyqtarëve për vlerësimin e tyre; e) Emëron dhe shkarkon, kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, emëron dhe shkarkon inspektorët e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; f) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj”.

<sup>160</sup> Neni 147(1) i Kushtetutës së Shqipërisë, 1998.

<sup>161</sup> Anastasi, Aurela, “Emërimi i gjyqtarëve, si çështje e rëndësishme kushtetuese”, Revista “Ligji mundësi zhvillimi për gratë”, nr. 15.

<sup>162</sup> Neni 1, ligji Nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9448, datë 5.12.2005.

<sup>163</sup> Neni 28 i Ligjit KLD

<sup>164</sup> Neni 29 i Ligjit KLD

<sup>165</sup> Neni 30 i Ligjit KLD

<sup>166</sup> Neni 14 i Ligjit KLD

për aftësinë profesionale të gjyqtarit. Gjithashtu, Inspektorati kryente verifikime për procedimin disiplinor të propozuar nga Ministri i Drejtësisë, në rastet kur çmohej dhe kërkohet nga KLD. Ai verifikonte ose i dërgonte Ministrin të Drejtësisë për trajtim, ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera që i drejtohen KLD-de për veprime të gjyqtarëve, të vlerësuara në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Inspektorati, në rastin kur vërente shkaqe ligjore për procedimin disiplinor, i dërgonte menjëherë Ministrin të Drejtësisë relacion shpjegues dhe dokumentacionin përkatës për të gjykuar për procedimin disiplinor. Inspektori, verifikonte edhe çështjet për pasuritë e deklaruara nga gjyqtarët, si dhe pajtueshmërinë ligjore të veprimtarisë dhe të sjelljes së tyre.<sup>167</sup>

Përbërja dhe veprimtaria e KLD ka qenë shpesh herë objekt kritikash apo objekt i vlerësimit gjyqësor nga Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ<sup>168</sup>. Komisioni i Venecias dhe Komisioneri për të Drejtat e Njeriut janë shprehur se tre anëtarët e KLD-së të emëruar nga Parlamenti, duhet të emërohen me shumicë të cilësuar, pasi kjo është thelbësore për të siguruar që administrata në detyrë nuk do të emërojë mbështetësit e saj politikë.<sup>169</sup> Gjithashtu, në vendimin nr. 11/2004 të Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht se nuk konstatoi problem kushtetuese, sërish argumentohet mbivendosja e punës së dy Inspektorateve (të Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së) si vijon:

*“ekzistenca e dy inspektorateve që duket se dublojnë njëri-tjetrin, përkufizimi dhe përcaktimi i qartë i nocioneve inspektim, kontroll, verifikim, evitimi i ndërthurjes së kompetencave midis dy inspektorateve dhe dy institucioneve (Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së) lidhur me administrimin e drejtësisë e të shërbimeve, si dhe të vendosjes së kufijve të qartë mbi kontrollin në gjykatat dhe gjyqtarët, janë disa nga çështjet që në kuadrin e përgjithshëm të përmirësimit të legjislacionit kanë nevojë për studim dhe rishikim nga organet përkatëse.”<sup>170</sup>*

Një problem tjetër i hasur në veprimtarinë e KLD-së ka qenë mbivendosja e rolit të këtij institucioni me veprimtarinë e ILDKPKI-së. Kështu, në bazë të nenit 61, pika 1 të ligjit organik për KLD, kjo e fundit mund të “verifikojë dhe ngrejë çështje në lidhje me pasuritë e deklaruara nga gjyqtarët“. Në bazë të ligjit nr.9049, dt. 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (i ndryshuar), kontrollin dhe verifikimin e pasurisë së gjyqtarëve e bën ILDKPKI. Këto parashikime ligjore kanë krijuar mosmarrëveshje të kompetencës ligjore midis këtyre institucioneve që kanë rezultuar me “konfrontime” institucionale në disa raste. Mosmarrëveshjet janë krijuar pasi kur ILDKPKI konstatonte që një gjyqtar kishte probleme me deklarimin e pasurisë, e dënonte gjyqtarin administrativisht dhe pastaj i kërkonte KLD të merrte masa disiplinore ndaj gjyqtarit, por pa vendosur në dispozicion dosjen e hetimit.<sup>171</sup> KLD në këto raste pretendonte se nuk mund të vendoste masa disiplinore ndaj gjyqtarit të bazuar në gjetjet e ofruara nga ILDKPKI sepse, në përputhje me ligjin organik të KLD, ky i fundit duhet të organizojë një proces të drejtë.<sup>172</sup> Në anën tjetër ILDKPKI pohon se gjetjet e hetimit të saj janë të padiskutueshme nga çdo autoritet tjetër administrativ.<sup>173</sup>

<sup>167</sup> Shih neni 16 i Ligjit KLD

<sup>168</sup> Çështja **Mishgjoni kundër Shqipërisë (Ankimi nr.18381/05) Strasburg, 7 dhjetor 2010, vendimi në shqip publikuar në linkun** [http://www.qbz.gov.al/botime/permbledhese/permbledhje%20gjednj\\_2016.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/permbledhese/permbledhje%20gjednj_2016.pdf), Çështja Agim Hysi kundër Shqipërisë (Ankimi nr. 38349/05), vendimi në shqip publikuar në linkun: <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20142/VENDIM%20I%20GJEDNJ,%20date%202.5.2018%20HYSI.pdf>

<sup>169</sup> Studim i Res Publica. “Pandëshkueshmëria në procedimet disiplinore për gjyqtarët. Analizë e disa prej shkaqeve që stimulojnë pandëshkueshmërinë në veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, financuar nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur, Maj 2015.

<sup>170</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr.11, datë 27.05.2004.

<sup>171</sup> Ministria e Drejtësisë, Dokument Analitik, Informacion i detajuar sipas sektorëve të sistemit të drejtësisë (Për kryerjen e një analize të plotë të gjendjes aktuale të sistemit të drejtësisë me qëllim njohjen dhe evidentimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim), Fq. 68 aksesuar në: [http://drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2017/10/Analiza\\_e\\_sistemit\\_te\\_drejtjesise\\_FINAL-1.pdf](http://drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2017/10/Analiza_e_sistemit_te_drejtjesise_FINAL-1.pdf)

<sup>172</sup> *Ibid.*

<sup>173</sup> *Ibid.*

Probleme të tjera të hasura në funksionimin e KLD mund të përmendet mos ushtrimi i kompetencave që kanë krijuar vonesa në emërimin e magistratëve, edhe pse ka pasur vende të lira, janë kryer shpallje të vendeve të lira pa propozim të Ministrisë së Drejtësisë, ka pasur vonesa në vlerësimin e plotë gjyqtarëve, tejkalimi i kufijve të ligjit për procedurën e ndjekur për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Administrative, mungesa e kriterëve objektive në transferimin e gjyqtarëve, promovimi i inspektorëve në kundërshtim me ligjin etj.<sup>174</sup> Këto kanë qenë disa arsye që e kanë çuar grupin e ekspertëve të nivelit lartë të reformës (ENL) në drejtësi për të propozuar ndryshime në strukturën e këtij Këshilli.<sup>175</sup> Rekomandimi i grupit të ekspertëve të nivelit të lartë, bazuar edhe në raportin e Komisionit të Venecias, ka qenë që KLD-ja duhet të depolitizohet, të jetë e pavarur nga politika dhe se anëtarët e saj duhet të zgjidhen me shumicë të cilësuar në Kuvend.<sup>176</sup> Sipas këtyre ekspertëve, përbërja e Këshillit duhet të reflektojë një mazhorancë nga gjyqësori, por edhe diversiteti i opinionëve në radhët e anëtarësisë është i vlefshëm.<sup>177</sup> **Roli i Presidentit si drejtues i KLD-së dhe ai i Ministrisë së Drejtësisë si organi me kompetencë ekskluzive për fillimin e procedimit disiplinor janë parë si problematike nga Grupi i ENL-së.**<sup>178</sup> Gjithashtu, mungesa e kriterëve bazë kushtetuese për zgjedhjen e anëtarëve nga Kuvendi nuk siguron transparencën dhe cilësinë në përbërje, si dhe i lë diskrecion të pakufizuar ligjvënësit në përcaktimin e këtyre kriterëve, kjo pasi shumica minimale e kërkuar për votimin e tyre në Kuvend nuk ofron garanci të mjaftueshme në drejtim të respektimit të pavarësisë së KLD-së.<sup>179</sup>

Probleme të tjera të identifikuar kanë qenë shpeshtia e ulët e mbledhjes<sup>180</sup>, mungesë qartësie në kriteret dhe procedurat për vlerësimin profesional të gjyqtarëve,<sup>181</sup> mungesë qartësie për zbatimin e masave disiplinore dhe transferimet,<sup>182</sup> probleme me mbledhjen dhe organizimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare etj.

Për t'ju përgjigjur nevojave për një këshill më të pavarur, më funksional dhe më eficient në emërimin, transferimin dhe procedimin e gjyqtarëve, paketa e Reformës në Drejtësi suprimoi KLD-në dhe parashikoi ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD).

Sipas nenit 147/a të Kushtetutës, KLGJ emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve, vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve, i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre, drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave, informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor si dhe ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor.<sup>183</sup> Nga ana tjetër, ILD është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të KLGJ dhe KLP, Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.<sup>184</sup> Gjithashtu, ILD është përgjegjës për inspektimin institucional të gjykatave dhe prokurorisë.<sup>185</sup>

<sup>174</sup> Ministria e Drejtësisë, Dokument Analitik, Informacion i detajuar sipas sektorëve të sistemit të drejtësisë, cit.supra, Fq. 65-66.

<sup>175</sup> Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Grupi i ekspertëve të Nivelit të Lartë. Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

<sup>176</sup> *Ibid*, fq.15

<sup>177</sup> *Ibid*.

<sup>178</sup> *Ibid*, Fq. 29, 30.

<sup>179</sup> *Ibid*, fq.33

<sup>180</sup> *Ibid*, Fq, 58

<sup>181</sup> *Ibid*, Fq. 66

<sup>182</sup> *Ibid*, Fq. 67-68.

<sup>183</sup> Neni 147/a(3) i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>184</sup> Neni 147/d(1) i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>185</sup> Neni 147/d(2) i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.



## 2. Kompetencat tranzitore të KLD sipas legjislacionit të ri të reformës në drejtësi

Sikurse është analizuar edhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dispozitat kalimtare janë ato që rregullojnë momentin e kalimit nga një sistem në një tjetër, duke parashikuar mënyrën si do zbatohen dispozitat e reja në lidhje me situatat faktike ose marrëdhëniet ekzistuese. Me plotësimin e këtij qëllimi (realizimin e këtij kalimi), ato e humbasin efektin e tyre<sup>186</sup>.

Në nenin 179 të Kushtetutës, të miratuar me ligjin nr.76/2016, në kuadër të reformës në drejtësi<sup>187</sup> është parashikuar mënyra dhe në disa raste afatet e mbarimit të mandatit të anëtarëve të institucioneve ekzistuese, deri në ngritjen e institucioneve të reja. Qëllimi i nenit 179 është përcaktimi i rregullave të zbatueshme gjatë periudhës kalimtare midis pushimit të veprimit të dispozitave “të vjetra” dhe fillimit të efekteve të dispozitave “të reja”. Gjithashtu, ky nen ka për qëllim të përcaktojë saktësisht efektet e dispozitave kushtetuese të miratuara, duke u kujdesur që efekti prapaveprues i tyre të jetë sa më i kufizuar dhe i përcaktuar saktësisht, si dhe të mos lejojë cenimin e parimeve kushtetuese të garantuara në tekstin e Kushtetutës<sup>188</sup>.

Neni 179, pika 5 e Kushtetutës ka parashikuar që KLGJ do të krijohej brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Konkretisht ligji nr.76/2016 është botuar në fletoren zyrtare nr.138 në datën 27 korrik 2016 dhe kanë hyrë në fuqi, 15 ditë pas botimit në fletore, përkatësisht në datën 11 gusht 2016. Pavarësisht nga kjo dispozitë, në fakt konstituimi i Këshillit erdhi rreth 2 vite e gjysmë pas miratimit të amendamenteve Kushtetuese. Mbledhja e tij e parë konstituuese u realizua në dt.11 dhjetor 2019. Arsyet e vonësive të ngritjes së KLGJ-së janë analizuar më herët në këtë raport.

Po sipas nenit 179, pika 5 e Kushtetutës, anëtarët e KLD-së e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, **por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit**. Më tej, neni 179, paragrafi 12 i Kushtetutës parashikon që Presidenti i Republikës vazhdon të qëndrojë Kryetar i KLD-së deri në krijimin e KLGJ-së, brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Po kështu, neni 277, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 parashikon se anëtarët e KLD-së qëndrojnë në detyrë deri në krijimin e KLGJ-së dhe se mandati i anëtarëve përfundon në ditën kur zgjidhet anëtari i fundit i KLGJ-së, por në çdo rast jo më vonë se 8 muaj pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese. Fryma e këtyre dispozitave kushtetuese të interpretuara në harmoni me nenin 227/1 1 të ligjit nr.115/2016 është që mandati i anëtarëve të KLD-së nuk mund të zgjasë më shumë se 8 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit për ndryshimet kushtetuese nr.76/2016.

Gjykata Kushtetuese ka interpretuar në disa vendime të saj qëndrimin në detyrë të anëtarëve të vetë Gjykatës Kushtetuese pas mbarimit të mandatit deri në zëvendësimin e tyre. Në vendimin nr.24/2011, Gjykata Kushtetuese rithekson se *“rregulli i vazhdimësisë së qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues është parashikuar për të garantuar, mbi të gjitha, funksionimin normal të Gjykatës në rast të krijimit të vendeve vakante, si pasojë e mosveprimit të ndonjërit prej organeve, të cilave Kushtetuta u njej një rol të veçantë në këtë moment për zëvendësimin e gjyqtarëve të vjetër me gjyqtarë të rinj. Nisur edhe nga natyra kolegjiale e këtij organi të pavarur kushtetues, çdo mosveprim do të kishte pasojë në funksionimin e Gjykatës.”* Po në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese argumenton se *“Në ndryshim nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë, neni 125/5 i Kushtetutës parashikon se gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij”*. **Pra qëndrimi në detyrë i anëtarit të Gjykatës Kushtetuese pas përfundimit të mandatit mbështetet dhe justifikohet pikërisht në dispozitat kushtetuese, ndërkohë që në rastin e anëtarëve të KLD-së, ligji i ri kushtetues nr.76/2019 ka parashikuar një afat për ngritjen e organit të ri që do të suprimojë**

<sup>186</sup> Vendimi nr. 24, datë 09.06.2011 i Gjykatës Kushtetuese

<sup>187</sup> Ligji nr.76/2016, datë 22.7.2016

<sup>188</sup> Komentari mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë (2016) – Komentari nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Instituti për Studimet Publike & Ligjore – fq.450

**KLD-në, që është pikërisht 8 muaj nga hyrja në fuqi e tij.** Gjithashtu Kushtetuta i referohet qëndrimit në detyrë të anëtarëve të KLD-së deri në krijimin e KLGJ-së, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve sipas ligjit. Ligji organik në rastin konkret është pikërisht ligji nr.115/2016 ku sërish në dispozitat tranzitore të tij referohet se procesi i përfundimit të mandatit të anëtarëve të KLD-së është ditën kur zgjidhet anëtari i fundit të KLGJ-së por në çdo rast jo më vonë se 8 muaj pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese. Kushtetuta gjithashtu, cakton në mënyrë të shprehur vazhdimin e mandatit të Presidentit si kryetar i KLD-së, deri në krijimin e KLGJ-së brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e ndryshimeve Kushtetuese. Pra të gjitha këto dispozita të analizuara në tërësi dhe harmoni me njëra – tjetrën, çojnë në vlerësimin se mandati i anëtarëve të KLD-së pushon jo më vonë se 8 muaj nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese. Për më tepër, Kushtetuta nuk mund të bënte dallim për afatin e mbarimit të mandatit të kryetarit të KLD-së nga mbarimi i mandatit të anëtarëve të tjerë të saj.

Gjithashtu, Gjkata Kushtetuese e ka cekur tërthorazi në vendimin nr.34/2017 të saj, çështjen e vazhdimësisë së KLD-së deri në krijimin e KLGJ-së. Në këtë vendim, GJK ka marrë në shqyrtim kërkesën e dy organizatave të gjyqtarëve për shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit nr.96/2016. Konkretisht, GJK shprehet se *“pasi formulimi i pikës 5 të nenit 179 të Kushtetutës se “anëtarët e KLD-së e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të KLGJ-së, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të KLGJ-së, sipas ligjit” shpreh dhe synon të sigurojë vlerën kushtetuese të vazhdimësisë dhe koherencës institucionale, për rrjedhojë, funksionimin normal të KLD-së në periudhën kalimtare.* Për sa kohë vullneti i kushtetutë bërësit ka qenë që të mos ndërpritet funksioni i KLD-së, Gjkata vlerëson se KLD-ja ashtu si edhe organet e tjera ekzistuese kushtetuese do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre deri në konstituimin e plotë të organeve të reja kushtetuese dhe, në këtë kuptim, zbatimi i neneve 160/1 dhe 173/1 të ligjit duhet të jetë në përputhje të plotë me këtë interpretim të Gjykatës, në respekt të frymës së Kushtetutës. Megjithatë, në këtë vendim, Gjkata Kushtetuese nuk ka analizuar qartazi çështjen e afatit të qëndrimit në detyrë të anëtarëve të KLD-së, nëse do të jetë brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e amendamenteve kushtetuese apo jashtë këtij afati në rastet kur KLGJ nuk krijohet brenda afatit 8 muaj.

Lidhur me këtë çështje, vlen gjithashtu të citojmë mendimin në pakicë të gjyqtarit S. B në vendimin nr. 41 datë 19.07.2012, i cili analizon sërish vazhdimësinë në detyrë e gjyqtarit Kushtetues. Konkretisht në arsyetimin e mendimit të pakicës, gjyqtari kushtetues referon se *“vazhdimësia e gjyqtarit në detyrë duhet të kuptohet dhe zbatohet si një vazhdimësi brenda një kohëzgjatjeje të arsyeshme. Një periudhë e gjatë qëndrimi në detyrë pas mbarimit të mandatit, e cila mund të përbëjë konsumim të një pjese substanciale të mandatit të rregullt 9 –vjeçar, megjithëse nuk është funksionalisht ekuivalente me një riemërim, juridikisht rrezikon t’i ngjajë një riemërimi, në shkellje të nenit 125/2 të Kushtetutës”.* **Në të njëjtën situatë vlerësojmë se janë vendosur edhe anëtarët e KLD-së, të cilët kanë qëndruar në detyrë gati 2 vite e gjysmë nga miratimi i ndryshimeve kushtetuese të reformës në drejtësi.**

Kohëzgjatja tej afateve kushtetuese dhe ligjore të mandatit të anëtarëve të KLD-së mund të vendosë në pikëpyetje legjitimitetin e institucionit dhe vendimmarrjes së saj. Vonesat për ngritjen e KLGJ-së pas sollën gjithashtu funksionimin në mënyrë të sforcuar të KLD-së, e cila do të ushtronte në mënyrë të kufizuar disa prej kompetencave të parashikuara nga ligji. Situata e krijuar solli probleme në drejtim të mirëqeverisjes së pushtetit gjyqësor, i cili u përball me një sërë problematikash të tjera në këtë periudhë tranzitore dhe në mënyrë të veçantë me vakancat e krijuara në Gjykatën e Lartë dhe në gjykatat e tjera si pasojë e shkarkimeve apo dorëheqjeve të disa gjyqtarëve për shkak të vettingut.

Një nga çështjet që ka qenë objekt rishikimi nga Gjkata Kushtetuese në vendimin nr.34/2017 të cituar më sipër, është ushtrimi i kompetencave tranzitore të KLD-së deri në periudhën e konstituimit të KLGJ-së. Neni 160, pika 1 i ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* parashikon se *“deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoratet ekzistuese do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.”* Po kështu, neni

173 i ligjit nr.96/2016 parashikon që në periudhën tranzitore, KLD do të ushtrojë kompetenca si vendosja për shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, vendosja e kriterëve për vlerësimin e gjyqtarëve, kontrollin dhe garantimin e procesit të vlerësimit dhe shqyrtimi i ankimeve të gjyqtarëve për vlerësimin e tyre dhe kontrolli për kualifikimin e tyre.<sup>189</sup> Në kërkesën e paraqitur nga *pala kërkuese*, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë dhe Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, u parashtrua se rregullimi i kompetencave tranzitore të KLD-së në ligjin nr.96/2016 bie në kundërshtim me nenin 179 të Kushtetutës. Sipas palës kërkuese ligji nr.96/2016, në kundërshtim flagrant me nenin 179 të Kushtetutës, i ka hequr KLD-së kompetencat që lidhen me (a) emërimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe apelit, b) transferimet e gjyqtarëve; c) emërimet dhe shkarkimet e kryetarëve të gjykatave; d) komandimet e tyre; e) emërimin e inspektorëve të KLD-së.<sup>190</sup> Kjo përplasje ka krijuar një vakum institucional me pasoja të rënda shtetërore deri në bllokim të veprimtarisë kushtetuese të KLD-së, si organi i vetëm i vetëqeverisjes së pushtetit gjyqësor.<sup>191</sup> Gjykata Kushtetuese ka argumentuar në vendimin e saj (nr.34/2017) se ky konstatim i palës kërkuese nuk mund të konsiderohet se përbën ometim kushtetues, pasi formulimi i pikës 5 të nenit 179 të Kushtetutës shpreh dhe synon të sigurojë vlerën kushtetuese të vazhdimësisë dhe koherencës institucionale, për rrjedhojë, funksionimin normal të KLD-së në periudhën kalimtare. Gjykata Kushtetuese konstaton se ligji, përmban edhe disa rregullime të tjera me natyrë kalimtare, të cilat, janë detajim i dispozitave kalimtare kushtetuese. Në këtë mënyrë ajo konstaton se ato nuk përbëjnë norma jashtë delegimit të kushtetutës (ometim kushtetues) por detajim të tyre.

Në ligjin nr.96/2016 vëmë re se ligjvënësi ka parashikuar dy grupe kompetencash gjatë periudhës tranzitore të krijimit të KLGJ, kohë e cila kushtëzohet me funksionimin përkohësisht të KLD-së. Grupi i parë i kompetencave janë kompetenca ekskluzive të organit të ri të qeverisjes së gjyqësorit, KLGJ. Kompetenca të tilla ekskluzive mund të përmendim caktimin e përhershëm në pozicion të magjistratëve që realizohet vetëm nga KLGJ, propozimi i anëtarëve të Gjykatës së Lartë, miratimi i rregullave të etikës, inspektimi institucional i gjykatave dhe prokurorive, propozimi i buxhetit të gjyqësorit, etj. Grupi tjetër i kompetencave gjatë periudhës tranzitore, janë kompetenca që i akordohen KLD-së. Këto kompetenca tranzitore janë parashikuar në mënyrë shteruese nga ligjvënësi. Kompetencat tranzitore janë të kufizuara kësajsoj në kohë dhe në objekt.

### 3. Analizë e monitorimit të vendimmarrjes tranzitore të KLD

Ekspertët e KShH-së kanë monitoruar faqen zyrtare të KLD-së nga ku rezulton se për vitin 2018 janë publikuar 36 vendime të këtij institucioni. Përkatësisht rezultojnë të publikuar vendimet me numrat rendorë të renditur në mënyrë progresive nga 1 tek 36. Vendimi i dt.36 daton në 07.05.2018.<sup>192</sup>

Këto vendimmarrje kanë pasur kryesisht të bëjnë me kërkesa të rendit të ditës, të lidhura me komandimin e përkohshëm, delegimin e gjyqtarëve, mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës për pension apo të heqjes dorë nga gjyqtarët, procedimet disiplinore etj. Qasja e kësaj analize do të fokusohet tek përshkrimi i kompetencave tranzitore duke i krahasuar ato me kompetencat e plota të organeve të reja të qeverisjes, përkatësisht KLGJ-së.

<sup>189</sup> Neni 173, b, c, d, dh i Ligjit për Statusin.

<sup>190</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetutës 34/2017, Fq. 4868.

<sup>191</sup> Ibid.

<sup>192</sup> Vendimi nr.36 dt. 07.05.2018 ; <http://ëëë.kld.al/vendime/vendim-nr-36.-datë-07-05-2018>

### 3.1 Emërimi i magjistratëve sipas nenit 160, pika 1, gërma “a” e ligjit nr.96/2016

Periudha tranzitore	Pas krijimit të KLGJ
<b>Emërimi i magjistratëve gjyqtarë</b>	
KLD	KLGJ
a) Emëron magjistratët <i>kandidatë të diplomuar në vitin 2016</i> , në përputhje me pjesën III, kreu II, të këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; (neni 160 pika 1 shkronja “a”, ligji 96/2016”).	a) <i>Emëron</i> , vlerëson, ngre në detyre dhe transferon gjyqtarët të të gjitha niveleve, (neni 147/a i Kushtetutës)

Neni 160, paragrafi 1, gërma “a” e ligjit nr.96/2016 i ka dhënë kompetencë KLD-së që ti japë titullin “Magjistrat” vetëm kandidatëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2016. Emërimi i kandidatëve për magjistratë duhet të bëhet brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Gjatë periudhës tranzitore, emërimi i magjistratëve, duhet të kryhet nga KLD sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara “në përputhje me pjesën III, kreu II” të ligjit nr. 96/2016. Duke qenë se neni 160, paragrafi 1/a i ligjit nr.96/2016 referon tek pjesa e tretë, kreu i dytë i këtij ligji, në këtë kre parashikohen disa dispozita për emërimin e magjistratëve. Konkretisht, kriteret për emërimin si magjistrat parashikohen në nenin 35 të ligjit nr.96/2016, i renditur si neni i parë i këtij kreu.

#### Neni 35

##### *Emërimi i kandidatit magjistrat të diplomuar*

*1. I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kriteret:*

*a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme;*

*b) është vlerësuar minimalisht "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar;*

*c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.*

*2. I diplomuari kandidon për t'u emëruar magjistrat pas marrjes së ftesës, sipas pikës 1, të nenit 39, të këtij ligji dhe brenda një afati dyjavor nga data e publikimit të listës së të diplomuarve. Për arsye të justifikuar, një i diplomuar mund të kandidojë për t'u emëruar në vitin pasues.*

*3. Kandidati për gjyqtar kërkon të emërohet si gjyqtar nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar Këshillit. Në kërkesë përcaktohen, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata në të cilat i diplomuari kërkon të emërohet. Kandidati për prokuror kërkon të emërohet si prokuror nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar Këshillit. Në kërkesë përcaktohen, sipas renditjes preferenciale, tri prokurori, në të cilat i diplomuari kërkon të emërohet.*

*4. Brenda afatit njëmuor nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, Këshillat:*

*a) emërojnë magjistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve, i cili përmbush kriteret e emërimit, si dhe ka paraqitur kërkesë, në përputhje me parashikimet e pikave 2 dhe 3 të këtij neni;*

*b) refuzojnë të emërojnë magjistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve që ka paraqitur kërkesë, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, por nuk përmbush kriteret e emërimit.*

*5. Këshilli miraton rregulla të mëtejshme për arsyet e justifikuar për kandidimin në vitin pasardhës të mëvonshëm, sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni.*

Referuar nenit 35 të ligjit nr.96/2016 (pasqyruar më sipër), parashikohen 3 kriteret për emërimin e kandidatit magjistrat të diplomuar. **Kriteri i parë** kërkon që kandidati duhet të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të

mundshme. **Kriteri i dytë** kërkon që kandidati duhet të jetë vlerësuar minimalisht "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar. **Kriteri i tretë** kërkon që kandidati të ketë kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat. Neni 32, paragrafi 2 i ligjit nr.96/2016 parashikon që Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë merr informacion nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Duke qenë se Byroja Kombëtare e Hetimit nuk u arrit të krijohej gjatë periudhës tranzitore të KLD, informacioni për verifikimin e pastërtisë së figurës së kandidatëve për magjistratë do të bëhet nga Prokuroria e Përgjithshme dhe shërbimet shtetërore informative, apo organet disiplinore për marrëdhëniet e punës së kandidatit.

Nga sa më sipër, KLD, për emërimin e kandidatëve magjistratë, *së pari* duhet ti kërkonte Shkollës së Magjistraturës renditjen sipas pikës 1 të nenit 35 të ligjit nr. 96/2016. *Së dyti*, KLD duhet ti kërkonte ILDKPKI, Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Administratës Tatimore dhe Doganore dhe Shërbimeve Shtetërore Informative, raportime lidhur me kandidatët për magjistrat për verifikimin e pasurisë dhe te figurës, në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues referuar nenit 35, pika 2, gërma "c" dhe nenit 32, pikat 2-6 të ligjit nr. 96/2016. *Së treti*, duhet t'ju kërkonte kandidatëve për magjistratë që në kërkesën për emërim drejtuar KLD-së të rendisin sipas preferencave tre gjykata, në te cilat i diplomuari kërkon te emërohet sipas referencave të pikës 3 të nenit 35 ligjit nr. 96/2016. Bazuar në këto të dhëna, KLD-ja do të verifikonte plotësimin e kushteve për emërimin e kandidatëve sipas nenit 32 dhe 35 të ligjit dhe do të vendoste sipas rastit, emërimin ose refuzimin e çdo kandidati.

Ushtrimi i kësaj kompetence tranzitore nuk ka kaluar pa debat në KLD. Në mbledhjen e KLD-së të datës 20 Janar 2017<sup>193</sup> ka pasur opinione të ndryshme si edhe paqartësi nga anëtarët e KLD-së lidhur me ligjin që do të zbatohet për emërimet e magjistratëve. Një çështje objekt diskutimi në këtë mbledhje ishte si do të vlerësoheshin kriteret e nenit 32 dhe 35 të ligjit nr.96/2016 dhe veçanërisht kriteri i pasurisë dhe verifikimit të pastërtisë së figurës. Në materialin e përgatitur nga grupi i punës së KLD-së ishin bashkëngjitur edhe shkresat e ILDKPKI-së dhe Prokurorisë, lidhur me kandidatët për Magjistratë të vitit 2016. Nga procesverbali i mbledhjes së datës 20 Janar 2017, rezulton se ILDKPKI është përgjigjur se "nuk mund t'ju jap informacionin e kërkuar, pasi këto subjekte nuk i janë nënshtruar ende kontrollit të plotë", ndërsa Prokuroria kishte deklaruar se këta subjekte nuk kanë probleme.

Sipas disa anëtarëve të KLD, emërimi "Magjistrat" nga KLD në periudhën tranzitore nuk duhej të bëhej pa pasur nga ILDKPKI dhe nga Shërbimi Informativ kombëtar të dhëna mbi pasurinë dhe verifikimin e figurës. Anëtarë të tjerë shtruan në mbledhje opsionin për ti emëruar magjistratët sipas kriterëve të ligjit të vjetër dhe sipas rastit, në bazë të nenit 173 dhe 175 të ligjit nr. 96/2016 të respektoheshin edhe kriteret e këtij të fundit.<sup>194</sup> Megjithatë, shumica e anëtarëve, duke u nisur nga interpretimi i frymës së ligjit dhe qëllimi për të mos bllokuar zbatimin e tij, vendosën të emërojnë kandidatët "magjistrat", pa pasur një verifikim të kriterit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës sipas nenit 35, pika 1, gërma "c" dhe nenit 32 të ligjit nr. 96/2016. Në mbledhjen e datës 20 Janar 2017, u morën 8 vendime për emërimin magjistrat të kandidatëve të shkollës së Magjistraturës të diplomuar në vitin 2016. Për të gjithë kandidatët, emërimi u bë mbështetur në vlerësimin përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës dhe nga fakti që "nuk ka informacione dhe të dhëna që çënojnë integritetin" e kandidatit. <sup>195</sup> Po të lexojmë të tetë vendimet e KLD për emërimet si "Magjistrat", formulimi është standard si më poshtë vijon:

*"Këshilli i Lartë i Drejtësisë i mbledhur më datë 20.01.2017, mbështetur në nenin 35 dhe 160 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në shkresën*

<sup>193</sup> <http://ëëë.kld.al/vendime/procesverbal-dat%C3%AB-20-01-2017-1-1-1>

<sup>194</sup> Fq. 22.PV Mbledhjes 20 Janar 2017

<sup>195</sup> Fq. 31-32 PV Mbledhjes 20 Janar 2017.



nr. 326 Prot., datë 29.07.2016 të Shkollës së Magjistraturës “Informacion mbi vlerësimin e kandidatëve për magistratë të vitit të tretë, profili gjyqtar, që kanë ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës tetor 2013 - qershor 2016”, si dhe në dokumentacionin shkresor të ardhur nga, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe të Konfliktit të Interesit, Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, me shumicën e votave, **vendosi:** 1. Të emërojë “Magjistrat” (gjyqtare) të diplomuarën në Shkollën e Magjistraturës ...”

Sikurse është përmendur më sipër, nëse informacioni i marrë nga prokuroritë referon se subjektet nuk kanë probleme me integritetin, nga ana tjetër, ILDKPKI ishte shprehur se nuk mund të japë informacionin e kërkuar, pasi këto subjekte nuk i janë nënshtruar ende kontrollit të plotë. Në datë 06.01.2017, KLD i ka kërkuar informacion me shkresë ILDKPKI dhe Shërbimit Kombëtar Informativ, megjithatë nga shumica e anëtarëve të KLD, nuk u konsiderua e nevojshme të priteshin raportet e thelluara për pasurinë dhe pastërtinë e figurës së kandidatëve, pasi që nga momenti që këta kandidatë do të emërohen magistratë dhe caktohen si gjyqtarë, ata janë subjekte të ligjit të vettingut, e për rrjedhojë nuk do ti shpëtojnë filtrit të vlerësimit të pasurisë dhe verifikimit të figurës.<sup>196</sup>

Arsyeja tjetër pse shumica e anëtarëve të KLD-së vendosën të emërojnë kandidatët “magjistratë” në datë 20 Janar 2017, lidhej me afatin 2 mujor që parashikon neni 160(2)(a) i ligjit nr.96/2016. Sipas këtij parashikimi, KLD “emëron magistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016, në përputhje me pjesën III, kreu II, të ligjit 96/2016, **të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji**”. Ndaj, Grupi i Punës së KLD konkludoi se emërimi duhet të bëhej brenda datës 22 Janar 2017. Ligji nr. 96/2016 është botuar në Fletoren Zyrtare më datë 7 nëntor 2016 dhe ka hyrë në fuqi më datë 22 nëntor 2016. Afati dy mujor i përcaktuar në nenin 160 (2) të këtij ligji përfundonte më datë 22 Janar 2017.

Referuar vendimeve të zbardhura të KLD-së<sup>197</sup> për emërimet e Magjistratëve të diplomuar në vitin 2016, konstatojmë se vendimet janë marrë duke ju referuar bazës së re ligjore dhe konkretisht nenit 35 dhe 160 të ligjit nr. 96/2016. Në lidhje me kriterin e parë, KLD është nisur nga vlerësimi i shkollës së Magjistraturës<sup>198</sup>, ku të gjithë kandidatët janë diplomuar me vlerësimin “shumë mirë”. Në vendimin e KLD-së apo edhe në procesverbalin e mbledhjes mungon referimi me pikë minimale (70 pikë), siç kërkohet neni 35, pika 1, gërma “a” e ligjit nr. 95/2016. Lidhur me kriterin e dytë të parashikuar në nenin 35, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 96/2016, ku kërkohet vlerësimi të paktën “mirë” për çdo detyrë gjatë vitit të praktikës në punë, vendimi KLD si dhe procesverbali i mbledhjes së datës 20.1.2017 nuk kanë asnjë një referencë.

Një çështje tjetër e diskutueshme në mbledhjet e KLD-së lidhet me interpretimin e nenit 160, pika 1, gërma “a” të ligjit nr.96/2016, nëse fusha e veprimit të këtij neni do të shtrihej vetëm për kandidatët për magistratë të vitit 2016, apo do të do të përfshinte edhe kandidatë të tjerë deri në krijimin e KLGJ-së. Ky diskutim erdhi si nevojë edhe për shkak të vonesave të krijimit të KLGJ-së dhe KLP-së, si edhe për shkak të diplomimit në Shkollën e Magjistraturës të brezave të rinj të magistratëve në vitin 2017 dhe 2018. Duke qenë se ligji i jepte KLD-së në mënyrë të shprehur, të drejtën për të emëruar vetëm kandidatët për magistratë të vitit 2016, për mos të lënë pa emëruar breza magistratësh deri në krijimin e dy këshillave, u propozuan ndryshime në ligjin nr. 96/2016. Kjo nismë ligjore erdhi nga dy deputetë të mazhorancës qeverisëse, të cilët propozuan të hiqej nga neni 160, pika 1 dhe 2 e ligjit nr.96/2016, referenca tek viti 2016 dhe ti hapej rruga KLD për emërimin e të gjithë magistratëve të diplomuar në

<sup>196</sup> Shih argumentin e paraqitur në Fq. 18 të PV së Mbledhjes 20 Janar 2017.

<sup>197</sup> Vendimi nr.2 datë 20.01.2017, Vendimi nr.3 datë 20.01.2017, Vendimi nr.4 datë 20.01.2017; Vendimi nr.5 datë 20.01.2017; Vendimi nr.6 datë 20.01.2017; Vendimi nr.7 datë 20.01.2017; Vendimi nr.8 datë 20.01.2017; Vendimi nr.9 datë 20.01.2017.

<sup>198</sup> Shkresa nr. 326 Prot., datë 29.07.2016 të Shkollës së Magjistraturës “Informacion mbi vlerësimin e kandidatëve për magistratë të vitit të tretë, profili gjyqtar, që kanë ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës tetor 2013 - qershor 2016”

Shkollën e Magjistraturës nga viti 2016 e më tej, deri në krijimin e KLGJ-së.<sup>199</sup> Duke qenë një nismë ligjore që kërkonte një shumicë të cilësuar në Kuvend, ky propozim nuk arriti të merrte numrin e kërkuar të votave dhe për rrjedhojë u rrëzua.

Në datë 14 Maj 2018, kandidatët për magistratë, 10 të profilit gjyqtar dhe 6 të profilit prokuror, ju drejtuan KLD-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme me kërkesë për emërimin dhe caktimin si magistratë të tyre brenda korrikut 2018.<sup>200</sup> Bazuar në nenin 175 të Kushtetutës, nenit 160, pika 1 dhe 173, pika 1 të ligjit nr.96/2016 dhe vendimit 34/2017 të Gjykatës Kushtetuese, kandidatët për magistratë pretenduan që “KLD dhe Prokuroria e Përgjithshme duhet të ushtrojnë jo vetëm kompetencat që parashikohen shprehimisht në ligj, por edhe ato kompetenca që sigurojnë funksionimin normal të KLD dhe PP si organe të qeverisjes së sistemit të drejtësisë gjatë periudhës tranzitore”. Në mungesë të reagimit nga KLD apo PP, kandidatët për magistratë, në nëntor 2018 ngritën një padi në gjykatën administrative të apelit, ku paditën KLD, PP dhe Qeverinë për mos emërimin e tyre si magistratë.<sup>201</sup> Gjykata administrative i njohu magistratëve të drejtën për të marrë pagesë deri në emërimin e tyre. Me krijimin e KLGJ-së ky ngërc u adresua, pasi një nga vendimeve të para të këtij Këshilli ishte ai për nisjen e procedurave për emërimin e të diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2018 (vendimi nr.8, dt.27.12.2018). Me anë të këtij vendimi, Këshilli filloi procesin e emërimit të kandidatëve për magistratë të cilët janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2018, duke kërkuar raport për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve për magistrat, nga institucionet kompetente parashikuar në nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 96/2016.

### 3.2 Caktimi në pozicion i magistratëve sipas nenit 160, pika 2, gërma “b” e ligjit nr.96/2016

Neni 160, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr.96/2016 parashikon që KLD “merr vendim për *caktimin në pozicion* të kandidatëve magistratë të diplomuar *në vitin 2016*, sipas pjesës III, kreu III, të këtij ligji, *brenda tre muajve* pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”. Sipas këtij parashikimi, caktimi në pozicione i magistratëve të emëruar do të bëhet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 96/2016, pra brenda datës 22 shkurt 2017.

*Neni 39 i ligjit nr.96/2016*

*Caktimi në pozicion i magistratit të emëruar*

*1. Brenda muajit qershor të çdo viti, pas përfundimit të procedurave të transferimit paralel dhe ngritjes në detyrë, secili Këshill shpall vendet e lira për të emëruarit.*

*2. Brenda muajit korrik të çdo viti, secili Këshill publikon vendimet e tij për caktimin e të emëruarve në pozicionet e lira për magistrat.*

*3. Caktimi në pozicion i të emëruarit të sapo diplomuar në Shkollën e Magjistraturës është parësor dhe bazohet në:*

*a) renditjen e tyre në listën e të diplomuarve, sipas nenit 34 të këtij ligji;*

*b) përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të diplomuarit në formimin fillestar, duke e zbatuar, për aq sa është e mundur, në përputhje me shkronjën "a", pika 3, të këtij neni.*

*...*

*5. I emëruari që caktohet në pozicion në gjykatat administrative, duhet të ketë përvojë pune në të paktën një vit e gjysmë në administratën publike ose të ketë rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës*

<sup>199</sup> <http://ëëë.kohajone.com/2018/05/14/magjistratura-ps-kld-dhe-prokuroria-te-vijojne-emerimet-deri-ne-ngritjen-e-klgj-dhe-klp/>; <http://ëëë.scan-tv.com/magjistratet-e-qershorit-semehohen-dot-nisma-ne-kuvend-emerimet-te-behet-nga-prokurori-e-kld-ne-tetor-25-pranime-vitin-tjeter-50/>

<sup>200</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/magjistratet-leter-kld-presim-emerimin-ne-sistemin-e-drejtësisë-brenda-korrikut?r=pop5s>

<sup>201</sup> <http://albanianfreepress.al/neës/2018/11/magjistratet-e-rinj-pasi-kryeprokurores-kld-se-dhe-qeverise-118716/>



KShH vëren se caktimi në pozicion i magistratëve të diplomuar në vitin 2016 u bë me vendim të KLD-së nr. 13<sup>202</sup>, datë 10.02.2017. Në këtë vendim thuhet:

*“Këshilli i Lartë i Drejtësisë i mbledhur më datë 10.02.2017, mbështetur në nenet 34, 39, në pikën 1 shkronja “b” të nenit 160, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në shkresën nr. 326 Prot., datë 29.07.2016 të Shkollës së Magjistraturës “Informacion mbi vlerësimin e kandidatëve për magistratë të vitit të tretë, profili gjyqtar, që kanë ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës tetor 2013 - qershor 2016”, në vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 2; nr. 3; nr. 4; nr. 5; nr. 6; nr. 7; nr. 8 dhe nr. 9, si dhe në preferencat e shprehura me shkrim nga vetë magistratët,*

**VENDOSI:**

*Të caktojë në pozicion, magistratët që kanë përfunduar në periudhën tetor 2013 - qershor 2016 në Shkollën e Magjistraturës, për të ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë gjykatave si më poshtë...”* (Theksimi i shtuar).

Tetë magistratët e diplomuar në vitin 2016 në Shkollën e Magjistraturës u emëruan në Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Durrës, Shkodër, Lushnje dhe Pogradec si dhe në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës dhe Vlorë. Vendimi i KLD-së për emërimin e këtyre magistratëve është shoqëruar me debate në radhët e anëtarëve të saj. Në mbledhjen e datës 10.02.2017, u ngrit çështja nëse renditja e magistratëve për caktimin në pozicion duhej të bëhej sipas shkallëve (“shkëlqyeshëm”, “shumë mirë”, “mirë”, “mjaftueshëm”, “pamjaftueshëm”) apo sipas renditjes së pikëve të provimeve në Shkollën e Magjistraturës. Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 268 parashikon që “vlerësimi i të gjithë komponentëve të vitit të parë dhe të vitit të dytë, mbi pikët e grumbulluara për çdo lëndë, ose element të programit të formimit fillestar dhe në tërësi, si dhe vlerësimi i provimit përfundimtar që organizohet pas vitit të dytë, bëhen nga komisionet përkatëse dhe Këshilli Pedagogjik, sipas një renditjeje të pikëzuar me 5 shkallë: a) “shkëlqyeshëm”; b) “shumë mirë”; c) “mirë”; ç) “mjaftueshëm”; d) “pamjaftueshëm”.

Nga ana tjetër, neni 34, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 parashikon renditjen e kandidatëve për magistratë sipas pikëzimit, në bazë të rezultateve të provimeve gjatë vitit të parë dhe të dytë, provimit përfundimtar, si dhe vlerësimit gjatë praktikës profesionale.<sup>203</sup> Midis anëtarëve të KLD-së pati debat lidhur me renditjen e sjellë nga “Shkolla e Magjistraturës.” Për disa anëtarë, sistemi me 5 shkallë ishte ai që duhet ndjekur në vlerësim, pasi kjo do të eliminonte çdo subjektivizëm të pedagogëve në vlerësimin e kandidatëve dhe do ti jepte një marzh më të madh veprimi KLD-së për të caktuar kandidatët në gjykata, sipas nevojave të sistemit, pa përqendruar më të mirët në rrethe si Tiranë dhe Durrës.<sup>204</sup> Anëtarë të tjerë mbrojtën qëndrimin që studentët e magjistraturës janë studentë të dalë nga një provim shumë i fortë përzgjedhës dhe motivimi që ata kanë për të dalë më të mirët në provime, lidhet pikërisht me faktin që renditja është e lidhur me caktimin e gjykatës ku ata do të vendosen.<sup>205</sup> Argument tjetër i sjellë nga ky grup anëtarësh i KLD-së lidhet me faktin se “caktimi në pozicion” rregullohet në mënyre specifike nga kreu III i ligjit nr. 96/2016. Në bazë të nenit 39 dhe 34 të këtij ligji, kandidatët do të renditen sipas rezultatit në provim, në të gjithë vitin e parë dhe vitin e dytë.

Referuar debateve të bëra nga anëtarët e KLD-së, KShH vlerëson se neni 34 i ligjit nr.96/2016 kërkon renditjen e kandidatëve dhe kjo renditje nuk do të ishte e saktë nëse do i referoheshim shkallës së vlerësimit dhe jo pikëzimit. Kjo e fundit bën diferencën reale mes kandidatëve. Ndaj do të ishte një interpretim i gabuar ligjor, nëse për renditjen do të merrej si referencë ligjore një tjetër dispozitë që nuk është e posaçme (speciale) për këtë situatë, sikurse është neni 268 i ligjit nr.115/2016. Rregullimi i posaçëm është prioritar, në zgjidhjen e situatave ku ligji e rregullon marrëdhënien juridike në mënyrë

<sup>202</sup> <http://www.kld.al/vendime/vendim-nr-13-datë-10-02-2017>

<sup>203</sup> Neni 34(2) I Ligjit 96/2016 “Të diplomuarit renditen në listë, bazuar në rezultatet e provimeve gjatë vitit të parë dhe të dytë, provimit përfundimtar, si dhe vlerësimet gjatë praktikës profesionale.”

<sup>204</sup> Shih PV e Mbledhjes 10.02.2017, faqe 22-38 publikuar në linkun <http://www.kld.al/vendime/procesverbal-datë-10-02-2017>

<sup>205</sup> Ibid.

të qartë dhe eksplicite. Megjithatë, shumica e anëtarëve të KLD-së, në diskutimet e tyre i qëndruan vlerësimit të kandidatëve mbi bazën e shkallës së vlerësimit dhe jo pikëzimit. Sipas shumicës, të gjithë kandidatët për magjistratë që do të caktohen në pozicion janë vlerësuar me “shumë mirë” në Shkollën e Magjistraturës dhe diferencat e tyre në pikëzim nuk përbëjnë ndryshim thelbësor. Vetëm 3 anëtarë të KLD-së, të mbetur në pakicë kërkuan zbatimin e nenit 34 të ligjit nr.96/2016, për caktimin në pozicion të magjistratëve duke ju referuar pikëzimit dhe preferencave të tyre. Në përfundim, votimi i anëtarëve të KLD-së për caktimin në pozicion të secilit kandidat për magjistrat të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016 u bazua mbi bazën e preferencave të vetë magjistratëve si dhe bazuar në renditjen e tyre sipas shkallës së vlerësimit dhe jo pikëzimit të përgjithshëm përgjatë tre viteve të formimit (fillestar/stazhit profesional). Nga 8 kandidatë për gjyqtarë, 7 prej tyre u caktuan në pozicione pranë gjykatave që kishin referuar si preferencë të parë. Në këtë mënyrë, KShH vëren se neni 34, pika 2 dhe neni 39, pika 3, gërma “a” e ligjit nr.96/2016 nuk janë respektuar në këtë vendimmarrje.

Në aneksin 10 të rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet sistemi i vlerësimit të kandidatëve për magjistratë në formimin fillestar. Rregullorja rezulton të jetë ndryshuar pas miratimit të legjislationit të ri të reformës në sistemin e drejtësisë, përkatësisht me vendimin nr.23, datë 23.10.2017. Vlerësimi për secilin kandidat për magjistrat në përfundim të Shkollës përbëhet nga vlerësimi total i të gjithë komponentëve të vitit të parë, të dytë dhe të tretë. Vlerësimi total bëhet me Vendim të Këshillit Pedagogjik në fund të vitit akademik dhe është shumatorja e:

- a) 2250 pikëve të vitit të parë;
- b) 1400 pikëve të vitit të dytë;
- c) 200 pikë, vlerësimi i provimit përfundimtar;
- d) 600 pikë vlerësimi i stazhit profesional të vitit të tretë. Rezultati përfundimtar i vitit të tretë del pas shumëzimit të vlerësimit prej 300 pikë me koeficientin 2.

Sikurse vërehet, numri maksimal i pikëve që mund ti akordohet kandidatit magjistrat në përfundim të Shkollës së Magjistraturës është 4450 pikë.

Një çështje tjetër që u ngrit për diskutim mes anëtarëve, lidhur me kompetencën tranzitore të KLD-së për caktimin në detyrë të magjistratëve, ishte edhe nëse magjistratët mund të emërohen në gjykatat administrative. Sipas nenit 39, pika 5 të ligjit nr.96/2016, i emëruari që caktohet në pozicion në gjykatat administrative duhet të ketë përvojë pune të paktën 1 vit e gjysmë në administratën publike ose të ketë rezultate shumë të mira në lëndët e të drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës. Kjo dispozitë kërkon që edhe magjistratët e diplomuar në vitet 2013-2016 të kenë mundësinë të emërohen në gjykatën administrative, nëse plotësojnë të paktën një nga këto kritere. Megjithatë, neni 5 i ligjit në fuqi të kohës për gjykatën administrative (nr.49/2012)<sup>206</sup> parashikon kritere të tjera emërimi si gjyqtar administrativ nga ato të ligjit nr.96/2016, përkatësisht që magjistrati duhet të ketë shërbyer si gjyqtar 5 vjet dhe të japë provimin për t’u kualifikuar për gjykatën administrative. Në këtë pikëpamje, edhe në mbledhjen e KLD, datë 10.02.2017 u konstatua një përplasje midis këndvështrimeve të anëtarëve për përplasjet dhe epërsinë midis këtyre dy ligjeve. Çështja nëse kandidatët për magjistratë të diplomuar në vitin 2016 duhet të emëroheshin në gjykatën administrative u hodh në votim në mbledhjen e KLD-së. Në këtë votim, anëtarët u ndanë në 6 (gjashtë) vota pro dhe 4 (katër) vota kundër dhe si rrjedhojë u pranua emërimi i tyre në gjykatën administrative. Për tre kandidatët e diplomuar në vitin 2016, të cilët kishin shfaqur si preferencë të parë caktimin në pozicion pranë Gjykatave Administrative, shumica e anëtarëve të KLD-së vendosi pro kësaj preference. Në asnjë rast, gjatë

<sup>206</sup> Ligji nr.49 u amendua në kuadër të reformës në drejtësi nga Parlamenti, në dt.30.03.2017, pra më shumë se një muaj pas mbledhjes së KLD-së, ku ndër të tjerash u shfuqizua edhe dispozita që parashikonte si kriter për emërimin e gjyqtarëve administrative, përvojën 5 vjeçare. Konkretisht, shiko ligjin nr. 39/2017 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar

procesit të relatimit të preferencave të tyre për në Gjykatat Administrative, nuk u diskutua plotësimi i kriterëve që parashikon legjislacioni i ri i reformës në drejtësi (ligji nr.96/2016) për vendosjen në këto gjykata, përkatësisht përvoja e punës të paktën një vit e gjysmë në administratën publike ose të pasurit e rezultateve shumë të mira në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës.

### 3.3. Vendosja e masave disiplinore sipas nenit 160, pika 1, gërma “c” e ligjit nr.96/2016

Në bazë të nenit 160, pika 1, gërma “c” të ligjit nr. 96/2016, KLD vendos masa disiplinore, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën V, kreu I, të këtij ligji. Ndërsa neni 160, pika 1, gërma “e” parashikon që gjatë fazës tranzitore, KLD vendos masa disiplinore për inspektorët, bazuar në aktet nënligjore në fuqi.

Ligji nr. 96/2016, në nenet 172, pika 2 dhe 174 rregullon disa çështje lidhur me procedimet disiplinore të gjyqtarëve gjatë fazës tranzitore. Kompetencat e KLD-së gjatë fazës tranzitore të lidhura me këto procedime rregullohen në nenin 172 dhe neni 174 të këtij ligji.

#### Hetimi disiplinor gjatë fazës tranzitore.

- Gjatë fazës tranzitore, Inspektorati i KLD-së është organi kompetent për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe inspektoreve, deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- KLD është kompetente për të shqyrtuar procedimet disiplinore që kanë filluar para hyrjes në fuqi të ligjit nr.96/2016 dhe që nuk janë përfunduar ende në momentin e hyrjes së në fuqi të këtij ligji. Afati i përfundimit të këtyre hetimeve disiplinore të papërfunduara do të ishte data 22.02.2017, **pra 3 muaj** nga dita e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016.
- Pas kësaj date, në bazë të nenit 160, pika 5 e ligjit nr.96/2016, Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë duhet ti përcillte materialet hetimore Inspektoratit të KLD, i cili do të ishte i vetmi organ kompetent për hetimin disiplinor deri në krijimin e organit të ri, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ligji i zbatueshëm në këtë rast do të ishte ligji i vjetër, pra ligji nr.8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe vendimi nr. 137/2013 i KLD.

#### Procedimi disiplinor gjatë fazës tranzitore

- KLD mund të kryente procedim disiplinor gjatë fazës tranzitore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016.
- Procedura dhe kriteret për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve përcaktohen në pjesën V, kreu I të ligjit nr.96/2016 (neni 105 - 116), *por një pjesë e këtyre dispozitave janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese*<sup>207</sup>.
- Në rast se procedimi disiplinor kishte nisur para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, ai duhet të përfundonte **brenda 6 muajsh** nga hyrja në fuqi e këtij ligji, pra në datë 22.05.2017. Rregullat e procedimit disiplinor në këtë rast do të ishin rregullat e parashikuara në ligjin për Statusin 96/2016.

Neni 172 paragrafi i katërt i ligjit nr. 96/2016 parashikon se në çdo rast, organet kompetente do të zbatojnë ligjin më favorizues për magjistratin që ka kryer shkelje disiplinore. Nëse krahasojmë sanksionet disiplinore të ligjit të ri nr.96/2016 me ligjin e vjetër nr. 9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor" vërehet se midis tyre ka dallime. KShH vëren se ka masa disiplinore të cilat nuk janë më në rregullimin e ri ligjor ose janë parashikuar masa të reja. Për shembull masa për dërgimin e magjistratit 1-2 vjet në një gjykatë tjetër të të njëjtin nivel nuk është në listën e masave disiplinore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016. Nga ana tjetër, masat disiplinore si ulja e përkohshme në pagë dhe pezullimi nga detyra, janë risi në ligjin e ri nr.96/2016. Nëse ligji i mëparshëm kishte sanksionin vërejtje me paralajmërim, ligji nr. 96/2016 ka masë vërejtje konfidenciale dhe vërejtje publike. Tabela

<sup>207</sup> Neni 100-104 janë shfuqizuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese 34/2017.

në vijim mundëson një krahasim më të mirë midis llojit të masave disiplinore të parashikuara në të dyja këto ligje.

<p><b>Ligji Nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”</b></p>	<p><b>Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”</b></p>
<p><b>Neni 33</b></p> <p>Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.</p> <p>Masat disiplinore janë:</p> <p>a) <b>vërejtje</b>;</p> <p>b) <b>vërejtje</b> me paralajmërim;</p> <p>c) ulje e përkohshme për 1 deri në 2 vjet në detyrë në një gjykatë të një niveli më të ulët;</p> <p>ç) dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij;</p> <p>d) <b>shkarkim nga detyra.</b></p>	<p><b>Neni 105</b></p> <p>Këshillat mund të vendosin një ose më shumë nga këto masa disiplinore:</p> <p>a) <b>vërejtje</b> konfidenciale;</p> <p>b) <b>vërejtje</b> publike;</p> <p>c) ulje e përkohshme e pagës: -deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit; -në rastin e magistratëve që kanë dhënë dorëheqjen, gjobë në një masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës.</p> <p>ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër;</p> <p>d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;</p> <p><b>dh) shkarkim nga detyra.</b></p>

Lidhur me zbatimin e ligjit të aplikueshëm për shkeljet disiplinore të kryera para hyrjes në fuqi të ligjit nr.96/2016 një çështje e diskutueshme në mbledhjet e KLD-së ka qenë fuqia juridike e akteve nënligjore që datojnë pikërisht para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Akti nënligjor që detajonte procedimin disiplinor të gjyqtarëve para hyrjes në fuqi të ligjit nr.96/2016 ka qenë vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) nr. 137, datë 21.02.2003 "Rregullore për procedimin disiplinor të gjyqtarëve". Ndërkohë, vendimi i KLD-së nr.195/2/a, dt. 05.07.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë” përcakton ndër të tjerash shkeljet disiplinore, verifikimin e shkeljeve disiplinore, procedimin disiplinor dhe shqyrtimin e tij si dhe masat disiplinore për Kryeinspektorin dhe inspektorët e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Sipas nenit 174, pika 6 të ligjit nr.96/2016 këto akte nënligjore të miratuara para hyrjes në fuqi të tij do të zbatohen sa kohë nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

Në mbledhjen e KLD-së datë 24.03.2017 u shqyrtuan masat disiplinore të propozuara për tre gjyqtarë, për të cilët procedimi disiplinor nga Ministri i Drejtësisë ishte kërkuar respektivisht në janar, shkurt dhe dhjetor të vitit 2016<sup>208</sup>. Kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarëve ishte paraqitur mbi bazën e ligjit të vjetër nr. 9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor". Në kohën e shqyrtimit të këtyre kërkesave të Ministrit të Drejtësisë nga KLD kishte hyrë në fuqi ligji i ri nr. 96/2016. Për dy prej gjyqtarëve, Ministria e Drejtësisë propozon masën disiplinore “vërejtje me

<sup>208</sup><file:///C:/Users/user/Desktop/Erida/Save%20the%20Children%20dhe%20Qendra%20e%20te%20miturve/Procesverbal%20e/kld-2017-03-24.pdf>

paralajmërim” ndërkohë që për një prej gjyqtarëve kërkohet masa më e rëndë disiplinore “shkarkim nga detyra” (referuar nenit 33, paragrafi 2, gërmat “b” dhe “d” të ligjit nr.9877/2008). Sipas dispozitave tranzitore të ligjit nr. 96/2016, KLD është organi kompetent për të shqyrtuar këto procedime disiplinor. Ndërkohë që ligji nr. 96/2016 nuk e parashikon më masën “vërejtje me paralajmërim” por parashikon si masë disiplinore “vërejtje konfidenciale” dhe “vërejtje publike”, përkatësisht në nenet 106 dhe 107 të tij. Duke u bazuar në analizën për shkeljet e konstatuara, llojin e tyre, mënyrën si kanë rrjedhur ngjarjet dhe duke pasur parasysh dhe referimet e reja ligjore, Ministri i Drejtësisë kërkoi për këta dy gjyqtarë ndryshimin e masës duke propozuar masën disiplinore “vërejtje konfidenciale” të parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016.

Për të tre gjyqtarët, KLD vendosi kundër propozimit të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore. Në dy raste, vendimmarrja e KLD-së ishte unanime “kundër” ndërsa në një rast shumica e anëtarëve, përkatësisht gjashtë prej tyre vendosën “kundër” dhe katër “pro”. Gjatë diskutimit të masave të propozuara, rezultoi se gjyqtarët ishin njohur paraprakisht me dokumentacionin mbështetës të masës disiplinore si dhe ju ishte dhënë mundësia të paraqisnin shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. Në mbledhje, gjyqtarët paraqitën në mënyrë të përmbledhur parashtrimet e tyre për rezultatet e inspektimit dhe propozimin e bërë nga Ministri i Drejtësisë. Gjithashtu, atyre ju drejtuan disa pyetje nga anëtarët e KLD-së dhe patën mundësi të japin shpjegimet dhe sqarimet e tyre. **Në përgjithësi, fryma e pyetjeve që ju adresuan gjyqtarëve kishte natyrë favorizuese, çka evidenton një qasje jo neutrale dhe jo objektive të anëtarëve në KLD-së. Për rastin e gjyqtarës ndaj të cilës ishte propozuar shkarkimi nga detyra për disa shkelje të lidhura me një vendim të formës së prerë, në diskutimet e anëtarëve mbizotëroi interpretimi se vendimi i formës së prerë nuk mund të merret në shqyrtim, nëse ka shkelje të dispozitave procedurale apo shkelje të ligjit material.** Një prej anëtarëve të KLD-së kritikon raportin e Inspektoratit duke referuar se shprehjet e raportit *“duhet të kishin ikur nga fjalori i inspektorëve, ta dimë një herë e mirë që nuk kemi më shprehje të tilla për një vendim gjyqësor, nuk është tagri i inspektorëve kjo”*. Një anëtar tjetër shprehet se *“Ky është një vendim i formës së prerë, na pëlqen, s’na pëlqen. Personalisht do të thoja që të kisha qenë unë gjyqtar mbase se kisha marrë këtë vendim, por ky është një vendim i formës së prerë dhe problemi kryesor nëse mund të ketë ndonjë problem, prandaj me të drejtë u theksua këtu që gjyqësori funksionon me shkallë gjykimi, e gjej te bashkia dhe avokatura shtetit”*. Një prej anëtarëve citon në fjalimin e tij ligjin e mëparshëm për dhënien e masës disiplinore duke referuar se *“Ligji mëparshëm në pikën c) parashikon kushte kumulative, shkelje e pajustificuar dhe e përsëritur dhe e dyta është kur këto kanë passjellë apo mund të sjellin pasoja, sikundër u referua edhe nga materiali që ne kemi nuk verifikohet asnjë nga kushtet se po të ishte një do të diskutonim nëse mund të ishte i dyti, nuk verifikohet shkelje e pajustificuar apo e përsëritur e dispozitave sepse nuk mund t’i referohemi të njëjtit proces. Referimi në legjislacionin e vjetër të drejtësisë nga anëtarët e KLD-së gjatë diskutimeve të masave disiplinore është i gabuar, në rastet kur ndaj gjyqtarit ka filluar një procedim disiplinor para se ligji nr.96/2016 të hyjë në fuqi dhe ky procedim disiplinor vazhdon ende pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.* Sikurse është theksuar më herët, sipas nenit 172, pika 2 të ligjit nr.96/2016, për këto procedime, organet përgjegjëse zbatojnë rregullat procedurale të parashikuara në këtë ligj. **Gjithashtu, gjatë kohës së diskutimit të këtyre masave disiplinore në mbledhjen e KLD-së, disa prej dispozitave të ligjit nr.96/2016 nuk ishin shfuqizuar ende nga Gjykata Kushtetuese. Në këto dispozita parashikohen edhe shkelje të natyrës procedurale nga gjyqtarët të cilat përbëjnë shkak për dhënien e masës disiplinore, pavarësisht nga fakti nëse vendimi për çështjen konkrete ka marrë ose jo formë të prerë.**

Në mbledhjen e dt.18.01.2018 të KLD-së<sup>209</sup> është ngritur nga Ministrja e Drejtësisë shqetësimi për mosrespektimin e afatit 3 mujor dhe 6 mujor, brenda të cilit KLD duhet të mbyllte përkatësisht hetimin disiplinor dhe procedimin disiplinor, nëse ato kishin filluar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.96/2016. Ministrja e Drejtësisë ngriti shqetësimin pse në rendin e ditës ishte futur shqyrtimi i vetëm 3 kërkesave për procedim disiplinor kur ka pasur 10 kërkesa, e për më tepër që të gjitha këto procedime disiplinore

<sup>209</sup> <http://www.kld.al/vendime/procesverbal-datë-18-01-2018>



duhet të kishin përfunduar brenda datës 22.05.2017.<sup>210</sup> Në këtë mbledhje, përfaqësuesi i Inspektoratit u përgjigj se çështjet nuk janë futur më parë për shqyrtim për shkak të axhendës së ngarkuar të KLD-së dhe Kryetarit të saj dhe se nuk ka pasur kërkesë nga ministrat e mëparshëm për ti futur në axhendë. Tre subjektet për të cilët do të shqyrtoheshin masat disiplinore, të cilat ishin futur në rendin e ditës ishin përzgjedhur në bazë të rendit alfabetik.<sup>211</sup>

I njëjti shqetësim u ngrit nga Ministria e Drejtësisë edhe në mbledhjen e datës 24.01.2018, ku sërish u vu në dukje se KLD nuk kishte respektuar afatin 6 mujor për përfundimin e procedimeve disiplinore të parashikuara nga neni 172, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Në këtë mbledhje u morën në shqyrtim 12 kërkesa të Ministrit të Drejtësisë të kohës për procedimin disiplinor ndaj 12 gjyqtarëve, 10 prej të cilëve gjyqtar në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore dhe 2 gjyqtarë në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë. Kërkesat për procedim disiplinor ndaj këtyre gjyqtarëve u mbështetën dhe u argumentuan nga Ministria e Drejtësisë prezent në mbledhje. Për 10 prej gjyqtarëve u kërkua shkarkim nga detyra, ndërkohë që për dy prej tyre u kërkua vërejtje publike.

Mbledhja e KLD-së e datës 24 Janar 2018 u shoqërua me diskutime për mënyrën se si do të interpretohen neni 160, pika 1, gërma “c” e ligjit nr.96/2016 në raport me nenin 172 dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.34/2017 që shfuqizon një numër të konsiderueshëm dispozitash për shkeljet dhe procedimin disiplinor të gjyqtarëve<sup>212</sup>. **Në diskutimet e mbledhjes së dt.24 Janar 2018, mes anëtarëve të KLD-së pati momente paqartësie, akuza reciproke dhe tensioni sa i takon legjislacionit të aplikueshëm për masat disiplinore, lidhur me arsyet që e kishin çuar KLD-në në bllokimin e vendimmarrjes përtej afateve ligjore si dhe pati interpretime të ndryshme për mënyrën se si do të zbatohet ky legjislacion në dritën e vendimit nr.34/2017 të Gj. Kushtetuese.**

Sipas një anëtari të KLD-së, Ministri i Drejtësisë mund të kërkonte procedimin disiplinor para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe ligjeve të reja të pushtetit gjyqësor, ndërkohë që pas hyrjes në fuqi nuk e ka më këtë tagër që i kalon KLD, i cili nëpërmjet Inspektoratit mund të fillojë procedimin disiplinor dhe njëkohësisht edhe të shqyrtojë këto çështje.<sup>213</sup> Sipas këtij anëtari, vendimi nr.34/2017 i Gjykatës Kushtetuese ka shfuqizuar të gjitha shkeljet që i korrespondojnë masave disiplinore të parashikuara në ligjin e ri për statusin.<sup>214</sup> Një prej anëtarëve të KLD-së referoi se *“Këshilli nuk ka neglizhuar asnjë moment përgjegjësitë e tij sa i përket shqyrtimit të këtyre masave sepse nuk e kemi pasur në tavolinë një çështje të tillë. ... Ne nuk e dimë se çfarë sjell ministri në Inspektorat. ... Vendimi nr.34/2017 ka shfuqizuar ato dispozita të cilat përcaktojnë shkeljet. Janë në fuqi masat, por që të vendosim një masë, masa është përfundimi i procesit disiplinor, ne duhet të dimë se çfarë janë shkeljet. ... Kemi një vit, ne duam të dimë sepse mund ti kërkohej llogari Këshillit dhe ne patjetër mbajmë përgjegjësinë tonë, por përgjegjësi ka edhe Kuvendi këtu që nuk ka bërë atë që duhet<sup>215</sup>”*. Një tjetër anëtar propozoi që Këshilli të zbatojë dispozitat më të favorshme dhe se duhej interpretuar neni 172(4) i ligjit nr.96/2016 dhe të mbahej qëndrim nëse ligji më i favorshëm do të thotë se s’ka fare shkelje, apo duhet të presim që të plotësohet ky vakum ligjor nga Kuvendi, që të bëhet krahasimi, ndaj ajo thirri anëtarët të mbanin një qëndrim në parim lidhur me këtë dispozitë.<sup>216</sup> Një tjetër anëtar i KLD e refuzoi interpretimin favorizues të nenit 172(4) të ligjit nr.96/2016, duke u shprehur se jemi para një vakumi ligjor të shkaktuar nga vendimi 34/2017 i Gjykatës Kushtetuese dhe se ligji favorizues aplikohet atëherë kur mund të bëhet krahasim midis dy ligjeve dhe ne nuk jemi para këtij rasti. Interpretimi që sugjeroi ky anëtar i KLD-së ishte për t’ju referuar ligjit të kohës kur është kryer shkelja.<sup>217</sup> Gjithashtu, sipas tij, neni 172 i ligjit nr.96/2016 nuk ka parashikuar pasojën se çfarë ndodh nëse procedimet nuk kryhen brenda 6 muajve, e për rrjedhojë ligji e ka lënë këtë si afat orientues për t’u përfunduar brenda

<sup>210</sup> Procesverbali 18.01.2018, Fq. 36

<sup>211</sup> Procesverbali 18.01.2018, Fq. 37.

<sup>212</sup> <http://www.kld.al/vendime/procesverbal-datë-24-01-2018>

<sup>213</sup> Procesverbali datës 24.01.2018, Fq 4

<sup>214</sup> Procesverbali datës 24.01.2018, Fq. 5

<sup>215</sup> Fq 9 – 10 e procesverbalit

<sup>216</sup> Faqe 9

<sup>217</sup> Fq. 11

6 muajve.<sup>218</sup> Ndërkohë Ministria e Drejtësisë dhe një anëtar tjetër mbajtën qëndrimin se mund të zbatohet drejtpërdrejt Kushtetuta, konkretisht neni 140, pika 2, gërma “a” dhe i lexuar bashkë me nenin 160, pika 1, gërma “c” dhe nenin 172 të ligjit të ligjit nr.96/2016, mund të ishin bazë ligjore për marrjen e masës së shkarkimit të gjyqtarit. Ky qëndrim është mbajtur deri në përfundim të fazës tranzitore të KLD nga Ministria e Drejtësisë. Sipas Ministres, kur sjelljet e gjyqtarit diskreditojnë figurën dhe pozitën e gjyqtarit, neni 160, pika 1, gërma “c”, i lexuar së bashku me nenin 140, paragrafi 2<sup>219</sup>, nenin 115 të ligjit nr. 96/2016 dhe duke pasur në vëmendje zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 34, 10.04.2017, i japin të drejtë ministri i Drejtësisë që deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të ketë kompetencën ligjore që t’i kërkojë KLD-së të vendosë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit.<sup>220</sup>

**Pavarësisht debatit juridik lidhur me legjislacionin e aplikueshëm dhe vakumin ligjor të krijuar nga vendimi i Gj. K nr.34/2017, në mbledhjen e dt. 24 Janar 2018, KLD vendosi për 10 gjyqtarë kundër masave disiplinore të propozuara nga Ministri i Drejtësisë së kohës dhe për të cilat Ministria e Drejtësisë prezent në mbledhje, mbështeti propozimin e bërë nga paraardhësi i saj. Ndërkohë për 2 gjyqtarë, KLD nuk mori vendim për shkak të mungesës së justifikuar të njërit prej gjyqtarëve ndërkohë që në rastin tjetër, dy prej anëtarëve të KLD-së kishin konflikt interesi, çka zbriste nën minimumin e parashikuar në ligj, të kuorimit për vendimmarrje. Në vendimmarrjen e KLD-së mbizotëroi dukshëm ndarja midis anëtarëve nga radhët e gjyqësorit nga njëra anë dhe Ministres së Drejtësisë dhe Presidentit, nga ana tjetër. Konkretisht, gjatë votimit për propozimin e masave disiplinore, në 8 raste vota e anëtarëve gjyqtar në KLD ka qenë unanime, ndërkohë që propozimi i bërë nga Ministria e Drejtësisë ka pasur gjithmonë mbështetjen e Presidentit si dhe mbështetjen një prej anëtarëve gjyqtar të KLD-së në 3 raste.**

Për tre nga rastet e sipërpërmendura, anëtarët e KLD-së nga radhët e gjyqësorit pavarësisht se votuan kundër shkarkimit propozuan një masë disiplinore më të lehtë, përkatësisht, “vërejtje me paralajmërim”, “vërejtje publike” dhe “vërejtje konfidenciale”. Konkretisht, në një rast, anëtarët e KLD edhe pse votuan kundër propozimit të Ministres së Drejtësisë për shkarkimin e gjyqtarës Dh. B., votuan për vërejtje me paralajmërim në bazë të nenit 146(3) të ligjit nr.96/2016<sup>221222</sup>, edhe pse në ligjin e ri nuk parashikohet më vërejtje me paralajmërim, por vetëm vërejtje konfidenciale dhe publike. Ky mund të ketë qenë lapsus, pasi në të njëjtën mbledhje për gjyqtarin T.K u arsyetua se: *“Evidentohet që ka shkelje në rastin konkret, por nisur edhe nga diskutimi që bëme më përpara, se dua të argumentoj votën kundër, jemi përpara një vakumi ligjor (nuk mund ta lejmë pa ndëshkuar), por duke marrë për bazë dhe parimin e proporcionalitetit dhe faktin se sa vjet ka qenë gjyqtar zotëria, në sjelljen e tij gjatë kësaj kohe, unë çmoj se duhet të jetë masa e dytë që vjen, është një “Vërejtje”, që në rastin konkret quhet “Vërejtje publike” (sipas ligjit të ri), e cila është ekuivalente me “Vërejtje me paralajmërim”.*<sup>223</sup>

Për sa i takon vlerësimin nga pikëpamja faktike të shkeljeve për të cilat kishte filluar procedimi disiplinor ndaj gjyqtarëve, sërish anëtarët e KLD-së patën ndasi ku në përgjithësi anëtarët gjyqtarë kanë ndjekur të njëjtën linjë argumentimi të ndryshme nga argumentimi i bërë nga Ministria e Drejtësisë. Së pari, këto mos dakordësi u shfaqën në rastet kur ndaj gjyqtarëve për të cilët ishte kërkuar procedimi disiplinor, për të njëjtin fakt prokuroria kishte vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të tyre. Sipas Ministres së Drejtësisë, pavarësisht nga vendimmarrja e organit të akuzës, fakti që gjyqtari nuk ka përgjegjësi penale nuk e përjashton atë automatikisht nga

<sup>218</sup> Fq. 9

<sup>219</sup> Neni 140, pika 2 thotë: *Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës*

<sup>220</sup> Procesverbali i mbledhjes 07.05.2018, Fq. 61, 76.

<sup>221</sup> Neni 146(3) i Ligjit “Për Statusin” parashikon: Këshilli nuk është i detyruar t’i qëndrojë masës disiplinore të propozuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim të paktën brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.

<sup>222</sup> Procesverbali i datës 24.01.2018, Fq. 33-34.

<sup>223</sup> Procesverbali i datës 24.01.2018, Fq. 59



përgjegjësia administrative<sup>224</sup>. Ndërkohë që në replikën e bërë nga një prej anëtarëve, për rastin konkret vlerësohet se vendimi i prokurorisë për pushimin e çështjes provon se pasuria dhe interesat private të deklaruara në ILDKPKI nga gjyqtari janë produkt i burimeve të ligjshme<sup>225</sup>. Këtij argumenti, një anëtar tjetër në radhët e gjyqtarëve në KLD i shton edhe faktin se ndaj vendimit të prokurorisë, ILDKPKI që ka qenë në cilësinë e kallëzuesit nuk ka bërë ankim.<sup>226</sup> ***Për një rast tjetër, me anë të pyetjeve drejtuar avokatit mbrojtës të gjyqtarit të proceduar, anëtari i KLD-së vë në dukje se pushimi i procedimit penal nga prokuroria ka ardhur për shkak se fakti nuk ekziston***<sup>227</sup>. Pra mos ekzistenca e faktit passjell që i njëjti fakt nuk mund të ekzistojë për përgjegjësinë administrative (disiplinore).

Në disa raste, propozimet e Ministrisë të Drejtësisë apo Inspektoratit të KLD-së për masa disiplinore ndaj gjyqtarëve janë hedhur poshtë nga KLD, me arsyetimin që shkeljet e pretenduara nga Ministri i përkasin çështjeve ndaj të cilave ka një vendim gjyqësor të formës së prerë. Për njërin prej gjyqtarëve, avokati i tij mbrojtës referon para Këshillit se ***“Derisa vendimi gjyqësor është i formës së prerë, ka prezumimin ligjor brenda që ky gjykim është realizuar i drejtë, i pavarur, i paanshëm, brenda një afati, kështu që nuk ka vend qoftë edhe nga pikëpamja formale që janë kryer shkelje të dispozitave procedurale në gjykim, pasi po të diskutonim këto dispozita do të vinim në diskutim vetë përmbajtjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë***<sup>228</sup>. Ky vendim i shumicës së anëtarëve të KLD është bazuar edhe në praktikën e Gj. Kushtetuese, konkretisht në vendimin nr.11, datë 27.05.2004, sipas të cilit KLD nuk mund të kontrollojë dhe të vlerësojë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Këto çështje janë objekt gjykimi nga gjykatat më të larta dhe në përputhje edhe me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga KLD.<sup>229</sup> Ndaj këtij reagimi, ***Ministrja e Drejtësisë ka argumentuar në një rast se, në vendimin nr.11 të vitit 2004 të Gjykatës Kushtetuese thuhet se KLD-ja mund të marrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve pa e kushtëzuar atë me faktin nëse ky vendim ka marrë formë të prerë, vetëm për rastet kur vendimi shoqërohet me akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor***<sup>230</sup>. Në raste të tjera, anëtarët e KLD kanë konsideruar se shkarkimi për shkak të deklaramit të pasaktë është një shkelje administrative që as nuk e diskrediton figurën e gjyqtarit dhe as nuk përbën vepër penale, e për rrjedhojë kanë votuar kundër masës së shkarkimit.<sup>231</sup>

**Gjatë debateve të zbardhura në procesverbalin e mbledhjes së dt.24 Janar 2018, vërehen elementë të korporatizmit pasi në disa raste, pyetjet e anëtarëve të KLD-së ndaj gjyqtarëve kanë qenë për të mbështetur pozitën e mbrojtjes së kolegëve të tyre ndaj të cilit është kërkuar procedimi disiplinor si dhe ka pasur edhe qëndrime dhe pyetje sugjestionuese.** Kështu, pyetjes së anëtarit të KLD-së ndaj avokatit mbrojtës të gjyqtarit për përvojën dhe ngarkesën e këtij të fundit, avokati nuk ka mundur ti japë përgjigje pyetjeve shumë specifike. Anëtari i KLD-së reagon në këtë mënyrë ***“Ju keni ardhur këtu të mbronni një njeri të iki me nder nga puna apo të mos iki, apo të iki pa ndër .... edhe për këtë jeni i papërgatitur***<sup>232</sup>. Këto qëndrime favorizuese, në disa raste lidhen edhe me faktin se vetë anëtarët e KLD-së kanë pasur problematika të ngjashme në të kaluarën e tyre ose për shkak se anëtarët njohin aftësitë/kapacitet e gjyqtarëve të proceduar disiplinorisht. Kështu, në rastin e një gjyqtari që është proceduar disiplinorisht për shkak se është aksioner në dy shoqëri tregtare, anëtari i KLD-së gjatë procesit të pyetjeve shprehet se ***“I bëj këto pyetje se unë e njoh mirë ligjin “Për konfliktin...”, se e kam vuajtur vetë në kurriz këtë pikën e konfliktit të***

<sup>224</sup> Po aty, Fq.13

<sup>225</sup> Po aty, Fq 18

<sup>226</sup> Po aty, Fq. 19

<sup>227</sup> Po aty, Fq.101

<sup>228</sup> Po aty, Fq.27, fq.67 citim nga Gj. Gjoni

<sup>229</sup> Shih procesverbalin e mbledhjes se datës 07.05.2018, rasti Laurent Fucia.

<sup>230</sup> Po aty, f1 64-65

<sup>231</sup> Procesverbalin i datës 24.01.2018, Fq. 18, 19

<sup>232</sup> Po aty, fq.31

*interesit.*<sup>233</sup> Për një tjetër gjyqtar, një anëtar tjetër i KLD-së referon “... *aq më tepër që në këtë rast kemi të bëjmë me një gjyqtare shumë të mirë. Unë e kam pasur studente dhe ka qenë studente shumë e mirë magjistrate. Shkelja nuk është e pajustificuar.*” Në një rast tjetër, anëtari i KLD-së shprehet se “*Juve mendoni, për shkak të vendimit të pushimit i cili ka vendosur që fakti nuk ekziston, a mund të ketë edhe procedim disiplinor për një rrethanë e cila, Ministria e Drejtësisë e ka sjellë motamo siç është kallëzimi dhe nuk është bërë një hetim administrativ*<sup>234?</sup>”

Një tjetër çështje e diskutuar nga KLD ka qenë nëse gjatë fazës tranzitore ky institucion mund të shqyrtojë ose jo raste të shkarkimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, kur këta kanë kryer një vepër penale.<sup>235</sup> Në mbledhjen e datës 17.07.2017, Kryetari i Gjykatës së Lartë solli kërkesën për masë disiplinore të shkarkimit të gjyqtarës së Gjykatës së Lartë, M.A për të cilën kishte një vendim penal të formës së prerë që e kishte deklaruar fajtorë për kryerjen e një krimi. Midis anëtarëve pati debat, pasi një pjesë e anëtarëve të KLD pretenduan se kjo duhet të shqyrtohet nga KLGJ, kurse të tjerë nuk e përjashtuan mundësinë që në fazën tranzitore edhe KLD mund të shqyrtojë masën disiplinore të shkarkimit të gjyqtarit të lartë, kur ndaj tij/saj ka vendim penal të formës së prerë. Megjithatë, **Ministri i Drejtësisë refuzoi të paraqiste propozim për masën disiplinore të shkarkimit, pasi sipas tij kjo kompetencë nuk i takonte KLD-së, por KLGJ.** Ministri i Drejtësisë u shpreh se KLD duhet të vazhdojë të ushtrojë të gjitha kompetencat që ka pasur deri në momentin e ndryshimit të legjislacionit në kuadër të reformës në drejtësi, por pa marrë kompetencat e KLGJ-së.<sup>236</sup> **Ministri i Drejtësisë sugjeroi që në këto rrethana çështja duhej të zgjidhej nga Gjykata e Lartë në bashkëpunim me Presidentin. Sipas tij, duke qenë se dënimi i ish gjyqtarës M.A. përfshihet në rastet e ndalimit për të ushtruar një funksion publik, Presidenti i Republikës mund të konstatojë që jemi në kushtet e pazgjidhshmërisë në kuptim të ligjit për dekriminalizimin dhe është autoritet verifikues për anëtarët e Gjykatës së Lartë.** Është kompetencë e Presidentit të Republikës, të konstatojë ekzistencën e këtij kushti pazgjidhshmërie në përputhje me ligjin për dekriminalizimin, ndaj ai ndërpret mandatin dhe njofton Gjykatën e Lartë, e cila në përputhje me procedurën kushtetuese bën deklarimin e përfundimit të mandatit të gjyqtarës M.A. Nisur nga ky arsyetim, Ministri i Drejtësisë refuzoi të paraqiste propozim për shkarkimin e gjyqtarës së Gjykatës së Lartë për shkak të një vendimi gjyqësor që e deklaronte fajtorë për kryerjen e një vepre penale. Në këto kushte, anëtarët e KLD-së vendosën kundër shqyrtimit të kërkesës së Kryetarit të Gjykatës së Lartë. **Sipas shumicës së anëtarëve, KLD-ja mund të shprehej lidhur me mundësinë e shkarkimit të anëtarës së Gjykatës së Lartë, vetëm nëse kërkesa për procedim disiplinor paraqitet nga Ministri i Drejtësisë, pasi neni 160(1)(c) e thotë qartë që kjo kompetencë fillon vetëm me paraqitjen e kërkesës nga ky i fundit.**

### **3.4 Pezullim i gjyqtarëve, sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në nenin 160, pika 1, gërma “ç” e ligjit nr.96/2016.**

Neni 160, pika 1, gërma “ç” e ligjit nr.96/2016 i jep një tjetër kompetencë tranzitore KLD-së që ka të bëjë pezullimin e gjyqtarëve. Në nenet 151-157 të ligjit nr.96/2016 parashikohen dy lloj pezullimesh: (a) pezullimi i detyrueshëm dhe, (b) pezullimi mbi bazë diskrecioni. Pezullimi i detyrueshëm jepet në rastet kur ndaj gjyqtarit caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale, ose kur gjyqtari merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje (neni 151 i ligjit nr. 96/2016). Kjo procedurë fillon me njoftimin nga kryetarët e gjykatave drejtuar KLGJ-së<sup>237</sup> dhe në fazën tranzitore i drejtohet KLD-së.

Pezullimi mbi bazë diskrecioni rregullohet në nenin 152 të ligjit nr. 96/2016. Në këtë dispozitë parashikohet që “*Nëse Këshilli krijon bindjen se qëndrimi në detyrë i magjistratit të akuzuar*

<sup>233</sup> Po aty, Fq. 58

<sup>234</sup> Po aty, Fq. 104

<sup>235</sup> Procesverbali i datës 24.03.2017

<sup>236</sup> Procesverbali datës 17.07.2017, Fq. 7.

<sup>237</sup> Neni 151(3) Kryetarët e gjykatave dhe të prokurorive, të cilët marrin vendimet përkatëse, detyrohen të njoftojnë Këshillin për faktet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këshilli, menjëherë pasi merr informacionet nga prokuroria ose gjykata, vendos pezullimin për shkak të ligjit të magjistratit

*paragjykon hetimin penal ose disiplinor, pengon përfundimin në mënyrë të drejtë ose të rregullt të hetimit penal ose disiplinor apo diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit, mund të pezullojë magjistratin nga detyra nëse: a) ndaj magjistratit ka nisur një hetim penal; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer nga pakujdesia; c) kanë filluar hetimet ose procedimet disiplinore për shkelje disiplinore*". Pezullimi mbi bazë diskrecioni mund të fillojë edhe kur Këshilli krijon bindjen, bazuar në provat e mjaftueshme, sipas parashikimeve të nenit 67 dhe 151/2 të ligjit nr.96/2016 që magjistrati nuk mund të qëndrojë përkohësisht në detyrë për shkaqe që lidhen me shëndetin fizik ose mendor.

Gjatë fazës tranzitore, KLD ka marrë 2 vendime pezullimi në vitin 2107 dhe 4 vendime pezullimi në vitin 2018. Me vendimin nr.12/2017, KLD ka vendosur pezullimin e gjyqtares për shkak se është në procedim penal për korrupsion pasiv, në bazë të nenit 151 të ligjit nr. 96/2016. Me vendimin nr. 26/2017, KLD ka vendosur revokimin e pezullimit. Ky revokim është vendosur nga KLD në bazë të vendimit përfundimtar të gjykatës mbi pafajësinë e gjyqtarit të pezulluar. Me vendimin nr. 57/2017, KLD ka vendosur pezullimin e gjyqtarit për shkak të vendosjes së masës së sigurimit "arrest në burg". Me vendimet nr. 22, 23 dhe 24 të vitit 2018, KLD ka vendosur pezullimin e gjyqtarit për marrje si i pandehur për korrupsion pasiv (nenit 151 i ligjit nr.96/2016).

***Edhe çështja e pezullimeve është shoqëruar në raste të caktuara me debate midis anëtarëve të KLD-së, sa i takon interpretimit dhe rrjedhimisht zbatueshmërisë ose jo të dispozitave të ligjit nr.96/2016, duke pasur parasysh faktet e çështjes konkrete.*** Kështu, në mbledhjen e KLD-së të datës 7.02.2017 u diskutua "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" ndaj gjyqtares së Rrethit Gjyqësor Elbasan P.H, e cila është marrë në cilësinë e të pandehurit. Sipas disa anëtarëve, ajo çfarë e ndërlikon situatën në rastin konkret është se ndaj gjyqtares është dhënë tashmë një masë ndaluese me vendim gjyqësor përkatësisht ndalimi i ushtrimit të funksionit të saj si gjyqtare, në kuadër të hetimit penal. Anëtarët referuan se e dublojnë gjykatën me dhënien e një mase pezulluese mbi masë ndaluese. Në këtë debat pati edhe argumente të tjera, sipas të cilave KLD si organ kalimtar ka kompetencën për të zbatuar ligjin nr.96/2016 për pezullimin e gjyqtarëve si dhe nenin 140, pika 3 të Kushtetutës. Ky vendim nuk merret automatikisht por nëse Këshilli krijon bindjen se qëndrimi në detyrë i magjistratit të marrë si i pandehur, paragjykon hetimin penal, pengon përfundimin në mënyrë të drejtë ose të rregullt të hetimit apo diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit.<sup>238</sup>

### **3.5. Vlerësimi i punës së gjyqtarëve dhe ofrimi i ndihmës në rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve**

Sipas nenit 160, pika 1, gërma "dh" të ligjit nr.96/2016, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoratet ekzistuese do të kryejnë vlerësimin etik dhe profesional të punës së gjyqtarëve, siç parashikohet në nenin 171 të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve, në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Ky vlerësim do të bëhet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoratet ekzistuese deri në ngritjen përfundimtare të KLGJ-së.

Me dispozitat e ligjit të ri nr. 96/2016, nuk lejohet më zhvillimi i procesit të vlerësimit të përsheptuar të gjyqtarëve, i cili para hyrjes në fuqi të ligjit kishte për subjekt gjyqtarët të cilët kandidonin për promovim dhe ishin emëruar në detyrë pas vitit 2009. Neni 171, paragrafët 2 deri në 10 të ligjit nr. 96/2016 përcaktojnë edhe procedurat që duhen ndjekur për plotësimin e detyrimit të KLD-së për të ndihmuar në zhvillimin e procesit të Vetting-ut. ***Në mbledhjet e KLD-së është përcjellë nga Inspektorati i këtij Këshilli shqetësimi për zbatimin e detyrimeve ligjore tranzitore që ka ky Inspektorat për të ndihmuar në procesin e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarëve në kuadër të vettingut. Sipas Inspektoratit, legjislacioni në këtë drejtim nuk është i plotë dhe ka nevojë për udhëzime të detajuara nga organet e vettingut.*** Kështu në mbledhjen e dt. 15.09.2017, Inspektorati i KLD-së ka përgatitur një informacion të detajuar lidhur me këtë çështje. Inspektorati referon se ka konstatuar disa problematika për të cilat nevojiten udhëzime të detajuara nga KPK dhe këto

<sup>238</sup> <http://kld.al/vendime/procesverbal-dat%C3%AB-7-02-2017>

problematika lidhen kryesisht me saktësimin e disa subjekteve të rivlerësimit, me periudhën e saktë të rivlerësimit profesional si dhe për sa i takon procedurave të detajuara të vlerësimit profesional. Inspektorati referon se në total janë 466 subjekte të rivlerësimit kalimtar për periudhën 21 tetor 2016 deri 31 mars 2017. Inspektorati ngre si problematikë që me numrin aktual të inspektorëve ka vështirësi për t'ju përgjigjur përmbushjes së kompetencave të tij si organ ndihmës, një volumi të lartë subjektësh, pra 466 të tillë. Ndërkohë ligji nr.96/2016 nuk mundëson që të plotësohen vendet vakante që ka Inspektorati. Nga ana tjetër, ligji i vettingut nr.84/2016 vendos si afat kohor, afatin 90 ditë, duke shtuar këtu edhe situatën që detyrat e Inspektorëve në këtë proces ndihmës nuk do të zhvillohet vetëm në zyrë por nevojitet që ata të shkojnë nëpër gjykatat respektive për të grumbulluar informacionin.

**Në mbledhjen e datës 16.10.2017** u diskutua informacioni nga grupi i punës së KLD<sup>239</sup>, mbi veprimtarinë e kryer nga data e mbledhjes së fundit, 02.10.2017, në bazë të detyrimeve ligjore tranzitore që lindin për ndihmën në rivlerësimin kalimtar të aftësive profesionale të gjyqtarëve. Grupi i punës ka zhvilluar mbledhje mbi baza ditore, por edhe mbledhje me të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në procesin e rivlerësimit profesional të gjyqtarëve. Si produkt, grupi i punës ka hartuar aktet që janë paraqitur për miratim formal ditën e mbledhjes, përkatësisht,

- a) forma standarde e Raportit për analizimin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit që hartohet nga Inspektorati i KLD-së,
- b) rregullat për përzgjedhjen me short të 5 dosjeve për analizimin e aftësive profesionale nga Inspektorati i KLD-së në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit,
- c) kalendari për organizimin e shorteve dhe veprimeve për përfundimin nga Inspektorati të raporteve për analizimin e aftësive profesionale të 35 subjekteve me përparësi në procesin e vettingut<sup>240</sup>.

Në mbledhjen e KLD-së të dt.24 Janar 2018, Krye inspektorja, Znj. Xhaferllari i përgjigjet kërkesës së Ministres së Drejtësisë, Znj. Gjonaj për informacionin statistikor të detajuar, të kërkuar nga Inspektorati për ecurinë e procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve. Në këtë raportim, Kryeinspektorja referon se duke qenë se kërkesa e Ministres së Drejtësisë është paraqitur në datën 15.01.2018, të dhënat e referuara duhen marrë pak me rezervë sepse janë në fazën e parë të përgatitjes. Konkretisht rezulton se:

- a) Për vitet 2005-2006 janë vlerësuar 248 gjyqtarë.
- b) Për vitet 2007-2009 janë vlerësuar 295 gjyqtarë.
- c) Për raundin e tretë 2010-2012 janë miratuar 17 akte vlerësimi, nga të cilët 16 janë gjyqtarë.
- d) Aktualisht, në sistemin gjyqësor ushtrojnë detyrën 362 gjyqtarë, nga të cilët, 4 gjyqtarë janë me 3 vlerësime, 248 gjyqtarë janë me 2 vlerësime, 48 gjyqtarë janë me 1 vlerësim, 62 gjyqtarë janë pa asnjë vlerësim.

Kryeinspektorja referon se ecuria e vlerësimit për vitet 2010-2012 është në proces. Inspektorati, bazuar në vendimin e KLD-së, ka vënë në përparësinë e veprimtarisë së tij përgatitjen e raporteve për rivlerësimin kalimtar. Lidhur me këtë raportim, **Ministria e Drejtësisë ngre shqetësimin për faktin që ka ende gjyqtarë të cilët nuk kanë asnjë vlerësim nga Inspektorati, ndërkohë që Kryeinspektorja referon se një pjesë e këtyre gjyqtarëve janë emëruar pas vitit 2012 dhe do të mbeten pa vlerësim nga kjo KLD pasi ajo ka kompetencë të vlerësojë punën e tyre deri në vitin 2012.** Në këtë diskutim, një prej anëtarëve të KLD-së referon se institucioni i ka dhënë prioritet punës së Inspektoratit në kuadër të procesit të vettingut, me qëllim që raportet përkatëse ti kalojnë KPK-së. Ndërkohë duhet pasur në konsideratë se gjysma e organikës së Inspektoratit po përballlet me vakanca dhe inspektorët që janë aktualisht po përgjigjen gjithashtu edhe për verifikimin e ankesave.

Nga komunikimi që KShH ka pasur me organet ndihmëse në kuadër të procesit të vettingut ka rezultuar se Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) dhe Prokuroria e Përgjithshme referojnë se nuk disponojnë konkluzione lidhur me aftësitë profesionale në raportet e hollësishme dhe

<sup>239</sup> Ngritur nga KLD me vendimin nr.43, datë 22.09.2017

<sup>240</sup> Procesverbal I datës 16.10.2017

të arsyetuara që u vendosin në dispozicion komisioneve të vettingut për subjektet që ato kanë në kompetencë. Rrjedhimisht, KShH ka evidentuar se mënyra se si kanë vepruar organet ndihmëse në raport me KPK-në pranë të cilit janë administruar këto raporte, nuk rezulton të jetë e unifikuar. Ndërkohë, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive kanë disponuar në raportet e tyre për secilin nga subjektet e kontrolluara, konkluzione ose vlerësime paraprake lidhur me dy komponentët për të cilat ato ndihmojnë<sup>241</sup>.

### **3.6. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve për plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata dhe caktimi i përkohshëm i gjyqtarëve në institucionet e drejtësisë**

Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve për plotësimin e trupave gjyqësorë në gjykata dhe caktimi i tyre në pozicione të përkohshme për të mundësuar ushtrimin e detyrave dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë është një tjetër kompetencë tranzitore e KLD-së, referuar nenit 160, pika 1, gërma “f” dhe 160, pika 4 të ligjit nr.96/2016. Ndërkohë, transferimi i gjyqtarit është rregulluar nga neni 42 të ligjit nr.96/2016<sup>242</sup> dhe është kompetencë ekskluzive e KLGJ-së, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 160, pika 1, gërma “f” dhe pikës 4 të po këtij ligji, ku janë parashikuar shprehimisht rastet kur KLD mund ta ushtrojë këtë kompetencë në mënyrë tranzitore. Në nenin 44, pika 1 të ligjit nr.96/2016 janë parashikuar rastet e transferimit pa pëlqim të magjistratit dhe konkretisht këto raste janë:

- a) në zbatim të masës disiplinore;
- b) kur pozicioni i magjistratit suprimohet për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive, pas kryerjes së një vlerësimi, bazuar në kritere objektive dhe transparente;
- c) për shkak të krijimit të marrëdhënieve familjare që çojnë në papajtueshmëri ambientale, sipas nenit 8 të këtij ligji (**kjo gërmë është shfuqizuar me vendimin nr.34/2017 të Gjykatës Kushtetuese**);
- ç) për shkak të mungesave të përkohshme të magjistratëve në gjykata dhe prokurori, të cilat nuk mund të plotësohen nga magjistratët që janë në skemën e delegimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 46 të këtij ligji.

Në nenin 46, pika 6 të ligjit nr.96/2016 parashikohet edhe afati maksimal i transferimit në mënyrë të përkohshme të magjistratit, për një periudhë të caktuar, por në çdo rast nuk duhet të zgjasë më shumë se një vit.

Në mbledhjet e KLD-së të realizuara pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.96/2016 ka pasur diskutime për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të këtyre dy kompetenca tranzitore të KLD-së (transferimi i përkohshëm në gjykata dhe caktimi i përkohshëm në institucionet e drejtësisë), në mungesë të akteve nënligjore të ligjit, pasi KLGJ nuk është ngritur ende dhe se çfarë efekti ligjor do të kenë aktet nënligjore të mëparshme të KLD-së. Konkretisht, në Planin e Veprimit të KLD-së, gjer në ngritjen e KLGJ-së, referohet se vendimi i KLD-së nr. 319, 03/05/2013, i cili rregullon delegimin e gjyqtarëve për shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore është nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri” dhe ndërkohë të dy këto ligje janë shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjeve të reja të reformës në sistemin e drejtësisë nr. 96 dhe 98 të vitit 2016. Meqenëse sipas ligjit nr. 96/2016 nuk ekziston më “delegimi”, por “transferimi”, mund të argumentohet mbi fuqinë ose jo të

<sup>241</sup> <http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2018/11/RAPORT-studimor-Monitorimi-i-procesit-te-vettingut-te-gjyqtareve-dhe-prokuroreve-Jan17-Qer18.pdf>

<sup>242</sup> Sipas nenit 42, pika 1 të ligjit nr.96/2016 “Transferimi” është:

- a) lëvizja në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga një pozicion në një gjykatë ose prokurori në një pozicion në një gjykatë ose prokurori tjetër të të njëjtit nivel;
- b) caktimi nga një pozicion i komanduar në një pozicion në gjykatë ose në prokurori, i cili është në të njëjtin nivel me pozicionin e mëparshëm;
- c) caktimi nga një pozicion i komanduar në një pozicion në gjykatë ose në prokurori të shkallës së parë, nëse magjistrati nuk ka pasur pozicione të mëparshme.

vendimit në fjalë, meqenëse në tërësinë e tij nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 96/2016, sipas nenit 174/6 të tij.<sup>243</sup> Kjo çështje është diskutuar edhe në mbledhjen e KLD-së të dt.20 Janar 2017, ku Kryeinspektorja e KLD-së referon se vendimi i KLD-së (sipërcituar) mund të jetë i zbatueshëm në rastet e transferimeve të përkohshme për plotësimin e trupave gjyqësore dhe se për këtë është marrë edhe mendimi i Misionit EURALIUS. Kryeinspektorja referon nenin 174 të ligjit nr.96/2016, sipas të cilit aktet nënligjore që datojnë para hyrjes në fuqi të ligjit nr.96/2016 zbatohen nëse nuk bien ndesh me rregullat e këtij ligji<sup>244</sup>.

**Transferimet e përkohshme për plotësim të trupave gjyqësore në çështje gjyqësore të caktuara janë referuar nga KLD me termin delegime, sipas aktit nënligjor të sipërcituar të KLD-së të vitit 2013. Pothuajse në shumicën e mbledhjeve të realizuara nga KLD ka pasur një numër të konsiderueshëm delegimesh të gjyqtarëve nga një gjykatë në gjykatën tjetër. Për një numër relativisht të lartë çështjesh gjyqësore, delegimet shkojnë në disa raste edhe mbi 100. Në vijim po përmendim vetëm disa prej tyre. Në mbledhjen e dt.20.01.2017, KLD përzgjedhi gjyqtarët që do të transferohen përkohësisht për plotësimin e trupave gjyqësore, për rreth 114 çështje<sup>245</sup>. Përzgjedhja u realizua me anë të procedurës së shortit të gjyqtarëve nga gjykata të ndryshme (të kategorizuara sipas niveleve dhe kompetencës lëndore në varësi të objektit të çështjes). Tre anëtarë të KLD-së asistuan për realizimin e shortit ndërkohë që nisur nga numri i lartë i çështjeve, vërehen vakancat dhe mangësitë e konsiderueshme të gjykatave në trupat gjyqësorë, çka evidenton një volum çështjesh që nuk i përgjigjet numrit të tyre. Në mbledhjen e dt. 10 Shkurt 2017, KLD realizon me procedurën e shortit, përzgjedhjen përkohësisht për transferimin e gjyqtarëve për plotësimin e trupave gjyqësore për 15 çështje.<sup>246</sup> Në mbledhjen e dt.24.03.2017, KLD realizon me procedurën e shortit, përzgjedhjen përkohësisht për transferimin e gjyqtarëve për plotësimin e trupave gjyqësore për 43 çështje<sup>247</sup>. Në mbledhjen e dt.17.11.2017, KLD realizon me procedurën e shortit, përzgjedhjen përkohësisht për transferimin e gjyqtarëve për plotësimin e trupave gjyqësore për 78 çështje<sup>248</sup>. Në mbledhjen e datës 12.06.2018<sup>249</sup>, KLD realizon me procedurën e shortit, përzgjedhjen përkohësisht për transferimin e gjyqtarëve për plotësimin e trupave gjyqësore për 76 çështje. **Vendimet e KLD-së për delegimin (transferimin) e gjyqtarëve përmbajnë bazën ligjore dhe japin të dhënat për gjyqtarët që transferohen, gjykatën dhe çështjen përkatëse për të cilën bëhet transferimi i përkohshëm gjyqtarëve (delegimi).****

Në mbledhjen e KLD-së të dt.18 Janar 2018, Ministrja e Drejtësisë referon shqetësimin e adresuar nga disa kryetarë gjykatash, për funksionimin e këtyre gjykatave nën numrin e gjyqtarëve të përcaktuar në organikën e gjykatave. Konkretisht, numri i gjyqtarëve sipas organikës së Gjykatës Kavajë është 4 (katër) gjyqtarë, ndërsa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje është 5 (pesë) gjyqtarë. Numri faktik që ushtrojnë detyrën pranë këtyre gjykatave janë: në Gjykatën Kavajë janë 2 (dy) gjyqtarë, ndërsa Gjykata e Lushnjës 3 (tre) gjyqtarë. Sipas Ministres, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, pavarësisht mungesës së gjyqtarëve, KLD-ja ka vendosur komandimin e një gjyqtari si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 33/2017. Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, sipas organikës duhet të kishte 4 (katër) gjyqtarë, por numri i gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën është 2 (dy) aktualisht. Mungesat në këtë gjykatë vijnë për arsye të daljes në pension të dy gjyqtarëve. Ministrja e Drejtësisë i rekomandon KLD-së të ushtrojë kompetencën për të realizuar transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve nga gjykata me ngarkesa më të ulët, në zbatim dhe në referim të parashikimeve të ligjit nr. 96/2016, pikërisht neni 160, pika 1, gërma “f”, duke kryer transferimin e përkohshëm për një periudhë kohore. Gjithashtu i propozohet Inspektoratit të realizojë një pasqyrim statistikor mbi numrin e gjyqtarëve faktik në çdo gjykatë, e shoqëruar kjo edhe me ngarkesën e

<sup>243</sup> “Mbi Planin e Veprimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë gjer në ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Fq/ 22. pika e).

<sup>244</sup> Fq.47 e procesverbalit, i aksesueshëm ne: <http://www.kld.al/vendime/procesverbal-datë-20-01-2017-1-1-1>

<sup>245</sup> Po aty, fq.51 - 63

<sup>246</sup> <http://www.kld.al/vendime/procesverbal-datë-10-02-2017>

<sup>247</sup> <http://www.kld.al/vendime/procesverbal-datë-24-03-2017>

<sup>248</sup> <http://www.kld.al/vendime/procesverbal-datë-17-11-2017>

<sup>249</sup> <http://www.kld.al/vendime/procesverbal-datë-12-06-2018>



çështjeve të regjistruara për gjykim pranë këtyre gjykatave si dhe ngarkesën mesatare të gjyqtarëve sipas gjykatave me ngarkesë të ulët, duke evidentuar një mesatare të numrit të gjyqtarëve që mund të transferohen. Bazuar në gjetjet e këtyre pasqyrimeve statistikore, Ministria propozon që të vijohet me ndjekjen e procedurave ligjore për të kryer transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve. Ky shqetësim gjeti mbështetjen e anëtarëve të tjerë të KLD-së dhe u ngarkua Inspektorati të hartojë raportin me të dhënat statistikore të kërkuara.

Në mbledhjen e dt.7 Maj 2018, Kryeinspektorja e KLD-së raporton se, bazuar në kërkesën e Ministres së Drejtësisë të dt.18 Janar 2018 dhe vendimit të KLD-së është ngritur grupi i punës, në përbërje nga Inspektorati, në bashkëpunim me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, i cili ka hartuar raportin me shkrim<sup>250</sup>. Në këtë raport është analizuar situata aktuale, janë marrë të dhëna statistikore në të gjitha gjykatat e shkallës së parë, është analizuar kuadri ligjor i zbatueshëm, i cili lejon transferimin e përkohshëm të gjyqtarit. Në përfundim të këtij raporti, grupi i punës ka dalë me disa konkluzione për gjykatat që kanë nevojë për transferime të përkohshme, numrin minimal të nevojshëm të gjyqtarëve që duhet të transferohen, periudhën minimale të transferimit, gjykatat me afërsi gjeografike me gjykatat ku do të bëhet transferimi të cilat nuk kanë ngarkesë të latë dhe gjyqtarët që kanë dhënë pëlqimin për tu transferuar nga këto gjykata. Gjatë diskutimeve në këtë mbledhje, anëtarët e tjerë referojnë si problematike edhe ngarkesën në disa gjykata administrative, përfshi edhe Gjykatën e Apelit Administrativ, të cilat duhet të përfshihen në raportin e grupit të punës. Një shqetësim tjetër që u ngrit në këtë mbledhje ishte ai i nevojës për të respektuar kërkesat që rrjedhin nga neni 46 i ligjit nr.96/2016 që rregullon transferimin e përkohshëm. Sipas njërit prej anëtarëve, Z. Gerd Hoxha, KLD duhet të zbatojë procedurën dhe të shpallë thirrjen publike për gjyqtarët që kanë interes për tu transferuar në këto gjykata dhe më pas kërkohet pëlqimi i kryetarëve të gjykatave pranë të cilave ata ushtrojnë detyrën. Kriteri i afërsisë gjeografike që është marrë për bazë në raportin e grupit të punës nuk është më një kriter referues në ligjin e ri nr.96/2016. Nëse gjyqtarët nuk japin pëlqimin, atëherë do të kalohet në dispozitën e ligjit nr.96/2016 që parashikon transferimin pa pëlqim. **Në këtë mënyrë se si është menduar realizimi i transferimeve nga grupi i punës, në vlerësimin e këtij anëtari lë vend për “qoka”.** Në përfundim, kryetari i KLD-së mbështet propozimin e bërë që mundëson realizimin e një procedure më transparente dhe i kërkon grupit të punës rishikimin e raportit.

Në mbledhjen e dt.13.06.2018, KLD mori në shqyrtim të plotë raportin nr. 1049 Prot, datë 29.03.2018 “Mbi organikat e paplotësuara të gjykatave dhe mundësitë e transferimit të përkohshëm”, si dhe Raportin shtesë nr. 1895, bazuar në vendimin e KLD-së nr.32, datë 07.05.2018.<sup>251</sup> Në këtë mbledhje ka pasur qëndrime dhe mendime të kundërta midis Ministres së Drejtësisë dhe disa prej anëtarëve të KLD-së. Sipas Ministres së Drejtësisë, inicimi i procedurës së transferimeve të përkohshme është bërë me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë dhe ndërkohë referuar raportit të ardhur nga grupi i punës, vërehet se është zgjeruar rrethi i gjykatave ku kërkohet transferim, përtej atyre të kërkuara prej saj, të cilat janë Gjykatat e Rretheve Gjyqësore të Kavajës, Kukësit dhe Lushnjës. Transferimi i përkohshëm në gjykatat administrative të shkallës së parë nuk është kërkuar ndërkohë që transferimi i përkohshëm në Gjykatën Administrative e Apelit përbën shkelje ligjore. Anëtarët e KLD-së kanë referuar se në mbledhjen e kaluar (të dt.7 Maj 2018) kur është marrë vendimi për të shpallur vakancat në gjykatat ku do të bëhet transferimi, Ministria ka munguar por kjo nuk e bën vendimmarrjen e KLD-së të pavlefshme. Gjithashtu, anëtarët referuan se për gjykatat për të cilat është bërë shpallja për transferim të përkohshëm po përballen me një volum dosjesh të jashtëzakonshëm, ku në disa raste stoku i dosjeve ka arritur 4-5 vjet. Kjo vendimmarrje e KLD-së synon lehtësimin e veprimtarisë së këtyre gjykatave dhe se nuk kemi të bëjmë me emërimet<sup>252</sup>. Dy prej anëtarëve të KLD-së mbështetën argumentin se nuk mund të kryhet transferim në Gjykatën e Apelit Administrativ, pasi nuk ka mungesa në organikën e gjyqtarëve (neni 42 i ligjit nr.96/2016). Në përfundim, anëtarët votuan për transferimin e përkohshëm dhe me shumicë votash nuk u votua për transferimin e përkohshëm në Gjykatën Administrative të Apelit, për argumentin e paraqitur më sipër.

<sup>250</sup> <http://www.kld.al/vendime/procesverbal-datë-07-05-2018>

<sup>251</sup> <http://www.kld.al/vendime/procesverbal-datë-13-06-2018>

<sup>252</sup> Po aty, shih fq.6 te procesverbalit



**KAPITULLI III****MONITORIMI I KOMPETENCAVE  
TRANZITORE TË PROKURORISË SË  
PËRGJITHSHME**

## 1. Prokuroria para Reformës në Drejtësi

Në Kushtetutën e vitit 1998, parashikohet “*se prokurorët janë organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar*”. Sipas nenit 3 të ligjit organik nr.8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Prokuroria organizohet dhe funksionon nën drejtimin e Prokurorit të Përgjithshëm si **strukturë e centralizuar**, ku përfshihen zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Këshilli i Prokurorisë dhe prokuroritë pranë sistemit gjyqësor.

**Parimi i hierarkisë institucionale** nënkuptonte varësinë e prokurorisë më të ulët nga prokuroria më e lartë. Sipas këtij parimi, në krye të prokurorisë është Prokurori i Përgjithshëm, i cili koordinon punën brenda prokurorisë dhe prokurori i hallkës më të lartë ndikonte në punën e prokurorisë më të ulët. Prokurori më i lartë mund të delegonte tek prokurori më i ulët ushtrimin e funksionit të ndjekjes penale, si edhe të vendoste vetë, pavarësisht mendimit të prokurorit të çështjes. Gjithashtu, prokurori i përgjithshëm, mbi bazën e ankimit të të pandehurit ose edhe *ex officio* urdhëron me vendim të arsyetuar marrjen përsipër të hetimeve, në qoftë se prokurori i rrethit nuk ushtron ndjekjen penale ose nuk e pushon atë në afatin e caktuar. Hierarkia e prokurorëve u sanksionua edhe më tej me ndryshimet e ligjit për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në 2008.<sup>253</sup>

Ligji organik i prokurorisë 2001 rregullonte edhe karrierën profesionale të prokurorëve, emërimin, ngritjen në detyrë, transferimin, si edhe procedimin disiplinor. Në të gjithë këto procedura Prokurori i Përgjithshëm kishte një rol kryesor dhe të rëndësishëm, i asistuar edhe nga Këshilli i Prokurorisë. Konkretisht, Prokurori i Përgjithshëm ndër të tjerash:

- i propozon Presidentit të Republikës numrin e përgjithshëm të prokurorëve, pasi të ketë marrë mendimin e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe përcakton numrin e prokurorëve, për çdo prokurori, përfshirë edhe Prokurorinë e Përgjithshme;
- i propozon Presidentit të Republikës emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë, largimin nga detyra dhe shkarkimin e prokurorëve;
- cakton drejtuesit e prokurorive dhe zëvendësit e tyre në prokuroritë pranë gjykatave, sipas kriterëve dhe procedurave, të përcaktuara në këtë ligj;
- urdhëron komandimin e prokurorëve, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj;
- kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë;
- urdhëron kryerjen e inspektimeve, fillon procedimin disiplinor dhe vendos për marrjen e masave disiplinore, si dhe urdhëron fillimin e procedimit penal kundër prokurorëve;
- mbikëqyr drejtpërdrejt shërbimin e inspektimit të prokurorisë dhe miraton planin vjetor të inspektimeve të përgjithshme në prokurori;

Në ndihmë të Prokurorit të Përgjithshëm, vepronte edhe Këshilli i Prokurorisë, i cili përbëhet nga shtatë anëtarë, nga të cilët gjashtë prokurorë dhe një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë. Në mbledhjen e këshillit mund të marrë pjesë edhe një përfaqësues i Presidentit të Republikës. Këshilli i prokurorisë kryen funksione këshillimore si organizimi i konkursit për emërimin e kandidatëve për prokuror, jepte mendim Prokurorit të Përgjithshëm për emërimin e prokurorëve në detyrë, shkarkimin e tyre, si dhe çdo nismë tjetër me natyrë disiplinore. Këshilli i Prokurorisë shqyrtonte vlerësimin e punës së prokurorëve dhe i paraqet për miratim, Prokurorit të Përgjithshëm raportin e vlerësimit përfundimtar të aftësive profesionale të prokurorëve. Po kështu, Këshilli i Prokurorisë i jep mendim Prokurorit të Përgjithshëm për ngritjen në detyrë të prokurorëve, transferimin, si dhe kandidaturat e drejtuesve të prokurorive dhe zëvendësit e tyre, duke paraqitur mendimin e tij për kandidatët pas procedurës së konkurrimit të tyre. Në rastet kur Prokurori i Përgjithshëm nuk është dakord me mendimet e sugjeruara nga Këshilli, vendimmarrjen e tij ndryshe e paraqet në arsyetuar.

<sup>253</sup> Neni 3/b Ligj nr.10051, datë 29.12.2008

Organizimi i centralizuar dhe hierarkik i Prokurorisë së përgjithshme si edhe procesi i emërimeve, transferimeve dhe shkarkimeve ka qenë objekt kritikash si edhe shqyrtimesh gjyqësore. Grupi i ekspertëve teknik të të nivelit lartë si një trupë pranë Komisionit të Posaçëm të Reformës në drejtësi analizoi me nota shqetësuese procedurën e emërimit të Prokurorit të Përgjithshëm si edhe procedurën për emërimin dhe shkarkimin e personelit kyç në institucionin e prokurorisë.<sup>254</sup> Edhe sipas Komisionit të Venecias është e rëndësishme që Prokurori i Përgjithshëm të mos rizgjidhet, të paktën jo nga legjislativi apo ekzekutivi dhe që periudha kohore nuk duhet të korrespondojë me mandatin e parlamentit apo qeverisë. Kjo heq mundësinë e politizimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Problem tjetër i identifikuar ishte se ligji për prokurorinë nuk përcakton mënyrën e përzgjedhjes së prokurorëve ndërmjet kandidatëve të kualifikuar gjatë testimit. Para reformës në drejtësi nuk kishte një parashikim ligjor nëse renditja bëhet sipas renditjes në rezultatet e testimit apo jo, dhe as detyrimin e transparencës lidhur me metodën e përzgjedhjes së tyre.<sup>255</sup> Për më tepër, ligji *nuk parashikon asnjë detyrim a procedurë përparësie* në plotësimin e vendeve vakante me kandidatë që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, kundrejt atyre që vijnë nga radhët e profesionistëve të tjerë. Kjo ka sjellë si pasojë që jo rrallë herë, në praktikë, prokurorët që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës mbeten në pamundësi të ushtrimit të funksionit të tyre, ndonëse përfitojnë pagën e plotë të një prokurori, ndërkohë që vendet vakante plotësohen me oficerë të Policisë Gjyqësore. Kjo praktikë nuk mbështet rritjen profesionale të prokurorisë dhe standardin për prokurorë me përgatitje të lartë profesionale.<sup>256</sup> Një tjetër mangësi ligjore në ligjin për prokurorinë ishte mungesa e kritereve mbi të cilat bazohet prokurori i Përgjithshëm në vendimmarrjen e tij për ngritje në detyrë të kandidatëve. Mendimi i Këshillit të Prokurorisë dhe renditja në vlerësim nuk përbënin kritere detyruese - dhe as detyrimin e marrjes së një vendimi të arsyetuar lidhur me përzgjedhjen e tyre. Mungonte një procedurë vlerësimi e standardizuar, e lidhur me kritere specifike për matjen e aftësive, kompetencës dhe integritetit.”<sup>257</sup> Duke qenë pra se roli i Këshillit të Prokurorisë nuk është i detyrueshëm në vendimmarrje, emërimet, transferimit, ngritjet në detyrë mbeteshin në ekskluzivitetin e Prokurorit të Përgjithshëm. Mungesa e kritereve të qarta dhe objektive mund të linte shteg për abuzime.

## 2. Prokuroria pas Reformës në Drejtësi

Me miratimin e ndryshimeve kushtetuese dhe paketës ligjore të ligjeve të reja organike të sistemit të ri të drejtësisë në vitin 2016, mënyra e organizimit dhe funksionimit të organit të prokurorisë ka pësuar ndryshime të ndjeshme. Janë prokurorët e çështjes që kanë funksionin e ndjekjes penale dhe kjo e fundit është e lidhur me llojin e veprës penale të kryer. Veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, sipas nenit 148/4 do të hetohen nga Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi i dytë të Kushtetutës. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm.

Ligji nr. 96/2016 i ka lënë Prokurorit të Përgjithshëm hapësirën për të ushtruar disa kompetenca në mënyrë tranzitore, deri në krijimin e KLP. Konkretisht, në bazë të nenit 160 pika 2, 4 dhe 5 si edhe nenit 172 të të këtij ligji, Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto dispozita tranzitore:

- emëron magjistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016, në përputhje me pjesën III, kreu II, të këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji
- merr vendim për caktimin në pozicione të kandidatëve magjistratë të diplomuar në vitin 2016, sipas pjesës III, kreu III, të këtij ligji, brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të tij.
- pezullon prokurorët, sipas procedurës dhe kritereve të parashikuara në ligj.

<sup>254</sup> Fq.14

<sup>255</sup> Faqe 131

<sup>256</sup> Ibid.

<sup>257</sup> Faqe 131

kryen vlerësimin e punës, siç parashikohet në dispozitën kalimtare të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të prokurorëve.

- vërteton mbarimin e emërimit në rast dorëheqjeje dhe arritjes së moshës së pensionit.
- vendos caktimin në pozicione të përkohshme të magistratëve për të mundësuar ushtrimin e detyrave dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë.
- Deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, heton shkeljet disiplinore nëpërmjet inspektorëve Prokurorit të Përgjithshëm.

Hetimet disiplinore të papërfunduara në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.96/2016 nga inspektorët në Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme përfundohen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas dispozitave në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedimet disiplinore të papërfunduara në Prokurorinë e Përgjithshme në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.96/2016 kryhen brenda afatit 6-mujor pas hyrjes në fuqi të tij. Organet përgjegjëse, sipas nenit 160, të këtij ligji, zbatojnë rregullat procedurale të parashikuara në këtë ligj. Organet kompetente për procedimin disiplinor zbatojnë parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm për magistratin që ka kryer shkeljen disiplinore.

### 3. Vendimet e Prokurorit të Përgjithshëm gjatë periudhës tranzitore

KShH ju drejtua Prokurorisë së Përgjithshme në dt.11 Mars 2019 me kërkesë për informacion, për vënien në dispozicion të disa urdhrave dhe vendimeve që i përkasin vitit 2018, për transferimin e prokurorëve dhe caktimin përkohësisht të tyre si drejtues prokurorie si dhe për masat e marra ndaj prokurorëve që refuzuan të bëhen pjesë e shortit të dosjes “Shullazi”. Në kthimin e përgjigjes, Prokuroria ka vendosur në dispozicion urdhrat dhe vendimet e kërkuara, përfshi këtu edhe vendimet për pezullimin e dy prokurorëve.

M.gj.th, pavarësisht nga kërkesa e KShH-së, Institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme nuk vendosi në dispozicion procesverbalet dhe opinionet këshillimore të dhëna nga Këshilli i Prokurorisë, nuk përcaktoi nëse përveç urdhrave apo vendimeve të kërkuara në mënyrë specifike ishin marrë ose jo vendime/urdhra të tjera në ushtrim të kompetencave tranzitore si dhe nuk vendosi në dispozicion informacionin e kërkuar për kundërshtimin në rrugë gjyqësore nga ana e prokurorëve, të urdhrave që lidhen me transferimin dhe procedimin disiplinor gjatë fazës tranzitore.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se nga Janari i vitit 2018, Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm (PP) ka kryer një sërë emërimesh dhe lëvizjesh në prokuroritë e të gjitha shkallëve, bazuar në nenin 160, pika 2/c të ligjit 96/2016.

Në ndryshim nga monitorimi i kompetencave tranzitore të KLD-së, ku vëzhguesit kanë pasur akses në procesverbalet e çdo mbledhje që ka qenë objekt i këtij raporti studimor, **në rastin e kompetencave tranzitore të PP, vëzhguesit e KShH-së kanë pasur akses vetëm në vendimet e këtij institucioni.** Në këto vendime referohet baza ligjore dhe pjesa e dispozitivit të vendimit që konkretizon vendimmarrjen përkatëse. KShH nuk ka mundur të njihet me pjesën arsyetuese të këtyre vendimeve, e cila mund të jetë e pasqyruar në pjesën tjetër të dokumentacionit të këtij institucioni, si p.sh. relacionet shpjeguese të vendimeve, procesverbalet dhe opinionet e Këshillit të Prokurorisë, i cili sipas legjislacionit të vjetër është organi konsultativ me të cilin Prokurori i Përgjithshëm konsultohet edhe për këtë vendimmarrje. Këto materiale nuk rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Rrjedhimisht, gjetjet dhe konkluzionet e KShH-së për këtë kapitull janë të pjesshme për shkak të dokumentacionit të kufizuar që ka qenë objekt i këtij studimi.

Duke mos pasur mundësi të njihemi me rrethanat konkrete që kanë kushtëzuar vendimmarrjen e Prokurorit të Përgjithshëm dhe arsyetimin e vendimit, kjo ka vështirësuar vlerësimin e bazueshmërinë në ligj të këtyre vendimeve. **Gjithashtu, bie në sy fakti se me përjashtim të dy vendimeve të pezullimit, vendimet e tjera që janë dhënë në ushtrim të kompetencave tranzitore gjatë vitit 2018**

**nuk janë të motivuara ose janë motivuar vetëm pjesërisht se në cilat kushte dhe rrethana janë marrë, se përse është vlerësuar nga kryeprokurori ushtrimi i kësaj vendimmarrje. Kështu, p.sh. në rastin e caktimit të përkohshëm të prokurorëve si drejtues të prokurorive, duke përfshirë këtu edhe ndryshimet e drejtimit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, në vendimmarrjet mungon informacioni nëse është bërë një vlerësim paraprak i performancës në punë të drejtuesve pararendës dhe drejtuesve që caktohen përkohësisht në këto pozicione, se përse lindi nevoja për të bërë këto ndryshime, çfarë rezultoi konkretisht nga vlerësimet dhe a është bazuar vendimmarrja e Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm mbi kritere merite, paanshmërinë dhe objektiviteti. I njëjti konstatim vlen edhe për kalimin përkohësisht të tre prokurorëve nga Prokuroria e Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore jashtë Tiranës. Mungesa e këtij informacioni e ka vështirësuar kryerjen e analizës së plotë të këtyre vendimeve sa i takon ligjshmërisë së tyre dhe më konkretisht respektimit të kritereve që parashikon legjislacioni në fuqi për secilën kompetencë tranzitore të ushtruar.**

Gjatë periudhës tranzitore, Prokurori i Përgjithshëm ka vendosur në dispozicionin e KShH-së 17 vendime/urdhra, të cilat kanë të bëjnë me:

- a) pezullimin nga detyra të dy prokurorëve (2 raste) për të cilët është ngritur akuzë penale lidhur me deklarin e pasurisë, deri në përfundim të hetimeve ose gjyqimit të procedimit penal të regjistruar ndaj tyre.
- b) ndërprerjen e komandimit dhe rikthimin e prokurorëve pranë prokurorive ku kanë qenë të emëruar më parë (3 raste).
- c) caktimin e përkohshëm të 8 prokurorëve si Drejtues të Prokurorive të Rretheve Gjyqësore (në disa rrethe) duke përfshirë këtu edhe Prokurorinë e Krimeve të Rënda.
- d) caktimin e përkohshëm të tre prokurorëve nga Prokuroria e Krimeve të Rënda në prokuroritë e rretheve gjyqësore.
- e) largimin në një rast nga funksioni si drejtues i Prokurorisë së Krimeve të Rënda i prokurorit Z. Besim Hajdarmataj.

Referuar njoftimit të bërë publik për median në faqen e tij zyrtare, në kuadër të riorganizimit, mirëfunksionimit të organit të akuzës, rritjes së performancës dhe besueshmërisë së publikut tek ky institucion, Prokurori i Përgjithshëm në dt. 09 Janar 2018 nxori 6 urdhrat e mëposhtëm<sup>258</sup>:

- (i) Urdhri nr. 13, për prokurorin Z. Dritan Gina, Drejtues i komanduar i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, të cilit i ndërpritet komandimi dhe kthehet si prokuror në Prokurorinë ku është i emëruar më parë.
- (ii) Urdhri nr. 14, për prokurorin Z. Ardian Nezha, Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë, i cili emërohet drejtues i përkohshëm i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- (iii) Urdhri nr. 15, për prokurorin Z. Pali Deçolli, drejtues i komanduar i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, të cilit i ndërpritet komandimi dhe kthehet si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës ku është i emëruar.
- (iv) Urdhri nr. 16, për caktimin e përkohshëm si Drejtues të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, të prokurorit, Z. Fatmir Lushi.
- (v) Urdhri nr. 12, për prokurorin Z. Artur Ismailukaj, drejtues i komanduar i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, të cilit i ndërpritet komandimi dhe kthehet si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tropojë, ku është i emëruar më parë.

<sup>258</sup> [http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/NJOFTIM\\_P\\_R\\_MEDIAN\\_1137\\_1.php](http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/NJOFTIM_P_R_MEDIAN_1137_1.php)

- (vi) Urdhri nr. 11, për caktimin e përkohshëm si Drejtuese të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, të prokurores Z. Alketa Nushi, e cila ishte e emëruar Prokurore pranë Rrethit Gjyqësor Mat.

Pas kësaj date, rezulton që PP i përkohshëm ka marrë edhe këto urdhra/ vendime si vijon:

- (vii) Urdhri nr.136, dt.09.05.2018 “Për largimin nga Funkzioni” si drejtues i Prokurorisë së Krimeve të Rënda i prokurorit Z. Besim Hajdarmataj. Ky vendim është i diskutueshëm sa i takon ligjshmërisë, pasi në këtë urdhër është referuar si bazë ligjore neni 160/4 i ligjit nr. 96/2016, i cili nuk parashikon si kompetencë tranzitore, largimin nga funksioni të drejtuesit të prokurorisë së krimeve të rënda. Neni 160, pika 4 e ligjit nr.96/2016 parashikon se Prokurori i Përgjithshëm mund të vendosë caktimin në pozicione të përkohshme të prokurorëve për të mundësuar ushtrimin e detyrave dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë. Kjo kompetencë nuk parashikohet gjithashtu as në dispozitat e Kushtetutës dhe të ligjit nr.97/2016 të referuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.
- (viii) Urdhri nr. 157, datë 06.06.2018, me anë të të cilit është vendosur caktimi si Drejtues përkohësisht i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Z. Ylli Pjetërnikaj. Urdhri mbështetet në nenin 160, pika 4 të ligjit nr.96/2016.
- (ix) Urdhri Nr. 158, datë 06.06.2018 për caktimin e përkohshëm të Z. Anton Martini nga Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda<sup>259</sup>.
- (x) Vendimi nr.140, dt.11.05.2018 për pezullimin nga detyra të Znj. Rovena Gashi, prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme. Ky vendim rezulton se është bazuar në nenet 148/d pika 4, gërma “b” dhe 179 pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 151, pika 1, gërma “b” dhe pika 2 gërma “b”, 155 dhe 160, pika 2, gërma “c”, të ligjit nr. 96/2016. Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të PP, pezullimi i Znj. Gashi u vendos pasi Kryeprokuroerja u njoh me informacionin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës, në lidhje me ngritjen e akuzës dhe marrjen në cilësinë e të pandehurit të prokuroresh Gashi për veprën penale: “Refuzimi për deklarimin, mos deklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, në formën e deklarimit të rremë, parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal. Prokurorja pezullohet deri në përfundim të hetimeve ose gjykimit të procedimit penal të regjistruar pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës.
- (xi) Vendimin nr.141, dt. 11-05-2018, për pezullimin e Z. Dritan Gina, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Ky vendim bazohet në nenet 148/d pika 4, gërma “b” dhe 179 pika 7 të Kushtetutës, nenet 151, pika 1, gërma “b” dhe pika 2 gërma “b”; 155 dhe 160, pika 2, gërma “c”, të ligjit nr. 96/2016. Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të PP, pezullimi i Z. Gina u vendos pasi Kryeprokuroerja u njoh me informacionin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës në lidhje me ngritjen e akuzës dhe marrjen në cilësinë e të pandehurit të prokurorit Gina për veprën penale: “Refuzimi për deklarimin, mos deklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, në formën e deklarimit të rremë, parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal. Prokurori pezullohet deri në përfundim të hetimeve ose gjykimit të procedimit penal të regjistruar pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës.<sup>260</sup>

<sup>259</sup>[http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/Caktohet\\_drejtuesi\\_i\\_perkohshem\\_i\\_Prokurorisë\\_se\\_Shkodres\\_1217\\_1.https://sh.time.mk/c/104cdc7cf8/transferimi-i-prokuroreve-dhe-sherri-tek-krimet-e-renda-kush-jane-dosjet-vip-qe-lihen-pas.htmlphp](http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/Caktohet_drejtuesi_i_perkohshem_i_Prokurorisë_se_Shkodres_1217_1.https://sh.time.mk/c/104cdc7cf8/transferimi-i-prokuroreve-dhe-sherri-tek-krimet-e-renda-kush-jane-dosjet-vip-qe-lihen-pas.htmlphp)

<sup>260</sup> [http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/Pezullim\\_nga\\_detyra\\_per\\_znj\\_Rovena\\_Gashi\\_dhe\\_z\\_Dritan\\_Gina\\_1197\\_1.php](http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/Pezullim_nga_detyra_per_znj_Rovena_Gashi_dhe_z_Dritan_Gina_1197_1.php)

- (xii) Urdhri nr.136, dt. 9 maj 2018 për largimin nga detyra të Drejtuesit të Prokurorisë për Krime të Rënda, Z. Besim Hajdarmataj, i cili mbetet prokuror në Prokurorinë për Krimet e Rënda. Më anë të këtij urdhri, Prokurorja e Përgjithshme caktoi përkohësisht Znj. Donika Prela në krye të Prokurorisë për Krime të Rënda. Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, ‘*Ky ndryshim ka për qëllim përshpejtimin e hetimeve të çështjeve sensitive që ka Prokuroria për Krime të Rënda. Kemi besim se ky ndryshim në drejtim do të sjellë si rezultat ndjekje penale më të shpejtë dhe më të efektshme të çështjeve me përparësi të lartë. Ndjekja penale e krimit dhe korrupsionit mbetet prioriteti më i lartë për Kryeprokuroren*’<sup>261</sup>. Megjithatë ky arsyetim i kësaj lëvizjeje nuk mundëson transparencë të plotë të kësaj vendimmarrje, pasi mungon një vlerësim mbi punën e prokurorit Hajdarmataj si drejtues i prokurorisë së krimeve të rënda, nëse janë konstatuar mangësi apo performancë e dobët dhe në ç’drejtim ka konsistuar ajo. Njëkohësisht, nuk jepet një vlerësim konkret për prokuroren Prela se përse ajo do të sjellë rezultate në drejtimin e kësaj prokurorie, cilat janë rezultatet që ka pasur në detyrat e mëparshme dhe performanca në punë e saj.
- (xiii) Urdhri nr. 197 datë 20.09.2018, për caktimin e përkohshëm të Z. Besim Hajdarmataj, nga prokuror pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
- (xiv) Urdhri nr. 198 datë 20.09.2018, për caktimin e përkohshëm të Z. Olsian Çela, nga prokuror pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat.
- (xv) Urdhri nr. 199 datë 20.09.2018, për caktimin e përkohshëm të Znj. Sonila Muhametaj, nga prokurore pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë.
- (xvi) Urdhri nr. 138, dt. 09.05.2018 për caktimin e përkohshëm të Znj. Anita Jella si Drejtuese në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>262</sup>.
- (xvii) Urdhri Nr. 104, datë 04.04.2018, për caktimin përkohësisht Drejtuese të prokurorisë së rrethit gjyqësor Elbasan, të prokurores Znj. Enkeleda Millonai. Urdhri mbështetet në nenin 160, pika 4 të ligjit nr.96/2016. Prokurorja Millonai caktohet në këtë detyrë pas dorëheqjes së drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan Z. Ardian Nezha<sup>263</sup>.

Kryesisht, për vendimet e mësipërme, Prokuroria e Përgjithshme përdori si bazë ligjore *nenet 148/d pika 4, gërma “b” dhe 179 pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 151, pika 1, gërma “b” dhe pika 2 gërma “b”; 155 dhe 160, pika 2, gërma “c”, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.*

#### 4. Ankimi i vendimeve të Prokurorit të Përgjithshëm në rrugë gjyqësore

Dy prokurorët e pezulluar nga detyra gjatë vitit 2018 për shkak se ndaj tyre është ngritur një akt akuzë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, përkatësisht Znj. Rovena Gashi dhe Z. Dritan Gina kanë ushtruar të drejtën e ankimit gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka rrëzuar kërkesë padinë e paraqitur. Ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është ushtruar e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit Administrativ. Kjo gjykatë, me vendimin e saj nr.181, datë 08.11.2018 ka vendosur pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimeve nr. 140, datë 11.05.2018 dhe nr. 141, datë 11.05.2018 të Prokurores së Përgjithshme për pezullimin nga detyra të prokurorëve Rovena Gashi dhe Dritan Gina<sup>264</sup>.

<sup>261</sup>[http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/Prokurorja\\_e\\_Pergjithshme\\_znj\\_Arta\\_Marku\\_caktoi\\_perkohesisht\\_znj\\_Donika\\_Prela\\_ne\\_krye\\_t\\_e\\_Prokurorise\\_per\\_Krime\\_te\\_Renda\\_1196\\_1.php](http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/Prokurorja_e_Pergjithshme_znj_Arta_Marku_caktoi_perkohesisht_znj_Donika_Prela_ne_krye_t_e_Prokurorise_per_Krime_te_Renda_1196_1.php)

<sup>262</sup>[http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/Prokurorja\\_e\\_Pergjithshme\\_znj\\_Arta\\_Marku\\_caktoi\\_perkohesisht\\_znj\\_Donika\\_Prela\\_ne\\_krye\\_t\\_e\\_Prokurorise\\_per\\_Krime\\_te\\_Renda\\_1196\\_1.php](http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/Prokurorja_e_Pergjithshme_znj_Arta_Marku_caktoi_perkohesisht_znj_Donika_Prela_ne_krye_t_e_Prokurorise_per_Krime_te_Renda_1196_1.php)

<sup>263</sup>[http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/Caktohet\\_drejtuesi\\_i\\_perkohshem\\_i\\_Prokurorise\\_se\\_Elbasanit\\_1187\\_1.php](http://ëëë.pp.gov.al/ëeb/Caktohet_drejtuesi_i_perkohshem_i_Prokurorise_se_Elbasanit_1187_1.php)

<sup>264</sup><http://ëëë.gjykataadministrativeapelit.al/detajeteceshjes3.php?id=%2021300>



Duke iu referuar bazës ligjore të cituar nga Prokurori i Përgjithshëm në vendimmarrjen për pezullimin në detyrë të dy prokurorëve, më saktë nenit 151 pika 1, gërma “b”, i ligjit nr. 96/2016, kjo dispozitë parashikon se “*Magjistrati pezullohet nga detyra me vendim të këshillit përkatës kur: ... b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje*”. Gjykata Administrative e Apelit, ka arsyetuar se tre janë pretendimet themelore të ngritura nga pala paditëse, për shpalljen e paligjshmërisë së akteve administrative dhe më konkretisht:

- a) *faktin që vepra penale që iu atribuohet nuk përbën krim të rëndë;*
- b) *vepra penale që iu atribuohet nuk kryhet vetëm me dashje, dhe,*
- c) *ata nuk kanë marrë cilësinë e të pandehurit, në përputhje me normat ligjore*

Gjykata e Apelit arriti në konkluzion se krimi i parashikuar në nenin 257/a-2 të Kodit Penal nuk përbën krim të rëndë. Për të arritur këtë konkluzion, ky kolegji pati parasysh llojin e veprës penale për të cilën akuzohen paditësit dhe më konkretisht elementët e anës objektive të kësaj vepre, lloji i dënimit që parashikohet me gjobë ose burg deri në 3 vjet si dhe faktin që kjo vepër penale është në kompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Konkretisht, citojmë një paragraf të arsyetimit të bërë nga Gjykata e Apelit Administrativ “*Ndër të tjera, në rastin konkret, referuar dispozitës penale përkatëse që paditësit janë akuzuar, neni 257/a-2 i Kodit Penal, referuar mënyrës, në të cilën pretendohet të jetë kryer vepra penale, nëpërmjet deklaramit të rremë, llojeve të dënimeve të parashikuara nga kjo dispozitë penale, dënim me gjobë ose me burgim, masës së dënimit me burgim, që parashikon kjo dispozitë, deri në tre vjet dhe duke qene se kjo vepër penale përfshihet në kompetencën lëndore të gjykimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, e që shqyrtohet në themel me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, rezulton se, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një krim të rëndë*”.

Edhe prokurorët, Z. Besim Hajdarmataj dhe Z. Olsian Çela i janë drejtuar Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, për të kundërshtuar vendimet e PP në lidhje me transferimet e tyre nga Prokuroria e Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë, në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Berat dhe Pogradec. Gjykata Administrative ka pranuar kërkimet e paditësve, duke shfuqizuar vendimet e PP. Në lidhje me rastin e Z. Hajdarmataj, kjo gjykatë arsyeton në vendimin e saj të pranimit të kërkesë padisë si dhe shfuqizimit të Aktit Administrativ si të paligjshëm, se: *Në rastin e nxjerrjes së Urdhrit nr.179 datë 20.09.2018, për caktimin përkohësisht të Z. Besim Hajdarmataj si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec, pala e paditur dështoj të provonte qëllimin për të cilin ishte nxjerrë ky akt. Duke mos qene në përputhje me nenin 59 të Ligjit Nr. 96/2016 ‘Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’.* Në përfundim, gjykata ka vendosur detyrimin e palës së paditur, Prokurori i Përgjithshëm që të rikthej paditësin Z. Hajdarmataj në pozicionin e mëparshëm të punës në prokurorinë e krimeve të rënda<sup>265</sup>.

Ndërkohë me ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me kërkesë të dy prokurorëve, Z. Hajdarmataj dhe Z. Çela drejtuar KLP, është vendosur nga ky institucion rikthimi në pozicionet e tyre të mëparshme<sup>266</sup>.

Sa më sipër, vlen të evidentohet se mund të ketë pasur edhe ankesa apo kërkesë padi të tjera të depozituara në gjykatë, por KShH ka mundur të sigurojë vetëm këtë informacion nëpërmjet përdorimit të faqes zyrtare të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe materialeve të vendosura në dispozicion nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

<sup>265</sup> <http://ëëë.gjykata.gov.al/umbraco/Surface/SearchSurface/GenerateAndDownloadFinalDecisionReport?caseId=80-2018-06256&courtId=80>

<sup>266</sup> <http://ëëë.oranës.tv/article/kerkesa-e-prokuroreve-cela-dhe-hajdarmataj-sjell-debate-mes-anetareve-te-klp>

## 5. Debati publik dhe mediatik për vendimmarrjen tranzitore të Prokurorit të Përgjithshëm

Në media janë pasqyruar disa mendime dhe opinione përsa i përket transferimeve dhe emërimeve të realizuara në mënyrë tranzitore nga PPP. Në disa raste vlen të evidentohet se media nuk ka informacionin e duhur lidhur me parashikimet ligjore të kësaj vendimmarrje dhe rrjedhimisht këto vendime emërtohen në mënyrë të gabuar. P.sh., transferimi i prokurorit Z. Hajdarmataj nga Prokuroria e Krimeve të Rënda në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor është cilësuar gabimisht nga media si shkarkim<sup>267</sup>. Mungesa e njohurive për pasqyrimin e vendimmarrjes së Prokurorit të Përgjithshëm ndikon në mos informimin në mënyrë të saktë të publikut, duke krijuar edhe konfuzion.

Në media është shkruar vazhdimisht se disa lëvizje/transferime të realizuara nga Prokurorit të Përgjithshëm janë të ndikuara nga njohjet me prokurorët e emëruar, si p.sh. rasti i emërimit të prokurores Znj. Donika Prella në drejtimin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ku në media është referuar njohja e tyre gjatë periudhës së ndjekjes së shkollës së magjistraturës.<sup>268</sup> Një rast tjetër i diskutuar gjerësisht në hapësirën mediatike është ai i pezullimit të prokurorëve Znj. Rovena Gashi dhe Z. Dritan Gina pas ngritjes së akuzës në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës mbi kryerjen e veprës penale nga ana e këtyre shtetasve<sup>269</sup>.

Debate dhe kundërshti të pasqyruara nga mediat që lidhen me vendimmarrjen e Prokurorit të Përgjithshëm, i përkasin çështjes gjyqësore mediatikisht të njohur si “Dosja Shullazi”. Prokurorët që kishin ndjekur më herët dosjen Shullazi apo dhe dosjen “Tahiri” ishin transferuar në prokurori të tjera dhe është kërkuar hedhja e shortit për të përcaktuar prokurorët që do të ndjekin këtë dosje. Mediat pasqyrojnë se mbledhja për hedhjen e shortit është shoqëruar me debate të forta si dhe me refuzimin e disa prokurorëve për marrje pjesë në hedhje shorti. Mediat pasqyrojnë se refuzimi nga ana e prokurorëve për tu bërë pjesë e këtij shorti, ka sjellë si pasojë vendimmarrjen e PP për transferimin e prokurorëve në prokurori të tjera si masë ndëshkimore<sup>270</sup>. Ndërkohë që në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme është publikuar një komunikatë për publikun e dt. 21.09.2018, ku ndër të tjerash shpjegohet se *“Prokurorët e Krimeve të Rënda, ndaj të cilëve është urdhëruar fillimi i hetimit disiplinor, kanë refuzuar të marrin pjesë në hedhjen e shortit, për të përfaqësuar në gjykim një çështje shumë sensitive për opinionin publik. Në këtë mënyrë, këta prokurorë kanë vepruar në kundërshtim me ligjin që i detyron të jenë pjesë e shortit, për sa kohë janë prokurorë të asaj prokurorie, duke vepruar në kundërshtim të hapur me detyrimin kushtetues, sipas të cilit “Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit...”. ... Kjo, si dhe shkelja e rregullave të etikës, janë arsytet e vetme që më kanë detyruar që, si Prokurorë e Përgjithshme e Përkohshme të qëndroj fort dhe të mos tërhiqem në zbatimin e kushtetutës dhe ligjeve të vendit tim, duke urdhëruar fillimin e hetimit disiplinor sipas përcaktimeve të nenit 160, pika 5 të ligjit nr.96/2016, ndaj këtyre prokurorëve që kanë refuzuar të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre që ju ngarkon kushtetuta dhe ligji. ... Çdo prokuror që refuzon të bëjë detyrën do përballet me përgjegjësi disiplinore, por edhe penale sipas rastit”<sup>271</sup>. Megjithatë, KShH vëren se për këtë çështje nuk ka pasur transparencë të mjaftueshme në faqen zyrtare të Prokurorit të Përgjithshëm, sa i takon publikimit të informacionit lidhur me fillimin e procedimit disiplinor dhe vendimmarrjes pas përfundimit të tij.*

<sup>267</sup> <https://ëëë.reporter.al/arta-marku-shkarkon-prokurorin-e-ceshtjes-tahiri/>

<sup>268</sup> <https://tvklan.al/perplasjet-ne-prokurorine-e-krimeve-te-renda/>; <http://shqiptarja.com/lajm/kush-eshte-donika-prella-prokurorja-qe-ka-ne-dore-dosjen-e-adriatik-llalles/>; <http://www.gazetatema.net/2017/11/21/iken-adriatik-llalla-zbulohet-dokumenti-i-opdat-dhe-euralius/>; <http://gazeta-shqip.com/lajme/2018/01/24/struktura-e-re-e-prokurorise-marku-rivleresim-te-gjithe-prokuroreve/>; <http://shqiptarja.com/lajm/shembet-drejtesia-shkrihen-kld-dhe-krimet-e-renda-arta-marku-humbet-kompetencat/>; <https://www.reporter.al/frike-apo-perplasje-e-brendshme-marku-shkemben-akuza-me-prokuroret/>; <http://www.oranews.tv/article/kunderpergjigjen-prokuroret-padi-ndaj-arta-marku-dhe-donika-preles>

<sup>269</sup> <https://balkanëeb.com/lajm-i-fundit-hetim-per-pasurine-prokurore-rovenga-gashi-dhe-dritan-gina-arta-marku-i-pezellon-nga-detyra/>

<sup>270</sup> <https://ëëë.reporter.al/dosja-e-emiljano-shullazit-zhyt-ne-kaos-prokurorine-e-krimeve-te-renda/>

<sup>271</sup> [http://ëëë.pp.gov.al/ëëb/Deklarate\\_e\\_Prokurorit\\_te\\_Pergjithshem\\_Arta\\_Marku\\_1224\\_1.php](http://ëëë.pp.gov.al/ëëb/Deklarate_e_Prokurorit_te_Pergjithshem_Arta_Marku_1224_1.php)

**KAPITULLI IV**

**MONITORIMI I MBLEDHJEVE TË  
KLGJ-SË DHE KLP-SË**

## 1. Fillimi i funksionimit të dy Këshillave (KLP dhe KLGJ)

Me përzgjedhjen e anëtarëve nga radhët e gjyqësorit për KLGJ-në nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve, në dt. 12 dhjetor 2018, si dhe me përzgjedhjen e anëtarëve nga radhët e prokurorisë për KLP-në nga mbledhja e përgjithshme e prokurorëve në dt. 11 dhjetor 2019, të dy këto Këshilla filluan nga veprimtaria brenda një afati shumë të shpejtë vetëm disa ditë më vonë.

Mbledhja e parë e KLP-së e realizuar më datë 19.12.2018, konsistoi në *miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë*<sup>272</sup>, *miratimin e vendimit deklarues me datën e krijimit të Këshillit*<sup>273</sup>, *hedhjen e shortit për përcaktimin e anëtarëve jo prokurorë që do të shërbejnë me një mandat 3-vjeçar dhe hedhjen e shortit për përcaktimin e anëtarëve prokurorë që vijnë nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe ato të apeleve, që do të shërbejnë me një mandat 3-vjeçar. Në faqen zyrtare të KLP-së rezulton të jenë publikuar vetëm vendimmarrjet respektive por jo rregullorja përkatëse për procedurën e zgjedhjes së kryetarit dhe Zv/kryetarit të KLP-së si dhe emrat e anëtarëve të përzgjedhur të cilët do të kenë mandat 3 vjeçar.*

Nga monitorimi i mbledhjes së parë të KLP-së, u konstatua se në përputhje me nenin 279, pika 7 të ligjit nr.115/2016, u përzgjedhën me anë të procedurës së shortit manual (me gogla), anëtarët jo prokurorë që do të shërbejnë për një mandat të kufizuar 3 vjeçar, përkatësisht Z. Gent Ibrahimimi dhe Z. Sandër Beci. Ndërsa anëtarët prokurorë nga shkallët e para dhe apelet që do të shërbejnë me mandat të kufizuar 3 vjeçar janë: Znj. Antoneta Sevdari<sup>274</sup>, Z. Arben Dollapaj dhe Z. Kosta Beluri. Anëtarët e tjerë prokurorë dhe jo prokurorë do të shërbejnë me mandat të plotë 5 vjeçar.

Ndërkohë mbledhja e parë e KLGJ-së u realizua më 20.12.2018. Rendi i ditës së kësaj mbledhje rezulton të jetë *mbi deklarimin e datës së krijimit të KLGJ-së*<sup>275</sup>, *mbi miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të KLGJ-së, zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KLGJ-së*<sup>276</sup>, *mbi caktimin me short të dy anëtarëve gjyqtarë dhe 2 anëtarëve jogjyqtarë, për të shërbyer për një mandat 3 vjeçar më KLGJ. Në ndryshim nga KLP, rregullat për zgjedhjen e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor rezultojnë të jenë publikuar në faqen zyrtare të Institucionit.*<sup>278</sup> **Në Vendimin nr. 5, datë 20.12.2018 nuk rezulton që të jenë publikuar emrat e anëtarëve të cilët do të shërbejnë pranë KLGJ-së me një mandat të kufizuar 3 vjeçar. M.gj.th, ky informacion u siguroi nga vëzhguesi i autorizuar i KShH-së dhe anëtarët në radhët e gjyqtarëve që do të kenë mandat të kufizuar janë Z. Medi Bici (nga Gjykata e Lartë), Z. Ilir Toska (nga Gjykata e Apelit) dhe Znj. Brunilda Kadi (nga Gjykata e Shkallës së Parë). Ndërsa anëtarët jogjyqtarë me mandat të kufizuar janë: Z. Erjon Muharremaj dhe Z. Maksim Qoku. Në mbledhjen e dytë të KLGJ-së të realizuar më dt. 21.12.2018, u relatuan nga ana e Kryetares ngërçet e krijuara si pasojë e mbarimit të mandatit të kryetarëve të disa gjykatave, të cilët pavarësisht kësaj situatë vazhdojnë të ushtrojnë funksionin e tyre, si dhe kryetarëve të cilët në pjesën më të madhe të gjykatave janë të komanduar nga ish KLD-ja. Kjo është në listën e 10 çështjeve prioritare të KLGJ-së por kjo listë nuk është e aksesueshme për publikun dhe as nuk është relatuar në mbledhjet e KLGJ-së.**

**Ligji nr.115/2016 është ligji organik që rregullon parimet dhe çështjet më të rëndësishme të krijimit, organizimit dhe funksionimit të të dy Këshillave.** Në këtë ligj nuk parashikohet për Këshillat detyrimi i tyre për të vendosur prioritete sa i takon vendimmarrjes së Këshillave, me përjashtim të prioriteteve që janë pjesë e planit strategjik për sistemin gjyqësor dhe planit strategjik për

<sup>272</sup> <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/03/Nr.3-Dat%C3%AB19.12.2018-.pdf>

<sup>273</sup> <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/03/Nr.1-Dat%C3%AB18.12.2018-P%C3%ABr-krijimin-e-KLP.pdf>

<sup>274</sup> Znj. Sevdari rezulton të jetë shkarkuar më vonë me vendim të KPA, çka solli në mënyrë automatike edhe ndërprerjen e mandatit të saj si anëtare prokurorë e KLP-së.

<sup>275</sup> <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-4-dat%C3%AB-20-12-2018>

<sup>276</sup> <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-2-dat%C3%AB-20-12-2018>

<sup>277</sup> <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-3-dat%C3%AB-20-12-2018>

<sup>278</sup> <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-1-dat%C3%AB-20-12-2018>

sistemin e prokurorisë, të cilat hartohen dhe zbatohen në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë. **Pavarësisht nga kjo, KShH vlerëson se të dy Këshillat duhet të hartonin një plan masash për tu përmbushur në terma afatshkurtër dhe afatmesëm, duke evidentuar edhe vendimmarrjet e natyrës emergjente. Kjo për arsye se vonesa gati 2 vjeçare në ngritjen e të dy Këshillave, natyrshëm krijoi ndërprerje në funksionimin e sistemit të drejtësisë, të cilat kishin nevojë për tu adresuar në mënyrë të organizuar me vendimmarrjen e tyre.** Pas konsultimit të këtij draft raporti me institucionet e monitoruara, KLGJ informon se nga momenti i krijimit ka punuar për hartimin e planit strategjik 2 vjeçar dhe planit përkatës të veprimit, të cilat janë në fazë finalizimi dhe do të konsultohen në periudhën qershor – korrik 2019.

## 2. Pajisja e Këshillave me infrastrukturë, buxhet dhe personelin e nevojshëm

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe ai i Prokurorisë, që nga momenti i krijimit janë përballur me vështirësi përse i përket infrastrukturës, buxhetit dhe pajisjes me personelin e nevojshëm.

Anëtarët e KLGJ-së ushtrojnë funksionin e tyre pranë godinës së KLGJ-së, ndërkohë që anëtarët e KLP-së, në mungesë të një infrastrukture të përshtatshme janë të akomoduar në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme. Hapja e garës për pozicionin vakant të Prokurorit të Përgjithshëm, më 29 Mars 2019<sup>279</sup> por edhe ushtrimi i funksioneve të tjera nga KLP të cilat janë të lidhura me prokurorët e kësaj Prokurorie, mund të krijojë perceptime për cenimin e objektivitetit dhe paanshmërisë së anëtarëve të KLP-së.

Pavarësisht se KLGJ është vendosur në godinën e një institucioni i cili nuk ekziston më, sërish problematike mbetet mungesa e hapësirës së nevojshme për anëtarët dhe për realizimin e mbledhjeve të KLD-së. Kjo për faktin se anëtarët e KLGJ-së, në ndryshim nga ata të KLD-së, e ushtrojnë funksionin me kohë të plotë. Në mbledhjen e dytë të realizuar nga KLGJ, më datë 21.12.2018 u diskutua nga ana e Kryetares, mundësia e akomodimit të anëtarëve të KLGJ-së në zyra, të cilat për shkak të situatës së përkohshme nuk mund të jenë individuale. Gjithashtu, u diskutua për realizimin e mbledhjes së Komisioneve në zyrën e Kryetares dhe Zv/Kryetarit. Çështja e akomodimit në zyra u shoqërua me debate dhe komente nga anëtarët nga radhët e gjyqësorit, duke qenë se ata ishin anëtarë që vinin nga sistemi gjyqësor, e për këtë arsye i duhej garantuar trajtim dinjitoz. Duke qenë se kjo është një situatë e përkohshme u vendos që ky diskutim të mos kalonte në votim, por të zgjidhej me marrëveshje dhe me frymën e tolerancës ndërmjet anëtarëve.

Referuar neneve 79, pika 2 dhe 178, pika 2 të Ligjit nr. 115/2016, Këshillat janë përgjegjës për përcaktimin e strukturës së administratës dhe të secilës njësi, krijimin e njësive të tjera organizative brenda administratës, përcaktimin e detyrave dhe të përgjegjësisë të të gjitha njësive organizative dhe të pozicioneve individuale etj.

Struktura e organizative e administratës të KLP-së është diskutuar në mbledhjen e datës 21.01.2019, ku është diskutuar ndër të tjerash *projekt vendimi për miratimin e strukturës së KLP-së dhe buxheti për vitin 2019*. Gjatë zhvillimit të punimeve të kësaj mbledhje u propozuan 3 variante të strukturës. Në përfundim, KLP vendosi të votojë variantin që propozonte numrin më të lartë të punonjësve, përkatësisht 75 punonjës. **Kjo strukturë është miratuar nëpërmjet Vendimit nr. 17, datë 21.01.2019<sup>280</sup>, por nuk rezulton të jetë publikuar një relacion shpjegues i kësaj strukture.**

Struktura organizative e administratës së KLGJ-së u diskutua dhe u miratua në mbledhjen e datës 18.01.2019. Anëtarët e Këshillit rezultoi se ishin njohur më parë me këtë projekt organikë, dhe sugjerimet e tyre rezultojnë të jenë pasqyruar në këtë skemë. Struktura u miratua me shumicë votash të

<sup>279</sup><http://klp.al/index.php/2019/04/01/keshilli-i-larte-i-prokurorise-shpall-fillimin-e-procedures-per-perzgjedhjen-e-kandidateve-per-prokuror-te-pergjithshem-permes-procedures-se-hapur-te-thirrjes-publike-per-aplikim-bazuar-ne-rregullor/>

<sup>280</sup> <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/03/Nr.17-Dat%C3%AB-21.01.2019-.pdf>



anëtarëve.<sup>281</sup> **Vendimi nr. 12, datë 18.01.2019 nuk rezulton i publikuar, ndërkohë që nga artikuj në lajme informohemi se ky vendim i është përcjellë Kuvendit bashkë me relacionin shpjegues bashkëlidhur vendimit, strukturën si dhe aneksin me parashikimin Buxhetor në mbështetje të skemës.**<sup>282</sup> Në shtypin e shkruar rezulton të jetë publikuar informacioni se struktura organizative e administratës së KLGJ-së përfshin një numër prej 144.<sup>283</sup> Nëse ky numër është real, atëherë vërehet se ai është sa dyfishi i numrit të punonjësve të KLP-së.

Nëpërmjet ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, rezulton të jetë parashikuar vlera deri në 400 milionë lekë në fondin rezervë të sistemit të drejtësisë për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të reja, pas miratimit paraprak nga Kuvendi.<sup>284</sup> Pas konsultimit të realizuar me Ministrinë e Financave, rezulton se mundësitë financiare për vitin 2019 për të dyja këto këshilla, janë 125 nëpunës për KLGJ-në dhe 65 nëpunës për KLP-në. Këto struktura u miratuan mes debatesh në mbledhjen e datës 19.02.2019, të Komisionit parlamentar të ligjeve.<sup>285</sup> Nga procesverbali i zbardhur i kësaj mbledhje konstatohet se varianti i sjellë për mendim nga misioni EURALIUS për KLP-në është 61 punonjës, ndërsa lidhur me strukturën e KLGJ-së, Ministria e Drejtësisë dhe EURALIUS kanë një projektion prej rreth 106 punonjës.<sup>286</sup> Pas kalimit në Komisionin e Ligjeve, strukturat u miratuan në seancën plenare të Kuvendit të datës 21.02.2019 me vendimet nr. 32/2019<sup>287</sup> dhe nr.33/2019<sup>288</sup>. Përfundimisht numri i punonjësve të miratuar për KLGJ-në nga Kuvendi është 125 veta, pra 30 persona më pak se propozimi i KLGJ-së, ndërkohë që numri i punonjësve për KLP-në është 65 veta, pra 10 persona më pak se propozimi i KLP-së. Sipas të dy vendimeve të Kuvendit, fondi për krijimin dhe funksionimin e KLGJ-së dhe KLP-së miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Fondi për krijimin dhe funksionimin e KLP dhe KLGJ nuk rezulton të jetë miratuar ende nga Këshilli i Ministrave (KM).<sup>289</sup> KM rezulton se ka miratuar me vendimin e dt.17 Prill 2019, disa shtesa në VKM nr. 187, dt. 08.03.2017 (të ndryshuar)<sup>290</sup>, në fushëveprimin e të cilës vendosen pagat e nëpunësve të KLGJ-së dhe KLP-së. Me anë të shtesave të miratuara në këtë VKM, ndër të tjerash, rezulton se është përcaktuar niveli i pagave për funksionarët e kabineteve dhe kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe atë të Prokurorisë.

Në mungesë të alokimit të fondit përkatës nga buxheti i shtetit, gjatë realizimit të monitorimit të mbledhjeve të KLP-së është vërejtur se prezantimi i drejtuesve të Prokurorisë së Apelit Korçë dhe të Prokurorisë së Apelit të Krimeve të Rënda është realizuar me sigurimin e transportit në mënyrë individuale nga anëtarët e përcaktuar të Këshillit.

Bazuar në nenin 53/2 të ligjit nr. 96/2016 dhe nenin 176/3 të ligjit nr. 115/2016, më datë 25.01.2019 është publikuar thirrja për të gjithë prokurorët e shkallës së parë dhe të dytë të cilët nuk shërbejnë në një pozicion me mandat të kufizuar dhe që nuk janë të komanduar në ndonjë pozicion tjetër, për të shprehur interesin për t’u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë KLP-së.<sup>291</sup> Me mbylljen e afatit janë depozituar 10 shprehje interesi, nga të cilat vetëm Znj. Pranvera Gruda rezulton se nuk përmbush kriterin e gëzimit të statusit të magistrates dhe ka hequr dorë nga ky kandidim. Nga ana e

<sup>281</sup> <http://www.kld.al/vendime/vendim-nr-12-dat%C3%AB-18-01-2019>

<sup>282</sup> <http://www.parlament.al/Files/Projekte/20190227150401raporti%20%20KLGJ%20KLP.pdf>

<sup>283</sup> [https://shqiptarja.com/uploads/ckeditor/5c543d954e14ckerkesa%20menyra%20funksionimit\\_001.pdf](https://shqiptarja.com/uploads/ckeditor/5c543d954e14ckerkesa%20menyra%20funksionimit_001.pdf)

<sup>284</sup> [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2018/PDF-2018/183-2018.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2018/PDF-2018/183-2018.pdf)

<sup>285</sup> <http://www.parlament.al/Files/Procesverbale/20190304105239Procesverbal%2019.02.2019.pdf>

<sup>286</sup> Faqe 9 e procesverbalit.

<sup>287</sup> <http://www.parlament.al/Files/Akte/20190301110223vendim%20nr.%2032,%20dt.%2026.2.2019.pdf>

<sup>288</sup> <http://www.parlament.al/Files/Akte/20190301110319vendim%20nr.%2033,%20dt.%2026.2.2019.pdf>

<sup>289</sup> Referuar vendimeve të publikuara deri në mbledhjen e dt.17 Prill në linkun:

<http://www2.kryeministria.al/newsrooms/vkm/>

<sup>290</sup> VKM “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, të ndryshuar

<sup>291</sup> <http://klp.al/index.php/2019/01/25/per-plotesimin-e-6-gjashte-pozicioneve-keshilltare-prane-keshillit-te-larte-te-prokurorise-permes-procedures-se-komandimit-te-prokuroreve/>



Komisionit të Verifikimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale rezulton të jenë publikuar opinionet në lidhje me 9 kandidaturat. Përpos të dhënave për praktika disiplinore në proces është kërkuar opinion edhe nga ana e drejtuesve të prokurorisë nëse komandimi i prokurorëve pranë KLP-së çënon ose jo mbarëvajtjen e funksionimit të prokurorive që ata drejtojnë.<sup>292</sup> Nga ana e Komisionit të përhershëm është vendosur përjashtimi i 3 kandidatëve, për arsye e cituara më poshtë.

Kandidatët e interesuar	Opinion	Miraturar/ Përjashtimi
Z. Arjan Muçaj (Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë)	<a href="http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Arjan-Mu%C3%A7aj.pdf">http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Arjan-Mu%C3%A7aj.pdf</a>	Miraturar unanim
Artur Cara (Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë)	<a href="http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Artur-Cara.pdf">http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Artur-Cara.pdf</a>	Miraturar unanim
Z. Erion Pustina	<a href="http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Erion-Pustina.pdf">http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Erion-Pustina.pdf</a>	Komandimi çënon mbarëvajtjen e funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec
Z. Ervin Beqiri	<a href="http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Ervin-Beqiri.pdf">http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Ervin-Beqiri.pdf</a>	Komandimi çënon mbarëvajtjen e funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë
Znj. Marsida Frashëri	<a href="http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Marsida-Frasherri.pdf">http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Marsida-Frasherri.pdf</a>	Prokuroria e Përgjithshme ka njoftuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë se me Vendimin nr.17, datë 01.02.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm, është filluar hetimi disiplinor ndaj Znj. Marsida Frashëri, prokurore në Prokurorinë e Shkallës së Parë Shkodër.
Z. Mihallaq Bleta (Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë)	<a href="http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Mihallaq-Bleta-e-re.pdf">http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Mihallaq-Bleta-e-re.pdf</a>	Miraturar unanim
Znj. Mirela Kapo (Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë)	<a href="http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Mirela-Kapo.pdf">http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Mirela-Kapo.pdf</a>	Miraturar unanim
Znj. Ornella Rrumbullaku (Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë)	<a href="http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Ornela-Rrumbullaku.pdf">http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Ornela-Rrumbullaku.pdf</a>	Miraturar unanim
Znj. Vitjuna Mata (Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë)	<a href="http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Vitjuna-Mata.pdf">http://klp.al/ep-content/uploads/2019/02/Opinion-Vitjuna-Mata.pdf</a>	Miraturar unanim

### 3. Objekti i veprimtarisë së deritanishme të Këshillave referuar kompetencave të parashikuara nga ligji nr. 115/2016

Nga krijimi i KLP-së në 19 Dhjetor 2018 deri në mesin e muajit Prill 2019, objekt i veprimtarisë së këtij Këshilli ka qenë:

- miratimi i rregullave për zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Këshillit dhe zgjedhja e tyre.
- miratimi i propozimit të strukturës dhe buxhetit për vitin 2019.
- krijimi i katër Komisioneve të përhershme.
- përcaktimi i numrit të kandidatëve për magjistratë në profilin prokuror në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020 (25 vende të lira).

<sup>292</sup> <http://klp.al/?s=komandim>

- e) hartimi dhe miratimi i rregullores për angazhimin e prokurorëve në veprimtari jashtë funksionit (mësimdhënie), i rregullores për zhvillimin e shortit për përzgjedhjen e dosjeve në kuadër të procesit të vettingut të subjekteve për periudhën 08.10.2013 – 08.10.2016.
- f) shqyrtimi i kërkesave të depozituara nga ana e drejtuesve të prokurorive për plotësimin e vakancave nëpërmjet caktimit të përkohshëm në këto pozicioneve.
- g) shqyrtimi i kërkesës së grupeve parlamentare të opozitës për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm.
- h) miratimi i rregullores lidhur me kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokurorë të Përgjithshëm.
- i) miratimi i rregullores për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe ngritja e Komisionit të Posaçëm të Përkohshëm për vlerësimin e kandidatëve për Strukturën e Posaçme Antikorrupsion (SPAK), etj.

Nga krijimi i KLGJ-së në dt. 20 Dhjetor 2018 dhe deri në mesin e muajit Prill 2019, objekt i veprimtarisë së këtij Këshilli ka qenë:

- a) miratimi i rregullave për zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KLGJ-së’ dhe zgjedhja e tyre.
- b) nisja e procedurave për emërimin e magjistratëve të diplomuar nga Sh. Magjistraturës në vitin 2018 dhe caktimi i numrit maksimal të kandidateve magjistratë, që do të pranohen në shkollë për vitin akademik 2019-2020, (25 vende).
- c) fillimi i procedurës për caktimin e përkohshëm (kalimit) të gjyqtarëve të gjykatave për krimet e rënda në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.
- d) miratimi i përbërjes së komisioneve të përhershme të saj si dhe ngritja e komisioneve të përkohshme.
- e) shqyrtimi i disa projekt – rregulloreve, përkatësisht “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit dhe projekt-rregulloren”, “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër”, etj.
- f) shqyrtimi i projekt-udhëzimit “Mbi pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare” etj.
- g) Delegimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera,
- h) miratimin e listës së kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në programin e formimit fillestar pranë Sh. Magjistraturës, etj.

Më konkretisht, në vijim po analizojmë disa prej vendimmarrjeve të Këshillave objekt i monitorimit nga vëzhguesit e KShH-së:

Në përputhje me nenet 62 dhe 160 të ligjit nr. 115/2016, Këshillat kanë krijuar komisionet e përhershme. Miratimi i përbërjes së komisioneve të KLGJ-së u realizua gjatë mbledhjes së datës 18.01.2019. Sa i përket shpërndarjes së anëtarëve nëpër komisione, nga ana e Këshillit u mor parasysh: *së pari* kriteri i eksperiencës dhe kontributit që çdo anëtar mund të japë në komisionet respektive, *së dyti* mandatet respektive të anëtarëve dhe *së treti*, referencat e secilit anëtar. Konkretisht përbërja e Komisioneve të KLGJ-së pasqyrohet në tabelën në vijim:

Përbërja	Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe i Buxhetit	Komisioni Disiplinor	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës	Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale
Anëtarë	Znj. Naureda Llagami	Z. Medi Bici	Z. ILIR Toska	Znj. Brikena Ukperaj
Anëtarë	Znj. Fatmira Luli	Z. Dritan Hallunaj	Znj. Marçela Shehu	Znj. Brunilda Kadi

Anëtarë	Z. Medi Bici	Z. Maksim Qoku	Z. ALBAN Toro	Z. Erjon Muharremaj
Anëtarë zëvendësues	Znj. Brikena Ukperaj	Z. ALBAN Toro	Znj. Naureda Llagami	Znj. Fatmira Luli
Anëtarë zëvendësues	Z. Erjon Muharremaj	Znj. Brunilda Kadi	Z. Dritan Hallunaj	Z. Medi Bici

Në faqen zyrtare të KLP-së rezulton i publikuar njoftimi se më datë 26.12.2018, janë ngritur 4 komisione e përhershme, në përputhje me nenin 160 të ligjit nr. 115/2016. Për konstituimin e këtyre komisioneve nuk rezulton që të jetë komunikuar paraprakisht zhvillimi i mbledhjes me dyer të hapura. Komisionet përkatëse dhe përbërja e tyre që nga momenti i konstituimit ka qenë në përputhje me parashikimin e reflektuara në nenin 160 të ligjit nr. 115/2016<sup>293</sup>, por shkarkimi i Znj. Sevdari nga KPA do të sjellë një ri-formim të këtyre komisioneve.

Përbërja	Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe i Buxhetit	Komisioni Disiplinor	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës	Komisioni i Etikës
Kryetar	Z. Gent Ibrahimi	Z. Bujar Sheshi	Z. Sandër Beci	Z. Alfred Balla
Anëtarë	Znj. Antoneta Sevdari,	Z. Besnik Cani,	Zarbën Dollapaj,	Z. Kostaq Beluri,
Anëtarë	Znj. Nurihan Seiti	Z. Tartar Bazaj	Znj. Antoneta Sevdari	Znj. Gentjan Osmani
Anëtarë zëvendësues	Zarbën Dollapaj, Z. Alfred Balla	Zarbën Dollapaj, Z. Alfred Balla	Z. Bujar Sheshi, Z. Gent Ibrahimi	Z. Tartar Bazaj, Z. Besnik Cani

Relacionet shpjeguese dhe projektet e vendimeve të përpiluara nga komisionet e përhershme, të cilat shqyrtohen mbledhjes plenare nuk gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Këshillave dhe as nuk ju vihen në dispozicion vëzhguesve gjatë procesit të monitorimit. Relatimi i këtyre materialeve nga anëtarët në mënyrë të përmbledhur e bën të vështirë procesin e të kuptuarit të përmbajtjes së tyre. **Kjo ka bërë që shumë prej të dhënave cilësore të monitorimit të kryer nga vëzhguesit të KShH-së të evidentohen me vështirësi dhe në mënyrë të pjesshme.**

Si pasojë e vendimmarrjeve të organeve të vettingut u krijuan vakanca për pozicionin e kryetarit të Gjykatës Pukë, Korçë dhe Berat. Kjo çështje u diskutua në mbledhjen e dytë të realizuar nga KLGJ, përkatësisht në dt. 21.12.2018. KLGJ mori në diskutim nenin 26, pika 2 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon një koncept të ri të drejtimit të gjykatës përmes kryetarit, Zv/kryetarit dhe këshillit të gjykatës. Draft rregullorja e përpiluar paraprakisht aty për aty, e cila kërkonte një vendimmarrje të menjëhershme u shoqërua me debate dhe diskutime ndërmjet anëtarëve. Kjo për arsye se shfuqizimi i disa dispozitave të ligjit nr.115/2016 nga Gjykata Kushtetuese kishin krijuar një ngërç në vendimmarrjen e KLGJ-së, e cila nuk mund të ushtrojë kompetencën për të bërë emërimet, por vetëm realizon caktimet të përkohshme të magjistratëve. Sa kohë që vendimet e KPK-së nuk janë të një natyre përfundimtare, pra të formës së prerë, KLGJ nuk vijoi me shpalljen e vakancave për pozicionin e kryetarit në këto gjykata, prandaj anëtarët dakordësuan në këtë linjë argumentimi.

Procedura e cila do të ndiqet nga ana e prokurorëve që nuk e kalojnë pozitivisht procesin e rivlerësimit kalimtar pranë KPK-së është shtruar gjithashtu për diskutim edhe në KLP. Në përputhje me ligjin nr. 84/2016, subjektet magjistratë pezullohen *ex lege* deri në pritje të vendimmarrjes nga ana e KPA-së. Në këto kushte u propozua nga një prej anëtarëve magjistratë të Këshillit që të kërkohej shkurtim vendimi nga ana e KPK-së, në mënyrë që më pas të vijohet me përpilimin e një akti për ta

<sup>293</sup> <http://klp.al/index.php/2019/02/14/keshilli-i-larte-i-prokurorise-miraton-ngritjen-e-kater-komisioneve/>

zëvendësuar. **Ky propozim në vetvete është i diskutueshëm, përse kohë që kemi të bëjmë me një vendimmarrje të organeve të vettingut e cila nuk është e formës së prerë. Ndërkohë vihet re që standardi që kanë ndjekur Këshillat janë të ndryshme në këtë rast, pasi KLGJ nuk ka vijuar me shpalljen e vakancave dhe ja ka deleguar zëvendëskryetarit ushtrimin e kompetencave të kryetarit.**

Procesi i krijimit të skemës së delegimit të magjistratëve ose transferimi i përkohshëm i tyre, referuar neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr. 96/2016 ka qenë objekt diskutimi në KLGJ. Kjo për shkak të fluksit të kërkesave të depozituara dhe situatës së krijuar nga dorëheqjet dhe shkarkimet e gjyqtarëve në kuadër të vettingut. Sipas projekt-akteve të përpiluara nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës rezultojnë dy momente të rëndësishme që janë mbajtur parasysh nga anëtarët: *vënia në lëvizje e procesit për krijimin e skemës së delegimit, e cila është një skemë vullnetare, pra kërkon pëlqimin e magjistratëve dhe konsiderimi i 'menjëhershëm' i dhënies së pëlqimit për transferim të përkohshëm.* Me qëllim garantimin e një procedure transparente dhe për vetë natyrën e krijimit të kësaj skeme, anëtarët me shumicë votash amenduan projekt-aktin duke parashikuar ***“Të kërkohet pëlqimi i të gjithë magjistratëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë që, pa u larguar nga pozicioni i tyre, të kandidojnë në skemën e delegimit””***.<sup>294</sup>

Kërkesa e drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat në lidhje me vakancat e kësaj prokurorie, e cila në një gjendje emergjente u shqyrtua në rendin e ditës të mbledhjes së tretë të KLP-së, të dt. 21.01.2019. Duke iu referuar kësaj kërkesë kërkohej rikthimi në pozicion në Prokurorinë e Rrethit Berat, i dy prokurorëve të komanduar në Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor të Tiranës dhe Shkodrës. **Gjatë zhvillimit të punimeve të mbledhjes së KLP-së u vërejtën diskutime të ndryshme nga ana e anëtarëve, të cilët, në përfundim vendosën rikthimin në pozicion vetëm të prokurorit të komanduar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër.**

Referuar detyrimit ligjor të Këshillave për të mbështetur organet e vettingut për realizimit e vlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar në nenin 171, pika 2 të ligjit nr. 96/2016, pranë KLGJ-së u krijua Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional. Ky komision i përbërë nga 5 anëtarë, 3 prej të cilëve përfaqësues të sistemit gjyqësor dhe 2 prej tyre anëtarë jomagjistratë u miratua në mënyrë unanime<sup>295</sup>:

KRYETAR	ANËTARË JO GJYQTARË	ANËTARË GJYQTARË
Dritan Hallunaj	Maksim Qoku	Medi Bici
	Erjon Muharremaj	Ilir Toska

Një çështje tjetër objekt i veprimtarisë së këshillave ka qenë edhe vendimmarrja për fillimin e procedurave për verifikimin e figurës dhe pasurisë së kandidatëve për prokuror dhe gjyqtarë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës. Këshillat, gjatë mbledhjeve të realizuara kanë caktuar edhe kriteret për kandidimin në Shkollën e Magjistraturës si dhe kanë miratuar një rregullore për vlerësimin e kandidatëve mbi bazën e një sistemi pikëzimi. Është referuar se kapaciteti maksimal i Shkollës është 75 vende për gjithë kandidatët, të profili gjyqtar dhe prokuror, përfshirë këshilltarët/ndihmësit ligjorë.

Ndërkohë që për magjistratët e diplomuar që nuk janë emëruar ende, nisur edhe nga vendimi i Gjykatës Administrative që është shprehur lidhur me pagesën që do kenë magjistratët gjatë periudhës mes diplomimit në shkollën e Magjistraturës dhe emërimit të tyre si magjistratë, KLP ka sugjeruar t'i bashkohen komisioneve për të dhënë kontributin e tyre në lehtësimin e punës që ata kanë. Në ndryshim nga KLP, KLGJ ka nisur procedurën për emërimin e magjistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2018, proces ky i cili do të paraprihej nga një procedure për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve para se të emërohen në detyrë.

<sup>294</sup> <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-14-dat%C3%AB-22-01-2019>

<sup>295</sup> <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-15-dat%C3%AB-22-01-2019>

Objekt i veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka qenë edhe krijimi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar. Skema e aplikuar për plotësimin e vakancave në Prokurorinë e Posaçme është me anë të procedurës së ngritjes në detyrë, në bazë të nenit 48 të ligjit nr.96/2016. Afati për aplikim ishte 1 muaj dhe numri i prokurorëve për SPAK, u vendos të jetë 15, për shkak se volumi punës së tyre dhe ngarkesa, është perceptuar të jetë shumë më e lartë se ngarkesa e Prokurorisë për Krimet e Rënda. Në mbledhjen e datës 6 shkurt 2019 (një ditë përpara mbylljes së afatit për aplikimet për prokurorë në SPAK), KLP njoftoi shtyrjen më dy javë të afatit të aplikimeve, deri me datën 21 Shkurt 2019. Shtyrja ka rezultuar e suksesshme, pasi 12 kandidatë ju shtuan 15 të tjerëve që kishin aplikuar në thirrjen e parë, duke e çuar në 27 numrin e përgjithshëm të kandidatëve për 15 vendet në këtë prokurori<sup>296</sup>. Lista e kandidatëve rezultoi e publikuar në media<sup>297</sup>, ndërkohë që në faqen zyrtare të KLP-së nuk ka ndonjë rubrikë të veçantë dedikuar profilit të kandidatëve për në institucione të tilla të rëndësishme.

Ndërkohë që edhe KLGJ, me vendimin nr.9 datë 27.12.2019, ka nisur procedurën për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të gjykatave për krimet e rënda në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar. Sipas këtij vendimi, gjyqtarët në detyrë të gjykatës së shkallës së parë për krimet e rënda dhe të apelit, të cilët vlerësojnë për të vijuar ushtrimin e detyrës së gjyqtarit pranë gjykatës së posaçme duhet të shprehin interesin me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar KLGJ-së. Në vendim nuk përcaktohet afati që ju lihet kandidatëve për të shprehur interesin. Në vendim gjithashtu thuhet se gjyqtarët dhe familjarët e afërm të tyre të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. KLGJ ka informuar zyrtarisht KShH-në se kanë dhënë pëlqimin 14 nga 15 gjyqtarë të cilët ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ndërkohë që nga 11 gjyqtarë që ushtrojnë detyrën në Gjykatën e Apelit për Krimet e rënda, kanë dhënë pëlqimin 8 prej tyre. KLGJ evidenton se për krijimin e gjykatës së posaçme pritet vettingu i kandidatëve që kanë dhënë pëlqimin si dhe krijimi i prokurorisë së posaçme, pasi pa krijimin e saj gjykatat nuk kanë lëndë gjykimi. KShH vlerëson se **ngritja e Prokurorisë dhe Gjykatës së Posaçme duhet të jetë një proces i rakorduar midis dy Këshillave, pavarësisht veçorive që kanë procedurat në secilin Këshill**. Edhe në faqen zyrtare të KLGJ-së nuk i është kushtuar një rubrikë e veçantë profilit të kandidatëve që aplikojnë për pozicione të rëndësishme në sistemin gjyqësor.

Më datë 29.03.2019, KLP në respektim të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 148/a paragrafi 3 të Kushtetutës dhe seksionit I dhe II të Kreut IV të ligjit nr. 97/2016 shpalli fillimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm.<sup>298</sup> Në përputhje me afatin 30 ditor të përcaktuar për depozitimin e shprehjeve të interesit nga kandidatët që plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligj dhe në rregulloren e miratuar . Në njoftimin e publikuar në faqen e internetit të KLP-së, rezultoi se kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për këtë pozicion, 4 kandidatë, Znj. Arta Marku, Znj. Fatjona Memçaj, Z. Lulzim Alushaj dhe Z. Olsian Çela<sup>299</sup>. Edhe për këta kandidatë vlen i njëjti konstatim sa i takon transparencës në faqen zyrtare të Këshillit si për kandidatët e SPAK-ut.

Projekt-vendimi për ngritjen e Komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e 183 ankimeve mbi vendimet e pushimit të procedimeve të marra nga ish Kryeinspektori i KLD-së u bë objekt debati dhe diskutimi në KLGJ u shoqërua me diskutime dhe opinionet e larmishme në radhët e anëtarëve të Këshillit. Në përfundim u vendos që ky Komision i ngritur sipas nenit 62, pika 13 e ligjit nr. 115/2016, të emërtohej “Komisioni i Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të

<sup>296</sup> <http://www.gazeta-shqip.com/2019/02/22/mbyllet-gara-zbulohet-numri-i-kandidateve-per-spak-un/>

<sup>297</sup> <http://www.panorama.com.al/emrat-spak-kush-jane-27-prokuroret-qe-duan-te-hetojne-korrupsionin/>

<sup>298</sup> <http://klp.al/index.php/2019/04/01/keshilli-i-larte-i-prokurorise-shpall-fillimin-e-procedures-per-perzgjedhjen-e-kandidateve-per-prokuror-te-pergjithshem-permes-procedures-se-hapur-te-thirrjes-publike-per-aplikim-bazuar-ne-rregullor/>

<sup>299</sup> <http://klp.al/2019/05/03/njoftim-mbi-listen-e-kandidateve-te-cilet-kane-aplikuar-per-pozicionin-e-prokurorit-te-pergjithshem-brenda-afateve-te-percaktuara-nga-keshilli-i-larte-i-prokurorise/>



Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”<sup>300</sup>. Një nga paqartësitë e adresuara nga ana e anëtarëve konsistonte në periudhën që ky komision duhet të ushtronte veprimtarinë e tij, nëse kjo periudhë do të shtrihej deri në ngritjen e ILD-së apo do të shtrihej deri në përfundimin e shqyrtimit të 183 ankesave të depozituara.

#### **4. Natyra e diskutimeve të anëtarëve të Këshillave, në optikën e monitorimit të KShH-së**

Në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar në nenet 68 dhe 166 të ligjit nr. 115/2016, pjesëmarrja e 11 anëtarëve respektivë të dy Këshillave është konstatuar në të gjitha mbledhjet plenare të monitoruara nga KShH. **Gjithashtu, KShH ka vërejtur se klima e diskutimeve në Këshilla ka reflektuar një rol pro aktiv dhe përfshirje vazhdimisht në debate me anë të shfaqjes së opinionëve të të gjithë anëtarëve, si në radhët e magistratëve dhe atyre jo magistratë.** Si shembuj mund të sjellim debatet lidhur me kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për të aplikuar në Shkollën e Magistraturës apo edhe debatet lidhur me numrin e prokurorëve që do përzgjidhen për Prokurorinë e Posaçme.

**Vlen të nënvizohet si fakt pozitiv që debatet e anëtarëve gjatë mbledhjeve plenare të Këshillave janë realizuar në mënyrë të moderuar dhe në respektim të rregullave të etikës. Kritikrat e shfaqura në drejtim të mangësive apo interpretimeve të ndryshme të legjislacionit të ri të drejtësisë kanë pasur frymën e konstruktivitetit.** Kryesisht mendimet janë shfaqur si nga anëtarët jo magistratë dhe nga ata magistratë, duke reflektuar gërshetim të qasjeve teorike me ato praktike.

Në disa raste të përsëritura, vendimmarrjet e KLGJ-së janë kundërshtuar nga një pakicë anëtarësh magistratë, të cilët kanë relatuar opinionin e tyre se nuk janë njohur paraprakisht me projekt vendimet e propozuara nga ana e Kryetares. Një nga këto çështje është diskutimi i realizuar mbi trajtimin e ankesave që i adresohen Këshillit. Kryetarja e KLGJ-së sqaroi se këto ankesa depozitohen dhe dokumentohen në një regjistër përkatës nga ana e stafit administrativ, ndërkohë që një kopje e tyre i për shqyrtim Komisionit të Disiplinës, por kjo nuk u mirëprit nga pakica e anëtarëve magistratë.

#### **5. Raportet midis anëtarëve magistratë dhe atyre jomagjistratë në vendimmarrjet e Këshillave**

**Pavarësisht diskutimeve dhe debateve aktive në radhët e anëtarëve të të dy Këshillave, në përgjithësi vendimmarrja e tyre është mbështetur në dakordësinë e shumicës dërrmuese të tyre.**

**Në raste tepër sporadike, për çështje të caktuara ka pasur edhe qëndrime të ndara mes anëtarëve magistratë dhe atyre jomagjistratë.** Rast i ndarjes së pastër të qëndrimeve midis anëtarëve në KLP është vendimi për rikthimin në Prokurorinë e Krimeve të Rënda të prokurorëve Olsian Çela dhe Besim Hajdarmata, të cilët u transferuan nga prokurorja e përgjithshme vitin e kaluar në prokuroritë e rretheve gjyqësore Berat dhe Pogradec. KLP votoi këtë vendim me 6 vota pro të anëtarëve magistratë (prokurorët) dhe 5 vota kundër, të anëtarëve jo magistratë.

Gjithashtu, mes debatesh ka kaluar shqyrtimi i një çështjeje urgjente në KLP, për kërkesën e depozituar nga një prokuror i prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë për shtyrjen e moshës së daljes në pension. Shumica e anëtarëve jomagjistratë të KLP-së mbajtën një qëndrim mbështetës për kërkesën, ndërkohë që shumica e anëtarëve magistratë kërkuan kohë për t'u njohur me legjislacionin në fuqi. Në këtë rast, anëtarja jomagjistrate e cila relatoi çështjen bashkë me 4 anëtarë të tjerë (duke përfshirë dhe ata magistratë) votuan në pakicë në favor të miratimit të kërkesës së depozituar nga subjekti. Në nenet 66/9 dhe 164/9 të ligjit nr. 115/2016 është parashikuar se në rastet e vendimmarrjeve administrative

<sup>300</sup> <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-31-dat%C3%AB-02-2019>



individuale nga ana e Këshillave, në lidhje me statusin profesional të një subjekti konkret anëtar i mbetur në pakicë mund të kërkojë që opinionin e tij t'i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. **Anëtarët e Këshillit gëzojnë të drejtën që të argumentojnë mendimin e tyre të pakicës, i cili i bashkëlidhet vendimit.**

## **6. Çështjet e debatueshme nga Këshillat në drejtim të qartësisë, plotësisë dhe unitetit të formulimit të dispozitave të ligjit nr. 115/2016**

**Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të cilat kanë shfuqizuar disa nene të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe disa nene të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë krijuar vështirësi në interpretimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni në vendimmarrjet e të dy Këshillave.** Për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm parlamentar nuk është arritur nga Kuvendi i R.Sh plotësimi i vakumit ligjor të krijuar në këto dy ligje organike bazë të veprimtarisë së Këshillave.

Vakumi ligjor ka qenë objekt i diskutimeve për çështje të caktuara në rendin e ditës, në disa prej mbledhjeve të KLGJ-së dhe KLP-së. Ka pasur debate në Këshilla lidhur me *kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e tyre*, në kushtet kur gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar një dy nenet e ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”<sup>301</sup>, të cilat i akordonin Këshillit në seancë plenare që të ushtronte vetëm disa nga kompetencat e parashikuara në Kushtetutë. Ndërkohë kompetencat e tjera, Këshillat do ti ushtronin në komisionet e përhershme sipas dispozitave në fuqi të ligjit (të pa shfuqizuara). Vetëm ankimet ndaj vendimeve të Komisioneve do shqyrtoheshin nga Këshilli në seancë plenare.

**Çështje të tjera të cilat bllokoi vendimmarrjen e dy Këshillave si rezultat i shfuqizimit të nenit 61 dhe 159 të ligjit nr.115/2016, janë adresuar nga anëtarët duke gjetur zgjidhjet më të favorshme, referuar dispozitave në fuqi të ligjeve të tjera të reformës në sistemin e drejtësisë, sikurse është ligji nr.98/2016.** Në pamundësi të ndërmarrjes së procedurës së emërimit të kryetarit të gjykatës dhe në mungesë të funksionalitetit të skemës së delegimit, e cila shoqërohet me një sërë procedurash, anëtarët e KLGJ-së ju referuan nenit 26, pika 2 të ligjit nr. 98/2016, i cili parashikon se në mungesë të kryetarit, kompetencat e tij ushtrohen nga zëvendëskryetari, ndërkohë që ky i fundit zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatës respektive.

Çështje e diskutueshme në veprimtarinë e KLGJ-së ka qenë shkresa e datës 13.12.2018, ku pasqyrohen disa problematika të adresuara nga Inspektori i Përgjithshëm Inspektoratit të KLD-së. Në këtë korrespondencë, ndër të tjera evidentohet statusi i inspektorëve të caktuar, të cilëve tashmë u ka mbaruar mandati por kërkojnë të informohen nëse do të kenë ose jo vazhdimësi në pozicionin e tyre. Dispozitat kalimtare të ligjeve të posaçme, përkatësisht neni 165, pikat 1 dhe 2 i ligjit nr. 96/2016 dhe neni 283, pika 10 i ligjit nr. 115/2016, parashikojnë se një pjesë e inspektorëve i atashohen KLGJ-së, ndërsa të tjerët do të kalojnë automatikisht pranë ILD (institucion që nuk është ngritur ende). **Për diskutimin e kësaj çështje dhe arritjen e konkluzioneve konkrete u kërkua asistencë e misioneve ndërkombëtare USAID dhe EURALIUS.**

Çështje e diskutueshme ka qenë ajo e pajtueshmërisë së rregullores së KLGJ-së “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit” me dispozitat e ligjit nr.96/2016. Në mbledhjen e datës 14.02.2019, KLGJ mori në shqyrtim kërkesat e 4 gjyqtarëve që shprehën interesin për të qenë pjesë e skemës së delegimit. Sipas nenit 9, pika 1 të Rregullores, Këshilli gëzon kompetencën për të vendosur për pranimin ose refuzimin e kandidaturës, bazuar në propozimin e shfaqur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Sipas opinionit të relatuar nga përfaqësues të këtij Komisioni rezulton se këto 4 kandidatura janë refuzuar, një prej të cilëve për shkak se ishte transferuar

<sup>301</sup> Neni 61 dhe neni 159 i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”

përkohësisht në një gjykatë tjetër (gërma f e nenit 4 të Rregullores)<sup>302</sup>, ndërkohë që përfshirja e tre kandidatëve të tjerë në skemë u vlerësua se passjell cënimin e funksionalitetit të gjykatës ku ata efektivisht ushtrojnë funksionin e tyre (gërma “e” e nenit 4 të Rregullores)<sup>303304</sup>. Sipas mendimit të anëtarit jomagjistrat në pakicë, **gërma “e” e nenit 4 të Rregullores ka krijuar në vetvete një kriter përjashtues dhe nuk pajtohet me nenin 45 të ligjit nr. 96/2016, i cili ka parashikuar dy kushte kumulative: *magjistrati të ketë të paktën 1 vit përvojë në funksion dhe të mund të kandidojë*. Pavarësisht këtij opinioni, refuzimi i përfshirjes në skemën e delegimit të 4 kandidatëve u votua me 10 vota pro dhe 1 votë kundër.**

**Pranë KLGJ-së rezultoi se janë depozituar rreth 179 kërkesa nga kryetarë të gjykatave për delegime të 259 gjyqtarëve, për shkak të mos formimit të trupave gjyqësore. Për shkak të fluksit të kërkesave dhe situatës emergjente të krijuar në sistemin gjyqësor, nga anëtarët u vlerësua se skema e delegimit dhe e transferimit të përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave. Në këto kushte, Këshilli vendosi që do të jetë Komisioni për Zhvillimin e Karrierës i cili do të propozojë seancës plenare të miratojë rregullat dhe procedurën e përkohshme për caktimin e gjyqtarit në gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër. **Këto rregulla do të zbatohen në momentin e mosfunksionimit të skemës së delegimit dhe transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.****

KLP-së ka marrë në shqyrtim kërkesën e grupeve parlamentare të opozitës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Prokurores së Përgjithshme, me arsyetimin se nuk ka identifikuar kriterin e pazgjedhshmërisë së anëtarit të KLP-së, Z. Bujar Sheshi. Për rastin në fjalë, kërkesa u bë objekt diskutimi pro-aktiv në mbledhjen plenare të KLP-së, nëse kërkesa ishte ose jo në kompetencën e mbledhjes plenare. Referuar të dhënave të publikuara KLP<sup>305</sup>, rezultoi se ky organ ka shpallur mos kompetencë ndaj kërkesës. Sipas medias<sup>306</sup>, në shkresën drejtuar krerëve të grupeve parlamentare, KLP thekson se e drejta për nisjen e procedimit disiplinor ndaj kryeprokurores nuk është kompetencë e tyre. Kjo e drejtë i takon Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë dhe se deri në përfundim të mandatit të Kolegjit të Apelit procedimet disiplinore kundër Prokurorit të Përgjithshëm shqyrtohen nga Kolegji i Apelit.

## 7. Transparenca e Këshillave kundrejt medias dhe vëzhguesve të autorizuar

Nga monitorimi periodik i mbledhjeve plenare të të dy Këshillave rezultoi se vetëm mbledhja fillestare e konstituimit të këtyre institucioneve, u përcoll nga mediat, ndërkohë mbledhjet e ardhshme u pasuan me mbylljen e dyerve për mediat. Si rezultat i moslejimit të medias për të transmetuar mbledhjet vijuese, më datë 11.03.2019, KShH iu drejtua me anë të kërkesave për informacion me qëllim evidentimin e bazës ligjore, e cila kishte shërbyer si një referencë për një vendimmarrje të tillë. KLGJ, më datë 13.03.2019 informoi KShH-në se mbledhja e saj e parë plenare ka qenë e hapur për publikun, të ftuarit e tjerë dhe mediat, të cilat e kanë pasqyruar gjerësisht. KLGJ nuk ka ofruar asnjë informacion mbi referencën ligjore e cila ka shërbyer për kufizimin e aksesit të medias në mbledhjet vijuese. Ndërkohë, KLP nëpërmjet kthim përgjigjes së saj të datës 28.03.2019, referon se nenet 164, 165, 166 dhe 167 të ligjit nr. 115/2016, nuk përmbajnë asnjë dispozitë referuese për Këshillin për të realizuar mbledhje të hapura. Në kuadër të transparencës, KLP informon se janë publikuar njoftimet për mbledhjet plenare si dhe brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes, në faqen zyrtare bëhet publik regjistrimi audio i seancës plenare. Gjithashtu, KLP referon se është në diskrecionin e tij vlerësimi i mënyrës së realizimit të mbledhjeve. Në vijim të kësaj shkrese, KShH reagoi nëpërmjet një letre të hapur drejtuar KLP-së, më datë 2.04.2019. KShH citoi në mënyrë eksplicite parimin e transparencës të pasqyruar në nenin 2 të ligjit nr. 115/2016 dhe synimin e legjislationit të ri të drejtësisë për të shënuar progres dhe jo regres në drejtim të transparencës. Përjashtimisht, në nenin 231 pika 1 të ligjit

<sup>302</sup> <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-17-dat%C3%AB-29-01-2019-1-1>

<sup>303</sup> <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-27-dat%C3%AB-14-02-2019>

<sup>304</sup> <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-28-dat%C3%AB-14-02-2019>

<sup>305</sup> <http://klp.al/index.php/2019/02/22/kerkesa-per-shkarkimin-e-arta-markut-klp-nuk-eshte-ne-kompetencen-tone/>

<sup>306</sup> <https://www.vizionplus.tv/klp-opozites-shkarkimi-i-arta-markut-i-takon-inspektoriatit-te-larte-te-drejtises/>

nr.115/2016, është parashikuar realizimi i mbledhjeve të mbyllura vetëm për KED-në, si dhe në nenin 191 ku parashikohet zhvillimi i seancës plenare me dyer të mbyllura për 2 këshillat.

Më datë 7.01.2019, KShH iu drejtua në mënyrë zyrtare Këshillave, me anë të një kërkesë për monitorimin e mbledhjeve plenare dhe të veprimtarisë së Komisioneve të përhershme, të cilat duhet të funksionojnë në bazë të neneve 62 dhe 160 të ligjit nr. 115/2016. Në këto shkresë evidentoheshin dhe të dhënat identifikuese të 4 vëzhguesve të autorizuar nga KShH, për të realizuar këtë proces monitorimi. Nga ana e KLGJ-së, nëpërmjet kthim përgjigjes së datës 15.01.2019, u informuam se në të gjitha mbledhjet do të kishte një njoftim, për shpejtësi në rrugë elektronike, nga organizatorët e mbledhjes. Ndërkohë nga ana e KLP-së, më datë 16.01.2019, u informuam se për të dhëna më të hollësishme mund të kontaktonim drejtpërdrejtë këshilltaren për mediat. Por KShH nuk u njoftua në mënyrë periodike paraprakisht nga ana e stafit organizativ të këtyre institucioneve, duke e bërë të pamundur monitorimin e mbledhjeve të para të tyre.

Më datë 7 Shkurt, KShH u informua nga media mbi realizimin e një tjetër mbledhje nga KLGJ, për të cilën nuk ishim informuar paraprakisht. Pas komunikimit dhe takimeve të realizuara me përfaqësues të personelit të këtij institucioni, u sqarua se mungesa e njoftimit vinte si rrjedhojë e mbingarkesës, urgjencës së mbledhjeve dhe mbingarkesës së çështjeve. Pas këtij komunikimi u realizua mbledhja e datës 12.03.2019 për të cilën sërish nuk u njoftuam. Mungesë informimi paraprak është vërejtur edhe në marrëdhënie me KLP. Nëpërmjet shtypit u njohëm me realizimin e seancës plenare nr. 5, më datë 6 Shkurt 2019. Ndërkohë, pika e kontaktit në këtë Këshill nuk kishte përcjellë një njoftim paraprak për këtë mbledhje. Në faqen zyrtare të KLP-së rezultoi i publikuar regjistrimi audio i kësaj mbledhje. **Ky shqetësim i ngritur zyrtarisht nga KShH në rrugë elektronike nuk pati asnjë përgjigje zyrtare nga KLP.** Më datë 25.09.2019, KShH u njoftua nëpërmjet pikës së kontaktit të KLP-së mbi realizimin e një mbledhje *ad hoc*, pasi kjo mbledhje efektivisht kishte 15 minuta që kishte filluar. Njoftimi paraprak dhe axhenda e mbledhjes nuk ishte publikuar paraprakisht në faqen zyrtare të KLP-së, duke e bërë të pamundur monitorimin në kohë të saj. KShH reagoi nëpërmjet një deklaratë për shtyp lidhur me këtë çështje.

Më 12.03.2019, KShH kërkoi të informohet nëse bazuar në nenin 149/b pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, nëse KLP ka marrë vendim lidhur me ankesën për ekzistencën ose jo të shkakut të pazgjedhshmërisë për anëtarin e saj, Z. Bujar Sheshi. Kësaj shkresë nuk i është dhënë përgjigje zyrtare nga KLP. Gjatë mbledhjes plenare të KLP-së nr. 8, më datë 19.03.2019, u vendos me shumicë votash që përfaqësuesit e misionëve të asistencës ndërkombëtare të marrin pjesë dhe t'ju drejtojnë pyetje kandidatëve për prokuror të Prokurorisë së Posaçme dhe kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, gjatë procesit të intervistave dhe fazave të tjera të vlerësimit. Më 21 Mars, KShH bazuar në rolin aktiv që ka reflektuar për zbatimin e reformës në drejtësi shprehu interesin për të monitoruar këtë procedurë. **Kjo shkresë nuk ka marrë ende një përgjigje zyrtare.**

**Në mbledhjet e realizuara dhe të monitoruara nga KShH, vëzhguesve nuk ju është vënë në dispozicion materiali i mbledhjeve. Axhenda e mbledhjeve në rastet e njoftimeve paraprake në faqet zyrtare të institucioneve është aksesuar individualisht nga ana e vëzhguesve. Me përjashtim të rasteve të cituara më sipër, aksesimi i vëzhguesve të KShH-së nuk është kufizuar në asnjë rast nga ana e administratës së këtyre institucioneve.**

Publikimi i materialeve nga ana e Këshillave nuk dokumentohet nën të njëjtin standard dhe praktikë. Në faqen zyrtare të KLP-së<sup>307</sup> rezultojnë të publikuara regjistrimet audio të mbledhjeve plenare dhe vetëm 1 procesverbal i mbledhjes së parë të realizuar më datë 19.12.2018<sup>308</sup>, në cënim të parashikimit ligjor të reflektuar në nenin 167, pika 3 të Ligjit nr. 115/2016. Ndërkohë KLGJ nuk ka publikuar asnjë regjistrim audio të mbledhjeve plenare në shkelje të nenit 69 pika 2 të Ligjit nr. 115/2016, ndërsa procesverbalet me përmbledhjet e diskutimeve janë publikuar në respektim të 69 pika 3 të Ligjit.

<sup>307</sup> <http://klp.al/>

<sup>308</sup> <http://klp.al/ep-content/uploads/2018/12/Procesverbali-i-mbledhjes-se-pare-te-KLP.pdf>

Vendimmarrjet e publikuara nga Këshillat deri në fund të muajit Mars 2019 janë të bazuara në ligj, ndërkohë që për raste të caktuara gjatë të cilave është vërejtur vakum ligjor apo anëtarët janë ndeshur me interpretime të ndryshme të ligjit ndërmjet tyre, Këshillat kanë proceduar nëpërmjet përdorimit të logjikës juridike dhe interpretimit sistematik të dispozitave të një ligji ose të një grupi ligjesh. Në vendimmarrjet e Këshillave është pasur në konsideratë mos ndjekja e procedurave dhe praktikave që kanë rezultuar “problematike” nga veprimtaria e KLD-së.

Aktualisht pranë KLGJ-së rezultojnë të jenë depozituar 114 kërkesa për delegim gjyqtarësh në gjykata të ndryshme, me qëllim funksionimin normal të sistemit gjyqësor. Projekt-rregullorja “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”<sup>309</sup> e përpiluar nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës u miratua në parim dhe në tërësi unanimisht nga të gjithë anëtarët.<sup>310</sup> Kjo rregullore konsiston në përcaktimin e rregullave të detajuara për kriteret dhe procedurën për funksionimin e skemës së delegimit dhe shërbimin në të sipas nenit 45 të ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. **Kjo skemë delegimi e cila bazohet në dhënien e pëlqimit nga ana e gjyqtarit parashikon komandimin e tij për një periudhë jo më pak se 6 muaj për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore në Gjykatën e cila është në nevojë.**

Referuar Projekt-rregullores “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, e përpiluar në zbatim të nenit 46 të ligjit nr. 96/2016, transferimi i përkohshëm i gjyqtarit realizohet vetëm kur nevoja e gjykatës nuk mund të plotësohet nëpërmjet skemës së delegimit. Në dallim nga skema e delegimit, në rastin kur asnjë gjyqtar nuk jep pëlqimin, transferimi i përkohshëm mund të bëhet edhe pa pëlqim, sipas kriterëve të nenit 46/2 të ligjit të sipërcituar. Nga leximi literal i nenit 11 të Rregullores, duke qenë se transferimi pa pëlqim është një situatë tepër delikate, rezulton se Këshilli ka respektuar parashikimet ligjore duke vendosur si kriter përkatësinë e gjyqtarit nga gjykatat me ngarkesën mesatare më të ulët për gjyqtar dhe me përvojën më të pakët si gjyqtar në atë gjykatë.

---

<sup>309</sup> Delegimi nënkupton caktimin nga KLGJ e gjyqtarit në skemën e delegimit për gjykimin e çështjeve gjyqësore në gjykata.

<sup>310</sup> <http://klgj.al/vendime/vendim-nr-22-dat%C3%AB-7-02-2019>

**KAPITULLI V****MONITORIMI I NGRITJES DHE  
FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË  
EMËRIMEVE NË DREJTËSI (KED)**

## 1. Listat e përgatitura për shortin e vitit 2019

Në bazë të nenit 221/1 të ligjit nr. 115/2016 mund të përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së vetëm ata magjistratë dhe gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të cilët, në momentin e organizimit të shortit, plotësojnë kushtet e parashikuara nga ky ligj.

Në bazë të nenit 221/3 të ligjit nr. 115/2016, jo më vonë se data 15 nëntor e çdo viti kalendarik, Gjykata Kushtetuese, KLGJ dhe KLP verifikojnë nëse kandidatët për anëtarë të KED-së plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, dhe i paraqesin Presidentit të Republikës dhe Kuvendit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet.

Deri në krijimin e KLGJ-së dhe KLP-së, ligji nr.115/2016 parashikonte në dispozitat kalimtare krijimin e një KED-je të përkohshme. Në bazë të nenit 284 të po këtij ligji, për shortin e anëtarëve të KED-së së përkohshme, katër institucione duhet të hartonin listat me personat të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga ligji për të qenë anëtarë të KED-së. Më konkretisht:

- a) Prokurori i Përgjithshëm harton një listë me emrat e të gjithë prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive në nivel apeli;
- b) Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Drejtësisë harton një listë me emrat e të gjithë gjyqtarëve të gjykatave të apelit dhe të gjyqtarëve të gjykatës administrative të shkallës së parë.
- c) Kryetari i Gjykatës së Lartë harton një listë me emrat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.
- d) Kryetari i Gjykatës Kushtetuese harton një listë me emrat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Ndryshe nga neni 221/3 i ligjit nr. 115/2016, i cili për KED parashikon se listat duhet të dërgohen jo më vonë se data 15 nëntor e çdo viti kalendarik, për sa i përket KED-së së përkohshme, neni 284 i ligjit nr.115/2016 nuk parashikon ndonjë afat për dërgimin e listave, por pohon se secili nga institucionet e sipërpërmendura “dërgon [listën] menjëherë Presidentit të Republikës”.

Në lidhje me shortin për KED-në 2019, vetëm dy prej institucioneve kanë publikuar në faqet zyrtare listat e tyre, përkatësisht Gjykata Kushtetuese dhe Prokuroria e Përgjithshme. Ndërkohë, Gjykata e Lartë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk kanë ndjekur një procedurë transparente ndaj publikut për publikimin e emrave. Konkretisht:

**a. Lista e kandidatëve nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese** – ky institucion ka publikuar një listë me anëtarët që plotësojnë kushtet e parashikuara nga ligji si dhe një listë me anëtarët të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore. Këto lista u publikuan në faqen zyrtare të këtij institucioni në datë 15 nëntor 2018, pra para datës së hedhjes së shortit dhe brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 221/3 i ligjit nr. 115/2016. Gjithsesi, listat përmbanin vetëm emrat e kandidatëve dhe në to nuk evidentohet asnjë e dhënë mbi verifikimin e përmbushjes së kriterëve të parashikuara nga neni 221/1 ligji nr.115/2016.

**b. Lista e kandidateve nga Prokurori i Përgjithshëm** – ky institucion ka publikuar një listë me anëtarët që plotësojnë kushtet e parashikuara nga ligji si dhe një listë me anëtarët të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore. Këto lista u publikuan në faqen zyrtare të këtij institucioni në datë 14 nëntor 2018, pra para datës së hedhjes së shortit dhe brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 221/3 i ligjit nr. 115/2016. Ndryshe nga listat e Gjykatës Kushtetuese, listat nga Prokuroria e Përgjithshme japin të gjitha detajet mbi plotësimin e kushteve të parashikuara nga ligji. Megjithatë, nuk jepet informacion i mëtejshëm mbi procedurën e ndjekur nga ky institucion për verifikimin e këtyre kriterëve (si p.sh. mënyrën në të cilën janë marrë informacionet, detajet mbi komisionin që ka përpiluar listat, etj.).

Në lidhje me listën e prokurorëve të cilët nuk plotësojnë kushtet e parashikuara nga ligji vërehet se ajo përmban vetëm emrat e prokurorëve, për të cilët kriteri i vetëm i mos përfshirjes është mungesa e përfundimit të Shkollës së Magjistraturës. Ndërkohë nuk jepen detaje mbi arsyen e mos përfshirjes së



emrave të të gjithë prokurorëve të tjerë në sistemin e drejtësisë të cilët nuk plotësojnë kushtet e tjera të parashikuara nga ligji së bashku me informacionet për verifikimit të kryer.

**c. Lista e kandidatëve nga Kryetari i Gjykatës së Lartë** - ky institucion i ka dërguar Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Kuvendit një listë me anëtarët që plotësojnë kushtet ligjore. Kjo listë mban datën 13 nëntor 2018, pra brenda afatit të parashikuar nga neni 221/3 i ligjit nr.115/2016. Lista nuk është publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni dhe i është vënë në dispozicion publikut vetëm gjatë hedhjes së shortit pranë ambienteve të Kuvendit. Gjithashtu, emrat e kësaj liste u publikuan nga media disa ditë përpara hedhjes së shortit.

Lista përmban vetëm emrat e kandidatëve dhe nuk evidentohet asnjë informacion mbi procedurën e ndjekur për verifikimin e përmbushjes së kriterëve ligjore të tyre. Gjithsesi me shkresë të Kancelarit të Gjykatës së Lartë, datë 20.12.2018, në përgjigje të një shkrese të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, u pohua se gjyqtari i vetëm që nuk plotësonte kriteret e parashikuara nga ligji ishte Z. Xhezair Zaganjori, në lidhje me kriterin e ushtrimit të funksionit të magjistratit për një periudhë 10 vjeçare.

**d. Lista e kandidatëve nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Drejtësisë** - ky institucion nuk i ka dërguar Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Kuvendit një listë me gjyqtarët që plotësojnë kushtet e parashikuara nga ligji brenda afatit ligjor sipas nenin 221/3 të ligjit nr.115/2016. Mbas vendimit të Presidentit të Republikës për mos hedhjen e shortit nga ana e tij, Kryetari i Kuvendit i ka dërguar një shkresë Sekretarit të KLD-së në datë 3.12.2018, me nr. 3732/4, e cila nuk është publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni. Në përgjigje të kësaj shkrese, Sekretari i Përgjithshëm i KLD-së, me shkresën nr. 3427/1 Prot., datë 04.12.2018 i ka përcjelle Kryetarit të Kuvendit, listat me emrat e gjyqtarëve të Gjykatave të Apelit dhe të Gjykatave Administrative, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga ligji si dhe të atyre që nuk i plotësojnë këto kushte. Këto dy lista nuk janë publikuar në faqen zyrtare të KLD-së por janë bërë publike gjatë hedhjes së shortit për KED 2019 pranë ambienteve të Kuvendit. Emrat e kësaj liste nuk janë publikuar as nga media para hedhjes së shortit. Ndryshe nga listat e Gjykatës Kushtetuese, listat e KLD-së japin të gjitha detajet mbi plotësimin e kushteve të parashikuara nga ligji, por nuk japin informacione të mëtejshme mbi procedurën e ndjekur në lidhje me verifikimin e këtyre kriterëve. Ndryshe nga listat e Prokurorit të Përgjithshëm, listat e përgatitura nga Sekretari i Përgjithshëm i KLD-së përmbajnë emrat dhe detajet edhe të gjyqtarëve të cilët janë përjashtuar nga shorti, edhe për arsye të ndryshme nga përfundimi i Shkollës së Magjistraturës.

Sipas nenit 221, pika 5 e ligjit nr.115/2016, kandidatët e përjashtuar nga institucionet që përgatisin listat njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit. Ata mund të ankohen brenda 5 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit. Në asnjë prej faqeve zyrtare të këtyre institucioneve nuk është publikuar informacion nëse është realizuar ky njoftim individual me shkrim.

## **2. Shorti i hedhur për anëtarët e KED-së për vitin 2019**

### **a. Mos hedhja e shortit nga Presidenti për shkak të vakumit ligjor**

Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka refuzuar hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së së përkohshme në vitin 2019. Nga realizimi i monitorimit dhe ashtu siç ka rezultuar në rrugë mediatike, nëpërmjet shkresës nr. 30479, datë 23.11.2018, Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka vënë në dijeni Kuvendin e Republikës së Shqipërisë se është në pamundësi të hedhjes së shortit. Kjo shkresë nuk është bërë publike në faqen zyrtare të Presidencës por shkresa ju dërgua KShH-së pasi ju drejtua Presidentit me shkrim me kërkesë për informacion në dt. 7/12/2018.

Në lidhje me vakumin ligjor të cituar nga Presidenti i Republikës duhet nënvizuar se si Kushtetuta po ashtu dhe ligji nr.115/2016 parashikojnë një procedurë standarde për përzgjedhjen e KED-së si dhe një procedurë të veçantë për përzgjedhjen e KED-së së parë që merr formën e KED-së së përkohshme.

KED, në procedurën normale zgjidhet në bazë të nenit 149/d të Kushtetutës dhe nenit 221 të ligjit nr.115/2016 dhe listat me kandidatët përgatiten nga Gjykata Kushtetuese, KLGJ dhe KLP.

Ndërkohë që dispozitat tranzitore të parashikuara në nenin 179/11 të Kushtetutës dhe në nenin 284 të ligjit nr.115/2016, siç u analizua më parë, përcaktojnë se për KED-në e përkohshme, listat me kandidatët përgatiten nga Prokurori i Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Kryetari i Gjykatës dhe Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Nga analiza e këtyre dispozitave konkludohet se deri në momentin kur dispozitat për përzgjedhjen e KED të zakonshme nuk mund të aplikohen (pra deri në krijimin e KLGJ e KLP), atëherë si referencë ligjore do të shërbejnë dispozitat kalimtare për KED-në e përkohshme. Sa kohë KLGJ e KLP u krijuan me vonesë, vetëm pas hedhjes së shortit për KED 2019, atëherë mund të pohojmë se kjo KED është konstituuar në formë të përkohshme. Nga pikëpamja ligjore në momentin e miratimit të reformës në drejtësi mendohej se institucionet e reja do të ngriheshin brenda 8 muajve (neni 179 pika 5 dhe 11 e Kushtetutës), por ky afat nuk u respektua për një sërë shkaqesh me natyrë objektive dhe subjektive. Si rrjedhojë, dispozitat kalimtare do vijojnë të zbatohen sa kohë ligjvënësi nuk ka vendosur një afat përfundimtar për zbatueshmërinë e tyre ose kufizimin e tyre në kohë dhe për sa kohë që rezulton i pamundur aplikimi i dispozitave për zgjedhjen e KED-së së zakonshme.

Më tej vlen të evidentohet gjithashtu se roli zëvendësues i Kuvendit që hedh shortin në mungesë të hedhjes së tij nga Presidenti parashikohet nga dispozitat për emërimin e KED së zakonshme (n.149/d pika 3 i Kushtetutës dhe neni 221/8 i ligjit nr. 115/2016). Në dispozitat kalimtare, ky rol parashikohet vetëm nga Kushtetuta (neni 179 pika 11) por jo nga neni kalimtar 284 i ligjit nr.115/2016.

#### **b. Hedhja e shortit pranë Kuvendit**

Shorti për KED 2019 u hodh në datë 07.12.2018 në ambientet e Kuvendit, sipas Urdhrit të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 3, dt. 03.12.2018, me nr. Prot. 3732/3. Në lidhje me urdhrin nr. 2 “Për përcaktimin e procedurës dhe të rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi” datë 03.12.2018 nuk kuptohen arsyet e përcaktimit të procedurave dhe rregullave të reja, ndërkohë që ato ishin përcaktuar kohë më parë me Urdhrin nr. 1 datë 22.11.2017 të Kryetarit të Kuvendit, në lidhje me shortin e KED 2018, i cili u shfuqizua me urdhrin nr. 2/2018.

Procesi i hedhjes së shortit ishte i hapur dhe transparent për median dhe vëzhguesit e pranishëm. Vëzhguesit u akomoduan në një mënyrë të atillë që të kishin akses pamor në procedurën e hedhjes së shortit. Shorti u regjistrua në audio dhe video, ndërkohë që media e transmetoi në mënyrë të drejtpërdrejtë. Megjithatë, jo të gjithë vëzhguesit patën akses paraprak në dosjet dhe listën e kandidatëve, për shkak të përlllogaritjes në mënyrë jo të duhur të pjesëmarrësve dhe vëzhguesve nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit<sup>311</sup>. Këto dokumente u vendosën në dispozicion në përfundim të procesit.

Në lidhje me aspektin e transparencës evidentohet se Urdhri nr. 409, datë 05.12.2018 “Për ngritjen e sekretariatit teknik që do të organizojë procedurat e KED-së (të përkohshëm)” nuk ishte publikuar më parë në faqen online të Kuvendit, por ju dorëzua pjesëmarrësve gjatë shortin së bashku me dokumentet e tjera. Përmbajtja e listave të kandidatëve që do të shortoreshin për anëtarë ose anëtarë zëvendësues në KED ishte si më poshtë vijon:

- 2 kandidatë nga Gjykata Kushtetuese

<sup>311</sup> Dosja përmbante dokumentet e mëposhtme:

Urdhër nr.3, dt. 03.12.2018 “Për caktimin e datës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm)”; Urdhër nr. 2, datë 03.12.2018 “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së (të përkohshëm)”; Urdhër nr. 409, datë 05.12.2018 “Për ngritjen e sekretariatit teknik që do të organizojë procedurat e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm)”; 4 shkresa përkatëse të lëshuar nga ana e Kryetarit të Gjykatës Kushtetutës, Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

- 3 kandidatë nga Gjykata e Lartë
- 1 kandidat nga Prokuroria e Përgjithshme
- 1 kandidat nga prokuroria pranë gjykatave të apelit
- 14 kandidatë nga Gjykatat e apelit
- 16 kandidatë nga Gjykatat administrative

Në përfundim të hedhjes së shortit manual rezultuan të përzgjedhur këta anëtarë për KED-në e Përkohshme 2019:

1. Znj. Vitore Tusha nga Gjykata Kushtetuese
2. Z. Bashkim Dedja nga Gjykata Kushtetuese
3. Z. Ardian Dvorani nga Gjykata e Lartë
4. Znj. Arta Marku nga Prokuroria e Përgjithshme
5. Z. Fatri Islamaj nga Gjykatat e Apelit
6. Znj. Margarita Buhali nga Gjykatat e Apelit
7. Znj. Fatjona Memçaj nga Prokuroria nga Gjykata e Apelit
8. Z. Eriol Roshi nga Gjykatat Administrative

Ndërkohë, u zgjodhën si anëtarë zëvendësues për KED-në e përkohshme 2019:

1. Z. Medi Bici nga Gjykata e Lartë
2. Z. Gurali Brahimllari nga Gjykatat e Apelit
3. Znj. Klodiana Veizi (Mema) nga Gjykatat Administrative.

Për shkak të mungesës së kandidatëve, mbetën vakante pozicionet pranë KED-së (si anëtar apo anëtar zëvendësues), të cilat duhet të përfaqësonin këto institucione:

- 1 anëtar nga Prokuroria në Gjykatat e Apelit
- 3 anëtar zëvendësues, përkatësisht nga Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroritë në Gjykatat e Apelit

Mbas hedhjes së shortit në faqen zyrtare të Kuvendit u publikua procesverbali<sup>312</sup> i mbledhjes dhe relacioni për procesin e zgjedhjes të KED-së<sup>313</sup>, ku u pasqyruan të gjitha detajet e hedhjes së shortit. Gjatë realizimit të procedurës së shortit, përfaqësuesit e opozitës ngritën një sërë pikëpyetjesh mbi ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e shortit, për shkak të vakumit ligjor të evidentuar edhe nga Presidenti i Republikës. Në mënyrë të veçantë u pretendua se:

a) Për KED-të e 2017-ës dhe 2018-ës, nën një interpretim të asaj kohe të kreut të Komisionit të Ligjeve, në kundërshtim me Kushtetutën, u bllokua funksionimi i KED-së me arsyetimin se pa mbaruar procedurat e vettingut, ky institucion nuk mund të funksiononte. Kjo pengoi ngritjen e Gjykatës Kushtetuese dhe emërimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

b) Në momentin e krijimit të KED 2017, vakancat në Gjykatën Kushtetuese ishin vetëm 3, ndërsa tani ato janë 8 (e më vonë, me shkarkimin e Z. Dedja, 9), pra e gjithë Gjykata Kushtetuese e re do të kalojë nën analizën e KED-së së përkohshme 2019.

c) Prokurorja e Përgjithshme e përkohshme është prokurore e caktuar në këtë detyrë por ka statusin e prokurores së rrethit e prandaj nuk plotëson kriteret e parashikuara nga ligji.

d) Dy prej tre kandidatëve të Gjykatës së Lartë janë në të njëjtën kohë edhe kandidatë për Gjykatën Kushtetuese, çka i vendos ata në pozitat e konfliktit të interesit, ndërkohë që një prej këtyre anëtarëve, në bazë të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese duhet të kishte lënë mandatin e tij.

e) Vakanca në KED-në e përkohshme 2019 për shkak të mungesës së një anëtari do të ndikojë në renditjen e kandidatëve dhe për rrjedhojë trupa është e paplotë dhe jo funksionale.

<sup>312</sup> <https://www.parlament.al/Files/Lajme/Dokument/ProcesverbaliShortiperKEDdate7122018.pdf>

<sup>313</sup> <https://www.parlament.al/Files/Lajme/Dokument/Relacioni7dhjetor2018.pdf>

Procesi i shortit i zhvilluar nga Kuvendit ka pasur pasqyrim të gjerë nga në media, ku është pasqyruar gjithashtu edhe qëndrimi i Presidentit mbi refuzimin e hedhjes së shortit, për shkak të vakumit ligjor.

### **c. Raporti monitorues i Avokatit të Popullit**

Avokati i Popullit publikoi raportin monitorues në faqen zyrtare të tij, i cili është kritik mbi procedurën e hedhjes së shortit<sup>314</sup>.

Në lidhje me transparencën e procedurës, Avokati i Populli evidenton se asnjë prej materialeve dhe urdhrave të publikuara nga Kryetari i Kuvendit nuk është vënë në dispozicion të këtij institucioni, përpara procedurës së hedhjes së shortit. Gjithashtu, njoftimi i shpalljes së shortit në faqet zyrtare nuk ka qenë i plotë dhe i mjaftueshëm. Më tej, Avokati i Popullit referon se nuk rezulton të jetë marrë në shqyrtim dhe në vlerësim raporti i këtij institucioni i publikuar në lidhje me shortin e KED-së 2018 dhe në veçanti, nuk është adresuar asnjëra nga problematikat e konstatuara dhe të paraqitura aty.

Në lidhje me formimin e listave, Avokati i Popullit evidenton se secili nga institucionet ka përdorur në mënyrë të ndryshme kriteret kushtetuese dhe ligjore. Këto kriteret duhet të zbatoheshin në mënyrë rigorozë nga institucionet përkatëse, por janë prezent shembuj të shumtë ku nuk rezulton të jetë vepruar kështu. Avokatit të Populli është në veçanti kritik në lidhje me listën e Gjykatës së Lartë, ku evidentohet *“se nëse të njëjtat kriteret që janë zbatuar për të përzgjedhur listën e ardhur nga prokuroria e përgjithshme dhe ose atë të ardhur për prokuroritë e apelit, Gjykata e Lartë do të mbetej pa përfaqësim duke qenë se asnjë prej anëtarëve të saj nuk i plotësojnë krejt kriteret e ligjit.”* Në të kundërt, po të përdroreshin të njëjtat kriteret që janë përdorur nga Gjykata e Lartë edhe për institucionet e tjera, *“atëherë në short për kandidatët e Prokurorisë së Përgjithshme dhe atyre të Apelit do të kishim shumë më tepër kandidatë dhe do të kishim edhe anëtarë zëvendësues nga këto kategori çka aktualisht nuk ka ndodhur”*.

Në konkluzion, Avokati i Popullit i kërkon Institucioneve përkatëse të vijojnë në amendimet ligjore në mënyrë që mënyra e përzgjedhjes së organeve të jetë më efektive dhe në përputhje me ligjin, sepse në rast të kundërt, interpretimet e ndryshme të ligjit, *“ulin potencialisht besimin e publikut në këtë proces përzgjedhjeje në veçanti dhe në aplikimin e reformës në drejtësi, në përgjithësi”*.

## **3. Funksionimi i KED-së 2019**

Referuar interpretimit sistematik të neneve 221/3 dhe 284 të ligjit nr.115/2016 ***është e paqartë se kush do të konsiderohet Këshilli i përkohshëm i Emërimeve në Drejtësi***. Anëtarët e KED-së 2017 iu nënshtruan procesit të vettingut me vonesë dhe shumica e tyre nuk arriti ta kalojë atë. Rrjedhimisht, KED 2017 nuk u konstituua me legjitimitet të plotë për të ushtruar vendimmarrje efektive. Po kështu ndodhi edhe me KED-në 2018. Nga leximi literal i përmbajtjes së dispozitave ligjore, KED i krijuar në formë të përkohshme, mund të funksionojë edhe pa nënshtrimin paraprak të kandidatëve në vetting. Megjithatë, në frymën e Kushtetutës dhe të legjislacionit të ri të drejtësisë, anëtarët e KED-ve të përzgjedhur me short në vitet 2017 - 2018 nuk mund të ushtronin efektivisht vendimmarrjen, sa kohë shumica e anëtarëve të tyre nuk e kalonin me sukses vettingun. Në të kundërt, minohej besueshmëria dhe cilësia e procesit vendimmarrës nëse shumica e këtyre anëtarëve do të shkarkohej nga vettingu.

Si rrjedhojë, KED 2017 nuk u mblodh kurrë, ndërsa KED 2018 realizoi vetëm një mbledhje në muajin mars 2018, duke pezulluar në vijim aktivitetin e tij në pritje të përfundimit të procedurave të vettingut. Duke u kthyer në analizën e aktivitetit të KED-së për vitin 2019, është e qartë se praktika e ndjekur nuk ka qenë konsistente. Edhe pse një pjesë e konsiderueshme e anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve nuk i janë nënshtruar procedurave të vettingut, KED 2019 ka filluar punën në mënyrë të plote duke marrë edhe vendimet e para. Referuar analizës së mësipërme, do të ishte më logjike pritja e përfundimit të vettingut edhe për anëtarët e KED 2019.

<sup>314</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20KED%202018%20.pdf>

Sa më sipër, dëshirojmë të evidentojmë edhe qëndrimin e ndryshëm të KED-së 2019 lidhur me këtë çështje, në kuadër të konsultimit të draftit paraprak të këtij raporti. KED 2019 vlerëson se duhet bërë dallimi midis legjitimitetit, pra edhe të standardit kushtetues të ngritjes dhe përbërjes së KED-së, me pritshmërinë e pasjes së një përbërje sa më me besueshmëri të KED-së. Ndër argumentet më kryesore të KED-së referojmë se, së pari, në dispozitat kushtetuese dhe ligjore për kushtet që duhet të përmbushen për të qenë anëtarë të KED-së, natyrshëm që nuk bëhet fjalë për kushtin e kalimit me sukses të procesit të vettingut. Së dyti, procesi i rivlerësimit kalimtar është në vetvete kalimtar, ndaj është e qartë se ky përcaktim bëhet për KED-in e parë që do të përzgjidhet nga Kuvendi ose Presidenti. Por ky nuk është një kriter ligjor dhe as kushtetues për zgjedhjen e anëtarëve në KED. Së treti, KED referon se procedurat dhe afatet e caktuara në Kushtetutë dhe në ligje për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe ILD-së janë të shkurtra, në asnjë rast jo më shumë se 3 muaj, dhe si të tilla duhet pashmangshmërisht të respektohen. Shkelja e tyre as që mund të mendohet të legjitimohet apo justifikohet me nevojën që anëtarët e KED-së të kalojnë njëherë të gjithë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Fakti që anëtarët e KED-së në tërësi, apo një pjesë e tyre nuk i janë nënshtruar ende procesit të vettingut nuk përbën dhe nuk duhet të pranohet se përbën element paragjykimi dhe cenues të integritetit të KED-së si institucion dhe të veprimtarisë së tij. Së katërti, sipas KED 2019 kushdo mund të shprehë mendimin e tij, por vetëm anëtarët e KED-së kanë të drejtën dhe përgjegjësinë që në mënyrë të pavarur, duke interpretuar dhe zbatuar vetëm Kushtetutën dhe ligjin, të çmojnë dhe vendosin vetë për çështjen e konstituimit dhe vijimit të veprimtarisë së tij. Prandaj, KED 2019 edhe pse dëgjoi me durim dhe respekt, nuk lejoi që asnjë opinion apo paralajmërim, sikurse mund të ketë pasur më parë, nuk lejoi as politikën dhe as ndonjë grup interesi, të ndërhyjë në procesin e analizës së situatës dhe vendimmarrjes së tij.

Sa më sipër, KShH në kuadër të transparencës dhe frymës së bashkëpunimit me institucionet shtetërore, vlerësoi të arsyeshme pasqyrimin në formë të përmbledhur të argumenteve të KED-së 2019 lidhur me faktin që legjitimiteti i këtij institucioni nuk cenohet apo nuk është i ndërvarur nga vettingu i anëtarëve të tij. **Pavarësisht nga kjo, KShH ndan sërish të njëjtin qëndrim si më herët në këtë raport dhe qëndrimet e tij të mbajtura publike për faktin se mosnënshtrimi në kohë ndaj procesit të vettingut i të gjithë anëtarëve të KED-së, para se të fillonin të ushtronin kompetencat e ngarkuara në Kushtetutë dhe në Ligj, përbën një praktikë të ndryshme nga dy KED-të e mëparshme, 2017 dhe 2018.** Ushtrimi i kompetencave të KED-së 2019 pa përfunduar me sukses vettingu i shumicës së anëtarëve të saj prek potencialisht besueshmërinë dhe cilësinë e procesit vendimmarrës të tyre. Sa kohë KED 2019, u ngrit sipas dispozitave tranzitore të ligjit nr.115/2016, pasi ende nuk ishin ngritur KLGJ dhe KLP, anëtarët e kësaj KED-je duhet ti nënshtroheshin me përparësi rivlerësimit. Efektivisht, anëtarët dhe zëvendës anëtarët e KED-së 2019 u parashikuan në listën prioritare të subjekteve që do ti nënshtroheshin procesit të vettingut pranë KPK-së, sikurse do të analizohet në vijim të këtij raporti. Megjithatë, ritmet e vettingut për këta anëtarë nuk ishin të shpejta dhe dinamike që të mundësonin përfundimin sa më parë të këtij procesi në të paktën një shkallë vettingu. Gjithashtu, nuk përbën shkak justifikues fakti që KED duhet të respektoje një afat ligjor tre mujor për verifikimin dhe renditjen e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese dhe ILD, pasi ky afat tre mujor nuk u respektua as me KED-në 2019, pavarësisht se kjo nuk u kushtëzua me procesin e përfundimit të vettingut të anëtarëve të kësaj KED-je.

Në nenin 149/d, pika 3 e Kushtetutës parashikohet në parim se KED duhet të përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short nga gjyqtarët e prokurorët ndaj të cilëve nuk është dhënë një masë disiplinore, ndërkohë që po i njëjti nen, në pikën 5, i delegon ligjit të veçante përcaktimin e kriterëve të tjera për shkallën e kualifikimit së bashku me rregullat e organizimit e funksionimit të KED-së. Këto kritere aktualisht përmbahen në nenin 221 të ligjit nr. 115/2016. Më tej, neni 229/1 i ligjit nr.115/2016 parashikon se pjesëmarrja në mbledhjet e KED është e detyrueshme dhe se anëtarët që mungojnë zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues, por nga ana tjetër pika 3 e këtij neni parashikon se KED vendos me shumicën e votave në prani të të paktën 5 anëtarëve. Nga interpretimi sistematik i këtyre dispozitave vërehet se KED mund të konstituohet edhe me një numër më të ulët se 9 anëtarë, siç ka ndodhur për KED 2019, për sa kohë që të paktën 5 anëtarë respektojnë kushtet e parashikuara nga ligji për pjesëmarrjen e votimin gjatë mbledhjes. Në situatën aktuale, krijimi dhe funksionimi i KED-së me

përbërjeje të plotë me 9 anëtarë do të ishte objektivisht e pamundur, në kushtet kur kushtetuta dhe ligji nr.115/2016 kërkojnë pjesëmarrjen e dy anëtarëve nga Gjykata Kushtetuese ndërkohë që ky institucion ka mbetur vetëm me një anëtar dhe anëtarët e rinj mund të emërohen vetëm pas listimit të kandidatëve i cili kryhet pikërisht nga KED.

Gjithsesi duhet evidentuar se Kushtetuta dhe ligji 115/2016 nuk e kanë disiplinuar shprehimisht një situatë të rëndësishme si ajo e mungesës së kandidatëve për shortin e KED. Edhe pse duhet konkluduar se KED, siç evidentuam më parë, mund të krijohet dhe të funksionojë edhe me vetëm 5 anëtarë, nuk është e qartë çfarë ndodh kur ka kandidatë të rinj për të plotësuar vakancat në KED. Gjithashtu, nuk është e qartë nëse shorti për KED-në mund të hidhet vetëm në muajin dhjetor, duke zgjedhur anëtarët e KED-së për vitin tjetër, apo nëse mund të hidhet edhe përpara këtij afati, pra në momentin kur disa kandidatë të rinj për vendet vakante në KED-në e vitit ushtrimor, të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për të qenë anëtarë të kësaj KED-je. Në të dy rastet ndodhemi përballë disa problematikave, të analizuara në vijim:

Së pari, në qoftë se shorti do të mund të hidhet vetëm në muajin Dhjetor, atëherë nuk do të këtë asnjëherë mundësi të plotësimit të vakancave të KED gjatë periudhës një vjeçare të mandatit. Së dyti, nëse shorti për vakancat e KED-së do të mund të hidhet edhe gjatë vitit ushtrimor të veprimtarisë së saj, caktimi i datës së shortit do të ishte një aspekt shumë delikat e për pasoje forcat politike do të ushtronin presion në institucionet për hedhjen ose mos hedhjen e shortit në një datë të caktuar në bazë të kandidatëve që do të plotësonin kriteret në atë datë.

Në konkluzion, vërehet se ligji nr.115/2016 nuk ka parashikuar plotësime përgjatë kohëzgjatjes së mandatit të KED-së për vakancat në anëtarët e saj, duke i dhënë përparësi vazhdimësisë së punës së KED kundrejt aspektit formal të plotësimit të vakancave. Kjo nga një anë për arsye të afatit vjetor për zgjedhjen e një KED-je të re dhe nga ana tjetër për respektimin e parashikimit kushtetues i cili pohon cakton muajin Dhjetor për hedhjen e shortit.

#### 4. Përbërja e KED-së 2019 dhe procesi i vettingut për kandidatët e saj

Pas krijimit të KED 2019 ka pasur disa zhvillime të cilat kanë ndikuar në mënyre direkte dhe indirekte në përbërjen e këtij organi:

a) Anëtari nga Gjykata Kushtetuese, Z. **Bashkim Dedja**, u shkarkua nga detyra me vendim të KPA-së të datës 17 dhjetor 2018<sup>315</sup>. Si rrjedhojë, KED 2019 mbeti me vetëm 7 anëtarë, ndërkohë që siç evidentohet më herët në këtë raport nuk kishte anëtarë zëvendësues nga Gjykata Kushtetuese.

b) Anëtarja nga Gjykata Kushtetuese, **Znj. Vitore Tusha**, u propozua nga Presidenti i Republikës si kandidate për postin e Kryetarit të Kontrollit të Shtetit<sup>316</sup>, përpara hedhjes së shortit për KED. Pas krijimit të KED 2019, Komisioni për Ekonominë dhe Financat i propozoi Kuvendit mosmiratimin e kandidaturës<sup>317</sup>, duke evidentuar, ndër të tjera, se “...emërimi i Zonjës Tusha në detyrën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, do të rrezikonte vijimin normal të organit të ri të sapokrijuar, duke vënë në dyshim procese më të rëndësishme sesa ai i zëvendësimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit...”. Në vijim, në datën 21 dhjetor 2018, Kuvendi, me 71 vota kundër, 3 abstenim dhe 1 pro, rrëzoi dekretin nr. 10929, datë 5.11.2018 “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të Znj. Vitore Tushës<sup>318</sup>. Ky rast është interesant për shkak të faktit se Kushtetuta e Ligji nuk parashikojnë se çfarë ndodh në rastin kur një magjistrat ose gjyqtar transferohet në një institucion tjetër të sistemit të drejtësisë gjatë mandatit si anëtar i KED. Nga interpretimi i frymës së reformës duhet pohuar se nëse një gjyqtar ose magjistrat mbetet brenda sistemit të drejtësisë, por me një funksion të ri (për shembull duke kaluar nga Gjykata e Apelit në Gjykatën e Lartë), mandati i tij në

<sup>315</sup> <http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2019/02/Vendimi-i-anonimizuar-subjekti-B.-Dedja.pdf>

<sup>316</sup> <http://president.al/njoftim-per-perzgjedhjen-e-znj-vitore-tusha-kandidate-ne-pozicionin-kushtetues-te-kryetarit-te-klsh-se/>

<sup>317</sup> <http://www.parlament.al/Files/Projekte/20181219160101Raport%20i%20Komisionit%20p%C3%ABr%20Ekonomin%C3%AB%20dhe%20Financat.pdf>

<sup>318</sup> <https://www.parlament.al/News/Index/7103>



KED vazhdon, ndërkohë që ky mandat përfundon nëse anëtari i KED humbet statusin e gjyqtarit ose magistratit.

c) Anëtari nga Gjykata e Lartë, Z. **Ardian Dvorani**, u tërhoq nga kandidimi për anëtar në Gjykatën Kushtetuese, me shkresën e datës 28 janar 2019<sup>319</sup>. Kjo ndikoi në shmangien e një konflikti të mundshëm interesi për kompetencat që ushtron KED për vlerësimin e kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

d) Anëtari zëvendësues Z. **Medi Bici** rezultoi të jetë kandidat për anëtar në Gjykatën Kushtetuese, aspekt i cili krijoi fillimisht shkak për konflikt interesi të mundshëm për shkak të faktit se gjatë mbledhjeve të para të KED 2019, kanë marrë pjesë edhe anëtarët zëvendësues. Referuar komenteve dhe sugjerimeve të KED-së për draftin e këtij raporti, Z. Bici është tërhequr nga kandidatura e tij për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në dt. 28.03.2019. Në datë 12.12.2018 Z. Bici u zgjodh edhe anëtar i KLGJ dhe mandati i tij si anëtar i Gjykatës së Lartë është i pezulluar. Si rrjedhojë është krijuar paqartësi për faktin nëse këto dy detyra funksionale mund të kryhen në të njëjtën kohë. Lidhur me këtë çështje, KED 2019 në komentet dhe sugjerimet e saj për draftin e raportit të KShH-së evidenton se ushtrimi njëkohësisht i detyrës së anëtarit të KED-së dhe anëtarit të KLGJ-së nuk parashikohet në Kushtetutë dhe në Ligj si rrethanë papajtueshmërie. Pavarësisht nga ky argument, KShH çmon se edhe në kushtet kur ushtrimi i njëkohshëm i këtyre detyrave nuk parashikohet shprehimisht në kushtetutë dhe në ligj si kriter ndalues për të mbajtur një pozicion, në vlerësimin tonë këto dy funksione nuk mund të mbahen njëkohësisht. Sa kohë statusi i gjyqtar i Gjykatës së Lartë për Z. Bici pezullohet, kjo pezullon automatikisht çdo funksion që mbahet prej tij për shkak të kësaj cilësie si gjyqtar i Gjykatës së Lartë dhe rrjedhimisht të anëtarit të KED-së. Gjithashtu, edhe pse në kuadrin ligjor nuk është parashikuar shprehimisht, mbajtja e funksionit të anëtarit të KED-së që bën verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve të ILD-së krijon në një farë mase konflikt me mbajtjen e funksionit të anëtarit të KLGJ-së, e cili do të marrë në shqyrtim procedimet disiplinore të filluara nga ILD.

#### a. Rivlerësimi kalimtar (vettingu) i anëtarëve të KED 2019

Procesi i deritanishëm i vettingut (gjatë kohështrirjes që ky raport mbulon) për anëtarët e KED 2019 evidenton këto të dhëna:

a) Katër anëtarët Znj. **Vitore Tusha**, Z. **Ardian Dvorani**, Znj. **Arta Marku**, Znj. **Fatjona Memçaj** si dhe anëtari zëvendësues Z. **Medi Bici** u konfirmuan në detyre me vendime të KPK-së, të cilat morën formën e prerë para hedhje së shortit për KED 2019.

b) Anëtari nga Gjykata Kushtetuese **Z. Bashkim Dedja**, u shkarkua nga detyra me vendim të KPA-së të datës 17 dhjetor 2018<sup>320</sup> e si rrjedhojë, KED 2019 mbeti me 7 anëtare, duke qenë se nuk kishte anëtar zëvendësues nga Gjykata Kushtetuese.

c) Anëtari Z. **Eriol Roshi**, me vendim të KPK të datës 7 shkurt 2019<sup>321</sup>, u konfirmua në detyrë. Në faqen e Komisionerit Publik është publikuar informacioni se për këtë subjekt nuk është ushtruar e drejta e ankimit në KPA<sup>322</sup>.

d) Anëtarët e tjerë janë ende në pritje të zhvillimit të procedurës së rivlerësimit. Përkatesisht, shorti nga KPK për anëtarin zëvendësues **Gurali Brahimllari** është hedhur në datë 16 maj 2018<sup>323</sup>, shorti për anëtarin Z. **Fatri Islamaj** është hedhur në datë 11 nëntor 2018<sup>324</sup>, ndërsa shorti për anëtarin Znj. **Margarita Buhali** dhe zëvendës anëtarin Znj. **Klodiana Veizi (Mema)** është hedhur në datë 16 janar 2019<sup>325</sup>. Në të gjitha rastet nuk është ende shpallur data e seancave dëgjimore.

<sup>319</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/terheqje\\_nga\\_kandidimi\\_ne\\_gjkushtetuese\\_1912.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/terheqje_nga_kandidimi_ne_gjkushtetuese_1912.pdf)

<sup>320</sup> <http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2019/02/Vendimi-i-anonimizuar-subjekti-B.-Dedja.pdf>

<sup>321</sup> <http://kpk.al/2019/02/07/njoftim-104/>

<sup>322</sup> <http://ikp.al/2019/04/04/njoftim-per-mosankimin-e-vendimit-nr-104-date-7-2-2019-te-kpk-se-per-subjektin-e-rivleresimit-z-eriol-roshi/>.

<sup>323</sup> <http://kpk.al/2018/05/16/njoftim-15/>

<sup>324</sup> <http://kpk.al/2018/11/16/njoftim-75/>

<sup>325</sup> <http://kpk.al/2019/01/16/njoftim-100/>

## 5. Veprimtaria e deritanishme e KED-së 2019 (për periudhën Janar – Mars 2019)

### 5.1 Mbledhja e parë konstituuese e KED-së 2019

Mbledhja e parë e KED-së (të Përkohshëm) u zhvillua në dt.15 Janar 2019, pranë ambienteve të Gjykatës së Lartë, në sallën e mbledhjeve. Për realizimin e saj, publiku u njoh nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të KED<sup>326</sup>, të njoftimit për median<sup>327</sup> mbi thirrjen e kësaj mbledhje nga Kryetari i saj Z. Dvorani, në përputhje me nenin 149/d, pika 4 të Kushtetutës. Rendi i ditës rezultonte i publikuar në njoftimin e shpërndarë nga vetë institucioni dhe nga mediat.<sup>328</sup>

Të pranishëm në mbledhje ishin 7 anëtarët e përhershëm dhe 3 anëtarët zëvendësues të KED-së 2019. Gjithashtu, të pranishëm në këtë mbledhje ishin përfaqësues të misioneve të asistencës ndërkombëtare (OPDAT, EURALIUS) përfaqësues të Komisionit parlamentar të Ligjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Avokati i Popullit dhe përfaqësues të Presidencës.

Nga monitorimi i mbledhjes së parë KED 2019, e cila zgjati rreth 5 orë u vërejt se mbledhja u karakterizua nga diskutime aktive nga pjesëmarrësit. Procesverbali i mbledhjes është publikuar në faqen zyrtare të KED-së.

Sikurse është evidentuar më herët në këtë raport, mungesa e anëtarësisë së plotë të KED-së nuk përbën shkak për të penguar mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së KED-së, e cila sipas nenit 229, pika 3 të Ligjit vendos edhe në prezencën e kuorumit prej të paktën 5 anëtarë.

KED vendosi të angazhohet fillimisht për hartimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të saj. Gjithashtu, në mbledhjen e parë u evidentua se sipas kërkesave që janë dorëzuar në KED për pozicionet vakante, kanë kandiduar 40 magjistratë dhe jo magjistratë, të cilët do të verifikohen nga KED.

Në lidhje me ngarkesën e pazakontë, KED vlerësoi të domosdoshme rritjen e numrit të personelit administrativ të Gjykatës së Lartë, me qëllim që të vendosen në dispozicion të veprimtarisë së KED-së. Gjithashtu, KED vlerësoi t'i drejtohet KLGJ-së dhe KLP-së, duke i kërkuar të mundësojë lehtësimin apo heqjen e ngarkesës së veprimtarisë si gjyqtarë apo prokuror të anëtarëve të KED-së, me qëllim që ata ti dedikohen plotësisht veprimtarisë së këtij institucioni. Në fund, u nënvizua nevoja për vazhdimin e bashkëpunimit me përfaqësuesit e misioneve të asistencës ndërkombëtare në vendin tonë si EURALIUS dhe OPDAT përgjatë vitit 2019. Mbledhja e radhës u vendos të mbahet, një javë më vonë, në datën 21.01.2019.

Në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit evidentohet se në përputhje me nenin 229, pika 1 të ligjit ajo është e detyrueshme. Ligji pavarësisht se nuk është shprehur në mënyrë eksplicite, në nenin 220, pika 3 të tij pohon se pjesëmarrja e anëtarëve zëvendësues është e parashikuar vetëm në rast pamundësie ose të konfliktit të interesit të anëtarit. Në mbledhjen e parë të monitoruar rezultoi që

<sup>326</sup> Nuk bëhet fjalë për një Webpage individual të këtij institucioni, por është një kategorizim i faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë: [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Njoftime\\_per\\_median\\_5485\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Njoftime_per_median_5485_1.php)

<sup>327</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/njoftim\\_per\\_median\\_mbi\\_mbledhjen\\_e\\_pare\\_te\\_ked\\_15\\_01\\_2019\\_1901.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/njoftim_per_median_mbi_mbledhjen_e_pare_te_ked_15_01_2019_1901.pdf)

<sup>328</sup> Mbledhja e parë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të Përkohshëm) 2019 është përcaktuar të zhvillohet me këtë rend dite:

1. Kostituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të Përkohshëm) 2019.
2. Përgatitja e akteve nënligjore dhe e rregullave të brendshme, sipas detyrimeve dhe delegimeve të ligjit nr. 115/2016, të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Afatet, përparësitë dhe veprimet për përgatitjen dhe miratimin e tyre në kohën më të shkurtër dhe të arsyeshme.
3. Informacion për pozicionet vakante, të shpallura nga Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë, për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, numrin e kandidaturave dhe administrimin e dokumentacionit përkatës.
4. Informacion për problematikën lidhur me pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, numrin e kandidaturave dhe administrimin e dokumentacionit përkatës.
5. Çështje të organizimit, dokumentimit dhe administrimit të dokumentacionit dhe të çështjeve, si edhe mbi nevojat e mbështetjes administrative dhe me personel nga Gjykata e Lartë për mirëfunksionimin dhe efektivitetin e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

anëtarët zëvendësues jo vetëm që ishin prezentë, por për pika të përcaktuara të rendit të ditës ata shprehën dhe mendimet e tyre. Lidhur me këtë çështje, KED 2019, pas konsultimit të draft raportit të KShH-së evidenton se *“KED 2019, veçanërisht nisur nga gjendja e konstatuar ku nuk ishte përgatitur, diskutuar dhe miratuar asnjë akt nënligjor normativ dhe rregullator për funksionimin e tij, vlerësoi se përgjatë gjithë veprimtarisë përgatitore legislative, por edhe në diskutimin e projekt akteve të angazhoheshin edhe anëtarët zëvendësues. .... Këshilli vendosi qysh në mbledhjen e parë të tij që, angazhimi i anëtarëve zëvendësues në këto raste, së pari nuk ishte i detyrueshëm për ta dhe, së dyti, ata ato mund të diskutonin për të dhënë mendimin e tyre dhe nuk do të kishin, sikurse edhe nuk kanë, të drejte vote për vendimet që duhen marrë nga KED.”*

Avokati i Popullit i pranishëm në këtë mbledhje evidentoi sërish shqetësimin për mungesën e plotësisht të kushteve dhe kriterëve ligjore të disa prej anëtarëve, elementë të cilët duhet të ishin mbajtur parasysh në momentin e zhvillimit të procedurës së shortit dhe procedurave të përzgjedhjes nga ana e institucioneve përkatëse. Duke ju referuar këtyre shqetësimeve, KShH vëren se Kushtetuta dhe Ligji nr.115/2016 kanë hapësira vakumi lidhur me mbarimin e mandatit të anëtarit të KED-së para kohe, nëse vërtetohen kushtet e pa zgjedhshmërisë në ushtrimin e funksionit apo për rrethana të tjera sikurse parashikohet për KLGJ-në dhe KLP-në. Gjithashtu, nuk është parashikuar organi që do të deklarojë me vendim mbarimin e mandatit. Ligji nr.115/2016 ka parashikuar në nenet 223, 224, dhe 225 vetëm rastet e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit, heqjes dorë apo përjashtimit të anëtarëve, por këto janë raste individuale që lidhen me objektin dhe veprimtarinë e KED-së në mbledhje të caktuara dhe nuk çojnë në përfundimin e mandatit të anëtarit të KED-së.

Nga përfaqësuesi i ftuar nga radhët e opozitës në këtë mbledhje, u përdorën në mënyrë të përsëritur deklaratatë intimiduese me ngjyrime “politike”. Kjo solli tej zgjatjen e mbledhjes, duke mos arritur në rezultate konkrete. Gjithashtu, përse i përket organizimit të veprimtarisë së KED-së, nëpërmjet krijimit të grupeve të punës për draftimin e rregulloreve të parashikuara me ligj, KShH është i mendimit se aspekti i kolegjalitetit të punës për hartimin e këtyre rregulloreve është element tepër i rëndësishëm. Si rrjedhojë, janë të pabaza argumentet e dhëna nga disa anëtarë të KED-së, për mos pjesëmarrje në këto procese pune, për shkak të dhënies së kontributit më parë si anëtar të KED 2018.

## 5.2 Veprimtaria e mëtejshme e KED-së dhe transparenca e tyre

Gjatë dy muajve të para nga data e konstituimit të KED 2019, ky institucion është mbledhur edhe 6 herë të tjera. Gjatë këtyre mbledhjeve nuk veprimtaria e KED-së nuk ka qenë mjaftueshëm transparente, bazuar në të dhënat dhe argumentet e përcjella në vijim të raportit.

Mbledhjet e KED-së janë zhvilluar me **dver të mbyllura**, në zbatim të nenit 233/1 të ligjit nr.115/2016 i cili parashikon se *“mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë të mbyllura”*. Megjithatë, KShH ju drejtua me shkresë të veçantë KED-së, me qëllim që në kuadër të interesit publik dhe rëndësisë që ka ky institucion, të mundësohej pjesëmarrja mbledhjet e KED-së të një vëzhguesi të KShH-së. Deri më tani, kjo kërkesë nuk është marrë ende në konsideratë. Ndërkohë që KED 2019, në komentet dhe sugjerimet e tij për këtë draft raport, evidenton ndër të tjerash se *“Këshilli nuk ka asnjë diskrecion të vendosë lejimin e të tretëve për të marrë pjesë në mbledhjet e tij pasi duhet të zbatojë rregullin imperativ të parashikuar në nenin 233 dhe 242 të ligjit nr.115/2016”*. Mgjth, sërish ka një kontradiktë në këtë qasje të KED 2019 pasi ky diskrecion i është akorduar Këshillit në Rregulloren e Brendshme, ku vetë KED 2019 referon se *“në këtë rregullore parashikohet mundësia që në mbledhjet e Këshillit të thirren dhe marrin pjesë individë apo subjekte për çështje për të cilat nga Këshilli kërkohet bashkëpunim apo përmbushje e detyrimeve procedurale në cilësinë e ekspertit*. Pavarësisht se KED evidenton faktin se të gjithë ekspertët e thirrur, përfshi ata të asistencës ndërkombëtare nuk kanë marrë pjesë në mbledhje të Këshillit që nuk kanë lidhje me objektin e veprimtarisë së tyre, për të cilin janë thirrur, sërish KShH vlerëson se niveli i ulët i transparencës së evidentuar në faqen e Këshillit nuk mundëson një gjykim të drejtë dhe objektiv lidhur me këtë parashtrim.

KShH ka vërejtur se elementi i transparencës së KED-së është cenuar edhe për shkak të mospublikimit në kohë të materialeve të mbledhjes si dhe dhënies së një informacioni tepër të kufizuar për publikun që akseson faqen zyrtare të KED-së. Konkretisht, nuk janë publikuar në faqen zyrtare të KED-së procesverbalet e këtyre mbledhjeve. Në faqen zyrtare të KED-së jepet vetëm një përmbledhje e shkurtër dhe jo e mjaftueshme e zhvillimit të tyre.

Sipas nenit 233/3, Ligji 115/2016 “*Këshilli komunikon me publikun pas çdo mbledhjeje përmes një komunikate për mediat cila informon së paku për:*

- i. kohën e mbledhjes;*
- ii. pjesëmarrjen;*
- iii. kandidatët, jetëshkrimin e përditësuar të tyre, pozicionet për të cilat ata kandidojnë dhe institucionet propozuese;*
- iv. një shpjegim të shkurtër të procedurave dhe të metodës së ndjekur për verifikimin kushteve ligjore dhe të kriterëve të përdorura për renditjen e kandidatëve;*
- v. aktin përfundimtar të verifikimit dhe renditjes së kandidatëve.*

Nga analiza e këtyre komunikatave, jemi të mendimit se gjatë mbledhjeve të para nuk janë pasqyruar në mënyrë të plotë zhvillimet e ndodhura (në disa raste nuk jepen detaje mbi pjesëmarrësit, në disa të tjera nuk jepet koha e tyre, në të gjitha rastet përmbledhja komunikohet në formë tepër të shkurtuar: pak rreshta për një mbledhje që ka zgjatur disa orë etj.) Pas konsultimit të këtij raporti me KED 2019, na është referuar se gjatë periudhës Janar – Mars 2019, janë zhvilluar nga ky Këshill 14 mbledhje dhe jo 6 mbledhje sikurse është evidentuar me më hollësi në pjesën vijuese të këtij raporti. Për secilën prej këtyre 14 mbledhjeve, KED 2019 ka referuar kohëzgjatjen, datën kur është zhvilluar mbledhja si dhe rendin e ditës së saj, mgjth KShH ka pasqyruar në vijim vetëm informacionin e publikuar për publikun në faqen zyrtare të KED-së 2019, deri në fund të muajit Mars 2019, kur është shtrirë monitorimi ynë. Gjithashtu, KShH nuk ndan të njëjtin vlerësim me KED 2019 se përcaktimet e nenit 233/3 të ligjit nr.115/2016 i referohen rasteve kur në mbledhjet e Këshillit janë shqyrtuar çështje që kanë të bëjnë me procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave. Në mendimin tonë, kjo dispozitë përmban elementë që lidhen edhe me këto mbledhje, për të saktësuar natyrën e informacionit që duhet të publikohet kur ka edhe mbledhje të tilla. Por kjo nuk përjashton KED 2019 nga detyrimi për ti komunikuar publikut pas çdo mbledhje komunikatën për median. Ndërkohë që procesverbali i mbledhjes është pikërisht dokumenti që jep një tablo më të mirë ndaj publikut të veprimtarisë së KED-së.

KShH nuk ndan të njëjtin qëndrim me KED 2019 për konceptin e “kohës së mbledhjes”. Sipas KED me këtë terminologji do të kuptohet data dhe ora e fillimit të mbledhjes dhe jo “kohëzgjatja e mbledhjes”. Në vlerësimin tonë, koha e mbledhjes përfshin gjithashtu edhe kohën në të cilën mbledhja ka përfunduar. Dhënia e këtij elementi, përveçse përfshihet në këtë koncept, nga ana tjetër nuk e cenon KED-në në veprimtarinë e saj, përveçse mundëson gjithashtu krijimin e një perceptimi më të plotë tek publiku për ngarkesën dhe volumin e veprimtarisë së këtij organi.

Lidhur me këtë aspekt të evidentuar nga monitorimi ynë, KED 2019 evidenton se është gjendur përpara vështirësive të shumta objektive dhe pengesave teknike për realizimin e këtyre detyrimeve... si p.sh. personeli mbështetës i pamjaftueshëm, teknologjia me mangësi në realizimin e detyrës si edhe shtimi progresiv i ngarkesës së punës së KED-së dhe personelit mbështetës nga numri i pazakontë i vendeve vakante në proces, të gjitha këto shoqëruara edhe me gjendjen e jashtëzakonshme të ngarkesës së punës së Gjykatës së Lartë. Sikurse mund të konstatohet nga pasqyra e mbledhjeve të KED-së, ato kanë qenë të shumta dhe me kohëzgjatje të konsiderueshme, gjë që kërkon edhe angazhimin të madh në mjete dhe personel për zbardhjen e procesverbaleve.

Për mbledhjet e zhvilluara deri më tani nga KED, informacioni i publikuar në faqen zyrtare të KED-së evidenton këto të dhëna:

**i) Mbledhja e datës 21.01.2019**<sup>329</sup>

Konkretisht, për këtë mbledhje mungon informacioni për pjesëmarrjen, kohën e mbledhjes, të ftuarit si dhe nuk është publikuar procesverbali i mbledhjes. Rendi i ditës rezulton të jetë publikuar, dhe konkretisht ka qenë për diskutimin dhe miratimin e projekt rregullore së brendshme për organizimin dhe funksionimin e KED-së. Gjithashtu, rezulton të jetë publikuar një përmbledhje e mbledhjes. Konkretisht përmbledhja e publikuar është si vijon:

- Këshilli, lidhur me materialet e përgatitura, vlerësoi se afati i përcaktuar në mbledhjen e mëparshme për të diskutuar mbi këtë projekt, ishte i pamjaftueshëm.
- Anëtarët e KED-së vlerësuan ndërkohë si të domosdoshme edhe marrjen e kohës së nevojshme nga institucioni i Avokatit të Popullit, për të parashtruar opinionet e tij lidhur me këtë akt.
- Mbledhja e radhës do të mbahet në ditën 28.01.2019 ora 16.00.

**ii) Mbledhja e datës 28.01.2019**<sup>330</sup>

Konkretisht për këtë mbledhje mungon informacioni për pjesëmarrjen, kohën e mbledhjes, të ftuarit si dhe nuk është publikuar procesverbali i mbledhjes. Rendi i ditës rezulton të jetë publikuar, dhe konkretisht ka qenë për diskutimin dhe miratimin e projekt rregullore së brendshme, për organizimin dhe funksionimin e KED-së. Gjithashtu, rezulton të jetë publikuar një përmbledhje e mbledhjes. Konkretisht përmbledhja e publikuar është si vijon:

- Në fillim të mbledhjes, Kryetari i KED-së 2019 i njoftoi Këshillit vullnetin e tij për tërheqjen nga kandidimi për postin vakant të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese<sup>331</sup>.
- Këshilli diskutoi dhe miratoi një pjesë të dispozitave të projekt aktit.
- Mbledhja e radhës do të mbahet në ditën 01.02.2019 ora 10.00.

**iii) Mbledhja e datës 01.02.2019**<sup>332</sup>

Pjesëmarrës në mbledhje kanë qenë të gjithë anëtarët si dhe dy anëtarë zëvendësues të KED-së. Mbledhja ka zgjatur rreth dy orë. Procesverbali i mbledhjes nuk është publikuar ende në faqen zyrtare. Të ftuar në këtë mbledhje kanë qenë Avokati i Popullit dhe subjektet e parashikuara në pikën 2 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, përkatësisht Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit si dhe Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, një prej të cilëve i përket opozitës. Ekspert i EURALIUS është ftuar në mbledhje, për shkak të mbështetjes me asistencë ligjore në përgatitjen dhe miratimin e projekt akteve rregullatorë të KED. Rendi i ditës së kësaj mbledhje ka qenë:

- Vijimi i diskutimit dhe miratimi i projekt rregullore së brendshme për organizimin dhe funksionimin e KED-së,
- Diskutimi mbi ecurinë dhe vijimin e bashkëpunimit të KED me EURALIUS për vitin 2019.

Gjithashtu, rezulton të jetë publikuar një përmbledhje e. Konkretisht përmbledhja e publikuar është si vijon:

- Këshilli diskutoi dhe vendosi në parim mbi disa çështje që lidhen me pozicionin dhe rolin e Avokatit të Popullit dhe të subjekteve që ftohen në mbledhjet dhe veprimtaritë e tij, si dhe miratoi disa dispozita të tjera të projekt rregullore së brendshme për organizimin dhe funksionimin e KED-së.

<sup>329</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja\\_e\\_K\\_E\\_D\\_e\\_dates\\_21\\_01\\_2019\\_5499\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_K_E_D_e_dates_21_01_2019_5499_1.php)

<sup>330</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja\\_e\\_K\\_E\\_D\\_e\\_dates\\_28\\_01\\_2019\\_5510\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_K_E_D_e_dates_28_01_2019_5510_1.php)

<sup>331</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/terheqje nga kandidimi ne gjkushtetuese\\_1912.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/terheqje nga kandidimi ne gjkushtetuese_1912.pdf)

<sup>332</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja\\_e\\_K\\_E\\_D\\_e\\_dates\\_01\\_02\\_2019\\_5518\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_K_E_D_e_dates_01_02_2019_5518_1.php)

- Këshilli vlerësoi ecurinë e bashkëpunimit të KED me EURALIUS përgjatë vitit 2018 dhe u shpreh për vijimin e këtij bashkëpunimi për mbështetjen dhe asistencën ligjore në procesin e përgatitjes dhe miratimit të projekt akteve rregullatorë dhe normative të KED, si edhe për forcimin e kapaciteteve të KED në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese.
- Mbledhja e radhës do të mbahet në ditën 08.02.2019.

**iv) Mbledhja e datës 08.02.2019<sup>333</sup>**

Pjesëmarrës në mbledhje kanë qenë të gjithë anëtarët si dhe të gjithë anëtarët zëvendësues të KED-së. Mbledhja ka zgjatur rreth gjashtë orë e gjysmë. Procesverbali i mbledhjes nuk është publikuar ende në faqen zyrtare. Të ftuar në këtë mbledhje kanë qenë Avokati i Popullit dhe subjektet e parashikuara në pikën 2 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, përkatësisht Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit si dhe Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, një prej të cilëve i përket opozitës. Dy ekspertë të misionit EURALIUS janë ftuar në mbledhje, për shkak të mbështetjes me asistencë ligjore në përgatitjen dhe miratimin e projekt akteve rregullatorë të KED. Rendi i ditës së kësaj mbledhje ka qenë vijimi i diskutimit dhe miratimi i projekt rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e KED-së.

Rezulton të jetë publikuar një përmbledhje e mbledhjes si vijon:

- Këshilli diskutoi dhe miratoi të plotë rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
- Mbledhja e radhës do të mbahet në ditën 15.02.2019

**v) Mbledhja e datës 15.02.2019<sup>334</sup>**

Pjesëmarrës në mbledhje kanë qenë të gjithë anëtarët si dhe të gjithë anëtarët zëvendësues të KED-së. Nuk jepet informacion për kohëzgjatjen e mbledhjes. Procesverbali i mbledhjes nuk është publikuar ende në faqen zyrtare. Të ftuar në këtë mbledhje kanë qenë Avokati i Popullit dhe subjektet e parashikuara në pikën 2 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, përkatësisht Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit si dhe Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, një prej të cilëve i përket opozitës. Dy ekspertë të misionit EURALIUS janë ftuar në mbledhje, për shkak të mbështetjes me asistencë ligjore në përgatitjen e projekt akteve rregullatorë të KED. Rendi i ditës së kësaj mbledhje ka qenë diskutimi dhe miratimi i projekt vendimit mbi procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion.

Gjithashtu, rezulton të jetë publikuar një përmbledhje e mbledhjes si vijon:

- Miratimi i projektvendimit mbi procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion.
- Mbledhja e radhës do të mbahet në ditën 22.02.2019.

**vi) Mbledhja e datës 22.02.2019<sup>335</sup>**

Pjesëmarrës në mbledhje kanë qenë të gjithë anëtarët si dhe të gjithë anëtarët zëvendësues të KED-së. Nuk jepet informacion për kohëzgjatjen e mbledhjes. Procesverbali i mbledhjes nuk është publikuar ende në faqen zyrtare. Të ftuar në këtë mbledhje kanë qenë Avokati i Popullit dhe subjektet e parashikuara në pikën 2 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, përkatësisht Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit si dhe Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, një prej të cilëve i përket opozitës. Ekspertë të misionit EURALIUS janë ftuar në mbledhje, për shkak të

<sup>333</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja\\_e\\_KED\\_e\\_dates\\_08\\_02\\_2019\\_5527\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_KED_e_dates_08_02_2019_5527_1.php)

<sup>334</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja\\_e\\_KED\\_e\\_dates\\_15\\_02\\_2019\\_5534\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_KED_e_dates_15_02_2019_5534_1.php)

<sup>335</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja\\_e\\_KED\\_e\\_dates\\_22\\_02\\_2019\\_5540\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_KED_e_dates_22_02_2019_5540_1.php)



mbështetjes me asistencë ligjore në përgatitjen e projekt akteve rregullatorë të KED. Rendi i ditës së kësaj mbledhje ka qenë diskutimi dhe miratimi projekt vendimit mbi procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion.

Sipas përmbledhjes rezulton se Këshilli, në përfundim të diskutimeve në parim mbi këtë projektvendim, vendosi datën e mbledhjes së radhës për t'u zhvilluar ditën e premte dt. 01.03.2019.

## **6. Miratimi i Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e KED-së**

Në mbledhjen e datës 8 shkurt 2019, sipas faqes së saj zyrtare, KED rezulton se ka diskutuar dhe miratuar të plotë “Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”. Ky është vendimi i parë i KED-së 2019, i cili rezulton të jetë publikuar edhe në faqen zyrtare të këtij institucioni<sup>336</sup>.

Në lidhje me aspektin e transparencës, nuk jepen detaje mbi diskutimet brenda Këshillit dhe mbi procedurat e votimit, si dhe nuk është publikuar procesverbali i kësaj mbledhje.

Disa nga aspektet më të rëndësishme të kësaj rregulloreje lidhen me rregullin 7/3 ku parashikohen rastet e pjesëmarrjes së anëtarëve zëvendësues në mbledhje. Konkretisht, sipas këtij rregulli “Anëtarët zëvendësues kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit, në rastet kur realizohet puna përgatitore ose kur në rendin e ditës, shqyrtohen çështje nga ato të përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 8 të kësaj Rregulloreje të Brendshme”, pra në të gjitha mbledhjet ku KED ushtron kompetencat e tij në mënyrë të përgjithshme. Ndërkohë, i vetmi rast ku nuk parashikohet pjesëmarrja e anëtarëve zëvendësues është ai i shkronjës “a” të njëjtit nen, d.m.th. kur KED: “shqyrton dhe vendos për çështjet e lidhura me procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore, të pasurisë, integritetit, të shkuarës profesionale e personale, si edhe me procedurat e vlerësimit të kriterëve profesionale e morale për përzgjedhjen, pikëzimin dhe renditjen e kandidatave për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë”.

Në rregullore është parashikuar se përveç anëtarëve, zëvendës anëtarëve, Avokatit të Popullit, organeve të parashikuara nga neni 233/1 i Ligjit 115/2016, në nenin 13 të Rregullores parashikohet se, “Rast pas rasti, sipas përcaktimeve të ligjit ose të nevojave për mbështetje me konsulencë apo njohuri të posaçme, Këshilli angazhon dhe thërret në veprimtaritë dhe mbledhjet e tij ekspertë apo subjekte me njohuri të posaçme të fushës përkatëse”. Ky parashikim sikurse është analizuar më sipër përjashton nga pjesëmarrja monitoruesit dhe vëzhguesit që kërkojnë të atashohen për të mbikëqyrur mbarëvajtjen e mbledhjeve, ndaj standardi i ndjekur për të lejuar ekspertët që kanë njohuri të posaçme krijon pabarazi me vëzhguesit e organizatave të specializuara në monitorimin e sistemit të drejtësisë.

Në nenin 17, pika 7 të rregullores parashikohet se do të bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë menjëherë pas zhvillimit të mbledhjes, procesverbali i përmbledhur i mbledhjes. Publikimi i tij bëhet menjëherë pas nënshkrimit nga anëtarët e Këshillit. Rregullorja nuk normon se cilat pjesë të procesverbalit publikohen dhe se çfarë nënkupton publikimi i përmbledhjes së tij. Ashtu sikurse është analizuar më herët në këtë raport, përmbledhjet e publikuara të mbledhjeve të KED-së janë shumë të përgjithshme dhe të kufizuara në informacion dhe nuk i japin një qasje transparente veprimtarisë së Këshillit. Përkundrazi, me aspektet e përmbledhjeve të publikuara, KED mund të konsiderohet një institucion i mbyllur në opinionin publik.

Për sa i përket procedurave të brendshme, në datë 15.02.2019, KED ka miratuar vendimin nr. 2, “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion<sup>337</sup>”

<sup>336</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Akte\\_te\\_K\\_E\\_D\\_5475\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Akte_te_K_E_D_5475_1.php)

<sup>337</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 19, date 19 Shkurt 2019

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2019/PDF-2019/19-2019.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2019/PDF-2019/19-2019.pdf)

## 7. Veprimtaria e Komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit 115/2016, lidhur me monitorimin e KED-së

Komisioni i Pavarur për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr.115/2016 (KPKM), në monitorimin e tij periodik, për periudhën nëntor 2018 - janar 2019<sup>338</sup>, evidenton se në lidhje me KED është miratuar raporti mbi “Monitorimin e procesit të ngritjes së KED-së së Përkohshme në Sistemin e Drejtësisë dhe disa rekomandime për funksionimin e tij”. Ky raport nuk gjendet i publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni, çka e bën të pamundur objektivisht dhënien e një opinioni apo vlerësimi për përmbajtjen e tij<sup>339</sup>. Në këtë drejtim, KShH tërheq vëmendjen për më shumë transparencë në veprimtarinë e këtij institucioni të rëndësishëm mbikëqyrës, karshi opinionit publik dhe ekspertëve apo organizatave të interesuara. Pas konsultimit të këtij draft raporti me KPKM-në, ky organ ka referuar ndër të tjerash se nuk është institucion me personalitet juridik dhe nuk administron faqe zyrtare të vetën. Kjo faqe është pjesë përbërëse e faqes së institucionit të Kuvendit të Shqipërisë dhe administrohet nga ky i fundit, ndaj shqetësimi i KShH-së i është përcjellë Kuvendit.

Në periudhën nëntor 2018 – janar 2019 evidentohet se KPKM i ka dërguar institucioneve përkatëse një numër të lartë shkresash në lidhje me KED-në dhe këto institucione kanë dërguar përgjigjet e tyre. Ndërkohë **asnjë prej këtyre shkresave nuk është publikuar nga ky Komision**, apo nuk është publikuar në mënyrë të përmbledhur se cila ka qenë natyra dhe objekti i këtyre shkresave. Edhe në këtë drejtim, veprimtaria e KPKM-së nuk ka pasur transparencë në faqen e Kuvendit.

KPKM evidenton se gjatë mbledhjeve të para të KED-së 2019, anëtarët e këtij Komisioni nuk janë ftuar të marrin pjesë, bazuar në nenin 233 të ligjit nr. 115/2016 nga ana e kryetarit të KED. Komisioni gjithsesi vlerëson se neni 288 i ligjit nr. 115/2016, është një dispozitë e posaçme që i jep KPKM-së të drejtën për të marrë pjesë në mbledhjet e KED. Konkretisht, në këtë dispozitë parashikohet se KPKM, ndër të tjerash “*bën koordinimin midis institucioneve dhe organeve që zbatojnë parashikimet ligjore të këtij ligji, si dhe ndjek ecurinë e zbatimit të parashikimeve ligjore nga institucionet respektive, të parashikuara në ligj, brenda afateve ligjore të parashikuara*”

Raporti për periudhën nëntor 2018 – janar 2019 përmban gjithsesi një përmbledhje të raportit mbi “*Monitorimin e procesit të ngritjes së Këshillit të Emërimeve të Përkohshëm në Sistemin e Drejtësisë dhe disa rekomandime për funksionimin e tij*”. Në këtë përmbledhje referohet ndër të tjerash se:

- a) në bazë të interpretimit të Komisionit, anëtarët e KED-së, të cilët nuk kanë kaluar ende procesin e vettingut, janë në ushtrim të plotë të funksioneve të tyre.
- b) duhet shmangur konflikti i interesit mes anëtarëve të KED-së që kanë kandiduar për pozicionin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.
- c) KLP në të ardhmen duhet të krijojë kushtet për përfaqësimin në KED, me rotacion vjetor, të kandidatëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës
- d) I rekomandohet institucioneve përkatëse, leximi i drejtë dhe aplikimi në praktikë i kriterit të “mbarimit të shkollës së magjistraturës”.

Nga analiza e mësipërme vërehet se, konkluzionet e këtij organi kanë natyrë të përgjithshme, mungon argumentimi ligjor dhe në disa raste, mungon qartësia apo konkretizimi i tyre. Konkretisht, në këtë raport thuhet se anëtarët e KED-së 2019 që nuk e kanë kaluar ende procesin e vettingut janë në ushtrim të plotë të funksioneve të tyre, por nga ana tjetër KPKM nuk analizon se përse dështoi procesi i konstituimit dhe funksionimit normal të KED-së 2017 dhe KED-së 2018. A kemi pasur një interpretim dhe zbatim jo të njëtrajtshëm të ligjit për këto tri KED dhe cili ishte ngërçi që e shkaktoi këtë situatë? I rekomandohet KLP-së që në të ardhmen të krijojë kushtet për përfaqësimin në KED, me rotacion vjetor të kandidatëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, por nuk argumentohet se mbi ç’bazë ligjore është i mbështetur ky rekomandim, pasi ligji nr.115/2016 nuk e parashikon një klauzolë të tillë. Në këto kushte, do të ishte në interes që në vend të këtij rekomandimi, ti sigurohej

<sup>338</sup> <https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/kom/Raporti%20i%20KPKMN%20periudha%20Nentor%202018-Janar%202019.pdf>

<sup>339</sup> <https://www.parlament.al/Strukture?kategori=2004&strukture=2053>

organeve që kanë të drejtën e nismës ligjore të shikonin mundësinë për të propozuar amendimin e ligjit nr.115/2016 me qëllim që të krijoheshin kushtet dhe hapësira për përfaqësimin me rotacion në KED të kandidatëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës.

Duke qenë se KPMK është një organ i pavarur i krijuar në Kuvendin e RSH, kemi mendimin se në veprimtarinë e tij ky Komision duhet të udhëhiqet nga parimet e objektivitetit dhe paanësisë. Në këtë drejtim, në përfundimet dhe rekomandimet e këtij organi drejtuar institucioneve të qeverisjes së drejtësisë (përfshi këtu KED) nuk duhet të mungojë qasja e unifikuar e një kritike konstruktive. Në këtë mënyrë, KPMK do të kontribuonte efektivisht për përmirësimin e mangësive të konstatuara në krijimin dhe funksionimin e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Për opinionet dhe sugjerimet e paraqitura për KPMK, ky organ pas konsultimit me draft raportin e KShH-së evidenton se KPMK nuk harton rregulla për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, nuk ka tagra vendimmarrëse dhe ndaj vlerësimi i KSHH-së duhet të rishikohet në këndvështrimin e tagrave që ka ligji dhe vendimi i Kuvendit. Në vlerësimin e KShH-së, ligji nr.115/2016 në nenin 288 të tij i ka dhënë kompetenca të rëndësishme monitorimi, mbikëqyrje dhe koordinimi KPMK-së në raport me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Pavarësisht se është i atashuar pranë Kuvendit, ky komision që në emërtimin e tij konsiderohet i pavarur dhe për të përligjur fushën e veprimtarisë së tij gëzon të gjitha atributet për të konstatuar si progresin por edhe problematikat në drejtim të zbatimit të ligjit nr.115/2016 nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Në funksion të parimit të zbatimit sa më të mirë të ligjit, KPMK mund të evidentojë gjithashtu problematikat në drejtim të paqartësisë, nevojës për përmirësim apo adresimit të vakumit ligjor të mundshëm që rezulton nga ushtrimi i veprimtarisë monitoruese, mbikëqyrëse apo koordinuese që ky institucion ka. Evidentimi i këtyre problematikave apo rekomandimeve nuk i jep kurrsesi këtij organi një rol vendimmarrës por përkundrazi pro-aktiv dhe në përmbushje të misionit të tij në këtë proces për të garantuar zbatimin e drejtë dhe të saktë të ligjit.

**KAPITULLI VI****MONITORIMI I PËRZGJEDHJES SË  
INSPEKTORIT TË LARTË TË  
DREJTËSISË (ILD)<sup>340</sup>**

---

<sup>340</sup> Raporti është përfunduar në datë 5 prill 2019.

## 1. Baza ligjore për zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Baza ligjore për krijimin dhe funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD-së) parashikohet në nenet 147/d – 147/ë të Kushtetutës si dhe në pjesën e IV të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, në nenet 193-216. Dispozitat kalimtare për zgjedhjen e parë të ILD-së përfshihen në nenin 179, pika 9 të Kushtetutës dhe nenet 282-283 të ligjit nr.115/2016.

Sipas nenit 147/d, pika 3 të Kushtetutës, ILD zgjidhet nga Kuvendi me një shumicë të cilësuar prej 3/5 të anëtarëve. Mandati i tij zgjat për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje. Kushtetuta parashikonte një dispozitë kalimtare, sipas së cilës deri në zgjedhjet parlamentare që do të mbaheshin pas hyrjes në fuqi të ligjit të reformës kushtetuese, por jo më vonë se data 1 shtator 2017, zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të bëhej me dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit, ndërkohë që zgjedhjet e tjera do të bëheshin me tri të pestat e anëtarëve të Kuvendit. Kjo dispozitë kalimtare nuk rezultoi të jetë zbatuar për shkak të faktit se ILD nuk mundi të zgjidhej brenda këtij afati kushtetues.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për ILD që do të votohen nga Kuvendi realizohet nga KED, i cili përzgjedh dhe rendit 5 prej tyre, bazuar në kriteret e parashikuara në ligj, sipas një procedure transparente dhe publike. Pasi KED paraqet listën me 5 kandidatët e renditur sipas vlerësimit të tij, në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej 3/5 për asnjë prej kandidatëve brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar. (neni 147/d pika 4 e Kushtetutës dhe nenet 199 pika 2, e 201 të ligjit nr.115/2016).

## 2. Kriteret për përzgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Kushtetuta përcakton kriteret bazë kualifikuese të kandidatëve për ILD, sikurse janë karriera e spikatur si jurist për jo më pak 15 vjet pune në profesion dhe integriteti i lartë moral e profesional. Kushtetuta parashikon si kriter përjashtues kryesor mbajtjen e funksioneve politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit (neni 147/d, pika 3 i Kushtetutës).

Ndërkohë, ligji nr.115/2016 detajon kriteret kualifikuese si formale dhe materiale për kandidatët për ILD, si shtetësia shqiptare, niveli i arsimimit, përvoja prej jo më pak se 15 vjet përvojë në profesion, kriteret përjashtuese si, rekordet kriminale, masat disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit, mbajtja e funksioneve politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit, si dhe lidhjet me ish-Sigurimin e Shtetit (neni 199 pika 1, dhe neni 201 “e” të ligjit nr.115/2016).

Inspektori i Lartë i Drejtësisë gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe ai mund të shkarkohet nga detyra vetëm me vendim të Gjykatës Kushtetuese (neni 147/d, pika 5, dhe Neni 147/e, pika 2 të Kushtetutës). Më tej, sipas nenit 147/ë të Kushtetutës qenia Inspektor i Lartë i Drejtësisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënies, akademik ose shkencor, sipas ligjit.

Ligji përcakton në detaje procedurën e shpalljes së vendit vakant nga KED dhe elementet përbërës të shpalljes së dokumentacionit të nevojshëm për aplikim, afatet përkatëse për shpalljen e vendit vakant (3 muaj nga mbarimi i mandatit të ILD në detyrë) dhe shqyrtimin e kandidaturave për kushtet e emërimit nga KED (neni 201 pika “c” dhe “d” i ligjit nr.115/2016). Gjithashtu, ligji nr.115/2016 parashikon fazën e përzgjedhjes nga KED të kandidatëve për ILD që plotësojnë kushtet formale, renditjen e tyre sipas kriterëve (materiale) të nenit 240 të këtij ligji që kanë të bëjnë me kriteret morale, etike dhe profesionale të detajuara. Renditja në listën e shkurtuar me 5 kandidatë parashikohet në nenin 147/d, pika 4 të Kushtetutës por nuk përmendet në ligjin nr. 115/2016 neni 201 germa “e” e tij. Ligji përcakton dhe detyrimin e publikimit të listës së kandidatëve të vlefshëm dhe arsyet e përjashtimit të kandidaturave (neni 201 germa “ë” i ligjit nr. 115/2016).

### 3. Procedurat e kandidimit për Inspektor të Lartë të Drejtësisë

Kuadri ligjor për reformën në drejtësi ka parashikuar se një organ i rëndësishëm si ILD duhet të ngrihet për herë të parë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ndryshimeve Kushtetuese (neni 179, pika 9 e Kushtetutës). Ky afat nuk u respektua edhe pas dy viteve nga miratimi i reformës në drejtësi. Madje ILD nuk u zgjodh as pas ngritjes së dy Këshillave duke krijuar ndërprerje në veprimtarinë e tyre për procedimet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ligji nr. 115/2016 përcakton rregulla të detajuara në lidhje me paraqitjen e shprehjes së interesit për të kandiduar për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, të cilat ndryshojnë në bazë të karakteristikave të subjekteve që kandidojnë. Dallimi kryesor midis këtyre kandidatëve është nëse ata duhet të nënshtrohen ose jo procesit të vettingut. Kështu, gjyqtarët, prokurorët ose çdo subjekt tjetër i cili sipas ligjit nr.84/2016 i nënshtrohet vettingut dhe ka interesi për të kandiduar për ILD, brenda afatit ligjor 1 mujor nga krijimi i KPK, duhet të paraqesë pranë tij interesin për pozicionin e ILD-së, duke depozituar një shkresë të posaçme si dhe dokumentacionin përkatës në lidhje me procedurën e rivlerësimit (neni 282 pika 1 e ligjit nr.115/2016). Në rastin e vonesës së krijimit të KPK-së, kërkesa për shprehjen e interesit depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Gjithsesi, në këtë rast, ligji nuk parashikon qartazi afatin brenda së cilit kjo kërkesë duhet të paraqitet. Ndërkohë, për personat që nuk kishin detyrimin për t'ju nënshtrohet vettingut por kishin interes për të kandiduar për ILD ligji nr.115/2016 në nenin 282, pika 2 parashikonte se çdo jurist i interesuar për këtë pozicion, brenda një afati prej 2 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit nr.115/2016 duhet të dorëzonte aplikimin pranë KED-së. Për këtë kategori subjektësh nuk është parashikuar asnjë hallkë tjetër ku mund të shprehin interesin për të kandiduar, në kushtet kur KED nuk u ngrit brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr.115/2016.

Gjatë afateve të përmendura në paragrafin e mësipërm kanë shprehur interesin për të kandiduar si ILD katër kandidatë, tre prej të cilëve janë magjistratë dhe një kandidate është juriste. Më hollësisht, nga subjektet që i nënshtrohen procesit të vettingu-t rezultoi se kanë kandiduar Z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe Znj. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore e KLD-së. Ndërkohë rezultoi se një kandidat i tretë të këtë hequr dorë nga kandidatura. Në lidhje me kandidatët Malaj e Xhaferllari, në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse (KPK apo Kuvend) nuk është dhënë informacion se në cilin prej tyre është paraqitur kërkesa për shprehjen e interesit. Për sa i përket këtyre kandidaturave, raporti vjetor 2016<sup>341</sup> dhe raporti 2017<sup>342</sup> i Kuvendit nuk japin asnjë informacion të mëtejshëm për institucionin e ILD-së. Ndërkohë, KShH ka analizuar raportin e monitorimit të Strategjisë Ndër sektoriale të Drejtësisë 2017 – 2020 të publikuar në faqen e Ministrisë së Drejtësisë<sup>343</sup> ku evidentohet se dy kandidatët e sipërpërmendur kanë paraqitur kandidaturën e tyre në Kuvend, në një datë para krijimit të KPK. Gjithsesi edhe në këtë rast, informacioni i publikuar nuk është i mjaftueshëm pasi nuk jepen detaje për datën e paraqitjes së kandidaturës në mënyrë që të verifikohet respektimi i afateve të parashikuara nga ligji.

Për sa i përket dy kandidatëve të tjerë një nga radhët e magjistratëve, i cili ka tërhequr kandidaturën, dhe njëri nga ana e juristëve, nuk janë dhënë për shumë kohë informacione publike. Me krijimin e KED 2019, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë (në seksionin për KED) është publikuar shkresa e datës 14 janar 2019<sup>344</sup>, drejtuar kryetarit të KED, me anë të së cilës Znj. Albana Shtylla, e cila kishte paraqitur kandidaturën për ILD në datë 14 shkurt 2017, paraqet tërheqjen e kandidaturës për shkak të së në datë 17 qershor 2017 është zgjedhur nga Kuvendi anëtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

<sup>341</sup> <http://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/raport-2016.pdf>

<sup>342</sup> <http://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/raport%202017.pdf>

<sup>343</sup> [https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Intersectorial\\_Justice\\_strategy\\_monitoring\\_report\\_2017\\_-\\_Per\\_WEB.doc](https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Intersectorial_Justice_strategy_monitoring_report_2017_-_Per_WEB.doc) (faqe n.12)

<sup>344</sup> <http://www.gjykataelarte.gov.al/web/terheqje nga kandidimi ne ild albana shtylla 1959.pdf>



Ndërkohë, nga mediat<sup>345</sup> mësohet se një kandidate tjetër të ketë qenë Znj. Lefterije Lleshi, por edhe në këtë rast nuk ka informacione të publikuara në faqet zyrtare mbi mënyrën e paraqitjes së kandidaturës dhe, në veçanti, për institucionin të cilit i është dorëzuar aplikimi si dhe datën e kandidimit në mënyrë që të verifikohet respektimi i afateve ligjore.

#### **4. Rivlerësimi kalimtar dhe vlerësimi i kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë**

Në lidhje me gjyqtarët, prokurorët dhe subjektet e tjera të cilët duhet t'i nënshtroheshin *ex-legge* vettingut, neni 282 pika 1 e ligjit nr.115/2016 parashikon se ato duhet të rivlerësohen nga KPK me përparësi. Nëse këto subjekte nuk konfirmohen në detyrë nga KPK, si organ i shkallës së parë të vettingu-t, ato përjashtohen nga lista e kandidatëve që shqyrtohet nga KED, pasi konsiderohen të papërshtatshëm për t'u zgjedhur (neni 282 pika 3 i ligjit nr.115/2016). Pra, siç është parashikuar për institucione si KLGJ dhe KLP, edhe ILD mund të zgjidhet vetëm pas përfundimit të procedurave të vettingu-t, nëse ka kandidatë që sipas ligjit kanë detyrimin të nënshtrohen këtij procesi. Ankimi i kandidatit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nuk e ndryshon situatën në favor të tij.

KShH vëren se pavarësisht se detyrimi për të kaluar procesin e vettingut me sukses vetëm në shkallë të parë mund të jetë parashikuar për të shmangur vonesat në krijimin e ILD-së, pas miratimit të ligjit nr.115/2016, sërish në kushtet e vonesave të tej zgjatura dhe të paparashikuara pas afro dy viteve e gjysmë nga miratimi i reformës në drejtësi, një klauzolë e tillë vijon të jetë aktuale për të dhënë procesit ritme më dinamike gjatë vlerësimit të kandidatëve për ILD nga KED 2019.

Neni 282, pika 4 e ligjit nr.115/2016 parashikon më tej se, pasi kandidatët e përshtatshëm kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit me vendim të KPK-së, kjo e fundit njofton KED dhe i përcjell dosjen, me qëllim kryerjen e vlerësimit dhe renditjes së tyre.

Sa i takon kandidatëve që janë juristë dhe që nuk i nënshtrohen *ex-legge* vettingut parashikohet se vlerësimi i tyre bëhet nga KED, institucion i cili mbështetet edhe nga KPK, për aq sa është e mundur, për zbatimin e parashikimeve të ligjit të vettingut (neni 282 pika 2 e ligjit nr. 115/2016).

Gjithashtu ligji kishte vendosur një afat prekluziv për KED që ishte data 1 Shkurt 2017, për nisjen e procedurës së vlerësimit për përmbushjen e kriterëve dhe renditjen e të gjithë kandidatëve për ILD. Kjo procedure duhet të përfundonte brenda 10 ditëve dhe më pas, pa vonesa, duhet t'i përcillej Kuvendit raporti përkatës (neni 282 pika 5 e ligjit nr.115/2016). Edhe në këtë rast, nënvizohet se ky afat i parashikuar nga ligji nuk është respektuar, pasi procesi i vettingut për kandidatin e fundit, siç do të analizohet në vijim, përfundoi vetëm në muajin mars 2019, pra më shumë se 2 vite pas shprehjes së interesit për këtë pozicion nga ana e kandidatëve. Faktor ndikues për këto vonesa ishte mosfunksionimi i KED 2017 dhe KED 2018.

Neni 282, pika 3 e ligjit nr.115/2016 vazhdon më tej duke parashikuar se, nëse është krijuar KPK dhe procesi i rivlerësimit i kandidatëve që kanë paraqitur interesin e tyre për pozicionin e ILD nuk ka përfunduar brenda dt.1 Shkurt 2017, këto kandidatë përjashtohen nga procesi i zgjedhjes. Ky afat nuk është respektuar, pasi efektivisht në këtë datë KPK nuk ishte krijuar për shkak të kundërshtimit të ligjit të vettingut nr.84/2016 në Gjykatën Kushtetuese si dhe më vonë për shkak të bojkotit parlamentar të opozitës që krijoi vonesa në ngritjen e komisioneve parlamentare për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të organeve të vettingut. Për shkak të mos ngritjes në kohë të KPK-së çka përbënte një prej kushteve ligjore që të përmbushej afati i dt.1 Shkurt 2017, atëherë edhe pasoja e parashikuar në këtë dispozitë për përjashtimin e kandidatëve nuk mund të shtrinte efektet mbi ta.

<sup>345</sup> <http://top-channel.tv/video/gjyqtaret-ska-kush-i-heton-inspektoriat-i-larte-i-drejtësisë-ende-sekziston/>

#### 4.1 Vettingu i kandidatëve për ILD që shprehën interesin në vitin 2017

a) Kandidati për ILD që shprehu interesin në vitin 2017, Z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, u konfirmua në detyrë me vendimin e KPK-së të marrë unanimisht më 3 Gusht 2018. Ndërkohë vëzhguesit ndërkombëtar ngritën disa pikëpyetje lidhur me pasurinë e kandidatit dhe një personi të lidhur me të. Bazuar në rekomandimin e ONM<sup>346</sup>, më 26 Tetor 2018, Komisioneri Publik paraqiti ankim<sup>347</sup> kundër vendimit të KPK-së në KPA, bazuar në argumente të lidhura me mos justifikimin e pasurive të subjektit. Komisioneri publik kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 62, datë 3.8.2018 të KPK dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Z. Artur Mala. Deri në fund të muajit Mars 2018, KPA nuk ka shpallur datën e seancës dëgjimore lidhur me këtë çështje.

b) Kandidatja për ILD që shprehu interesin në vitin 2017, Znj. Marsida Xhaferllari u thirr dhe u paraqit në KPK seancën dëgjimore. KPK në dt. 11 Mars 2019 njoftoi mbylljen pa vendim përfundimtar<sup>348</sup> të rivlerësimit të subjektit Marsida Xhaferllari. Me një vendim shumice, trupa e KPK arsyetoi se Znj. Xhaferllari, e cila ka mbajtur postin e Kryeinspektorese së KLD deri në krijimin e KLGJ, ka humbur statusin e magjistratit, dhe për këtë KPK vendosi të deklaruar procesin e vettingut për këtë subjekt pa një vendim përfundimtar. Edhe ONM raportohet<sup>349</sup> të ketë ngritur dyshime nëse subjekti kishte apo jo statusin e magjistratit. Vendimi për Znj. Xhaferllari është i pari i kësaj natyre nga KPK, pavarësisht se ky organ kishte realizuar një hetim të thellë administrativ për të tria kriteret. Në njoftimin e publikuar në faqen e KPK-së evidentohet gjithashtu fakti se subjekti i rivlerësimit nuk i është nënshtruar testimit pranë Shkollës së Magjistraturës (bazuar në pikën 2 dhe 4 të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016). Ndërkohë vetë subjekti këmbënguli se gëzonte statusin e magjistrates, duke qenë se ligji i aplikuar kur ajo kishte lënë detyrën si gjykatëse, për të marrë detyrë në Ministrinë e Drejtësisë, nuk kishte parashikime për humbjen e këtij statusi. Lidhur me këtë çështje, KShH ka monitoruar seancat ndaj subjektit dhe ka vërejtur në një njoftim publik<sup>350</sup> se ligji i vettingut nuk parashikon në asnjë rast, përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar. Masat që mund të marrë komisioni parashikohen në nenin 58 të këtij ligji dhe ato kategorizohen në 3 kategori, përkatësisht subjekti mund të konfirmohet në detyrë, mund të pezullohet nga detyra ose mund të shkarkohet nga detyra. Ligji nr. 84/2016, në nenin 4/6 parashikon se komisioni mund të referojë në Kodin e Procedurave Administrative, nëse procedurat administrative të ndjekura prej tij nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për vendimin ndaj Xhaferllarit referoi nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative. “Organi publik deklaroi të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.” Parë në të gjithë shtrirjen e tij, procesi ndaj Znj. Xhaferllari ngre në vlerësimin e KShH-së pikëpyetjen se përse duhej vonuar për 14 muaj procesi i vettingut, teksa subjekti ishte në listën prioritare dhe nuk e gëzonte statusin e magjistratit sipas KPK-së?

Në përfundim evidentohet se procesi i vettingut për dy kandidatët magjistratë ka qenë shumë i ngadaltë. Referuar nenit 282 pika 1 të Ligjit 115/2016, këto kandidatë duhet të rivlerësoheshin me përparësi nga ana e KPK por, edhe pse ky organ ka rivlerësuar mëse 100 kandidatë deri në fillimet e vitit 2019, vettingu për kandidatët për ILD u mbyll vetëm në muajin mars 2019 ndërkohë që shorti përkatës u hodh në datën 30 nëntor 2017.

<sup>346</sup> <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Rekomandim-dat%C3%AB-10.8.2018.pdf>

<sup>347</sup> <http://ikp.al/2018/10/26/ankim-kunder-vendimit-nr-62-date-3-8-2018-te-kpk-se-per-subjektin-e-rivleresimit-z-artur-malaj/>

<sup>348</sup> <http://kpk.al/2019/03/11/njoftim-118/>

<sup>349</sup> <https://www.reporter.al/kpk-mbyll-pa-vendim-vettingun-e-marsida-xhaferllarit/>

<sup>350</sup> [https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/posts/1877009845755870?\\_xts=%5B0%5D=68.ARA6yucyUdntatN1NQ0hf0qTSpjWwBbcosqiVmWvYVa6n6yIbtTZKMeA85e6Ae\\_psLehbZ4pNGCzc8iJ1zP3JuydoysrQG6Hd7\\_0dU\\_NIyKJfZ9GQloHHmXmBUniXXPMVeCmt4OvMTjdg52NU2ow8Jeuvf4jFfUCW0cKKQGPDbQHzPVdpFlGRXYefLDwFs-DaI1gvE-dt1PGTh0NddntfiqHTI9-IDVj2cEkc8sjigVhQoB2q6CmzIFL85YEKmbPZlfea0XXY5gPdEUu4dCC6T9MPvJ1z0pNfVhfQOunr5i8R1ufQt3ZrhH54wZW0XwuW2VZV7DwUCWUNn89cS\\_Jwq49w&tn=K-R](https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/posts/1877009845755870?_xts=%5B0%5D=68.ARA6yucyUdntatN1NQ0hf0qTSpjWwBbcosqiVmWvYVa6n6yIbtTZKMeA85e6Ae_psLehbZ4pNGCzc8iJ1zP3JuydoysrQG6Hd7_0dU_NIyKJfZ9GQloHHmXmBUniXXPMVeCmt4OvMTjdg52NU2ow8Jeuvf4jFfUCW0cKKQGPDbQHzPVdpFlGRXYefLDwFs-DaI1gvE-dt1PGTh0NddntfiqHTI9-IDVj2cEkc8sjigVhQoB2q6CmzIFL85YEKmbPZlfea0XXY5gPdEUu4dCC6T9MPvJ1z0pNfVhfQOunr5i8R1ufQt3ZrhH54wZW0XwuW2VZV7DwUCWUNn89cS_Jwq49w&tn=K-R)

## 4.2 Veprimtaria e KED-së 2019 për përzgjedhjen dhe administrimin e kandidaturave për ILD

### a. Administrimi i kandidaturave që kishin aplikuar në vitin 2017

Në lidhje me administrimin e kandidaturave për ILD që shprehën interesin për të kandiduar në vitin 2017, KED 2019, në kuadër të konsultimit të draft raportit të KShH-së referon se nuk ka pasur problematika për administrimin apo inventarizimin e dokumentacionit të këtyre kandidatëve, të cilat i ka gjetur të depozituara pranë zyrës së Këshillit.

Nga analiza e procesverbaleve të KED-së 2018 dhe KED-së 2019 vërehet se procedura e administrimit dhe verifikimit të kandidaturave për ILD-së është debatuar gjatë. Në veçanti, në mbledhjen e vetme të realizuar nga KED 2018 rezultoi që ky aspekt të jetë diskutuar ndërmjet anëtarëve. Në faqen 29 të procesverbalit të mbledhjes<sup>351</sup> së datës 19.03.2018, është reflektuar se ndoshta aplikimet edhe për ILD, i janë dorëzuar sekretarisë së Gjykatës së Lartë. Nga kryetari i Komisionit parlamentar të Ligjeve Z. Manja, është shprehur mendimi se përsa kohë nuk ka pasur një shpallje publike nga KED, pasi ky institucion nuk ishte konstituuar, aplikimet e ardhura në adresë të sekretariatit të Gjykatës së Lartë nuk duhet të administrohen nga KED, por paraprakisht duhet të vijohet me publikimin e një shpallje publike dhe realizimin e procedurës në përputhje me parashikimet ligjore. Ndërkohë Avokatia e Popullit, Znj. Ballanca është shfaqur mendim i kundërt bazuar në parimin e të drejtës administrative, sipas të cilit *“kur vjen një kërkesë apo ankesë dhe i drejtohet një organi, le të jetë organi i gabuar, në rastin konkret ka qenë Gjykata e Lartë organi i gabuar, pra ajo ka qenë sekretariati, në gjykimin tim kryetari i Gjykatës së Lartë në momentin që u konstituua KED si organ, me një shkresë përcjellëse ja dërgon KED-së”*.<sup>352</sup> Ky opinion pati mbështetjen e kryetarit të KED-së 2018, Z. Broci, ku në rastin konkret bëhet fjalë për inventarizim të këtyre kërkesave dhe jo administrim të tyre.

Duke qenë se KED 2018 pas kësaj mbledhje ka pezulluar aktivitetin e tij dhe vendimmarrja e vetme e publikuar e KED 2018, e dt. 26.03.2018, ka si objekt heqjen dorë të anëtares Znj. Rovena Gashi. Ndaj KShH nuk mund të konkludojë nëse diskutimi i çështjes së aplikimeve të depozituara para konstituimit të KED-së për pozicionin e ILD-së është shqyrtuar nëpërmjet një procedure votimi dhe nëse ka pasur vendimmarrje konkrete.

Ndërkohë, sipas informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, edhe KED 2019 e ka diskutuar çështjen e kandidaturave për ILD por, edhe pse ky institucion është mbledhur mbi rreth 14 herë deri në fund të muajit mars 2019, në faqen zyrtarë është publikuar vetëm procesverbali i mbledhjes së parë të dt. 15 janar 2019<sup>353</sup>. Në faqet 60-61 të procesverbalit të vetëm të publikuar referohet se kanë kandiduar 4 persona për ILD në vitin 2017, por njëri prej tyre është dorëhequr. Në total, numri i kandidatëve për ILD rezultonte 3, dy kandidatë magjistratë dhe një kandidat jomagjistrat. Në shkresën zyrtare nr.354, dt. 21.05.2019 me anë të të cilës KED 2019 ka dhënë parashtrime dhe shpjegime për draft raportin e KShH-së, nuk evidentohet nëse ka pasur vendimmarrje për inventarizimin apo administrimin e këtyre aplikimeve, por sikurse është evidentuar më sipër, KED 2019 nuk ka identifikuar problematikë në këtë drejtim, pasi dokumentacioni i kandidimeve është gjetur i depozituar pranë zyrës së Këshillit. Gjithashtu, KED 2019 referon se nuk ka shqyrtuar dokumentacionin e kandidatëve të mbetur dhe atyre të tërhequr, plotësinë e tyre, kohën e kandidimit, organin e emërtesës pasi në vlerësimin e tij ishte e panevojshme dhe e pamundur pasi nuk ishin miratuar aktet nënligjore normative për verifikimin dhe vlerësimin e kandidaturave.

Në përfundim, KShH evidenton se KED 2019, pavarësisht nga veprimtaria intensive që ka pasur me fillimin e veprimtarisë së saj duhet të kishte mundur të transparençën e nevojshme në drejtim të vendimmarrjes së saj për kandidaturat për ILD të paraqitura në vitin 2017 dhe administrimin e dokumentacionit të tyre.

<sup>351</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/prverb\\_i\\_ked\\_19\\_03\\_2018\\_1816.doc](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/prverb_i_ked_19_03_2018_1816.doc)

<sup>352</sup> Fq. 30 e procesverbalit dt. 19.03.2018

<sup>353</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/procesverbali\\_i\\_mbl\\_se\\_pare\\_te\\_ked\\_1913.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/procesverbali_i_mbl_se_pare_te_ked_1913.pdf)

**b. Shpallja e re nga KED 2019 për kandidatura në pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**

Në vazhdim të aktivitetit të KED 2019, në datë 1 Mars 2019, në vijim të vendimit nr. 3<sup>354</sup> të KED, të së njëjtës datë është publikuar shpallja “Për hapjen e procedurës së aplikimit në pozicionin vakant Inspektor i Lartë i Drejtësisë”.<sup>355</sup> Sipas kësaj shpallje, data 20 Mars 2019 ka qenë afati i fundit për dorëzimin e shprehjes së interesit dhe dokumentacionit mbështetës nga kandidatët.

Në lidhje me kandidatët e mëparshëm pohohet se këto të fundit duhet të paraqesin sërish shprehjen e interesit (“kandidatët e deritanishëm, që kanë aplikuar sipas procedurave kalimtare kushtetuese dhe ligjore, duhet të paraqesin dokumentacionin e sipërcituar, të përditësuar”), por nuk citohet baza ligjore dhe arsyetimi i KED-së në lidhje me këtë vendim. Përderisa shpallja citon vetëm “përditësimin e dokumentacionit”, nuk kuptohet nëse kandidatët e mëparshëm vazhdojnë të jenë pjesë e procesit të përzgjedhjes, por kanë barrën përditësimit të formularëve, apo nëse duhet të shprehin interesin sërish duke filluar një procedurë të re.

Në shkresën zyrtare nr.354, dt. 21.05.2019 me anë të të cilës KED 2019 ka dhënë parashtrime dhe shpjegime për draft raportin e KShH-së, është pasqyruar një tablo më e plotë lidhur me këtë çështje. KED 2019 referon se ka evidentuar si problematikë kushtetuese dhe ligjore faktin që në asnjë moment të procesit të kandidimit për vendin vakant të ILD-së, nuk ka pasur 5 kandidatura për verifikim dhe vlerësim nga KED, ndërkohë që Kushtetuta kërkon dërgimin në Kuvend të një liste prej 5 kandidatësh të përzgjedhur nga KED. Ndodhur në rrethana të tilla faktike dhe duke pasur parasysh përcaktimet e Kushtetutës dhe të ligjit, përmbajtjen, qëllimin dhe frymën e këtyre dispozitave, KED 2019, në mbledhjen e dt.1 Mars 2019 diskutoi dhe vendosi të rishpallë garën për vendin vakant të ILD-së (bashkëlidhur dërgohet dhe një pjesë e arsyetimit dhe motivimit të KED-së 2019 për këtë vendimmarrje). Gjithashtu, KED 2019 referon se, duke e rishpallur garën për vendin vakant të ILD-së, KED 2019 pashmangshmërisht i vendos kandidatët konkurrues në të njëjtin nivel, për të mos krijuar pabarazi ndërmjet tyre për shkak të kohës së kandidimit. Për rrjedhojë, sipas saj, edhe për tre kandidatët ekzistues për këtë vend vakant kërkohej që nëpërmjet përditësimit të dokumentacionit, të tregonin shprehjen e vijimit të interesit të tyre për pjesëmarrje në konkurrim për vendin vakant në ILD.

Sa më sipër, KSHH vlerëson se nga pikëpamja formale, KED 2019 duhet të merrte një vendim për kandidaturat për ILD të paraqitura në vitin 2017. Edhe pse e ndodhur përballë një situatë ekstra-ligjore e lidhur me mosfunksionimin e dy KED-ve të vitit 2017 dhe 2018, në vlerësimin tonë, statusi i kandidatëve për ILD në vitin 2017 nuk mund të barazohej me kandidatët që do të shprehnin interesin e tyre për të kandiduar për këtë vend vakant pas thirrjes së publikuar nga KED 2019. Nëse KED 2019 kishte vendosur si kusht për të aplikuar paraqitjen e dokumentacionit shtesë, kjo mund ti kërkohej kandidatëve për ILD të paraqitur në vitin 2017, me një komunikim të realizuar me shkresa drejtuar secilit kandidat, dhe kjo listë e tre kandidatëve ti shtohej listës me kandidatët e paraqitur rishtazi pas publikimit të thirrjes në muajin Mars 2019.

Gjithashtu, KED 2019 duhet të kishte qenë më transparente në thirrjen e publikuar në muajin Mars 2019, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, për shprehjen e interesit nga personat që dëshirojnë të kandidojnë për ILD, për të publikuar arsyet se përse po shpallej kjo thirrje, e cila sipas saj kishte të bënte me mosarritjen e kuorumit të nevojshëm prej të paktën 5 personash si kandidatë për këtë vend vakant.

**c. Shqyrtimi i kandidaturave të paraqitura për ILD pas shpalljes së realizuar nga KED 2019**

<sup>354</sup>[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/vendim\\_nr\\_3\\_2019\\_per\\_shpalljen\\_e\\_vakances\\_per\\_ildrejtisesise\\_1936.doc](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/vendim_nr_3_2019_per_shpalljen_e_vakances_per_ildrejtisesise_1936.doc)

<sup>355</sup>[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Per\\_shpalljen\\_e\\_procedures\\_se\\_aplikimit\\_per\\_plotesimin\\_e\\_vendit\\_vakant\\_ne\\_ILD\\_5555\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Per_shpalljen_e_procedures_se_aplikimit_per_plotesimin_e_vendit_vakant_ne_ILD_5555_1.php)



Më datë 21.03.2019 në faqen zyrtare të KED-së rezulton të jetë publikuar lista<sup>356</sup> me emrat e kandidatëve që kanë aplikuar për vendin vakant të ILD-së. Rezultojnë të kenë shfaqur interesin 13 kandidatë, përkatësisht: Z. Altin Hazizaj, Z. Artur Malaj, Z. Artur Metani, Znj. Elira Kokona, Z. Eris Hysi, Z. Ferdinand Caka, Z. Genci Gjonçaj, Z. Genci Ismaili, Z. Klodian Rado, Znj. Lefteri Lleshi, Znj. Marsida Xhaferllari, Znj. Mimoza Qinami, Znj. Suzana Frashëri. Tre prej këtyre kandidatëve rezultojnë të jenë të njëjtët persona që kanë kandiduar në vitin 2017, për të cilët KSHH ka parashtruar konstatimin dhe vlerësimin e tij në rubrikën e mësipërme dhe më konkretisht janë Z. Artur Malaj, Znj. Marsida Xhaferllari dhe Znj. Lefeteri Lleshi.

Në lidhje me kandidatët, vërehet se pak ditë pas publikimit të listës zyrtare, njëri prej kandidatëve, Z. Ferdinand Caka ka paraqitur dorëheqjen nga kandidatura<sup>357</sup>, për arsye personale.

Në përputhje me nenin 201, pika 2, gërma d) të ligjit nr. 115/2016, KED ka detyrimin që pa vonesë, dhe në çdo rast brenda afatit 1 muaj nga përfundimi i afatit të kandidimit (i cili përkon më datën 20 Mars 2019), të shqyrtojë nëse kandidaturat e paraqitura plotësojnë kushtet ligjore formale të parashikuara në nenin 199, pika 1 të ligjit.

Për sa i përket procedurave të brendshme, në datë 15.02.2019, KED ka miratuar vendimin nr. 2, “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion<sup>358</sup>”, ku në veçanti, pohohet se “*dita dhe ora e zhvillimit të procedurës së shortit elektronik për caktimin e relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion caktohet jo më vonë se 5 ditë nga dita e publikimit të listës së kandidatëve për pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi ose nga ajo e publikimit të listës së kandidatëve për pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga ana e këtij Këshilli.*” (pika n.5 e vendimit). Më tej, KED në datë 11.03.2019 ka miratuar edhe vendimin n. 4 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë<sup>359</sup>, me anë të së cilit janë përcaktuar rregulla të mëtejshme për vlerësimin dhe analizën e kandidaturave.

Edhe pse lista me kandidatët e ILD është publikuar në datë 21 mars 2019, shorti i parashikuar nga vendimi i cituar në lidhje me relatorin e pozicionit vakant është hedhur vetëm në datën 5 prill 2019, siç raporton vetë KED<sup>360</sup>, pra në shkelje të afatit 5 ditor të caktuara vetë nga KED vetëm një muaj më parë. Ky short, siç pohon vetë KED, nuk është hedhur në mënyre elektronike, siç parashikon procedura e miratuar nga vetë KED, por është hedhur në mënyre manuale “*për shkak të pamundësisë teknike të zhvillimit të tij në mënyrë elektronike*”<sup>361</sup>. Rezultati i këtij shorti është përzgjedhja e Znj. Margarita Buhali, e cila është një nga kandidatët e KED-së cilët që nuk i është nënshtruar ende procedurës së rivlerësimit kalimtar<sup>362</sup>.

Lidhur me mosrespektimin e afatit 5 ditor për hedhjen e shortit për relatorin e KED-së për pozicionin vakant të ILD-së, KED 2019 parashtron se procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave nuk mund të fillonin dhe të zhvilloheshin pa miratuar paketën e akteve nënligjore normative përkatëse sepse kjo urdhërohet nga po i njëjti ligj në nenin 229 të tij. Indirekt, KED 2019 vlerëson se shkak i vonesës ka qenë pikërisht kohë dhe angazhimi i këtij organi në hartimin e paketës së akteve nënligjore. Pavarësisht nga ngarkesa që impononte ky proces, duke marrë parasysh që KED filloi veprimtarinë e

<sup>356</sup>[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Shpallje\\_e\\_listes\\_se\\_kandidateve\\_pe\\_vendin\\_vacant\\_Inspektor\\_i\\_Larte\\_i\\_Drejtësi\\_se\\_date\\_21\\_03\\_2019\\_5663\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Shpallje_e_listes_se_kandidateve_pe_vendin_vacant_Inspektor_i_Larte_i_Drejtësi_se_date_21_03_2019_5663_1.php)

<sup>357</sup>[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ferdinand\\_caka\\_1976.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ferdinand_caka_1976.pdf)

<sup>358</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 19, date 19 Shkurt 2019

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2019/PDF-2019/19-2019.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2019/PDF-2019/19-2019.pdf)

<sup>359</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, date 15 Mars 2019

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2019/PDF-2019/32-2019.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2019/PDF-2019/32-2019.pdf)

<sup>360</sup>[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja\\_e\\_KED\\_e\\_dates\\_02\\_04\\_2019\\_5743\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_KED_e_dates_02_04_2019_5743_1.php)

<sup>361</sup>[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja\\_e\\_KED\\_e\\_dates\\_05\\_04\\_2019\\_5774\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_KED_e_dates_05_04_2019_5774_1.php)

<sup>362</sup> Shorti për Znj. Buhali është hedhur vetëm në datën 15 janar 2019, sipas njoftimit përkatës <http://kpk.al/2019/01/16/njoftim-100/>

saj në dt.15 Janar 2019 si dhe duke ditur urgjencën që paraqet plotësimi i vakancave për ILD dhe anëtar të Gjykatës Kushtetuese, kemi mendimin se kjo periudhë ka qenë e arsyeshme për të përfunduar këtë paketë ligjore normative.

Lidhur me verifikimin që KED duhet të kryente për 13 kandidatët për ILD, KShH nuk mund të ndajë gjetje dhe të dhëna për këtë fazë, pasi periudha që ky raport mbulon shtrihet deri në fund të muajit Mars 2019, që korrespondon vetëm me 10 ditë nga afati 1 muhor që KED 2019 kishte në dispozicion për të kryer këtë verifikim. Monitorimi i mëtejshëm i këtij procesi do të jetë në fokus të veprimtarisë së ardhshme të KShH-së.



**KAPITULLI VII**

**REKOMANDIME**

KShH shpreson që gjetjet, progresi dhe problematikat e identifikuar në këtë raport si dhe vlerësimet e përcjella për aspekte të rëndësishme që kanë qenë në fokus të monitorimit tonë, ti shërbejnë përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së legjislacionit të ri të reformës në drejtësi për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes së drejtësisë si dhe zbatimit sa më korrekt dhe profesional të tij nga të gjitha organet e ngarkuara me përgjegjësi direkte apo edhe indirekte për zbatimin e këtij legjislacioni. Në këtë drejtim, KShH vlerësoi gjithashtu të arsyeshëm të ndajë disa rekomandime konkrete si vijon.

**1.** Kuota minimale e parashikuar në nenin 51, pika 5 nuk përputhet me atë të parashikuar në nenin 53, pika 1 të ligjit nr.115/2016, i cili parashikon se “... i përcillen Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit në një listë me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta, por jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante...”. Sipas kësaj dispozite, për dy vende vakante në secilin prej Këshillave kërkohen të paktën 6 kandidatë (pra 3 për një vend vakant). Rrjedhimisht i rekomandojmë Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të rishikojnë nenin 51, pika 5 dhe nenin 53, pika 1 e ligjit nr.115/2016, të cilat mund të harmonizohen për të shmangur paqartësitë, subjektivizmin dhe zbatimin jo të njëtrajtshëm të ligjit.

**2.** Në nenin 152, pika 2 të ligjit nr.115/2016 është parashikuar vetëm publikimi i menjëhershëm i emrave të kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore, ndërkohë rezultati i mos plotësimit të kushteve ligjore si dhe shkaqet e përjashtimit i komunikohen në mënyrë individuale kandidatëve. Kemi mendimin se kjo dispozitë duhet të reflektonte qartazi edhe detyrimin e publikimit të listës së kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillave (KLGJ dhe KLP). Transparenca e fazës së verifikimit paraprak të plotësimit të kushteve ligjore është një element i domosdoshëm, i cili duhet të shoqërojë këtë proces. Rrjedhimisht i rekomandojmë Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të rishikojnë këtë dispozitë.

**3.** I rekomandojmë në të ardhmen Avokatit të Popullit të publikojë në faqen zyrtare platformat e kandidatëve për anëtar jo magjistratë në dy Këshillat. Pavarësisht se ky nuk është një detyrim ligjor, e parë në këndvështrimin e transparencës ndaj publikut mund të cenohet edhe gjykimin e publikut mbi meritokracinë në vetvete të procesit të vlerësimit të këtyre platformave nga Komisioni.

**4.** Në funksion të transparencës së procesit të përzgjedhjes së kandidatëve dhe emërimit të anëtarëve në të dy Këshillat, i rekomandojmë në të ardhmen Avokatit të Popullit dhe Kuvendit të mundësojnë aksesimin në çdo kohë të dokumentacionit që evidenton procedurat e ndjekura sipas ligjit nr.115/2016, duke i arkivuar këto dokumente sipas rubrikave përkatëse të strukturuar në mënyrë sa më të orientueshme për publikun.

**5.** KShH vlerëson se neni 35, pika 13 i ligjit nr.115/2016 mund të rishikohet nga Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi në kuadër të situatës së krijuar me s’kualifikimin e një kandidati nga shoqëria civile që garonte për anëtar në KLGJ, pasi nënkomisioni parlamentar *ad hoc* ka vepruar në kushtet e një vakumi ligjor, duke mos pasur atribut të shprehur në ligj për të përjashtuar nga gara, kandidatët e kualifikuar nga Sekretari i Përgjithshëm të cilët më vonë vërtetohen se janë në kushte pazgjdhshmërie.

**6.** KShH i sugjeron mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve dhe mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve, të unifikojnë për aq sa është e mundur draftet e rregulloreve që bëjnë të mundur detajimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve magjistratë në të dy këshillat.

**7.** KShH vëren se për të mundësuar një nivel më të lartë konkurrueshmërie në radhët e kandidatëve për anëtar të KLGJ dhe KLP që përfaqësojnë trupën pedagogjike në Fakultetet e Drejtësisë dhe Shkollën e Magjistraturës, është e nevojshme të rishikohen nga Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi në të ardhmen, dispozitat përkatëse të ligjit nr.115/2016 që parashikojnë kuotat dhe formulën e përzgjedhjes së këtyre kandidatëve.

**8.** Ligji nr.115/2016 mund të ishte më i qartë në drejtim të çështjeve që kanë të bëjnë me trajtimin financiar të anëtarëve të komisionit Ad Hoc, vakancave që u krijuan për funksionimin e Komisionit Ad Hoc për kandidatët e Avokatisë, sikurse ishin paqartësitë e krijuara nga mungesa e kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, se kush do ta zëvendësonte atë. Rrjedhimisht i rekomandojmë Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të rishikojnë dispozitat përkatëse, me qëllim plotësimin dhe qartësimin e tyre.

**9.** KShH i sugjeron të gjitha organeve dhe strukturave të ngarkuara me përgjegjësi për marrjen në shqyrtim, verifikimin, vlerësimin dhe miratimin e kandidatëve për anëtar në të dy Këshillat (KLGJ dhe KLP) të kenë në konsideratë, për aq sa është e mundur dhe pa shkelur kriteret ligjore, vendosjen e një balance proporcionale të elementit gjinor për anëtarët e zgjedhur. Sikurse vërehet në përbërjen e Këshillave të ngritur, KLGJ ka një raport të drejtë të përfaqësimit të meshkujve dhe femrave në radhët e anëtarëve të saj, ndërkohë që KLP ka vetëm një anëtare femër dhe dhjetë prej tyre janë meshkuj.

**10.** KShH i sugjeron KLP-së dhe KLGJ-së të vijojë menjëherë në punën e tij dhe të ushtrojë në mënyrë të shpejtë dhe efikase të gjitha kompetencat e rëndësishme që ligji i cakton dhe në veçanti në lidhje me procesin e përzgjedhjes së Prokurorit të ri të Përgjithshëm, anëtarëve të Prokurorisë dhe Gjykatës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ri-organizimin e gjykatave, etj.

**11.** KShH i sugjeron KLP-së dhe KLGJ-së që të hartojnë një kalendar me prioritete në punën e tyre, duke pasur në vëmendje të veçantë zgjidhjen e atyre problematikave që kanë krijuar ngërçe në funksionimin e sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë, duke ndikuar në vonesa të tej zgjatura të proceseve ndaj qytetarëve.

**12.** Për të bërë një vlerësim më të drejtë të veprimtarisë së Këshillave, KShH i sugjeron KLP-së dhe KLGJ-së që të vendosin në dispozicion të personave në radhët e publikut që janë të pranishëm në sallë, kopje të relacioneve shpjeguese dhe projekt-vendimeve të përpiluara nga komisionet e përhershme. Publikimi i tyre në internet paraprakisht, para seancës plenare do të shërbente gjithashtu një transparence më të mirë karshi publikut për një vlerësim më të drejtë dhe objektiv të punës së Këshillave.

**13.** Për të rritur besimin e publikut në veprimtarinë e dy Këshillave (KLGJ dhe KLP), sugjerojmë që gjatë procesit të emërimeve apo ngritjes në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshi këtu edhe kandidimet në Prokurorinë dhe Gjykatën e posaçme, Këshillat të publikojnë në faqet e tyre zyrtare CV-të e kandidatëve në një rubrikë të veçantë dedikuar profilit të tyre.

**14.** I sugjerojmë anëtarëve të të dy Këshillave (KLGJ dhe KLP) që për vendimmarrjet për të cilat ka mendime kundër (pakicë), ato të arsyetohen dhe ky mendim pakice ti bashkëlidhet vendimit duke e publikuar në faqet zyrtare të Këshillave.

**15.** KShH i sugjeron të dy Këshillave (KLGJ dhe KLP) të mundësojnë jo vetëm pjesëmarrjen e medias në mbledhjet plenare por njëkohësisht të lejojnë median të kryejë regjistrime audio-vizuale. Për këtë, të dy Këshillat mund të akreditojnë përfaqësuesit e medias që autorizohen për këto regjistrime. Zbatimi i këtij rekomandimi do të mundësonte një shkallë më të mirë të transparencës së Këshillave dhe respektimit të lirisë së medias për të marrë dhe për të dhënë informacion ndaj publikut.

**16.** KShH i sugjeron të dy Këshillave (KLGJ dhe KLP) që me anë të një rubrike të veçantë në faqet e tyre zyrtare të mundësojnë një transparencë sa më të plotë ndaj medias dhe publikut për mbledhjet dhe veprimtarinë e Komisioneve të përhershme të tyre por gjithashtu edhe për komisionet ad-hoc.

**17.** KShH i rekomandon Këshillit të Lartë të Prokurorisë të zbatojë legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, pasi disa kërkesave zyrtare të KShH-së për informacion, ky organ nuk i ka kthyer përgjigje (shkresat zyrtare të KShH-së të dt. 12.03.2019, 19.03.2019, etj.).

**18.** KShH i rekomandon KLP-së<sup>363</sup> që në zbatim të parashikimit ligjor të reflektuar në nenin 167, pika 3 të ligjit nr. 115/2016 të publikojë përmbledhjet e procesverbaleve të mbledhjeve plenare.

**19.** KShH i rekomandon KLGJ-së që në zbatim të nenit 69 pika 2 të Ligjit nr. 115/2016 të publikojë regjistrimin audio të mbledhjeve plenare.

**20.** KShH i sugjeron Kuvendit të Shqipërisë që me dialog konstruktiv të shqyrtojë me kujdes dhe të miratojë vakumin ligjor të krijuar si rezultat i vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese në disa prej dispozitave të ligjit nr.96/2016 dhe të ligjit nr.115/2016. Kjo do të mundësonte një funksionim normal të të dy Këshillave (KLGJ dhe KLP), konform parimit të ligjshmërisë si dhe do të bënte efektive vendimmarrjen e këtyre Këshillave për procese të rëndësishme të lidhura me statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe ngritjen e prokurorisë dhe gjykatës së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

**21.** I rekomandojmë Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të prokurorisë që në kuadër të kompetencave që kanë sipas nenit 221 të ligjit nr.115/2016 të bëjnë publike në faqet e tyre të internetit, listat me kandidatët që i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të KED-së 2020 si dhe listat me kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet. Gjithashtu, në kuadër të transparencës për publikun, KShH sugjeron që në faqet zyrtare të publikohet edhe procedura e ndjekur për të verifikuar kushtet ligjore të kandidatëve për anëtarë të KED-së 2020.

**22.** Në funksion të parimit të transparencës, KShH i sugjeron Gjykatës Kushtetuese, KLGJ-së dhe KLP-së që bazuar në nenin 221, pika 5 të ligjit nr.115/2016, të publikojnë informacion në faqet e tyre zyrtare nëse është realizuar njoftimi individual me shkrim për kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriteret ligjore për të qenë anëtarë të KED-së 2020.

**23.** Në funksion të parimit të transparencës, i sugjerojmë Presidentit dhe/ose Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (të ngarkuar me detyrën e hedhjes së shortit për KED-në 2020) që të vendosin paraprakisht në dispozicion të vëzhguesve dosjet e plota dhe listën e kandidatëve për anëtar KED-je 2020. Gjithashtu, u sugjerohet këtyre institucioneve që të publikojnë në faqet e tyre zyrtare të dhënat për anëtarët e Sekretariatit Teknik që do të organizojë hedhjen e shortit.

**24.** KShH i rekomandon Gjykatës Kushtetuese, KLGJ-së dhe KLP-së që në krijimin e listave për KED-në 2020 dhe KED-të e viteve të mëpasshme, të zbatojnë në mënyrë rigoroze dhe të njëtrajtshme dispozitat kushtetuese dhe ligjore që parashikojnë kriteret për përfshirjen ose jo të tyre në listat përkatëse.

**25.** KShH i sugjeron Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të RSH që të rishikojë dispozitat e ligjit nr.115/2016 mbi saktësimin e rrethanave të papajtueshmërisë për ushtrimin njëkohësisht të funksionit të anëtarit të KLGJ-së ose KLP-së, me funksionin si anëtar të KED-së. Anëtari i zgjedhur nga radhët e magistratëve në KLP apo KLGJ nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i KED-së pasi statusi i tij/saj si magistrat është pezulluar deri në përfundim të mandatit si anëtar i KLGJ-së apo KLP-së.

**26.** Duke pasur parasysh se Kushtetuta dhe ligji nr.115/2016 kanë vakum lidhur me mbarimin e mandatit të anëtarit të KED-së para kohe, nëse vërtetohen kushtet e pa zgjedhshmërisë në ushtrimin e funksionit apo për rrethana të tjera sikurse parashikohet për KLGJ-në dhe KLP-në, si dhe nuk është parashikuar organi që do të deklarojë me vendim mbarimin e mandatit të KED-së, KShH i sugjeron Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit plotësimin e këtij vakumi ligjor duke bërë plotësimet përkatëse.

**27.** KShH i sugjeron Kuvendit rishikimin e dispozitave të ligjit nr.115/2016 (nenit 233/1 të këtij ligji), me qëllim që të garantohet aksesin e vëzhguesve të pavarur në ndjekjen dhe monitorimin e

<sup>363</sup> <http://klp.al/>

mbledhjeve të KED-së, çka do të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së këtij organi të rëndësishëm të qeverisjes së drejtësisë.

**28.** KShH i sugjeron Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit që në bashkërendim me Komisionin e Pavarur të Monitorimit dhe Koordinimit (KPMK) të garantojë publikimin e rregullt të raporteve të KMPK-së apo aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së këtij organi që mundësojnë një transparencë sa më të mirë ndaj medias dhe publikut.

**29.** KShH i sugjeron KPMK-së që me objektivitet, profesionalizëm dhe paanshmëri të reflektojë në raportet periodike të tij, të gjitha problematikat e identifikuara nga monitorimi dhe mbikëqyrja e organeve të qeverisjes së drejtësisë, si dhe të adresojë rekomandime që i shërbejnë zbatimit rigoroz të legjislacionit prej tyre.

**30.** KShH i sugjeron KED-së 2019 që të publikojë në kohë dhe pa vonesë në faqen e Gjykatës së Lartë, të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të realizuara nga ky Këshill.

**31.** KShH i sugjeron KED-së t'i kushtojë vëmendje hap pas hapi transparencës në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, procesit të verifikimit të kritereve ligjore dhe renditjes së kandidatëve për ILD. E themi këtë, për arsye se mbledhjet e KED-së sipas ligjit janë të mbyllura, ndërkohë që është shumë i rëndësishëm besimi i publikut që në fazën e krijimit të organeve të reja të drejtësisë. Një qasje transparente mundëson gjithashtu edhe një hapje ndaj komenteve apo sugjerimeve konstruktive të organizatave të shoqërisë civile që e monitorojnë procesin.